

JERONIM
DE RADA

891383

Δ 40



vepra letrare 1

Përgatitur nga


**Prof: JUP KASTRATI,
kand. e shk. KLARA KODRA,
PERIKLI JORGONI**

Redaktor

PERIKLI JORGONI



JERONIM DE RADA



KRIJIMTARIA E JERONIM DE RADËS

Shqipëria – siç kanë shkruar studiues arbëreshë – përpara se të bëhej një entitet politik i pavarur, qe një realitet poetik në veprën e Jeronim de Radës. Ky arbëresh i madh, i frymëzuar nga historia e lavdishme e popullit tonë, iu përvesh me vetëmohim një ndërmarjeje të lartë dhe fisnike: zgjimit dhe përforcimit të ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve, që vuanin në atdheun e të parëve, prej katër shekujsh, nën zgjedhën e rëndë të osmanëve. Vepra e tij, e shikuar në tërësinë e vet dhe në perspektivën historike që ndryn në vetvete, mund të quhet, me plot gojën, heroike. Merita e parë e De Radës qëndron në faktin se, në gji të arbëreshëve që kishin mërguar në Itali qysh në shekullin XV, krijoi, në qindvjetin XIX, një poezi kombëtare artistike.

Kjo poezi, me përshkrimin e bëmave të rralla heroike të Skënderbeut dhe të trimave të tij kundër pushtuesit turk, u bë e aftë, jo vetëm për të zgjuar në zemrat e bashkatdhetarëve të vet krenarinë e emrit dhe të gjakut shqiptar, por, njëkohësisht, ajo shërbeu, përmes admirimit ndaj kësaj kënge të vetvetishme, për të zgjuar edhe interesimin e opinionit publik të Evropës së atëhershme për çështjen e një kombësie shqiptare, qënien e së cilës disa shtete e mohonin ose e harronin me vetëdashje. Për shtatëdhjetë vjet me radhë, që nga viti 1832 e derisa vdiq, më 1903, De Rada botoi me

dhjetëra vepra të ndryshme, në shqip dhe në italisht, me karakter letrar, folklorik, gjuhësor, historik, etnografik, estetik, filozofik, publicistik, politik, shoqëror dhe shkollor. Për nevoja të zgjimit kombëtar, ai u bë historian dhe gazetar, folklorist dhe gjuhëtar, eseist dhe dramaturg. Por, mbi të gjitha, De Rada qe dhe mbetet poet.

De Rada filloi të hartojë që në moshën 15-vjeçare. Më 21 qershor 1829, në një letër që i drejtonte të vëllait, Kostandinit, ai shkroi një tingëllim italisht. Ka të ngjarë të jetë krijimi i parë i poetit në lëmin e poezisë që kur ishte nxënës. Në të shkrepëtijnë shkënjat e personalitetit të ardhshëm. Tema është misioni udhëheqës që i vë vetes poeti. Nxjerr krye shqetësimi i tij për atdheun e të parëve. Zbulohen synimet që kishte ai në lëmin e poezisë. Qysh në këtë moshë të re, ai e vështron me ngulm e me seriozitet rrugën e artit të vet. Soneti ka njëfarë rrjedhshmërie e muzikaliteti, që dëshmojnë për përdorim të sigurt të mjeteve shprehëse.

Në moshën 18-vjeçare, më 1832, De Rada iu vu punës për hartimin e poemës «Odiseu», me katër këngë, me temë shqiptare. Poeti fliste për odisenë e arbëreshëve të Italisë, të cilët, që prej vitesh, me mall po prisnin agimin e lirisë, për t'u kthyer në gjirin e Itakës shqiptare, në prehrin e atdheut të vërtetë. Po jeta e tyre endacake nëpër vise të huaja, rragimet e tyre nëpër vende të panjohura, s'po kishin të sosur. Të braktisur dhe pa cak, në mes vështirësish të panjohura, ata po kalonin me të vërtetë odisenë e jetës plot brennga. Poema doli si përfundim i leximit të Bajronit. De Rada, pra, që në fillim u nis si romantik përparimtar,

Në Autobiografinë e vet na tregon se, përsa i përket formës së kësaj poeme të vogël, ai «u frymëzua nga Dantja dhe nga «Basviljana» e Montit».

Poemën «Odiseu» e botoi në Napoli më 1847, nën emrin e Françesko Saverio de' Markezi Prato. Poema ka katër këngë në strofa treshe danteske. Ka, gjithashtu, pesë distikë si edhe njëmbëdhjetë strofa katërshe anakreontike. Gjithsej 1370 vargje 11-rrokëshe italiane, një parathënie, në të cilën autori na tregon gjenezën e lindjes së poemës. «Duke lexuar «Historinë e Republikës Italiane» të Sismondit» e «preku thellë lufta heroike që përballoi Shqipëria në shekullin XV kundër turqve». Po në shpirtin e poetit ndikuan edhe ide të tjera, të cilat i «dhanë mendimin e formën veprës rinore, djaloshare që nxori në dritë». Pak vjet më parë, në atë moshë kur mbresat janë më të gjalla, ai kishte përshkuar një pjesë të madhe të Kalabrisë dhe aty kishte parë ngulimet arbëreshe. Veshja piktoreske kombëtare e vajzave dhe e grave shqiptare, gjuha shqipe aq e ngjeshur me tinguj harmoniozë, liria që ndihej aty, në familjet arbëreshe, si një frymë fisnikërie, e përhapur ndër të gjithë, e kishin pushtuar imagjinatën e De Radës së ri. Ndër bashkatdhetarët e vet arbëreshë, në radhë të parë, ai kishte gjetur një jetesë të gëzueshme, të rreptë e plot besim, siç është ndër popujt me mençuri tradicionale. Aty kishte gjetur bujq punëtorë dhe njerëz të guximshëm. Ndër katundet e atyre ngulimeve kishte njohur nëna shqiptare me gjak të kulluar, siç mburren ato vetë, me mjeshtëri artizanale të bukura. Shumë të hijshme ishin vashat, bija bujarësh. Ato ruanin zakonin e lashtë që të mos shiheshin prej të huajsh. Poeti i tyre kombëtar, De Rada, u kishte kënduar me

këto vargje: «Dielli, përmes degëve të pemëve që i bëjnë hije qytetit, vezullon e depërton mbi tezgjahe, dhe i njuh virgjëreshat që i fshihen gjithë botës». Duke kujtuar, pra, këto gjëra, De Rada po e pyeste veten: «Si mund të ketë ndodhur që të ketë lulëzuar sërishmi një jetë e tillë ndër mbeturinat e njerëzve të shpërngulur të një kombi të fortë që ra në mënyrën më të mjerueshme?». Dhe poetit iu duk se burimi i gjithë kësaj jete duhet të ishte ajo pastërti e kthjellët dhe e sigurt e ndjenjave familjare e qytetare, të mbështetura në ligjet e shenjta të trashëguara nga eërit, nga të parët e tyre. Këto ndjenja të holla e të larta, të pacënuara në thjeshtësinë e tyre, mundën të shoqërojnë plagët e një populli fisnik .«Nga ky mendim, – deklaroi vetë De Rada, – lindi tema, që u bë bazë për poemën time».

Përtej caqeve letrare, poema heroike po edhe tragjike është një dokument i gjallë i etnografisë arbëreshe. Në të ka përshkrime dokesh e zokonesh të ndryshme shqiptare me vlerë për studiuesin e sotëm të kësaj fushe të dijes. Poema shquhet për imagjinatë të fuqishme. Në krye të çdo kënge, hartuesi ka vendosur një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes apo të argumentit që do të shtjellojë. Patriotizmi është karakteristika kryesore e poemës. Fati i keq i atdheut-mëmë, Shqipërisë, është preokupimi themelor i poetit. De Rada vë në dukje me art vitalitetin e popullit shqiptar, vetëmohimin e tij, trimërinë, heroizmin, guximin, burrërinë dhe flijën e tij, Personazhet e poemës janë: Odiseu (djalos i ri, i mërguar nga Shqipëria), Daidha (e ëma, nga ato nënat shqiptare fisnike e dinjitoze), Perlati (bujar shqiptar), Eloda (e bija, vashë plot hire), Aleks (shok e mik i Odiseut), Astiri dhe Avieta. Personazhet janë përshkruar

me ngjyra të holla, të gjalla dhe plot ngrohtësi. Ngjarjet e poemës zhvillohen në Krujë, te lumi i Kratit (afër fshatit të Shën Sofisë) dhe në katundin Specano; pra në atdheun e të parëve, në Shqipëri, dhe në ngulimet arbëreshe të Kalabrisë. Mikpritja shqiptare në kështjellën e dukës së vjetër dhe kulla e Perlatit janë një copë Shqipërie në një tokë të huaj. Martesa e dy të rinjve (Odiseu-Eloda), episodi i Astirit dhe i Avietës, themelimi i ngulimit arbëresh – janë himne admirimi të poetit ndaj mëmëdheut dhe ndaj dashurisë. Poema epiko-lirike «Odiseu» pasqyron çështjen e shqiptarëve të mërguar pas vdekjes së Skënderbeut.

Ndër shënimet e pasura me karakter mitologjik, legjendar, etnografik, social dhe folklorik; De Rada na flet edhe për doke e zakone të lashta të arbëreshëve të Italisë. Ai boton edhe baladën e njohur të Pal Golemit. «Pal Golemi, — shkruan poeti ynë, — qe një hero i famshëm shqiptar, ndër këngët popullore të kombit të tij». Poema «Odiseu» është një himn i vërtetë kushtuar Shqipërisë, popullit shqiptar, gjuhës shqipe, këngëve popullore, cilësive të mira të bashkatdhetarëve arbëreshë. Figura e Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut, dhe Kruja, kryeqyteti i Shqipërisë në kohën e mesjetës, u bëjnë thirrje shqiptarëve për bashkim, për luftë të armatosur për t'u çliruar nga pushtuesi i huaj turk. Poema «Odiseu» përveç ndikimit pozitiv nga Dantja, Monti e Bajroni, ka diçka edhe nga Virgjili.

Poeti, në një autograf të tij, na tregon se, kur ishte nxënës në shkollë të mesme, hartoi dy poema të vogla italisht. Njëra nga këto duhet të jetë poema «Krutani i mërguar», që, si krijim, u takon viteve 1832-1833. Për këtë vepër të rinisë së parë kemi dy burime auten-

tike nga vetë hartuesi. Më 20 tetor 1834, në parathënie e «Këngëve të Milosaut», ndër të tjera, De Rada shkruan edhe këto: «Në korrik të 1833-ës, me kokën plot me (numra) matematike e me shpresa dola nga kolegji. Toka më buzëqeshte ngado që unë e shikoja: derdhja, në këngën e dytë të «Krutanit të mërguar» me vargjet që ndjekin, ndjenjat me të cilat më mbushte atdheu im». Dhe, po aty, riprodhon në italisht 22 vargje. Nga ana tjetër, në poemën «Odiseu» (1847), në faqen 43, De Rada përmend vetë «një poemth të rinisë së tij, «Krutani i mërguar», plot me burime frymëzimesh kombëtare». Po te poema «Odiseu» (1847), De Rada ka botuar 158 vargje nga dorëshkrimi i poemës së rinisë së tij «Krutani i mërguar». Pra njohim, gjithsej, 180 vargje nga kjo vepër që mbeti e pabotuar për gjallje të poetit.

Te libri «Krutani i mërguar»¹⁾ botimi ynë, Tiranë, 1977, ka gjetur mishërim aspirata kombëtare. Në këtë vepër hartuesi ka parashtruar disa koncepte e pikëpamje shoqërore e politike, që do të ndiqen më vonë prej tij në tërë veprimtarinë e gjerë atdhetare, publicistike e letrare, duke marrë gjithnjë e më tepër trajta më të përcaktuara, më të qarta e më të plota. Në poemë bëhet fjalë për tragjedinë shqiptare të shekullit XV, për «rënien e mbretërisë së Shqipërisë», pas vdekjes së Skënderbeut. Ky është fakti themelor historik që përbën tabanin e veprës. Mbi të poeti është përpjekur të lihtë të kaluarën e madhërisme me gjendjen tragjike, dhembjen për vendin e pushtuar me brought e me vuajtjet e

1) Më 1977 u botua poema «Krutani i mërguar». Kjo vepër, e shqipëruar nga dorëshkrimi italisht që mban datën 1841, ruhet në origjinal dhe dorëshkrimi është pa titull, për arsye se mungon mbulesa.

mërgimit, etjen për lumturi personale me dëshirën për t'i flijuar në emër të lirisë së atdheut, disfatën me brerjen e ndërjegjes për detyrën e pakryer. Poema shqyrton, deri diku, edhe jetën e të mërguarve arbëreshë me shpresën e çlirimit të atdheut.

Ndërkohë, në vitet 1834-1836, De Rada botoi edhe gjashtë krijime poetike dhe proza ritmike: 1) Për vdekjen e Françesko Panes (sonet), 2) Vallja (ode), 3) Ode shqiptare, 4) E vërteta (poezi), 5) Këngë për vdekjen e Skënderbeut, 6) Aria e vashës së Ambrakisë, fejuar me një fisnik të huaj. Për herë të parë, në krijimtarinë e De Radës, shfaqet figura e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriotit. Më vonë, për të do të shkruajë një epopë. Del edhe Serafina, për të cilën do të hartojë një poemë. Këto krijime poetike, botuar te gazeta letrare «*Omnibus*» e arbëreshit Vinçenc Toreli, që shtypej në Napoli, paraqesin interes për brendinë e tyre ideore, sepse japin një pasqyrë, pak a shumë të qartë, të konceptimit të jetës nga ana e De Radës. Që në këto tingëllime dhe proza poetike ndihet stoicizmi, koncepti burrëror për jetën, bukuria e së cilës për poetin qëndron në forcën morale, e cila mposht edhe dhimbjen, edhe vdekjen. Këto krijime i përkasin fazës së parë të krijimtarisë së De Radës.

Në gusht të vitit 1836, De Rada botoi në Napoli vëllimin «*Poezi shqipe të shekullit XV. Këngë të Milosaut, bir i sundimtarit të Shkodrës. Megjithëse i ri, 22-vjeçar, misionin e tij prej poeti në zhvillimin dhe përpunimin e gjuhës dhe të letërsisë shqiptare dhe platformën e vet në dobi të kulturës kombëtare, ai e ka përcaktuar mirë në epigrafin-citat të nxjerrë nga «*Odet*» e Pindarit dhe të vënë në krye të këtyre këngëve: «*Muza,**

pra, më ndihmon mua që, një varg të ri e të shndritshëm, ia përshtat ritmit dorian». Citati sintetizon edhe disa nga tiparet e vetë poetit dhe të poezisë së tij. Për gjuhën dhe poezinë shqipe De Rada do të bëjë atë që bëri Pindari për gjuhën dhe poezinë e vendit të tij. Ky është, me sa duket, kuptimi i të zgjedhurit si epigraf i këtyre vargjeve. Mbi tabanin e lashtë pelazgjik (shqiptar), i mbështetur në poezinë popullore dhe i frymëzuar nga jeta, poeti do të këndojë këngën e tij të re. Në kushtim të librit, De Rada theksonte se këto këngë do të jenë dëshmi të lidhjeve shpirtërore me zakonet e lashta ndër njerëzit e shpërndarë të Shqipërisë dhe ndër arbëreshët e Italisë, kudo që të ishin këta. Pra, De Rada, që i ri, çlirimin e atdheut të të parëve të vet e shikon në bashkimin luftarak të të gjithë shqiptarëve, si të atyre brenda mëmëdheut, ashtu edhe të atyre të shpërndarë në viset e tjera të botës, në radhë të parë të arbëreshëve të Italisë, të cilët kurrë nuk duhet ta harrojnë Shqipërinë, dhe për të nuk duhet të kursejnë asgjë, madje as jetën e tyre. Parathënia e poemës është shkruar në Maqë, më 20 tetor 1834. Kjo është një e dhënë me vlerë, që dëshmon se «Milosau», ndoshta, mund të ketë qenë gati për shtyp dy vjet përpara botimit. Pjekurinë prej apostulli të shqiptarizmit de Rada i ri e kishte arritur që në bankat e shkollës së mesme, nën ndikimin e një plejade të tërë arbëreshësh iluministë, ku bënte pjesë edhe i ati e shumë pedagogë të tjerë të tij. Por nga ky i ri edhe masat fshatare prisnin shumë. Nga kjo anë, është plot kuptim një pasazh i hyrjes së poemës, kush-tuar shokut të tij shumë të ngushtë në shkollën e mesme. Pasazhi paraqet atmosferën që u krijua te fshatarët arbëreshë, në çastin kur këtë të ri e përcillnin për

studime të larta. «Kudo që kaloja, uronin që nisja ime për në Napoli t'i sillte dobi vendit». Kështu, i frymëzuar nga kjo dashuri e madhe për atdheun e për lirinë shkroi i riu De Rada, duke derdhur në këngët e tij «shumë ëmbëlsi e mallëngjim dhe, mbi të gjitha, të vërtetën», ku poetizoi ngjarje të jetuara, të ndiera thellë, me pikësynimin që të mos imitonte asnjë nga poetët që kishte lexuar e studiuar. Pra, edhe poema «Milosau» nuk është cilësuar thjesht si një ditar «roman dyfish lirik», por edhe si një jehonë poetike e betejave që zhvilloheshin në Shkodër e në rrethe kundër hordhivave osmane në vitet 1833-1835. Bashkë me lavdinë e «Mottit të madh» të kohës së Skënderbeut, në epiqendër të frymëzimit të poetit tonë janë edhe lavditë e shqiptarëve bashkëkohës të këndejetit.

De Rada e filloi veprimtarinë e vet botuese në shqip me një vepër madhore, me poemën «Këngë të Milosaut». Vepra ka një rëndësi të madhe historike për letërsinë shqipe, sepse me të fillon letërsia artistike, laike, demokratike dhe kombëtare shqipe, Milosau vdiq në luftë me armë në dorë për nderin e Shqipërisë. Edhe De Rada vdiq në një luftë të gjatë kulturore e politike në të mirë të popullit të vet. Te poeti ynë i madh arbëresh kemi një romantizëm aktiv, sepse heroi i tij nuk mbytet, nuk vret veten, sikurse heronjtë e romaneve të zakonshme sentimentale dhe romantike të sëmura. Milosau vdes, vërtet, por vdes si burrë dhe për një çështje të madhe e të bukur. Në mbarë romanin lirik vlon zemra e poetit për vendin e pushtuar nga turqit dhe nga venedikasit. Dhe heroi bie në këtë luftë. De Rada, i pari në historinë e letërsisë shqiptare, lëshoi kushtrimin e atdhetarit të vërtetë për fatin e vendlindjes.

«Milosau» është një poemë, veprimi tregimtar i së cilës zhvillohet brenda një periudhe prej nëntëmbëdhjetë vjetësh. Ngjarjet fillojnë më 7 qershor 1405 dhe mbarojnë më 7 maj 1423, marrë me mend në Shkodër, në të vërtetë në Maqë, vendlindja e poetit. Ajo që e dallon veprën, është, kryesisht, karakteri atdhetar. Në poemë fiton dashuria e atdheut ndaj asaj të vajzës. Rikrijohet një periudhë e lavdishme e së kaluarës heroike të popullit shqiptar, shekulli XV, kur vendi ynë ishte i lirë. Me fjalët e heroit kryesor të veprës, poeti, tërthorazi, duket sikur i fton bashkatdhetarët për të luftuar kundër pushtuesit osman. Poeti vajton lirinë e humbur dhe madhështinë e perëndimit të Shqipërisë së lirë. Milosau bie në sheshin e betejës kundër armikut të vendit. Për të parën herë, në historinë e letërsisë artistike shqiptare, paraqiten guximi dhe trimëria e popullit shqiptar në një vepër letrare artistike. Milosau, përshkruar aq fuqishëm nga pena deradiane, bie theror për mbrojtjen e atdheut. Ai i ngrys ditët e veta si burrat e zakonshëm, si dëshmorët e popullit tonë trim. Shuhet pranë liqenit të Shkodrës, te lumi i Obotit. Në këtë poemë, De Rada shpreh nostalgjinë dhe dashurinë për atdheun e etërve të tij. Ai shfaq mendimet dhe ëndërrimet e veta për çlirimin e vendlindjes. Ndjenja për atdhe e poetit bie në sy në mjaft vise të poemës. Në qoftë se poema i doli poetit nga zemra, hartimi a kompozimi, përtfimi dhe trajta e saj iu frymëzuan nga këngët popullore arbëreshe, të cilat ai kishte nisur t'i mblidhte me kohë. Poema është shprehja e natyrës, kurdoherë e freskët dhe e re, që kundërmon parfumet e tokës, të ajrit të pastër, të bukurisë së qiellit të kulluar, të detit të gjerë, të njelmët, të kaltër, që lëviz në djepin e lirë të valëve; është piktura e jetës

shqiptare me zakonet e moçme dhe të paprishura, me krenarinë legjitime të prejardhjes së tyre të lashtë, me thjeshtësinë naive të stërgjyshërve, me doket e tyre të patundura. Natyra është përshkruar me shprehje skalitëse e të forta, e freskët, e fuqishme, shumë e kulluar, me konture të thjeshta, të shkurtra, të sakta si prej një dalte të sigurt, që vijëzon tipare të përsosura. Shprehjet e saj, që u duken të gjithëve të rëndomta, sepse janë të zakonshme dhe të dukshme për të gjithë, ndehen si mbi një pëlhurë me ngjyra të gjalla po të përkorta, na godasin me një habi të ëmbël dhe të çuditshme. Dashuria është njerëzore, e dalë nga pejzat më të thella dhe nga venat më të fshehta, po e mbuluar me një pastërti të hollë e delikate. Përmbushja e dëshirave të Milosaut këndohet në një idil të mrekullueshëm, që shquhet për freski, për hov lirik dhe për gjendje psikologjike të çastit të lumturisë.

Me poemën «Këngë të Milosaut» De Rada u imponua si poet me cilësi të larta, duke fituar admirimin e botës letrare shqiptare dhe të huaj. Vepra shquhet për origjinalitet, për sensibilitet të hollë, për frymëzim e spontaneitet, për shprehje figurash e mendimesh, për paraqitje e përshkrim ndjenjash të fshehta e të thella të shpirtit njerëzor, për thjeshtësi, freski e naivitet, për ëmbëlsi dhe kumbim të vargut, për atë fllad të lehtë virgjiniteti e dëlirësie që fryn në të gjitha kangjeljet e De Radës. Poeti kishte një kuptim të lartë për artin poetik. Për të poezia ishte krijim, ndjenjë, frymëzim. Ajo nuk ka retorikë e artificialitet. Poemën e dallojnë sfumaturat dhe nuancat e holla, fluiditeti, epitetet metaforike aq të bukura dhe të qëlluara, figurat artistike aq të pasura, intuita artistike e krijuesit, lirizmi delikat, stili kon-

çiz, poezia ritmike, pastërtia dhe sinqeriteti, fjala e kursyer dhe e matur. Një nga meritat kryesore të De Radës është fakti që ai e ngriti të folmen e katundit të tij. Maqë, në lartësinë e një gjuhe, letrare. Në poemë fjala anon nga shkurtësia e nga shprehja eksklamative. Trajta e saj është, zakonisht, eliptike, me zhdukjen e shpeshtë të foljes «jam». Poezia aty është e dendur, e rrastë, e thuktë dhe e paraqitur në një vëllim sa më të vogël.

Poema u përshëndet me entuziazëm, që në dalje të saj, dhe vazhdon të vlerësohet pozitivisht, edhe sot e kësaj dite, nga një varg shkrimtarësh, dijetarësh, gjuhëtarësh dhe kritikësh letrarë. Njerëz të përmendur kanë dhënë për këtë poemë gjykimin e tyre, i cili, shkurt, është një himn admirimi. «Milosau» u shqua, menjëherë, në horizontin e letërsisë shqiptare, si një flamur që po ngrihej. Poema u çua si një monument vigan në fushën e poezisë artistike shqipe. Shpejt u bë e njohur në Evropë. «Kush dëshiron të shohë plotësimin e poezisë romantike moderne, të lexojë «Këngët e Milosaut» të zotëri Jeronim de Radës». Kështu e lavdëronte poetin tonë arbëresh shkrimtari i madh i letërsisë frënge, Viktor Hygoi. Poeti dhe dijetari i përmendur francez, Lamartini, shkruante «Poezia ka ardhur nga brigjet tuaja dhe atje duhet të kthehet përsëri. Uroj lirinë dhe ringjalljen e Shqipërisë». Frederik Mistrali, Homeri i Provansës, i drejtohej De Radës me këtë gjykim: «Krijimet tuaja janë plot magjepsje, freski dhe paqë evangjelike. Ç'tablo fort e bukur! Ajo ka parfumin e idileve biblike dhe esencën (nëktarin) e gjuhës virgjëreshë. Ju uroj, zotëri, që ua keni kushtuar muzën tuaj, dashurinë tuaj dhe qenien tuaj kulteve të gjuhës suaj nënë për lavdinë e vendit tuaj dhe të popullit tuaj. Nëse gjuhët e mëdha zyrtare u

jamin më shumë lexues shkrimtarëve të tyre, gjuhët natyrale nxjerrin në shesh fshehtësinë e poezisë së vërtetë. Të jeni, pra, i lumtur që u zgjodhët për të hartuar psalmet e Shqipërisë suaj të dashur.»


Një varg studiuesish arbëreshë zbuluan vlera të shumta artistike në këtë poemë. Françesk Krispi e quajti «Milosaun» «paraqitje origjinale e një dashurie të pastër, të thjeshtë dhe të vërtetë». Për Vinçenc Dorsën «Këngët e Milosaut» janë portreti i rinisë së poetit dhe përhapin atë frymë naive dhe sentimentale që është tamam e jetës shtëpiake dhe të ngushtë në fshatrat e vegjël». Vinçenc Toreli nënvizonte: që De Rada «u kujton ato mënyra të çuditshme të poezisë lindore, të shartuara me një kujtim të përjetshëm dhe të natyrshëm hidhërimi dhe dashurie». Deradiani i mirënjohur Mikel Markiano shënonte se «Milosau» ka fuqinë dhe madhështinë e poezisë së Safos. Imazhet apo përfytyrimet janë nga më të zgjedhurat, me të cilat mund të mburret çdo letërsi. Te kjo poemë, poeti, duke ndjekur nxitjen e zemrës së tij, u frymëzua vetëm prej zemrës dhe e çliroi mendjen e tij nga teprimet që mbushën veprat e tjera poetike». Të tjerë studiues e krahasuan «Milosaun» me këngëtorët e Petrarkës, me idilet e Teokritit dhe të Gesnerit dhe me «Hermandin e Dorotenë» e Gëtes.

Fakti që «Milosau» u çmua kaq lart nga këta njerëz të përmendur në fushën e artit dhe të kulturës, është kuptimplotë. Ata ditën të zbulojnë veçoritë apo tiparet themelore, që e bëjnë veprën një krijim të dorës së parë, sidomos në letërsinë tonë. Bukuria e tablove, gjallëria dhe origjinaliteti i figurave, ngrohtësia e ndjenjave, përshkrimet e goditura të natyrës, mjeshtëria artistike në portretizimin e personazheve si edhe në pa-

raqtjen e peizazhit, mbështetja në folklorin arbëresh, fryma popullore dhe demokratike, ngjyra kombëtare dhe humanizmi i thellë – të gjitha këto dhe të tjera tër-hoqën dhe tërheqin, edhe sot e kësaj dite, vërejtjen e lexuesve dhe të studiuesve të shquar. Me „Milosaun” kemi kryeveprën e parë të letërsisë artistike shqiptare. Me këtë vepër, De Rada i tregonte mbarë botës, se ndërgjegja kombëtare e popullit tonë kishte nisë të zgjohej.

Të gjithë ata që janë marrë me De Radën, kanë nënvizuar takimin e tij vendimtar me poezinë popullore të arbëreshëve të Italisë. Dhe, në të vërtetë, prej andej, siç është thënë, lind përkushtimi i tij si poet shqiptar. Dhe shumë prej poezive të tij populli i mori dhe i bëri si këngë të vetat. Kështu na dëshmon vetë poeti në Autobiografinë e tij. Bota arbëreshe ka qenë përvetësuar aq shumë nga De Rada, sa që të sajohë një element përcaktues në brumosjen e poezisë së tij. Nuk është fjala këtu vetëm për anën teknike, për trajta të jashtëme, për vargje, po për atë çka është më njerëzore. Ai u ka dhënë një ndërthurje më të madhe motiveve të ndryshme, që e kishin ekzistencën e tyre në rapsoditë. Një epokë interesante e historisë së Shqipërisë është paraqitur ndër ato këngë tradicionale, që të mërguarit i kishin mbartur me vete dhe ruajtur me xhelozë dhe që De Rada i mblodhi dhe deshi t’u japë një unitet të jashtëm aq sa t’i bëjë të duken si fragmente të një poeme. Ajo që bie në sy menjëherë si e gjallë tek lexuesi, është jeta dhe mënyra e një të sjelluri të kulturuar dhe të qytetëruar, në të cilat kishin arritur shqiptarët. Vetë mjediset e përshkruara e përftojnë këtë atmos-

ferë të posaçme dhe përsëriten ndër «Këngët e Milosaut» për të krijuar të njëjtin skenar. Disa terma që gjenden tek rapsoditë kombëtare, hasen edhe në poemën e De Radës. Ato dëshmojnë për ndikim të drejtpërdrejtë e të folklorit mbi poetin e ri. Bota e pasqyruar në këngët popullore pjesërisht jeton e paprekur edhe në veprën poetike të De Radës. Shpirti i poetit e ka mbrujtur, plazmuar, zbuluar e fisnikëruar poemën e vet sipas kësaj fryme. Doke jetësore, që kishin qenë regjistruar ndër këngët tradicionale, si «vallja» dhe loja e diskut «rolje», përsëriten shpesh ndër «Këngët e Milosaut» dhe përbëjnë strukturën e jashtme të tyre, duke u dhënë, në të njëjtën kohë, atmosferën e dikurshme, për të përdorur fjalët e vetë De Radës. Elemente të tjera etnografike të «Milosau» janë edhe festa e Shën Mërisë Mesosproite apo Zonja e Kostandinopolit, që bie më 21 nëntor, në mes të kohës së mbjelljes së grurit; «flakadani» që ndizet në mëngjesin e ditës së pashkëve; nga rendja e djemve me urë të ndezura nëpër duar pas lakuriqve (zogjëve) të natës; «jetullëza» (lidhëz e bardhë apo fjongo për thurjen e gërshetave të vashave); «keza» e nuseve (kurora apo diadema e qëndisur me ar e argjend); guna e kuqe, një si lloj xhublete, apo fundi i një fustani me tegela, kindi i gjerë i së cilës është me ngjyra të kaltëra dhe të blerta; në të kremte popullore; shandanet e arta (ndër të pasurit) dhe kandilet (ndër të varfërit); «shqitëza e bardhë» (zhytërra, zog dëti, mjellma), etj. Vetë emri Milosau e ka prejardhjen e vet nga Miloshini, që është një nga heronjtë më të njohur të epikës popullore arbëreshe. Emrin e tij e ndeshim në «Rapsodi të një poeme shqipe».



Familja e tij ishte fisnike dhe ku një pjesë me rëndësi në epopenë shqiptare. Kjo duket edhe nga Marko Shini dhe Pjetër Shini. Milo Shinin do ta shohim edhe në veprën epike të De Radës, «Skënderbeu i pafat», ku heroi i këndon së fejuarës, Agata Pravatës, një nga lirikat më të bukura. Dialogët e vazhdueshëm në poemën «Milosau»: takimi i parë te kroi, ligjërimi poetik mes Milosaut e Rinës, kur ai e gjen vetëm rreth vatrës, biseda në mes nënës e bijës, bashkëbisedimi i shkurtër e i mallëngjyer në ëndërr mes Milosaut dhe vëllait të vdekur, etj., që synojnë t'u japin një formë tregimtare këngëve, janë edhe ato një trashëgim i poezisë së rap-sodive, që në këto forma teknike kanë shprehjen më të përdorshme. Të gërshetuarit e ngjarjeve vetjake të Milosaut me ato të atdheut e ka pasqyrën e vet në këngët popullore arbëreshe, në të cilat motivet subjektive shkrihen me ato objektive historiko-politike të Shqipërisë. Në pjesët lirike (sipas miratimit tradicional të gjinisë letrare), kur, pra, don të shfaqë në mënyrë të menjëhershme e të drejtpërdrejtë ndjenjën, sikur në «Vjershë» të së bijës së Kallogresë dhe në ato të Milosaut, poeti përdor një formë të poezisë popullore, e gjallë edhe sot e kësaj dite ndër arbëreshët e Italisë, këngën liriko-monostrofike, për natyrën e së cilës De Rada na jep një shembull të qartë në një shënim të botimit të dytë të poemës: «Tek arbëreshët kënga nuk shoqërohet me instrument muzikor, as nuk këndohet vetëm, por, pothuajse, gjithmonë në ajër të hapët. Ata këndojnë lavditë dhe ndjenjat e dashurisë o të përbuzjes kundrejt atij të cilit ia drejtojnë, ndër fusha, qoftë ditën apo natën, edhe rrugëve ku banojnë njerëz». Ky kërkim his-

torik ka vlerën e vet, po të kuptohet si ndriçim i asaj bote shpirtërore, nga e cila është nisur poeti në krijimtarinë letraro-artistike.

Nga takimi i tij me poezinë popullore lind tek ai poeti-apostull, që i kushtohet tërësisht ringjalljes së atdheut. Flamuri i Shqipërisë është shenjë e çdo gjëje të bukur në poemë, është diçka simbolike për poetin. De Rada, poet i ri e i madh i kombit shqiptar, ngriti zërin plot besim rreth së ardhmes së atdheut të të parëve dhe të popullit shqiptar. Me gojën e heroit pozitiv të poemës hartuesi u thirri bashkatdhetarëve me një zë kiejt të ri. Ai i ftoi shqiptarët që të luftojnë dhe të mbrojnë trojet e veta. Kush nuk bie përpara derës së shtëpisë së vet duke luftuar kundër pushtuesit, do të vdesë i harruar nga të gjithë. Prandaj, më mirë të vdesim me nder, në shesh të betejës, sesa në shtrat. Vargjet e arbëreshit tonë të madh të kujtojnë ato të poetit të përmendur të antikitetit klasik, Tirteut. Në këtë roman lirik De Rada, si asnjë poet tjetër përpara tij, shprehu shqetësimin dhe ndjenjat e veta më të thella për atdheun: «Me gojën e Milosaut, autori vajton lirinë e humbur dhe madhësinë e perënduar të Shqipërisë së dikurshme. Duke e përgjithësuar këtë ide, ne duhet të shohim mendimin e autorit për popullin e skllavëruar. Por poeti është plot shpresë për vendin e tij. Kurorëzimi i veprës është vdekja e protagonistit në fushën e luftës kundër të huajit. Në luftë midis detyrës dhe dashurisë, triumfon detyra ndaj atdheut. Milosau bie në sheshin e betejës me armë ndër duar për nderin e Shqipërisë. Figura e tij fisnike na kujton figurat e pasura të epikës legjendare arbëreshe, si Rada Vani,

Milo Shini, Nikë Peta, Pal Golemi, Pjetër Shini e.j. Me fatkeqësitë e personazheve të veta, De Rada, thujse, do të na bindë për shqetësimet e luftës në shekullin XV, kur shqiptarët luftonin kundër turqve për mbrojtjen e mëmëdheut. Pikërisht, për këtë qëllim, autori përpiqet të evokojë të kaluarën përmes Milosaut, të cilin, në disa këngë, e vesh me petkun e trimave legjendarë, vetëm që të ndikojë për të mirë në formimin e ndërgjegjes kombëtare ndër bashkatdhetarët e vet, t'i mësojë ata se dashuria për atdheun duhet të vihet mbi interesat vetiake.

Sikundër shihet, pra, një nga veçoritë themelore të poemës «Milosau» është fryma popullore, që depërton në mbarë veprën. Ndikimi i folklorit arbëresh është i qartë dhe i dukshëm. Kjo është bërë me vetëdije të plotë nga poeti. Për një punë të tillë, ai ka qenë i ndërgjegjshëm. Një vend të mirë aty zë edhe jeta arbëreshe, me doket dhe zakonet e saj.

Me një rëndësi të posaçme është motivi atdhetar që ngjizet në poemën e «Këngëve të Milosaut». Te De Rada, në fakt, kur po hartonte veprën, ishte e gjallë kërkesa për t'i shërbyer çështjes së lirisë së vendit, që ai e quan dhe e konsideron të vetën. Për këtë, provë janë përqendrimi i ndjenjave të tij tek i biri i sundimtarit të Shkodrës, dhënia «Këngëve» si skenar qytetin e Shqipërisë së shekullit XV, karakterizuar nga lufta kundër turqve: moment historik që gjendet në «Rapsoditë» dhe shumë i gjallë ndër shpirtrat e arbëreshëve dhe që, duke u puthitur me frymëzimin e tij për lirinë, do të përsëritet edhe më me forcë ndër veprat e mëvonshme. Porse këtu duhet shënuar se toponomastika është ar-

bitrare dhe Shqipëria e De Radës është imagjinare, o, më mirë të themi, është ajo që jetonte ndër Rapsoditë e ndër ngulimet arbëreshe, dhe së cilës pasioni i apostullit i jep një jetë të re. Kështu, viset rreth afërsive të Maqit, katund i lindjes së De Radës, janë shpërngulur në Shqipëri. Të tilla janë toponimet: Fjokat (krua), Rodhë (kodër), Kroi i ri, Korqolon, Marbela, Samërankat, Rahi i lumbardhave (kodra e pëllumbave), Pokfili (krua), Rakkanieli (lumë i vogël), Shurëzët (rruga e rërës), Marljujle (lule mareja), Shën Lliu (kishë e vogël në majë të një kodre), Mbazati etj.

Megjithëse De Rada nuk na fut në thellësinë e jetës shoqërore arbëreshe, prapëseprapë poema «Këngë të Milosaut» na jep më se një pamje pak a shumë të idealizuar të asaj jete. Thashethemet e grave, lodrat e burrave, festat fetare, dasma, jeta në stan, punët e arave e të ullishtave, veshjet karakteristike etj., janë elemente të shumta etnografike, që na krijojnë atmosferën e jetës arbëreshe. Këtu është dhe një nga meritat e poemës. Megjithatë, kemi të bëjmë me një vizatim në vija të rralla e të holla. Me të drejtë theksonte Dora d'Istria që «ashtu si këngët e kaltëve e frymëzuan një shkrimtar skocez (Makfersonin) për thelbin e poemave të tij osianike, kështu një arbëresh i Italisë së Jugut gjeti në poezinë popullore të arbëreshëve burimin e frymëzimeve të veta». Kritika letrare, qysh në mesin e shekullit XIX, vinte në dukje se Jeronim de Rada, që në moshën e tij të re, vendosi në mendjen e vet të krijonte një letërsi shqipe dhe, i patundur në këtë qëllim, për t'ia dalë në krye, iu desh të fillonte nga kënaqësitë popullore, meqë së andejmi fillon letërsia e çdo

populli. Pra, u përpoq me kohë të studiojë natyrën dhe ecurinë e gjuhës së tij, me qëllim që ta shpinte në njëfarë zhvillimi. De Rada, – shkruan Dorsa, – ka hyrë kaq thellë në shpirtin e këngëve popullore të kombit të vet, sa që poezia e tij, duke e parë nga një pikëpamje, mund të pohohet fare mirë se është një jehonë e asaj të shqiptarëve të shekullit XV, epokë e periudhës së tyre heroike. Them nga kjo pikëpamje, pasi, nga ana tjetër, ajo sjell karakteristikën më të dalluar të poezisë së ditës, sepse tek ajo vihet re përzierja e të gjitha cilësive që janë tamam të poezisë së popujve të rinj të bashkuar me thellësinë dhe me lartësinë e mendimeve që i përkasin një shekulli të ditur (filozof), i cili pasqyron jetën dhe gjithçka e përqëndron te njeriu dhe te shoqëria.²⁾.

De Rada është mjeshtër në përshkrimin e personazheve. Portretet e tyre poeti i ka trajtuar me hollësi të brendshme dhe i ka përjetësuar si personazhe me tipare mjaft të dalluara. Protagonisti kryesor, Milosau, ka tiparet e përgjithshme të një heroi romantik, pak si të përmbajtur, që vepron në rrethin e një idili sentimental, me idetë e përparuara të një djaloshi të gjysmës së parë të shekullit XIX. Është i riu i rrëmbyer nga dashuria, nga një dashuri e shëndoshë, serioze, për realizimin e së cilës ai është gati të bëjë çdo sakrificë. Milosaun e karakterizon dashuria për vendin dhe popullin. Patriotizmi e demokratizmi janë tiparet shquese të tij. Ai është gati të braktisë të mirat materiale të tjera që i

2) V. Dorsa, Su gli albanesi – Ricerche e pensieri, Napoli, 1847, f. 132

siguron pozita shoqërore dhe të përqafojë, për të mos u ndarë nga e dashura, jetën e një bujku të varfër. Rina, e bija e Kallogresë, është vajza e thjeshtë fshatare, që dashuron me zemër të dëlirët, po edhe me druajtje, se dyshon në realizimin e dashurisë së saj. Ajo është e përvuajtur, e urtë, e turpshme. Për një kohë ajo është grua e nënë e lumtur që përkund me gëzim djepin e i qëndis të shoqit brezin, që i jep hijeshi shtëpisë. Nëna e Milosaut, Zonja e madhe, është një personë e respektueshme për dashurinë ndaj vendit dhe konceptin heroik të jetës, por njëkohësisht edhe njeri me botëkuptim konservator, ruajtëse e palëkundshme e zakoneve të vjetra, e moralit të klasës së vet. Leticia, motra e Milosaut, është mishërimi i dashurisë së motrës për të vëllanë; punëtore e bindur dhe plot respekt për t'ëmën, ajo heq dorë nga martesë dhe vjen të jetojë me Milosaun për t'iu gjendur atij dhe për të mos e lënë vetëm në fatkeqësitë që e kanë goditur. Në personazhet e poemës, kryesisht në ato të dy protagonistëve, si shihet, janë vizatuar jo tipa të shekullit XV, por bashkëkohës arbëreshë të poetit. Nga kjo pikëpamje, s'ke mi vërtetësi historike.³⁾

Kjo poemë idilike e me frymëzim romantik, e përshkruar nga poezia naive-arkaike e rapsodive arbëreshe të Italisë, për karakterin e ngjeshur që ka, mbetet një nga ato fort të para vepra të letërsisë shqiptare të traditës, që e bëjnë këtë të përfaqësohet në letërsinë artistike botërore. «Milosau» është një vepër e koncentruar dhe me një plan të vetëm subjekti. Ajo shënon

3) USHT «Historia e letërsisë shqipe», v. II, f. 80, Tiranë, 1950

kalimin nga poezia epike narrative në poezinë lirike ose epiko-lirike moderne. Poema lindi si një këngë spontane mbi truallin e tabanit tonë kombëtar popullor. Ajo qe një poezi e re, e bukur, e lirë, e singertë. Ajo është e mbushur me imazhe dhe figura të freskëta e origjinale. Poema ka një konceptim të pasur figurativ plot nuanca ngjyrash, tingujsh dhe emocionesh. «Milosau» e bëri të njohur De Radën te të gjithë arbëreshët dhe nisi ta bëjë të njohur edhe në Itali e në botën e jashtme. Ishte prodhimi i parë i romantizmit, që lindi kështu si rrymë letrare edhe në letërsinë tonë. Me këtë vepër u hap një periudhë e re, një erë e re, një epokë e re në letërsinë artistike kombëtare shqiptare.

«Më 1836, nga dashuria për emrin e Atdheut, u ngrita i pari dhe, si i vetmi shqiptar, qita në dritë të diellit, pothuajse si në një palestër të përbashkët, fiset e ndryshme që tregojnë virtytet e tyre». Kështu do të shprehet poeti i madh arbëresh, Jeronim de Rada, për vepërën e vet të parë gjysmë shekulli më vonë.⁴⁾

Më 20 shtator 1839, në burg De Rada përfundoi «Historinë e re lirike shqiptare». Ndërsa ishte duke u shtypur si libër më vete, me titullin: «Këngë historike shqiptare të Serafina Topisë, grua e princit Nikollë Dukagjinit», censura e ndaloi vazhdimin e botimit të veprës si edhe qarkullimin e saj, sepse poema i këndonte lirisë. Poema ndahet në dy periudha dhe në njëmbëdhjetë këngë, të gërshetuara edhe me disa lirika të tjera. Këngët dhe lirikat kanë nga një titull të veçantë. Aty

4) G.De Rada, «Canti storici albanesi di Serafina Topia, moglie del principe Nicola Ducagini». Tradotti in prosa italiana. Napoli, della Tipografia Boeziana, 1839, f. 62.

flitet edhe për kthimin e Skënderbeut. Për botimin e parë të kësaj poeme, shtypi arbëresh foli qëkurse libri u vu në radhitje. Sipas Françesk Krispit, ky kompozim i ri i De Radës paraqet kuadro të larmishme, që shprehin transfigurimin e një shpirti rinor përmes përshtypjesh të jetës shtëpiake dhe ndikimesh të një kohe të stuhishme dhe pasionesh qytetare. Dashuria dhe jeta kaloiësiake e mesjetës, veçori të romantizmit, gjenden në poezinë e Jeronim de Radës të shartuara me zakonet e rrepta dhe me ritet piktoreske të Spartës e të Athinës. Gjithashtu, muza shqiptare, me mënyrat e saj të veçanta, harton më një të përbashkët shpirtin e lashtë dhe të ri.⁵⁾ Serafina Topia, – shkruante Dora d'Istria, është «një poemë që jep një tablo të gjallë të përpjekjeve të një populli në luftë me pushtuesin dhe me despotizmin».⁶⁾

Poemën De Rada e ribotoi më 1843 në një version krejt të ndryshuar dhe me titull «Këngë të Serafina Topisë, princeshë e Zadrimës, në shekullin XV». Këngët e kësaj vepre autori na i paraqet sikur janë fragmente poezish të shekullit XV, që përfaqësojnë mënyrën e jetesës së shqiptarëve dhe pjesërisht historinë e luftës që kanë bërë ata kundër turqve të asaj kohe. Lidhur me këtë botim, Vinçenc Dorsa shkruante: Më të larta, më filozofike, me tjetër qëllim dhe me skena të ndryshme, ato mbajnë vulën epike dhe paraqesin njëfarë ngjash-

5) Rev. «L'ore'eo». Palermo 7.X.1839 sp. «Rassegna albanese»,,, Palermo, 15.III.1920 29-30.

6) «Dora d'Istria les osrivainc albanais del' Italie meridionale Indepence Hallenique» Athinë 1867 sp. G. PETROTTA, «Popolo, lingua e letteratura albanese», Palermo, 1930, f. 257

mërie të përgjithshme me ato të Osianit (poetit skocez Makferson). Dhe vërtet, nëse poeti keltik, duke na përshkruar bëmat luftarake, na pikturon kohët dhe zakonet e vendit të tij, prirjen ekskluzive drejt lavdisë, opinionëve, marrëdhënieve dhe kujtimeve të disa familjeve fisnike të Skocisë, gjithashtu na del edhe De Rada në tërësinë e këngëve të tij për popullin shqiptar. Pastaj, ideja zotëruese në këto këngë, dhe tek e cila venë e bashkohen si në një fokus gjithë të tjerat, është ajo e lirisë së Atdheut. Në epokën në të cilën vërshon poema, Shqipëria dergjej nën zgjedhën turke, prandaj ishte fare e natyrshme që poeti të na përshkruante Shqipërinë se po ziente për fatin e saj dhe po kërkonte me padurim kthimin e ditëve të lumtura. Ndërsa te «Milosau» kishte edhe frymë naive e sentimentale, te «Serafina Topia», përkundrazi, ka këngë më të ngritura e më filozofike. Në poemën e dytë, ideja zotëruese është ajo e çlirimit të Atdheut. Poema ka karakter epiko-lirik. Poeti derdh në të tërë fuqinë e shpirtit të vet dhe në shpirtin e vet tërë frymën e atij shekulli historik të Shqipërisë. Në vepër mpleksen dy dëshira të fuqishme: dëshira e poetit për t'i kënduar heroizmit të atdheut të të parëve dhe dëshira romantike për të shprehur mendimet e ndjenjat e veta. Në poemë poeti fliste për luftën e popullit tonë kundër Turqisë në shekullin XV. Poema ishte, në të njëjtën kohë, një thirrje për bashkim të toskëve dhe të gegëve, në kohën kur ndarja krahinore ndër ne ishte pengesë serioze për lëvizjen tonë kombëtare. Në poemë, princesha e imagjinuar Serafina nga Arta, flijoi dashurinë e saj për Bozdar Stresin dhe u martua me Nikollë Dukagjinin, me qëllim që të bëhej e të forcohej

bashkimi i Jugut me Veriun e Shqipërisë. Poeti, në përshkrimin e përpjekjeve dhe të luftërave kreshnike të shqiptarëve, e kishte qëllimin në kryengritjen e armatosur. Poema e Serafinës ishte një ekuivalent femëror i Milosaut. Në poemë, poeti bashkoi shkrimin lirik të pasionit të tij me himnizimin e Shqipërisë heroike të qindvjetit të Skënderbeut.

Poema «Serafina Topia» shquhet për veçoritë e saj romantike, në të cilën poeti rikujton kohën e lumtur të atdheut të vet. Figura kryesore e poemës, Bozdari, është një nga personazhet më burrërore dhe më të plotësuara në poezinë deradiane. Vepra është e mbështetur në këngët popullore. Ajo ka për sfond historinë shqiptare. Poema niset nga një mendim atdhetar dhe filozofik, nga pikëpamje dhe ndjenja që burojnë prej kushteve historike të Shqipërisë, prej gjendjes së arbëreshëve dhe të vetë poetit si dhe nga ndikimi i rrymave filozofike dhe estetike të kohës. Nga ana tjetër, libri përmbyll një faqe të historisë intime të poetit, ndiesitë që i frymëzoi, duket, dashuria me Gavrilën, vajzën e dukës Spiriti, në Napoli. Në poemë spikasin si personazhe: Serafina, Bozdari, Nikë Dukagjini, Astiri, Irarti, Goneta. Aty del edhe Skënderbeu. Davadasa, heroina që na del në këngën e gjashtë e të tetë, është një emër indas, ndikim i letërsisë indiane të De Rada.

Këngët e Serafina Topisë De Rada i mori disa herë nëpër duar, futi pjesë të tyre të «Skënderbeu i pafat» (1872-1884) dhe i ribotoi në një përpunim përfundimtar nën titullin: Një pasqyrë e jetës njerëzore» (1897). Poema ka si nëntitull: «Jeta e Serafina Topisë, princeshë e Dukagjinit dhe fragmente të këngëve të saj në shekullin

XV». Këtë radhë ishte një poemë më e pjekur se ajo e viteve të rinisë, që, sadopak, me gjithë freskinë e saj, paraqitej e nxituar dhe mjaft e paqartë. Në këtë libër poeti futi në një kornizë të vetme shumë nga krijimet e tij të përparshme, shtoi dhe hoqi mjaft gjëra, ndryshoi këngë të tëra, duke i përfshirë nën një titull të përbashkët. Vepra shpreh patriotizmin dhe demokratizmin e De Radës. Por, krahas motivit patriotik, i cili është kryesori, edhe motivi i dashurisë, i jetës, i kuptimit të saj, gërshetohet e njësohet me të, sepse De Rada ishte kryesisht një poet romantik, i cili nuk pajtohej me deklaratat e zhveshura nga emocionet dhe nga njeriu vetë dhe romantizmi i zhvilluar e shtron në mënyrë të veçantë problemin e ndjenjës, të gjendjes morale dhe psikologjike, e koncepton jetën përmes idealesh sublime, por edhe ndijimesh konkrete e të holla që përftohen nga kujdesi më i madh për botën e brendshme të njeriut. Për këtë, siç dihet, ai gjeti mbështetje të fortë te folklori, për të cilin janë të huaja çdo retorikë apo çdo tregim prolis dhe emfatik. Kur mbaron së lexuari poemën e De Radës, ke një përfytyrim të gjerë dhe të shumanshëm të Shqipërisë së shekullit XV. Kjo pamje përfshin imazhet e krahinave të ndryshme, bukurinë dhe ëmbëlsinë e natyrës, figurat e Serafinës, të Bozdarit, të Evodës që u martua me një të huaj dhe mbaroi tragjikisht mbi flakën e druve, të Parayllës, të princërve të zemëruar dhe të Skënderbeut shpirtmadh, të të rinjve dhe të barinjve që donin me çdo kusht bashkimin me Skënderbeun dhe që ishin aq të njerëzishëm. Në një skaj të kësaj bote poetike të vërtetë dhe imagjinare, të krijuar prej De Radës, sheh Todrin që kërkon të sjellë një moral të

papranueshëm për shqiptarët dhe vdekjen e tij të shpejtë.

«Pasqyra e një jete njerëzore» është, pra, vepër krejt e re, megjithëse trajton po ato ngjarje që janë trajtuar në tri variantet e mëparshme të Serafinës (1834, 1839, 1843). Kjo poemë, që mund të quhet varianti i katërt, është ndër krijimet më të fuqishme të De Radës për gjerësinë e thellësinë e frymëzimit e të konceptimit, për dramacitetin, për epicitetin dhe lirizmin e shumë skenave dhe episodeve, për figurat e skalitura, për kompozicionin e saj, për konfliktet dhe karakteret e përshkruara, për idilet e holla dhe pasionet e fuqishme, për gjuhën e pasur, për idealet fisnike që pasqyron. Ajo ndryn në vetvete një tok problemesh patriotike, shoqërore, filozofike, estetike. Mbi të gjitha, poema thekson bashkimin e shqiptarëve, luftën e armatosur, çështjen kombëtare problemin e lirisë së njeriut, të drejtën e tij për të vendosur fatin e vet. Nga ana e gjinisë letrare, poema është epiko-lirike narrative. Kjo i ka dhënë mundësi De Radës që të shprehë gjerësisht demokratizmin, humanizmin dhe iluminizmin e tij. Vepra është një himn për emancipimin e gruas shqiptare dhe për virtytet e saj të larta morale dhe intelektuale. Mikel Markianô ka shkruar: «Poema, në mos në formën e jashtme, në konceptimin e saj është një dramë e gjerë me nota tragjike të fuqishme, që mund të zbërthehet në një tetralogji madhështore, ku secila pjesë mishërohet në një protagonist: Serafina, Bozdari, Evoda dhe Parayllja». Ndërsa Viktor Gualtieri jep këtë gjykim: «Skena e vdekjes së Bozdarit është vërtet e denjë për pendën e Shekspirit». Eqrem Çabej ka zbuluar një ndikim pozitiv të letërsisë klasike indiane në poetin

e madh arbëresh. Te drama e Dandinit, Vasantasena hi-pën në stivë të druve për t'u djegur së toku me fëmijët e saj, po shpëton bashkë me të shoqin. Një skenë të tillë na paraqet De Rada te «Një pasqyrë e jetës njerëzore», ku Evoda pëson këtë vdekje të tmerrshme për hakmarrje politike të popullit. Kjo skenë mund të jetë frymëzuar së andejmi. Po ajo, më anë tjetër, na kujton një pamje të «Jeruzalemit të liruar» të Tasos, në të cilën virgjëresha kristiane, Sofronia, duhet të digjet në turrë të druve së bashku me të dashurin e saj, Olindo, po ndërmjetëson Klorinda për shpëtimin e tyre. Gjurmët e poezisë inde te De Rada kanë lidhje me faktin që në gjysmën e parë të shekullit të XIX, letërsia inde kishte marrë një hov të madh në Evropë, duke depërtuar kudo nëpërmjet përkthimesh në gjuhë të ndryshme. Burimet e poezisë popullore shqiptare e të letërsisë botërore e pasuruan krijimin poetik të De Radës, por kjo në qenësi mbetet pjella e frymëzimit të tij.⁷⁾

Më 30 qershor 1844, De Rada botoi në prozë tregimin italisht «Diana».⁸⁾ Tema e punimit nuk është shqiptare. Ngjarjet zhvillohen në Toledo. Personazhet që veprojnë janë: Diana de Silva, Konsuelo, Lara, Garcia de Silva, Vantisana. Emri i Vantisanes është marrë prej De Radës nga Savantasena, heroina e dramës «Mrhakatika» të Dandinit, poet indas i shekullit të VII të erës së re.

7) E. Çabej «Vatra dhe bota në poezinë e De Radës», Tiranë 1965, f. 54.

8) G. De Rada, «Diana» racconto «il calabrese» nr. 16 del 30 Giugno, 1844, nr. 17 del 15 Luglio 1844.

9) G. De Rada, «I numidi», Tradotta dall' albanese per l'autore. Napoli, dalla Tipografia dell' Urania, 1846, 75 f.

Ky emër del edhe te libri i pestë i poemës «Skënderbeu i pafat» i De Radës. Novela «Diana» himnizon dashurinë e dëlirët. Ajo del me një botë të pasur shpirtërore. Tregimi shquhet për dramacitet, për gjuhë të rrjedhshme, për figura shprehëse, për stil të bukur e tërheqës, për dialogë të gjallë, për unitet veprimi, për skena tragjike.

Në tetor të vitit 1846, De Rada çoi në shtyp tragjedinë italisht «Numidët»¹⁾, të cilën e kishte hartuar, së pari, shqip në të folmen arbëreshe, ashtu si të gjitha veprat e tjera. Në parathënie autori shënonte që nuk po e vinte përballë prozës italiane origjinalin shqip, siç kishte bërë më parë në vepra të tjera. Dramaturgut tonë nuk ia kishin dobësuar mendimin, për të hedhur një gur në themelet e një kulture mendore shqiptare, as vështirësitë, as koha. Përkundrazi, fati u kishte dhënë përkrahje përpjekjeve të tij fisnike. Ai e quante, tashmë, një mision atë që, dikur, i dukej vetëm një frymëzim i thjeshtë kombëtar. Dhe, pikërisht, për këtë, mbasi kishte ngritur në poezitë e tjera të tij disa forma në harmoni dhe në përputhje me këngët popullore shqipe, nuk desh të lërë që në ngulimet arbëreshe të lindte, para atyre të vendit dhe të natyrshmeve, një bimë e huaj, siç është kjo dramë. Tema e veprës «Numidët» është marrë nga historia e një populli tjetër. Forma e saj është imituar, kurse brendia është nxjerrë nga ngjarjet dhe fatet e një jete individuale. Këtë tragjedi De Rada e shkroi «me ankth të ethshëm» – siç thotë vetë. Me sinqeritetin që e karakterizon, autori na tregon se, kur ua këndoi këtë krijim disa miqve të tij, e kuptoi shpejt se ata e pritën me të ftohtë: «Si mblodha ca shokë, u lexova atyre «Numidët», por nuk vura re që të shkëputeshin. Isha i de-

kurajuar, isha i mposhtur nga një pasion i nxehtë që i shkrinte të gjitha fuqitë e mia dhe që ma kishte shndërruar frymëzimin në një dëshirë kapitëse». Që vepra nuk u pëlqye prej shumë vetësh, e marrim vesh edhe nga Ëngjëll Bazile (1813-1848), patriot demokrat, poet, dramaturg, një nga admiruesit më të flaktë të poezisë së De Radës. Sipas Baziles, mungesa e suksesit të tragjedisë erdhi nga shkaku i stilit të vështirë të De Radës, i cili nuk kuptohej lehtë. Pas afro gjysmë shekulli, më 1892, në pleqëri të thellë, poeti ynë u kthye përsëri mbi këtë argument, duke hartuar një dramë historike, me emër tjetër, për të cilën do të flasim më poshtë.

Më 1847, De Rada botoi poemën: «Histori të Shqipërisë» ose «Shqipëria nga viti 1460 deri më 1485». Ajo përmban katër novela poetike: Ana Maria Kominate, Adina, Nata e kërshëndellave dhe Videlaida. Vepra, teksa u botua, u prit shumë mirë nga arbëreshët e Italisë. Shkrimtari i mirënjohur Anton Santoni shkruante më 1848: «Qoftë ky libër për gjuhën shqipe, ashtu siç qenë veprat e Homerit, Platonit dhe Aristotelit për gjuhën greke!» Edhe brendia e kësaj vepre poetike, sikurse poemat e para të De Radës, shtjellohet gjatë shekullit XV në Shqipëri. Të katër historitë nuk paraqesin një kuadër të gjerë të plotë të Shqipërisë, siç mund të merret me mend nga titulli, por vetëm disa pikëzime të gjendjes së saj, gjatë pushtimit të turqve, dhe, fill pas hyrjes së osmanëve në vendin tonë. Tri novelat e para poetike të kësaj vepre, të lidhura në mes tyre me një fill të fortë, shprehin trilogjinë tragjike të shtëpisë së Arianit Komnen Topisë. Por edhe historia e katërt është një tragjedi prekëse më vete. Delia vdes nga fatkeqësitë e Shqipërisë. Novela poetike është një punim me ndjenja të

theksuara njerëzore. Hartimi më i freskët dhe më i dashur i kësaj vepre është Ana Maria Kominiate, që mund të përfillet si një nga kryeveprat poetike të De Radës.

Vepra e arbëreshit të madh, «Histori të Shqipërisë», pas përshtatjes në gjuhën e sotme shqipe (1975), ka hyrë me titullin «Rrëfime të Arbërit». Poeti e hartoi veprën për të treguar begatinë e shqipes dhe mundësitë shprehëse të saj. E shkroi poemën për të dëshmuar se, me anë të lëvrimin të gjuhës amtare, përtëritet jeta bujare e lashtë e bijve dhe bijave të Arbërisë së dikurshme. E përpiloi për të kallëzuar se prindërit e këtyre fëmijëve, etërit shqiptarë, në pjesën më të madhe qenë prijës të Shqipërisë në betejat e lavdishme të lirisë në shekullin XV. Libri kishte vlerë të madhe edukative për bashkatdhetarët tanë. Në parathënie, De Rada e thoshte shkoqur mendimin dhe qëllimin e vet: «Mbaroi koha për njerëz të huaj që të dërgojnë, si përpara, këshilla të këqija në Shqipëri, për ta sflitur dhe prishur, me anë përlëshjesh të përgjakshme, pa synime të vërteta kombëtare. Mbaroi koha për të huaj – shtonte poeti aty – sepse sot e tutje do të jemi ne, arbëreshët e shqiptarët, që, duke e dashuruar me gjithë zemër Arbërinë, do t'i themi të vërtetën, do të mbrojmë virtytet, do ta çojmë Shqipërinë drejt madhësisë së saj».

Poeti kishte besim të plotë e të patundur në ringjalljen kulturore dhe intelektuale të popullit të vet. Dhe këtë e deklaroi që në hyrje të poemës: «Nuk do të kalojë shumë kohë e, ashtu siç më në fund rilindi Greqia (më 1821), edhe nga dera, më e parë e më e pastër e trungut pellazg (nga dera ilire, arbëreshe, shqi-

ptare) do të shkëlqejë në mes të popujve kurora e saj e lashtë zemërbardhë, sepse kjo degë ka brenda saj të gjitha vlerat, dobisë si popull, virgjërinë e gjuhës, mungesën e një kulture të huaj, kurdoherë të dëmshme për zhvillimin e lirë dhe origjinal të aftësive mendore dhe artistike të njerëzve dhe të popujve».

Ky ishte lajtmotivi, qëllimi dhe pikësynimi i poetit e atdhetarit më të madh të arbëreshëve të Italisë në hartimin e kësaj poeme. Ato që poeti nuk arriti t'i shprehte plotësisht në «Milosaun» dhe «Serafina Topinë», i qartësoi te «Rrëfime të Arbërit». Të prekin thellë imazhet e shkurtra, të hajthshme, të fuqishme për bukurinë dhe madhësitinë e tyre. Në vepër lexuesi vëren se si njerëzit nga një sferë fshatarake, apo fisnike qoftë, do të ngrihen në largësi të tilla magjepsëse që të bëjnë për vete. Poema «Rrëfime të Arbërit», që përbehet prej katër këngësh, të cilat qëndrojnë edhe si poemtha-statujë më vete, ndërlihet e përshkohet nga ideja kryesore e bashkimit të shqiptarëve të shpërndarë nga dallgët dhe shqotat e shekujve, në luftën për çlirimin e atdheut dhe në kthimin e të gjithëve në trojet e origjinës së tyre, për të përtëritur me shkëlqime shumë më të mëdha traditat më të shëndosha, si pasardhësit më të denjë të pellazgëve të lashtë, për të bërë një atdhe, të cilin askush nuk do të guxonte që ta prekte, sepse do të mbrohej nga gjokse fatosash. Në kuadrin e kësaj ideje kryesore apo të këtij problemi themelor, si rrezik numër një për De Radën paraqitej bashkëjetesa me sundimtarët dhe, ca më keq, martesat me ta dhe me të huajt. Te këto ai shikonte një nga format më të stërholluara për shkombëtarizimin tonë, në këtë dhe në atë anë të deteve.

Vlerat ideoshkencore të veprës «Rrëfime të Arbërit» dalin jashtë kufijve të subjektit e të personazheve. Ato përbahen në frymën e përgjithshme humanitare, demokratike dhe patriotike, në konstatimet e holla të ndjenjave e të luftës shpirtërore, në frymën kritike ndaj çdo gjëje që cënon ose prish dinjitetin e njeriut, në përpjekjet për të përtëritur realitetin e dikurshëm historik dhe për ta përdorur këtë si shembull për bashkohësit. Poema «Rrëfimet e Arbërit» këndon me një lirizëm të hollë dhe patos epopenë dhe virtytet e larta të shqiptarëve në luftën e tyre shekullore për të mbrojtur lirinë. Veprimi i katër rrëfimeve poetike zhvillohet në një periudhë prej rreth 40 apo 50 vjetësh. Ngjarjet historike, që zënë fill menjëherë pas vdekjes së Skënderbeut e shkojnë deri në fillimet e shekullit XVI, ndërthuren dhe me fatin e Bozdarit, të Vlladanit, të Gramosit, Miranës, Dinës, Vidës dhe të personazheve të tjera të kësaj vepre. Ashtu si te «Milosau», «Serafina Topia» e në vepra të tjera, edhe në Rrëfimet e Arbërit' De Rada, si romantik, nuk kufizohet me përshkrimin e përjetimeve dhe ndjenjave të heronjve, po përpiqet t'i vendosë ata në një epokë të caktuar historike përmes linjave politike e shoqërore, morale e filozofike. Është kjo gjë, pikërisht, që i jep veprës përmasat e një romani dhe atë tendosje mendimi dhe ndjenje, që është karakteristikë e De Radës. Me tërë veprën e tij dhe me këto katër afreske të «Rrëfimeve të Arbërit», që përmbajnë një numër të kufizuar figurash, por me një dinamik të fortë ndjenjash dhe mendimesh, që lëviz historikisht në një periudhë të shkurtër, poeti pritet drejt epopesë njerëzore, pritet të shkruajë legjendën e shekujve shqiptarë.

Poema «Rrëfimet e Arbërit» është një vepër tranzitore në krijimtarinë letrare artistike të De Radës.¹⁰⁾ Poemën e dallojnë disa tipare që do të jenë karakteristike për veprat e pjekurisë së De Radës, si forcimi i epizmit, gjerësia dhe kompleksiteti i problematikës, larmia dhe thellësia e karaktereve, prirja për situata dhe heronj të jashtëzakonshëm, thellimi i ngjyrës historike. Kjo vepër është romantike, e një romantizmi të stuhishëm që parapëlqen pasionet e forta, situatat dhe karakteret e jashtëzakonshme dhe ku elementi i tmerrshëm dhe ai fantastik zënë tepër vend. Në poemë mbizotëron patosi heroiko-tragjik. Aty vëmë re edhe elemente të realizmit, dukuri kjo karakteristike më tepër për periudhën e pjekurisë në krijimtarinë e De Radës. Vepra ka rëndësi për brendinë e saj ideore, për vlerat artistike të padiskutueshme. Ajo përbën një urë kalimi nga krijimet rinore të De Radës në veprat e pjekurisë.¹¹⁾ Poema «Rrëfime të Arbërit» shquhet për karakterin e saj patriotik, politik, kombëtar, shoqëror, filozofik, etik dhe estetik. Vepra pasqyron vitalitetin e popullit shqiptar. Çlirimi i atdheut nga pushtuesit e huaj arrihet vetëm përmes luftës së armatosur. Poema afirmon kombin tonë. Në të shprehet urrejtja e pakufishme e bashkatdhetarëve kundër pushtuesit turk. Aty shkrihet në një humanizmi dhe iluminizmi i poetit. «Rrëfime të Arbërit» është një poemë epiko-lirike me elemente të theksuara dramatike dhe narrative. Heroikja dhe tragjikja, romantizmi dhe sentimentalizmi, imagjinaria dhe realja janë të mpleksura në mënyrë të harmonishme njëra me tjetrën. Nga ana psikologjike, personazhet janë përshkruar dhe skalitur me

10) V. Gualtier «Girolamo de Rada», Palermo, 1930, f.76

11) E. Çabej art. cit. f.54

mesjtëri; kështu Ana Maria, Videlajdja, Adina, Delia, Julja, Lena etj. Poema «Ana Maria Kominiate» u përkthye gjermanisht nga albanologu Teofil Shtir, më 1856. Më vonë, pjesë të zgjedhura nga kjo poemë përktheu edhe poetesha austriake Knorr.

Në vitin 1861, De Rada botoi librin italisht «Parime të estetikës», që është një monument me vlerë të posaçme për mendimin estetik të Rilindjes sonë Kombëtare. Ajo ndihmon që të informohemi më mirë për botëkuptimin filozofik dhe sociologjik të shkrimtarit, për pikëpamjet e tij etike, folklorike dhe juridike, estetike dhe gjuhësore. Vepra dëshmon se De Rada ka mundur të thotë fjalën e tij me peshë për shumë çështje të rëndësishme të botëkuptimit. Ai na paraqitet si një mendimtar i thellë dhe origjinal, i krahasuar jo vetëm me përfaqësuesit e tjerë më të shquar të Rilindjes sonë, por edhe me mendimtarët më të rëndësishëm të Italisë së gjysmës së parë të shekullit XIX. Libri është shkruar me shqetësimet dhe preokupacionet e një shqiptari, e arbëreshit të madh, zemra dhe mendja e të cilit punojnë për atdheun, sytë e të cilit janë drejtuar teji Adriatikut, nga Shqipëria. Vepra «Parime të estetikës» dëshmon më së miri, se autori i saj është në kërkim të mjeteve të tjera në favor të idealeve patriotike përparimtare, që e frymëzojnë, është në kërkim edhe të argumenteve filozofike, sociologjike, historike, estetike, juridike, gjuhësore, etike etj. Libri tregon se hartuesi i saj është i preokupuar për krijimin e një arti shqiptar, që të vihet në shërbim të qëllimeve patriotike. Për këtë arsye, ai tregon një kujdes të madh për traditat artistike të popullit tonë dhe çmon shumë lart frymën patriotike të këngëve popullore, që ishin ruajtur dhe për-

hapur tek arbëreshët e Italisë. Ashtu si gjithë rilindësit tanë të mëdhenj, në këtë vepër autori çmon lart rolin e madh që luan për ringjalljen e kombit tonë përhapja e arsimit kombëtar. Ai e quante themelimin e Kolegjit të Shën Benedeto Ulanos dhe të Shën Adrianit si një mjet që duhej përdorur për të përhapur midis arbëreshëve të Italisë kulturën kombëtare dhe për të zgjuar tek ata ndjenjat e atdhedashurisë. Mendimet e shprehura në «Parime të estetikës» tregojnë se kjo vepër, edhe pse e shkruar italisht, i përket kulturës sonë kombëtare. Libri në fjalë është me vlerë të madhe për të sqaruar edhe disa anë shumë të rëndësishme të krijimtarisë artistike dhe të pikëpamjeve estetike të autorit Estetika e tij dëshmon se De Rada ka qenë nisur në betejat e krijimtarisë artistike i armatosur mirë me armë teorike, domethënë ka qenë ndër ata poetë që i kanë konceptuar edhe teorikisht problemet e ndërlikuara të krijimtarisë. Vepra «Parime të estetikës» e De Radës dëshmon se teoria mbi artin, si pjesë e teorisë së tij estetike, ka pasur për kohën e vet karakter përparimtar. Në të hasim plot konstatime të drejta dhe interesante mbi artin në përgjithësi dhe mbi llojet e veçanta të tij. Megjithëkëtë, teoria e tij e artit karakterizohet nga një varg kufizimesh të rëndësishme. Sidoqoftë, pikëpamjet estetike të De Radës tregojnë se ai i ngarkonte artit një mision të madh shoqëror; ai ishte për një art të përkryer, të mbrujtur me idealet e çlirimit kombëtar dhe të përparimit shoqëror, plot bukuri dhe madhështi, si jeta e popullit, të cilit i kushtoi gjithë talentin e tij.¹²⁾

12) A. Uçi, «Probleme të estetikës», Shtëpia Botuese «N. Fra shëri», Tiranë, 1976, f. 263-318

Vëllimi «Parime të estetikës» të De Radës pasqyron kulturën estetike të autorit dhe shpreh pikëpamjet e tij për të bukurën në përgjithësi dhe në veçanësi, për të bukurën te njeriu, për të madhërishmen, për të mirën e të dobishme, për artin dhe jetën, për muzikën, poezinë dhe romanin, për funksionin e artit. Botimi i veprës «Parime të estetikës» të De Radës është një ngjarje e shënuar në historinë e mendimit tonë letrar. Libri përbën të parin traktat të mirëfilltë estetik shqiptar. Megjithëse vepra nuk merret tërësisht me probleme estetike, dhe, siç është vënë re nga studiuesit, paraqitet komplekse e kontradiktore, me pikëpamje idealiste dhe të pakapërcyera, prapëseprapë ajo ka rëndësi dhe vlera të posaçme, sidomos po të marrim parasysh nivelin dhe stadin e mendimit shqiptar të kohës. Me të drejtë është konstatuar se, me këtë traktat, De Rada del si mendimtar i thellë dhe i përpëruar në disa aspekte. Në «Estetikën» ndihet jehona e zërit arbëresh, që tingëllon i ngrohtë përpara përfytyrimit të kolegjit arbëresh të Shën Mitrit, boshti i fateve të atdheut, dhe rreth «Rapsodive», monumenti i ndritur dhe i lashtë i gjuhës dhe i letërsisë kombëtare shqiptare. Ashtu sikurse Tasoja dhe Shileri, që i mblodhën parimet e poezisë së tyre në një teori të posaçme të së bukurës, po kështu edhe De Rada i grumbulloi në një traktat parimet estetike, mbi të cilat mbështeten poemat e tij. Poeti ynë i madh, pasi thuri e botoi disa poema me vlerë të veçantë artistike, deshë të ndërtojë një sistem estetik që, në mos është një zbulim, ka origjinalitet. De Rada e ndërtoi sistemin e tij estetik në varësinë e poemave të tij epike-lirike-

-dramatike. Stili i tij është i ngjitur shumë pas latinites.¹³⁾

Në vitin 1866, De Rada botoi veprën «Rapsodi të një poeme shqiptare». Poeti i madh arbëresh u shty që t'i botojë këto rapsodi, para të gjithash, nga qëllimi i lartë patriotik për t'i shërbyer çështjes kombëtare, politikës çlirimtare që bënin atdhetarët shqiptarë, brenda dhe jashtë atdheut. Kjo vepër e De Radës luajti një rol të mirë e të dukshëm në botën e jashtme për afirmimin e kombit tonë. Botimi i rapsodive popullarizoi epopenë e madhe heroike të Skënderbeut, që u bë edhe tematika kryesore e gjithë letërsisë arbëreshe. Ai botim i vlejti shumë çështjes shqiptare në opinionin e Evropës, sepse i bëri të njohura cilësitë më të shëndosha të popullit tonë, trimëritë e luftërat e tij për liri. Botimi doli në një kohë shumë të volitshme për të hedhur poshtë shpifjet e armiqve, që filluan ta paraqesin popullin tonë si popull primitiv, pa një të kaluar kulturore, të paaftë për të krijuar një shtet të pavarur kombëtar. Poeti ynë i shquar ishte i vetëdijshëm për rolin dhe rëndësinë e madhe të këtyre rapsodive. De Rada i mblodhi këto këngë si monumente që pasqyrojnë jetën e kaluar dhe historinë e lavdishme të popullit tonë. Entuziazmi i poetit për ta ishte i madh. Vepra u përhap në ngulimet arbëreshe të Italisë dhe të Greqisë, në Shqipëri brenda, në Veri dhe në Jug, në kolonitë e tjera shqiptare si edhe në mbarë Evropën, përmes albanologëve të kohës. Vepra i shërbeu shumë zgjimit kombëtar të popullit tonë. Libri luajti një rol me rëndësi të dorës së parë në botën e huaj në lidhje me çësh-

13) M. Marchino, «L. Albania e l'opera di Girolamo de Rada,» Trani, 1902.

tjen e rilindjes së kombit shqiptar. Këngët tërhoqën vëmendjen e mjaft dijetarëve dhe shkrimtarëve të shquar të Evropës për Shqipërinë dhe historinë e saj. Përmes kësaj vepre u njohën, më për së afërmi, cilësitë dhe vetitë më të mira të popullit tonë. Në parimet e tij për qitjen në dritë të virtyteve të shqiptarëve, De Rada u nis, kryesisht, nga dy kërkesa themelore: nga historia dhe nga kultura kombëtare. Duke u marrë, në mënyrë të gjallë, me luftën politike për të drejtat e popullit shqiptar, De Rada u bë një përhapës i shquar i këngëve popullore shqiptare në shërbim të ideve dhe të synimeve politike të Rilindjes sonë Kombëtare. Por, në të njëjtën kohë, me rapsoditë ai e pasuroi kulturën kombëtare me një visar të mendimit dhe të fjalës artistike shqipe «Në qoftë se në kohën e tij, poeti shqiptar – shkruan De Rada – fitoi me poezitë e tij të përkthyer simpatinë e popujve jo vetëm të vendeve kufitare, por edhe të viseve të largëta, tani, po të grumbulloheshin ose të rimëkëmbeshin poezitë e tij në trajtat e tyre të vërteta, autentike, do të çmoheshin edhe më tepër nga arti i kultivuar i Evropës, ndoshta edhe pse do të ndikonin pozitivisht mbi artin bashkëkohor».

Në këtë mënyrë, rapsoditë dëshmonin jo vetëm për pasurinë e veçantë të së kaluarës sonë popullore, por edhe për bukuri të rralla artistike. Vepra tërhoqi vëmendjen e shkencës folkloristike evropiane, si një përmbledhje që kapërcente shumë, nga rëndësia, çka ishte botuar deri atëherë nga folklori ynë. Për atë pati recensione shumë të favorshme në shtypin shkencor, letrar dhe në atë folklorik. U bë edhe një provë përkthimi gjermanisht, po që s'dimë të jetë botuar. Dora d'Istria e quajti këtë vepër si një epopë kombëtare origjinale

si histori të atdhetarëve shqiptarë, që ranë për lirinë, për pavarësinë dhe për qytetërimin. Në letrën e datës 22 janar 1866, dërguar Dhimitër Kamardës, De Rada ka dhënë këtë përkufizim: «Siç keni mundur t'i shikoni, («Rapsoditë e një poeme shqiptare») janë me të vërtetë të bukura. Sa për mua, e përsëris, mendoj se në poezinë e sotme (evropiane) ato do të duken ashtu siç u duk Skënderbeu midis princërve bashkëkohës me të». Po aty, poeti i përmendur arbëresh shtonte: «Përmendurja e shqipes më të kulluar është kënga e kohës së Skënderbeut, që edhe sot e kësaj dite ekziston».

Vepra madhore e Jeronim de Radës, për të cilën punoi gjysmë shekulli, është «Skënderbeu i pafan». Poema është krijuar nga poeti gjatë një periudhe pesëdhjetëvjeçare (1834-1884), ndër vise të ndryshme, në Maqë, Napoli, Portic Paola, Kalvaric, Mali i Qanës, Koriljano. Projekti i parë i autorit ishte që ta zhvillonte epopenë e Skënderbeut ndër dymbëdhjetë libra, dhe ato ishin të hartuara e të bëra për botim që më 1880, por duket se ende kishin nevojë për ripunime, për renditje të re e për t'u lidhur më mirë në mes të tyre. Prej këtyre 12 librave, De Rada botoi nga «Skënderbeu i pafan» vetëm 5 libra: I, II, III në Koriljano Kalabro (më 1872 e 1873), IV, V në Napoli (më 1877 e 1884). Pas vdekjes së tij, më 1906, u botua poema «Gjon Huniadi», që duhet të zërë vend o në librin e gjashtë o në të shtatin e poemës «Skënderbeu i pafan». Gjashtë vëllimet e tjera, që mbetën dorëshkrim, pjesërisht gjenden në Bibliotekën Qytetare të Kozencës (Kalabri) dhe pjesërisht në Bibliotekën Mbretërore të Kopenhagenit, shkruar me dorë ndër fletore të mëdha protokolli (ato të Kozencës) dhe ndër regjistra të mëdhenj shkolle, që i kishte bartur me vete prej

gjimnazit komunal të Koriljano Kalabros, mbasi pat dhënë dorëheqjen nga ajo shkollë e mesme. Po, me gjithë dëshirën e mirë, poeti nuk pati mundësi t'i merrte në dorë edhe një herë, për shkak të pleqërisë së tij të thellë, të vuajtjeve familjare, të gjendjes së keqe ekonomike, etj. Megjithatë, sipas një letre të vetë De Radës, të 13 prillit 1901 del se plaku i nderuar 87-vjeçar i ishte kthyer edhe një herë krijimit më të dashur të veprës së tij jetësore dhe kishte hartuar këngë që rivalizonin me ato të Homerit. Ja konkretisht fjalët e De Radës: «Nuk mund të më gjykoni me drejtësi, po nuk e lexuat edhe një herë këtë poemë timen të reformuar. Aty pasqyrohet një faqe e jetës, e ndryshme dhe e vetme, mbas asaj që na ka dhënë Homeri pagan».

Poeti i madh arbëresh e hartoi poemën «nga devotshmëria për Shqipërinë e mjerë dhe të braktisur» – siç deklaroi vetë. Ai e përpiloi këtë vepër madhore «për të ringjallur gjuhën amtare». Ai «deshi ta ngrejë shqipëren në shprehjen e një jete të lartë dhe të zgjedhur». Duke u nisur nga kënga popullore, e pa natyrën e vështirë të epikës, të lirikës e të dramatikës në atë gjini letrare. Mendja e tij e lartë poetike u kujdes që t'i hartojë ato në harmoni të qartë, me gjithë të metat e veglës që kishte në dorë. Kështu shprehet poeti. Pas shumë vitesh, kur iu duk se kishte arritur një stil të vetin, atëherë iu ringjall besimi në një mision fisnik që t'i jepte shkas fillimit të kulturës dhe rilindjes së atdheut të të parëve, Shqipërisë. Kështu, duke nxjerrë në dritë një pas një librat e «Skënderbeut të pafat», poeti kishte për qëllim të zgjonte te bashkatdhetarët e vet shqiptarë vetëdijen e tyre kombëtare. Gjithë kësaj pune të gjatë i kushtoi tërë jetën e tij dhe tërë gjënë

që pat. Asnjë njeri nuk i dha dorë, askush nuk e përkrahu; përkundrazi, e luftuan me mjete dhe forma nga më të ndryshme; por ai nuk u dha, nuk u dorëzua. Ai ishte i bindur që vepra e tij do të luante një rol të madh edukues, frymëzues, mobilizues, rilindës. Ajo ngrinte edhe një herë frymën kombëtare, zgjonte dhe përforconte ndërgjegjen kombëtare, të shqiptarëve për çlirimin e atdheut. Në parathënien e kësaj vepre, hartuar në dhjetor 1870, De Rada vë në dukje se si, qysh në vitin 1836, i shtyrë nga dashuria e madhe për mëmëdheun e etërve të tij, që i pari shqiptar që u vu të shkruajë një poemë, e cila kishte për qëllim të ngrinte lart gjuhën shqipe dhe traditat tona. Megjithëse vepra mund të mos i ketë arritur majat e artit, për të cilat autori ishte i vetëdijshëm, poeti thekson se ajo është shkruar e hartuar me qëllim që të përgatisë zgjimin e ndërgjegjes kombëtare, rilindjen e kulturës shqiptare, besimin për të ardhshmen e lumtur të ditës së pavarësisë.

Formën e këngëve të poemës «Skënderbeu i pafan» De Rada – siç na dëshmon vetë – e mori prej rapso-dive kombëtare shqiptare që bartën me vete nga atdheu i të parëve, Shqipëria, dhe i çuan në ngulimet arbëreshe të Italisë. «Ato janë pjesë të fondit të përbashkët popullor, prej të cilit ka lindur çdo poezi heroike e vetvetishme e kombeve evropiane. Shenja më dalluese e saj është se tregimi, veprimi e frymëzimi ndjekin njëri-tjetrin dhe shkrihen së bashku ashtu si shihen në jetë». Kështu shkruante vetë poeti. «Përsa i takon përmbajtjes, desha, në trajtën që më dha atdheu im, ta përfytyroj jetën ashtu si bëhet e si duhet në shtëpinë e tij. Jeta që është në to, e thith ajrin nga të katër anët».

Titulli «Skënderbeu i pafan» tërheq vëmendjen, ve-

çanërisht, sepse Skënderbeu nuk është protagonist i veprës, po paraqitet vetëm në ndonjë këngë të poemës. Si shpjegohet atëherë ky titull? Vepra vendoset e tëra në shekullin XV shqiptar. Është fjala, pra, për lavdinë e këtij shekulli, të cilin, me plot gojën e quajmë shekulli i Skënderbeut. Por ky shekull qe edhe «i patanë», i pafat, fatkeq, sepse gjithë ajo lavdi, nëpër aq luftëra epike e fitimtare, ishte në të njëjtën kohë, edhe një tragjedi e madhe, meqë, së fundi, turqit e pushtuan Shqipërinë¹⁴). Me këtë vepër, poeti i vuri detyrë vetes të krijonte një epike për kohën e Skënderbeut, ku të pasqyroheshin tërë madhështitë e tërë vuajtjet e Shqipërisë. Ai deshi të pohonte edhe nje herë, vitalitetin e popullit shqiptar, i cili mundi dikur të nxirrte nga gjiri i tij një hero si Skënderbeu dhe t'i qëndronte aq gjatë rrebesht osman, sa çuditë botën. S'ka dyshim se, duke ringjallur atë epokë të lavdishme, autori të përtërinte një shekull të ndritur, që do t'i frymëzonte për veprim dhe do t'u rriste besimin në forcat e veta.

«Skënderbeu i pafat» është një poemë me pesë libra. Secili libër është i ndarë në këngë. Ndër dy librat e fundit këngët quhen histori. Libri i parë ka tetë këngë, i dyti – gjashtë, i treti – shtatë, i katërti – gjashtë, i pesti – pesë. Gjithsej tridhjetë e dy këngë dhe histori me afro 10.000 vargje. Përveç këtyre, ka një prolog të gjatë në fillim të poemës, si edhe shumë lirika të gërshetuara në mes këngësh ose të futura në to. Është botuar ndër vëllime të vogla. Koha, në të cilën zhvillohen ngjarjet e kësaj poeme, përfshihet brenda 26 vjetësh, që nga viti 1418 deri më 1444. Vendet, në të

14) Dh. S.Shuteriqi, «Nëpër shekujt letrarë», f.156

cilat ndodhin këto ngjarje, janë të ndryshme: Shqipëri e Veriut, Shkodër, Mirditë, Shqipëri e Mesme, Dibër, Elbasan, Krujë, Bogdani, Shqipëri e Jugut, Himarë, Artë, Janinë Adrianopol, Azi etj. Në poemën «Skënderbeu i pafat» historia e Shqipërisë në shekullin XV, d.m.th. në periudhën e saj kulminante të së kaluarës së lavdishme, është pikëzuar me vizatime të gjera e madhështore, me ngjyra të plota e të vrazhda, me ashpërsi të mbyllëta e tragjike. Është një popull luanësh që lufton me energji të pashtershme e të pamposhtura kundër turqve. Ky popull heroik e mbron tokën e vet pëllëmbë për pëllëmbë, e vadit me gjak. E mbron atdheun e vet me shpatë, me zjarr, me dhëmbë e me thonj, me shpirtin e pamposhtur dhe të paepur, me një besim të patundur në të drejtën e vet dhe të arsyes së vet. Luftëtarë me burrëri të vjetër, heronj me fisnikëri klasike na parakalojnë të shpejtë ashtu si stuhitë e tmerrshme. Ata bien, në emër të atdheut, me gjoksin e mbushur plot urrejtje kundër të huajit, kundër pushtuesit osman. Heronjtë nuk hyjnë në veprim shpesh. Ngandonjëherë ata na paraqiten si hije të zbehta dhe të zymta që, pastaj, në veprime vendimtare, shkëlqejnë prej dritës plot rreze të një dore mjeshtri, të një poeti artist. Krijimet që përfshihen në tridhjetë e dy këngët e poemës «Skënderbeu i pafat», janë pjesë të një realiteti, realitet heroik dhe luftarak, por edhe thjesht familjar e vetjak. Janë pjesë që poeti i hartoi dhe i brumosi si pa ndonjë radhitje dhe kujdes njësimi, por që shënojnë një etapë të shndritshme në udhën e lartësimit të artit të tij, art që bëhet gjithnjë e më objektiv dhe më i kthjellët. Në këtë mënyrë, poema është përpjekur të japë një pamje të gjerë të Shqipërisë së shekullit XV. Në të poeti

sitemoi rishtazi, trajtoi edhe një herë ose shkriu disa nga këngët dhe nga poemat e botuara më parë, në të cilat frymëzimi kryesor kishte qenë, gjithnjë, Shqipëria, lavdia, kishin qenë fatkeqësitë, shpresat, qytetërimi, jeta e saj si vend i lirë e i përparuar. Vepra s'ka vazhdimësi e njësi veprimi, ajo s'ka karakterin e një poeme epike, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.

Poema përfundon në një mënyrë të papritur dhe të lë përshtypjen e një vepre organikisht jo të plotë, të cinguar. Gualtieri e quan «galeria e Skënderbeut». Argumenti është, si e thamë, Shqipëria e shekullit XV, lufta e saj heroike kundër agresioneve turke. Ai s'është shtjelluar në një aksion të vazhdueshëm e të unjshëm, që të shërbejë si bosht i episodeve të ndryshme, po në një seri pikturash më vete. S'gjemë aty as harmoni të vijave. Poezitë që përbëjnë veprën u shkruan në kohë të ndryshme: në idetë e punën e tyre lanë gjurmë ngjarjet e atmosfera e kohëve kur u shkruan, mendimet e gjendja shpirtërore në këto kohë. Markiano thotë se në «Skënderbeun e pafat» kemi krijime, të cilat qëndrojnë si statuja homogjene në galeri të njëpasnjëshme, të vendosura në mënyrë që të përfytyrojnë aspekte të ndryshme të jetës. Lexuesi mbetet i mahnitur nga fuqia krijuese e De Radës, madhështia e konceptit të tij, përpjesëtimet e afreskës që del prej gjithë këtyre pamjeve, nga shumësia e skenave dhe galeria e admirueshme e figurave që lëvrijnë në to.

Vepra «Skënderbeu i pafat» është, më tepër se një poemë, një cikël konceptimesh epiko-lirike, që ka analogji pjesërisht me «Legjendën e shekujve» të Viktor Hygoit, me ndryshimin se këtu flitet vetëm për një shekull e për një popull, për Shqipërinë e shekullit XV.

Skenat episodike i japin veprës karakter të gjerë epiko-lirik dhe narrativ. Skënderbeu nuk është, siç mund të lërë të kuptohet titulli, figura qëndrore e poemës, protagonist i rreth të cilit zhvillohet subjekti, po simboli që lidh episodet e ndryshme. Njësia e poemës qëndron këstu në idenë për të kënduar, në episode të ndryshme qëndresën e popullit shqiptar kundër hordhivë osmane. «Skënderbeu i pafat» është një roman në vargje, me ndodhi të vërteta, të trilluara, me personazhe realë dhe imagjinarë, me copa përshkruese dhe tregimtare, me qëndrime subjektive dhe objektive të poetit, me figura letrare, me elemente kalorësiake dhe romantike, me idealizime dhe hiberbolizma, me paraqitje dokesh e zakonesh si dhe gjendjesh të thella shpirtërore, me botën e brendshme të personazheve. Vepra përshkruan Shqipërinë e shekullit zulumëmadh, me lavdinë dhe heroizmin e saj, me fatkeqësitë dhe shpresat, me qytetërimin dhe jetën saj të gjallë, kur ishte e lirë dhe e pavarur, nën prijësin e vet. Grindjet midis shqiptarëve dhe venecianëve, të cilët nuk lëviznin me qejf kundër turqve, tregojnë se vetëm vendasit qenë ata që flijoheshin për mbrojtjen e vatrave të tyre. De Rada ka ditur të paraqesë artistikisht hovin luftarak, me të cilin shqiptarët mbrojtën vendin e tyre. Burrat dhe gratë që përshkruhen aty, janë nga ata që luftuan kundër turkut për të mbrojtur nderin e Shqipërisë dhe të shqiptarit. Edhe në këtë vepër, poeti për pjesën më të mirë të personazheve u frymëzua nga rapsoditë popullore, pjesërisht nga historia. Poema është konceptuar në formën e një afresku të gjerë, të sajuar prej tablosh të ndryshme, të lidhura midis tyre me një bosht të padukshëm: motivi i qëndresës kundër turkut në shekullin XV. Te «Skënder-

beu i pafat» ideja e çlirimit të atdheut ka gjetur mi-shërimin e saj më të fortë.» Tablotë e përpjesëtimeve të gjera, skenat e larmishme dhe personazhet e shumta që lëvrijnë në to, kanë ndihmuar që kjo ide të zbulohet me forcë e plasticitet të veçantë dhe të krijohet kua-dri epik i shekullit të madh të Skënderbeut, të cilit ve-tëm një fuqi e rrallë krijuese si ajo e De Radës mund t'i jepte jetë të vërtetë në art. Situatat që krijon poeti në vepër, kontrasti i skenave e zgjidhjet e goditura ko-mpozicionale, çojnë në mënyrë të natyrshme në idenë patriotike, në idenë e çlirimit të atdheut të të parëve nga zgjedha e të huajit»¹⁵.

De Rada e ka pasqyruar shekullin XV në plan të gjerë, duke ndërthurur motivin patriotik me motivin sho-qëror, motivin filozofik me motivin etik. Kjo duket, në më-nyrë të veçantë, te «Skënderbeu i pafat», ku poeti jo vetëm që ka parë disa kontradikta të epokës, si përçar-jen midis feudalëve, rolin e pabesë të Venedikut, por ka hedhur dritë, në ndonjë rast, edhe mbi ndonjë nga kontradiktat klasore të kohës, p.sh. duke dënuar rreptë shfrytëzimin feudal përmes rrëfimit të Gjon Kastriotit. De Rada ka meritën se është i pari në letrësinë artis-tike shqiptare, që trajtoi figurën e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit. Megjithëse vendi që zë Skënderbeu në poemë është i vogël, prapëseprapë ai dallohet me të-rë madhësinë e tij. Skënderbeu është i veshur me ka-rakterin që i jep historia. Ai është heroi, që mendon një hakmarrje të tmerrshme. Është një kolos, përpara të cilit diidhet toka e të cilit i qesh, për një çast, fati tragjik i atdheut. Figura e tij del në pah, sidomos, në dyluftimin me dy tartarë. Skënderbeu nuk është heroi që

15) Akademia e Shkencave «Historia e letërsisë shqiptare» I, 158, Tiranë, 1976.

i jep emrin eposit, por simboli përmbledhës i kësaj poeme, prej së cilës na paraqitet në episod me një gjerësi dhe dinjitet të vërtetë epik. Poeti i jep gjallëri skenës. Hyn thellë në shpirtin e heroit dhe na elektrizon me fuqinë e pamatur të skenave të tij, duke na ngritur, me të vërtetë, ndër majet e eposit. Brohoritjet, me të cilat e presin bashkatdhetarët Skënderbeun, kur nis dyluftimin, si edhe përshëndetjet, në fund, mbas triumfit të betejës mbi dy tartarët, tregojnë qartë dashurinë e madhe që kishte ky hero midis luftëtarëve të vet shqiptarë dhe lidhjen e tij të ngushtë me masat e ushtrisë, që e donin, e nderonin dhe i bindeshin plotësisht. De Rada na ka dhënë një tablo të gjallë të luftës, një kuadër epik, një poezi të fuqishme, që shpreh forcën e vet krijuese. Përshkrimi është i natyrshëm. De Rada ruan nga Barleti deri shprehjen: «e, megjithëse Kastrioti rrëfente me fjalë e me të parë një shpresë të pamasë, prapëseprapë zemrat e të pranishmëve i preku një kujdes i përzier me dhimbje». Poeti ruan nga Barleti edhe krejt vënien në skenë të heroit, me përjashtim të flamujve të shëmtuar, bërë me lëkura njerëzish, ideja e të cilëve do t'i ketë ardhur De Radës nga ajo që tregon Herodoti për skytët.

Kënga «Dyluftimi i Skënderbeut me dy tartarë» shquhet për forcën epike, për gjuhën e gjallë e shprehëse, për frazeologjinë e pasur, për stilin e rrjedhshëm, për figurat e natyrshme, për onomatopetë dhe aliteracionet e fuqishme. Por krahas me forcën, krahas me popullaritetin e madh, heroi ynë shquhet edhe për zemërgjerësi dhe për madhështinë shpirtërore e morale. Kur kundërshtari, i mundur dhe i gjunjësuar përpara Skënderbeut, i kërkon mëshirë, heroi ynë e fal. Këto faqe përshkrimi

janë me të vërtetë të mrekullueshme. Në këtë pjesë, De Rada kulmon në poezinë epike. Idealin e vet të pri-jësit të urtë, të lidhur me popullin, De Rada e mishëron në figurën e Skënderbeut, prania e të cilit, edhe pse ai shfaqet rrallë, ndihet përmes qëndrimit të personazheve të tjera. Në vizatimin e kësaj figure, që gëzon një origjinalitet të veçantë, poeti ka alternuar ngjyrat hiperbolike legjendare me notat e thjeshta njerëzore. Duke pasqyruar në një vepër të përmasave të tilla figurën e heroit të qëndresës shqiptare të shekullit XV, De Rada çeli një traditë që u ndoq nga gjithë letërsia e Rilindjes, c cila e vuri në qendër të saj figurën e Skënderbeut, si simbol të lirisë dhe të shpirtit luftarak e të panësh-truar të popullit tonë. De Rada ia kushtoi poemën jo bëmave të Skënderbeut, por emrit të tij, Heroit Kombëtar, heroit të të gjithë shqiptarëve. Te Skënderbeu poeti shihte simbolin e ringjalljes shqiptare. Për meritën e De Radës, figura e Skënderbeut dhe epoka e tij u bënë frymëzim gati për gjithë letërsinë shqipe të mëvonshme.

Duke u frymëzuar nga heroizmat e personazheve të rapsodive, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, flitnin edhe për Skënderbeun, De Rada, në poemën «Skënderbeu i pafat», krijoi një galeri perso-nazhesh që s'i kishte parë deri më atëherë letërsia shqiptare. Këta personazhe, me shembullin dhe heroizmat e tyre, ngjallën ndenjën e dashurisë së thellë për atdhe, të flitimit dhe të vetëmohimit për të. Një hero tjetër i denjë për Homerin, është Radavani, Markiano i thotë i entuziazmuar: «Kurrë ndonjë poet nuk skaliti me shpirt të dridhur një luftëtar si hero i Janinës, që qëndron i patundur në mes breshërit të shigjetave dhe ve-tëtimës së topave». Dhe më poshtë: «Të duket sikur po

dëgjon borinë epike të Homerit, zhurmën e armëve të heronjve të tij. Figura e këtij heroi merr një pamje sublime, kur shigjetat largohen të trembura prej tij». Një trim tjetër është Astiri, që spikat me dy ndiesitë e thella të shpirtit të tij: dashurinë e patriotizmin. Figura të dyta ndër burrat janë Bozdari e Xhibraltari. Më e larmishme, e gjallë dhe e pasur në figura është galeria e femrave. Te «Skënderbeu i pafat» tipi femëror merr një varietet të mrekullueshëm, fizionomish e karakteresh. Poeti pikëson me një mjeshëtri të rrallë format e ndiesitë e tyre, gdhend me daltë të sigurt botën e tyre të brendshme. Pikturat e figurat marrin jetë. Shpesh e njëjta figurë merr qëndrime të ndryshme, na zbulohen anë të ndryshme të karakterit të saj. Plot fisnikëri del figura e Imotesë. Plot hir e pasion është Agata e Pravatës. Frosina është e dëlirtë dhe me dinjitet. Goneta është martirja, posqyrë e mjerimeve që kanë pllakosur mbi Shqipërinë e pushtuar. Një notë të veçantë sjell Viola Oderizi. Po figura më delikate e më e përkryer është Gavrila, e bija e princit të Danjës, si për bukurinë e konceptimit ashtu edhe për realizimin e saj artistik. Në «Skënderbeun e pafat» kemi De Radën poet të pjekur, me një penel shumë të pasur, të aftë të dalë nga vetja e vet e ndiesitë e veta, për të depërtuar në botën e brendshme të tipave më të ndryshme, për të krijuar skena e figura nga më të larmishmet e për të gjetur parafytyrime të reja. Pranë poetit lirik është rritur poeti epik e ai dramatik». ¹⁶

Te De Rada shihet një horizont letrar i gjerë. Në disa figura e motive të poemës së tij vihen re gjurmët e poe-

16) USHT, Historia e letërsisë shqipe, II, f. 111, Tiranë 1960.

mave italiane të Rilindjes, sidomos të Ariostos e të Tassos. I trajtuar në letërsinë evropiane është dhe motivi i dashurisë fatkeqe të një çifti që rrjedh prej dy familjesh armike, motiv që te poeti ynë na del në figurat e Bozdar Strezit e të Serafina Topisë në Artën e kohës së Skënderbeut. Heronjtë turq Almazore e Algazile, që dalin te «Skënderbeu i pafat», me emrat e tyre na shpjen në botën arabe të Spanjës mesjetare si na del te Romancero e Cidit. Emri i Aidesë, që del si e motra e Skënderbeut, na kujton poemat e Bajronit. Nuk mungojnë dhe reminishencat e botës klasike, si motivi i Psikës, frymëzuar nga «Gomari i artë» i poetit Apuleius. Ideja e fatit (moira) si na shfaqet në dramën greke, sidomos te Sofokliu, depërton edhe kjo në veprat e poetit. Edhe bibla ka lënë mbresa të thella tek ai. Në poemën epike-narrative dramatike «Skënderbeu i pafat», lirizmi shprehet kryesisht nëpërmjet këngëve që këndohen dhe që herë kanë lidhje me kallëzimin, herë janë të shkëputura. Ndër krijimet më të bukura lirike është piktura e Psikës, që vizaton një piktor i Gjakovës në burg, në mes të mjerimit e robërisë së Shqipërisë.

Pas kritikave që iu bënë veprës «Skënderbeu i pafat» për mungesë organiciteti e për kompozicion të shthurur, De Rada mori nga poema gjithë ato pjesë që mendonte se mund të shkonin bashkë e lidheshin me të njëjtin argument, me rënien e Shqipërisë nën robërinë turke, i ripunoi, i risistemoi, shtoi dhe botoi me to, në revistën «Fjamuri i Arbërit», një vepër të re, së cilës i vuri titullin «Rënia e mbretërisë së Arbërit». Poema ndahet në dy libra me katërmbëdhjetë histori. Po edhe në këtë vepër mungon një veprim kryesor që të shërbejë si bosht i gjithë ngjarjeve, ka fragmentarizëm e paqartësi. Me

gjithë këto, në poemë nuk mungojnë skena e figura të një konceptioni fisnik e të një realizimi artistik të bukur. Mjafton të përmendim historinë e Astirit e të Gonetës, figurën madhështore të Radavanit, që Markiano i thotë se mund të matet me heronjtë e Iliadës, e sidomos kuadrat e mahnitshme të Psikës.

Në vitin 1891, De Rada botoi dramën historike «Sofonisba». Vepra hapet me një parathënie kushtuar princeshës Adele Pinjatelit Strongoli, e cila kishte prejardhje shqiptare: «Uroj që fati, princeshë e përndritshme, të ketë ngritur në personin tuaj mbështetje për kombin tim. Ju e dini se unë, me një punë që vazhdon prej më tepër se një gjysmë shekulli, kam rimëkëmbur gjuhën shqipe, me qëllim që të përgatis ringjalljen ose rilindjen e pashmangshme të popullit tim». De Rada thekson se është hapur një shkollë shqipe në kolegjin arbëresh të Shën Adrianit, e cila, për gjuhën amtare, do të jetë «një flamurtare e vetë ekzistencës. Me gëzimin e këtij fati të mirë, — shkruan autori, — unë mendova se kjo është koha më e përshtatshme të paraqesim edhe ne ndonjë përngjasim besnik të vetes sonë. Këtë dramë — vazhdon De Rada — e sprovova unë i pari, duke e shndërruar në një tragjedi njerëzore që ka tronditur dhe vazhdon të trondisë zemrën e jetës së njeriut». Sipas pohimit të tij, veprën «Sofonisba» e ka hartuar, së pari, shqip, pastaj e ka përkthyer në italisht: «Brenda kam futur shpirtin e thjeshtë shqiptar dhe e bëra të flasë (e si mund të veproja ndryshe unë?) gjuhën e vërtetë e të qartë shqipe. Sot vepra është e gatshme. Dhe, sikur nëna i dorëzon djalit të vet të ri shpatën dhe mburojën për të dalë në mbrojtje të qytetit të vet, ashtu edhe unë po e nis, duke pasur besim në drejtësinë».

I denë fillestare të dramës «Sofonisba» De Rada e ka pasur qëkurse ishte 30 vjeç, dhe e pati shprehur në dramën «Numidët», botuar më 1847. Megjithëse vepra nuk frymëzohet nga atdheu i të parëve, prapëseprapë De Rada synon të pasqyrojë shpirtin shqiptar. Prandaj heroinës së vet, Sofonisbës kartagjenase, autori i jep disa nga tiparet më të mira të vajzës shqiptare: dëlirësinë, forcën e karakterit, stoicizmin. Te figura e protagonistes, De Rada mishëron idealin e vet të gruas shqiptare, prandaj ajo ngjan si një motër ideale e «Serafina Topisë», si kanë vënë re edhe studiuesit deradianë, Markianô e Gualtieri.

Pas vdekjes së De Radës, më 1906, u botua poema e tij «Gjon Huniadi». Ajo ka 579 vargje. Siç e dëshmon edhe titulli, lexuesi menjëherë e kupton se De Rada është frymëzuar nga ngjarje të shënuara historike dhe pikërisht nga beteja e Nishit, në brigje të Moravës, ku besëlidhësit, kryesisht ballkanas e danubjanë, nën komandën e heroit Gjon Huniadi, përleshën me pushtuesit osmanë (nëntor 1443) dhe Skënderbeu nga sheshi i betejës, me të treqind besnikët shqiptarë, kthehet në Krujë duke nisur epopenë e famshme shqiptare. Vepra postume «Gjon Huniadi» nuk ka pasurinë e ideve dhe të karaktereve të veprave të tjera të De Radës, por spikat për qartësinë, unitetin dhe forcën epike. Karakteret jepen me pak viza, po janë të skalitura. Poema ka ngjyrën e vet të veçantë që e vlen t'i shtohet tablosë së madhërishtme që paraqesin së bashku veprat e De Radës. Me të drejtë shëncn Markiano i që «figura e Huniadit në kullë, lirimi i tij, bujaria e Skënderbeut, përshkrimi i betejës dhe vërshimi i Danubit, konceptim tepër origjinal, si edhe guximi i pashait, dëshmojnë për një talent poetik me

fuqi të rrallë». Për hartimin e poemës, De Rada u mbështet kryesisht te Marin Barleti. Poema ka elemente demokratike, përparimtare dhe humanitare. Vepra ka organizimet. Poema është e gjinisë epike narrative, në të cilën ndihet i fuqishëm ndikimi pozitiv i eposit të lashtë.

Një nga veprat më të mëdha të De Radës, e pabotuar deri më sot, është epistulari i tij, i përbërë prej shumë letrash. Në këtë korrespondencë të gjerrë dhe të rëndësishme ka letra nga shkrimtarë dhe dijetarë arbëreshë. Një botë e tërë e qindvjetit të nëntëmbëdhjetë dallohet në këtë pasuri kolosale të kulturës sonë shpirtërore, një panoramë e gjallë e lëvizjes mendore, intelektuale, letrare, shkencore del në pah përmes këtij epistulari me vlerë. Lidhjet e arbëreshëve të Italisë, me shqiptarët e Atdheut të të parëve, me Shqipërinë, si dhe me atdhetarët e ngulimeve shqiptare të Rumanisë, Egjiptit, Turqisë, me arbëreshët e Greqisë, spikasin në letrat e shkrimtarëve dhe të rilindësve tanë të shquar. Këto letra hedhin dritë mbi veprimtarinë letrare e atdhetare të De Radës në të mirë të çështjes shqiptare. Veç kësaj, ato sjellin të dhëna me interes për historiografinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Këto materiale dokumentare dëshmojnë për vijën e përbashkët që ndoqën luftëtarët tanë të shekullit të kaluar për përhapjen e ideve kombëtare shqiptare dhe për njohjen në opinionin publik evropian të traditave historike të popullit shqiptar. Një pjesë e mirë e korrespondencës përfshin letra nga albanologë dhe dijetarë të ndryshëm, historianë, gjuhëtarë, folkloristë, kritikë letrarë, burra shteti, diplomatë, juristë, etj. Nga gjithë ky letërkëmbim i gjerë shihet qartë shqetësimi i De Radës për çdo gjë që i përket

gjuhës shqipe, atdheut tonë dhe shqiptarëve. Në radhë të parë, ai interesohet për çështjen e çlirimit të mëmëdheut të vet. Kjo është pika kryesore. Ai flijon çdo gjë për t'ia arritur këtij qëllimi të lartë, që i ka ngarkuar vetvetes. Për këtë ai flet nëpër kongrese, shkruan artikuj dhe vepra të ndryshme, lidh korrespondencën me njerëz të njohur të kohës së tij, që interesoheshin për vendin dhe kulturën tonë. Këtë karakter kanë, në përgjithësi dhe në veçanti, veprat e shumta të tij. Krahas me të, ai ka kujdes për zgjimin e popullit tonë nga errësira shekullore. Ai e di se pa arsim, pa kulturë, pa letërsi, s'ka si ecet përpara. Prandaj ai çel kolegje-konvikte, gjimnaze, shkolla shqipe, themelon katedra, organizon kuvende studimore për gjuhën amtare, boton fletore e të përkohshme. Në këtë mënyrë, bëhet pishtar i çështjes shqiptare. Ai pohon dhe mbron tezën se gjuha jonë është shumë e vjetër. Për këtë qëllim boton gramatika, të cilat ua dërgon gjuhëtarëve dhe albanologëve të kohës, që të njihnin më për së afërmi shqipen me prejardhje të lashtë. Në letrat e tij të shumta ai shtron probleme nga më të rëndësishmet, që kanë të bëjnë me Rilindjen tonë Kombëtare, me lëvizjen atdhetare, çlirimtare, përparimtare, kulturore, letrare, gjuhësore. Ai është plotësisht me idetë dhe idealet e rilindësve tanë të mëdhenj. De Rada ndiqte me vëmendje punën e frytshme që bënë patriotët e kësaj kohe për zgjimin politik e kulturor të masave të popullit tonë, për forcimin e lëvizjes së çlirimit kombëtar, për ngritjen e prestigjit të Shqipërisë në botë.

Krahas krijimtarisë letrare, De Rada u mor edhe me veprimtari shkencore, përpiloi një varg punimesh gjuhësore rreth shqipes. Nën këtë titull, ne nënkuptoj-

më shkrimet e tij me karakter filologjik, veprat gramatikore, fjalorin e rapsodive, konferencat e tij për lashtësinë e shqipes dhe të popullit tonë si edhe punën e madhe që bëri për alfabetin e gjuhës shqipe. Edhe në fushën e gjuhësisë, veçanërisht në lëmin gramatikor, De Rada dha një ndihmesë të vyer. Puna e tij, në këtë drejtim, qe mjaft frytdhënëse. Ajo duhet çmuar dhe vlerësuar veçanërisht për njohjen e të folmeve të ndryshme të arbëreshëve të Italisë në format fonetike, morfologjike dhe leksikore. De Rada u kushtoi një kujdes të posaçëm çështjeve të prejardhjes së shqipes dhe të shqiptarëve. Dhe këto i ndoqi me zell gjatë gjithë jetës së tij. Me gjurmimet e tij, ai arriti të zgjojë kureshtjen e botës shkencore të dijetarëve të kohës, d.mth. të shekullit XIX. Vepra e tij gjuhësore do të mbetet në historinë e albanologjisë si një përpjekje fisnike e një shqiptari të madh, i cili arriti të vërë një gur në themelet e shkencës gjuhësore shqiptare.

Jeronim de Rada është poeti dhe atdhetari më i madh i arbëreshëve të Italisë. Në veprat e veta letrare shprehu në mënyrë të lartë artistike dashurinë për atdheun, shpirtin e flijimit për idealet e çlirimit dhe të lulëzimit të Shqipërisë. Romantizmi i kohës e ka përshkuar mbarë krijimtarinë poetike të tij. Romantizmi i De Radës është jetëdhënës, luftarak. De Rada është një nga shkrimtarët tanë të mëdhenj, që e ndihmoi gjuhën amtare të shprehë ndjenjat e larta, me të cilat afshi për dashurinë e kombit dhe të vendit e kishte frymëzuar. Ai ka qenë i pari letrar arbëresh që përdori me një mjeshtëri të rrallë gjuhën e thjeshtë të krahinës së tij, për të shkruar vepra letrare, që kaluan rrethin e ngushtë shqiptar dhe hynë në kuadrin e letërsisë botë-

rore. I nxitur nga ideali i vendit të të parëve, De Rada punoi pa u lodhur kurrë për t'i dhënë, me shkrimet e veti, përparim letërsisë sonë e emër e nder tokës arbërore. Vepra letrare e De Radës lindi dhe u zhvillua në atmosferën e romantizmit dhe, me tiparet kryesore e shumicën dërrmuese të elementeve, hyn në këtë drejtim letrar. Me romantizmin, kuptohen e shpjegohen frymëzimi, përmbajtja e forma e saj. Ajo i përket romantizmit përparimtar, duke u frymëzuar nga jeta personale e poetit dhe nga idetë e lëvizjes kombëtare të popullit tonë. Ngjarjet e poezive të tij, De Rada i vendosi kurdoherë në gjysmën e parë të shekullit XV, në kohën e luftërave të popullit tonë kundër turqve dhe u përpoq të ringjallë me artin e tij një epokë aq të lavdishme të historisë sonë, me skenat e çastet më dramatike e epike të saj, për të fuqizuar krenarinë e vetëdijen kombëtare ndër bashkatdhetarët e për të afirmuar, para botës së huaj, të drejtat e Shqipërisë. Ndjenja e atdheut përshkon gjithë botën poetike të tij. De Rada ia kushtoi jetën çështjes kombëtare, krijimit të një letërsie artistike kombëtare shqiptare, misionit të realizimit të Rilindjes së Shqipërisë. Figura e De Radës ngrihet lart si figura më e kulluar, më e fuqishme e letërsisë arbëreshe, e botës arbëreshe, si një nga figurat më të bukura të Rilindjes sonë. Ai i vuri themelet letërsisë së re artistike arbëreshe me frymë kombëtare. E mbështeti krijimtarinë e vet letrare në poezinë popullore, në atë të arbëreshëve të Italisë, dhe hapi kështu një rrugë të re që do të ndiqej edhe nga poetë të tjerë.

De Rada është poet i temave të mëdha, të cilat i realizon nëpërmjet pasqyrimin të tablove të gjera jetësore. Vepra e De Radës ka përpjesëtime epike. Pasqy-

rimi i situatave, i rrethanave, i veprimet të heronjve, i ngjarjeve, kalimet nga një vend në tjetrin dhe nga një kohë në tjetrën zënë një pjesë me rëndësi të veprave dhe janë elemente kryesore të shprehjes poetike të subjekteve. Poemat e tij këndojnë ndjesinë e kulluar atdhetare dhe e paraqesin Shqipërinë me vuajtjet e saj, me dhimbjet e zgjedhës turke. Ato lartësojnë qëndresën e popullit shqiptar kundër rrebeshit osman. Poeti ia kush-ton mendjen e zemrën e vet atdheut. I fal lavdërime përmes veprave epike. Poemat zhvillohen me një shpirt kalorësiak. Heronj legjendarë, luftëtarë sypatrembur, patri-cë e plebej shqiptarë, shtëpi në zë e të përmendura, po edhe fshatarë e qytetarë të thjeshtë, përshkruhen me shprehje të thella, me parafytyrime mitike, që zbu-kurojnë e pasurojnë epikën reflekse shqiptare. Në poe-mat e De Radës vërehet një arradhë e pamatur shqip-tarësh që luftojnë kundër pushtuesve turq, po edhe ve-nedikas. Atmosfera epike gërshetohet me gjendje lirike dhe dramatike të një tragjiciteti të theksuar. Dëgjohen jehe lumturie të përziara me britma vuajtjesh. Poeti pas-qyron shpirtin shqiptar me përfytyrime të reja e shpreh-je origjinale. Ndjenja atdhetare, si gjithmonë në veprat e poetit të madh arbëresh, është e fortë. Ajo shpreh madhështinë e luftëtarëve trima e të paepur të Shqipë-risë. Epika e këtij shkrimtari të madh, e mbrujtur me një frymë poetike të lartë, ruan rëndësinë e vet për ndjesinë atdhetare të shprehur estetikisht. Ajo krijon rilindjen e shqiptarizmit, ngazëllimin e shfrimit kombë-tar. Skenat e luftimeve, situatat tragjike, dinamizmi veprues, karakteret e spikatura të personazheve, burimet historike nga Barleci, toponimet dhe antroponimet, his-toria dhe epopeja e lashtë, – të gjitha këto dhe të tjera

paraqesin epizmin e poemave deradiane. Poeti i madh arbëresh na e ka dhënë historinë e Shqipërisë nëpërmjet historisë së heronjve dhe heroinave të veprës së tij, nëpërmjet fatit, mendimeve dhe ndjenjave të tyre. Poemat e tij ndryjnë në vetvete elemente të theksuara të eposit heroik e dramatik klasik. De Rada dha përfytyrime poetike të mëdha të jetës, depërtoi në mjedise, rrethana shoqërore e historike, duke krijuar kështu një tablo plot relieve të Shqipërisë së shekullit XV. Interesat e poetit të madh arbëresh qenë të pakufizuara. Ai qe poet i mendimeve të mëdha, i përfytyrimeve të gjera dhe i përgjithësimeve të fuqishme filozofike-artistike. De Rada është kryesisht poet lirik, poet delikat, poet i ndjesive të holla njerëzore. tek ai duhen parë të shkrira më një lirizmi dhe natyra, lirizmi dhe marrëdhëniet e personazheve. Poezia e De Radës është një poezi lirike, e vërtetë, e çiltër, poezi e sintezës, e përgjithësimeve dhe e figurave të gjalla të mendimit. Në veprat e tij dramatizmi është si përftesë e epizmit dhe e lirizmit. Në të dallohen dialogu i brendshëm ose lirik, dialogu tregimtar, dialogu përmbledhës. Pjesë e dramatizmit të tij janë edhe këngët e personazheve si edhe këngët e korit. Në të gjitha poemat e De Radës ndrisin vise-vise shkëndijat e një poeti me frymëzim gjenial, arti i të cilit konsiston në ndriçimin e disa pamjeve e figurave e në lënien e të tjerave në errësirë. Kritika ka vërejtur prej kohe lakonizmin e shprehjes deradane. Kështu ka lindur pikëpamja e drejtë se idetë e De Radës, rëndom, janë të mjeguallta, se në veprën e tij duhet lexuar edhe midis radhëve të pashkuara.

Në formimin letrar të De Radës janë shkrirë, në formë origjinale e të freskët, traditat e poezisë sonë popullore, elementet e theksuara të letërsisë antike,

klasike greko-latine dhe këto, pastaj, i kanë dhënë romantizmit të tij atë fytyrë vetiake, që e dallon De Radën nga çdo poet romantik shqiptar. Në këtë veçori themelore të poezisë së arbëreshit të madh gjejmë një harmonizim të habitshëm të «ftohtësisë» klasike në të dukur me shpirtin romantik, shprehës i të cilit ka qenë poeti. Si me përmbajtjen ashtu edhe me formën e saj, vepra poetike e De Radës, objektivisht është përpjekja më e madhe në historinë e letërsisë arbëreshe. Përbërësit epikë, lirikë dhe dramatikë të strukturës së poemave të tij dëshmojnë qartë se ai përpiket të bëjë sintezën e tri gjinive themelore në poezinë shqiptare. Poezia e De Radës i ngjan detit ku, sa më thellë futesh, aq më i kthjel.ët bëhet. De Rada është lirik edhe kur flet për luftën, mbështjell me hijedritë dramat më të forta njerëzore e prapë mbetet lirik. Përmes një gërshetimi të natyrshëm të dialogut e të monologut psikologjik, të elementit epik narrativ e të meditacionit lirik, De Rada alternon me mjeshtëri, ashtu siç ndodh në jetë, dhe shkrin në një unitet artistik rrëfimin dhe mendimin, objektin dhe subjektin. De Rada mbetet figura më e madhe e letërsisë arbëreshe të shekullit XIX dhe një nga figurat më të mëdha të Rilindjes sonë Kombëtare.

Prof. JUP KASTRATI



KËNGËT E MILOSAOS

poemë



**Përshtatur
në gjuhën e sotme nga
Prof. DHIMITËR S. SHUTERIQI**



1942

1943

1944

1945

1946

1947

1948

1949

1950

1951

1952

1953

1954

1955

1956

1957

1958

KËNGA I

Bota kish ndërruar lisa,
uji i ri në det
kaltëronte n'ditn' e re;
por lumbardha e Anakreontit
në Temp rronte e moçme.
Nd'uj një dit' vate te mali
e s'u kthye si e kish zakon.
Veç që atë s'e thau bora,
s'e përgjaku heshtëza,
po u largua gjersa ra
tek e bardha shpia ime.
Kur n'agim tokë edhe shpi
u zbuluan bashk' me detin,
si hareja që del sysh,
më zgjoi duke fërfëlluar
qelqeve t'dritares.
U pataksa e ruajta jashtë:
rrusht', pak aguridhe,
dheut tonë i kishin hie;
lule liu të hapura,
n'i tund era e i përzien,
në atë ninull qeshin
si ato lule – qielli.
Ti vështroje dhe s'kujtoje

asnjë mbëhi njerëzish.
Kallëzoret nëpër duajt
po këndonin. Dheut huaj
ahere ndër time motra
kisha arritur; mëma ime
emrin tim thosh nëpër shpi.
Një hare më rodhi kurmit,
si hareja kur te shtrati,
mbrëmanet, vajza e ngrohtë
ndien për të parëzën
sisët që m'i fryhen.

KËNGA II

Vreshtat ishin verdhëllore.
Erdh nga mali dhelpëra
me të lodhurat të bijat,
me të mbaruar të vjelat;
e at'here kur ndër sheshe
fshihet dielli (si nën tokë
mëmat që kënduan në valle),
kur në Fjokat unë rashë.
E përveshur e e lartë,
me gërshet të pleksur
në një lidhëse të bardhë,
ish te kroi një vash'. Te balli
një mendim i kishte hie.
I lidhur te brezi i kaltër,
mbi truall i çik mandili.
Posa që më ndiejti,
vasha drejt nga unë u suall,
gjifyrë edhe plot hie,
me një të trembur hare.
Trimi – Vajzë, a m'ep ti një pikë ujë?
Vajza – Sa të duash ti, bir zoti.
– Kuja bijë je ti, vashë?
Mos më je nga dheu i huaj?
Kur, djalosh, në Selanik

vajta, vashëzat nuk ishin
në katund me kaq hir.
Në çeret e ndezur,
vucën ajo ngrinte:
– Jam e bijë e Kollogresë,
ngriti ballët e zbuluar.
Duke shkuar asaj udhe,
gjembat që vareshin udhës
s'e gërvishtnin atë çupë:
me llërët përgjakur,
unë nga ballët ia reshtja.
Dy buzë të qeshura,
njëj here të bardhë,
atë mbrëmje dukeshim.

KËNGA III

Ishte mbrëmja e shën Mërisë.
Vashat kishin lënë lodrat
e te dyert kuvendonin,
se nuk qenë në shtëpi
etërit e vrenjtur.
Kudo niste një nxitim:
ndaheshin ar e kandile,
tek ne pritej nata.
Bija madhështore zonjash
përdorez do luanin
me të nderëm bij bujarësh.
Ashtu si engjëjt në qiell,
më të mir' nga njerëzit,
bëjnë veç harenë e tyre.
Dola në Rodh e, te kopshti,
ku po frushullonte elbi,
eca nën ullinj të.
Posht' te kroi, me katër vasha,
me të bardhë cipë kreit,
erdh e bijë e Kollogresë.
Dukeshin kallëz të pjekur.
Vajza – Fatmirosh ai që ra del;
mbi Rodhen e gjethëruar
si flamur i Arbërit!

Fatmiroshe ajo çupë,
që, e puthur nga e ëma,
do pushojë n'atë krah!
Nga do niset, e magjepsur?
Nga Veriu si deti,
apo nga e bardha Jugë?

KËNGA IV

Ish e diela menatë
e i biri i zonjës madhe
ngjitej tek e bukura
të m'i lypë një pikë ujë,
se ish etit djegur.
Vetëm e gjeti te vatra,
që më plekëste gërshetin.
Ata duheshin e s'e thoshin.
Vajza, me buzën më gaz:
– Ç'ke që po ikën si era?
– Më presin në roliet.
– Dy mollë, të ardhura,
qëndro, se t'i ruajta.
Me një dorë ngritur
mbante mbi veshin e bardhë
leshtë e saj të shpleksur,
kalli tjetërën te gjiri
e më hoqi mollëzët,
më ia vu në dorët,
në çeret e ndezur.
Thomni ju, të dashurit,
m'ëmbël ë' të puthurit.

VJERSHË E BIJËS SË KOLLOGRESË

Nga m'erdh te kurmi gjith' ky gëzim?
Si e pafaj unë zhvishem te shtrati
e zgjohem e hareshme se u zgjova,
si ajo që gdhihet me një fat të bardhë.

KËNGA V

Përse të venë në det
mendimet, zemëra ime?
Zbardhuan anijezat,
panë këndeje e u fshehën...
Erdhi dita e Arbërit!
Doemos do vdesim
në shtrat, në mos rënçim
përpara shtëpive tona,
e nën dhe do na harrojnë
shokët e vëllezërit,
krojet e katundi ynë.
Tani që nata e zezë
me shiun e saj të butë
kudo i përbalti udhët,
hapnie ju derën
tek të përhedhurat çupa
lozin të harruara.
Vasha forëmadhja
ma rrëmbefi' nga dora
atë buzëhieshmen
e ma sjellte mua përpara.
Kanë për t'iu ndezur faqet

me atë shenjzën në mes,
kur e drojtur të më qeshë.
Veç në sy të shihemi,
pa dhe bota të përmbysët.

KËNGA VI

Ra bora mbi det
e ndër leshteriqe zbardhi
kraht' e shqitëzës.
Gjumi mua më lodh:
thujse trupi më largohet,
si një gruaje që, Marbelës,
mbrëmjes, i largohet
zhurma e trokashkave
dhe të lehurit e qenve
mbi mullinjtë, e sheh si shuhet
zjarri e ndizet vreshtave.
Jeta akoma s'fjet.
O, vasha kryegështenjë
shtratin butë të ma shtronte,
pra të vihej duke tjerrë
gjysmë në terr e në dritë,
me këngë në gojë!
Të harroja se nën borë
biren krojet e të mbjellat
që na mbajnë jetën;
edhe djemtë e zonjave
Samërankut, që gumojnë,
me tambur vreshtën e largët
e i thonë: – Ne të ruajm'.
I kotur do ëndërritja

se, përdore, fushave
vemë dhe shtëpitë e njerëzve
na faniten më të aguar
edhe yjtë na lënë;
apo se më zgjidhet kali
dhe shkon te një trumë gra,
që përndahen, veç asaj
që i zë lakun e përtrollëm:
syri i bukuri i njeriut,
dhe vështrimi i tij e zbut.
Krahërorin e dërsitur
ajo e fshin me mandil,
e skuqur se po ma shohin.
Ajo vashë zakonbukur
nuk leu ndër të mëndafshta;
porse mua, kur zbardh dita,
në një kasolle të lënë
e të hapur ernave,
prej ku duken, nëpër të,
brinja e bardhë, malet, lumi,
fort ma kënda ta kem pranë
vajzën që më mori zemrën;
ajo mua më ka hije.

KËNGA VII

Kundrejt kodrave e detit,
dita e kaltër gëzoi
valleve të vashave:
i shohin të dashurit.
Në këtë jetë ç'kemi më?
Hënëzën e mbrëmjes,
kur te dera ime dalin
vashëzat e bëshme,
motrat e ushtarëve.
Unë tringëllij kitarën,
ato, të përveshura,
lozin e një ëmbëlsi
faqet ua zbeh. —
Kemi më të mirën ëndërr,
që i sjell trimit vajzën.
Kur shpitë mbyllen, te dera,
në të errët ai e pret,
e ul, prehrin ajo hap:
— Trim, na merr dyzë lajthi.
Ai m'i tregon se ç'bëri
që ta shih e të m'i fliste;
ajo dëgjon e me sy
ruan një yll e një tjetër,
nuk do t'ikë, por dhe trembet.

– Lamtumir', trim, zgjohet mëma. –
bën ajo buzën më gaz.
– Vashë, puthëmë më parë.
Ajo e resht kryethit,
ai e heq e vasha i bie
dalezë te zverku
e pushton trimi në gji.
– Lamtumir'. – Ec me shëndet.
Ai e ruan në të ikur:
u zhduk e njeri s'e pa.
Djali zgjohet e në jetë
atë dit' më rron me mall.

KËNGA VIII

Mu në mes të gurëve
mbiu një re manushaqesh,
shenjë e pranverës së bardhë:
me gazmend i venë vesh
zhurmërimësë së lumit.
Pa një re mali me borë
e butthohet njerëzve:
ata lutin për të korra.
Këtij dimri kam pushuar
si thëllëza te foleja.
Ngriti degt' ulliri i shkundur
edhe vashëza e bukur,
harruar vëllezërve,
duketë në valle
vetëm kur unë e dredh.
Botë e madhe, që s'qetohet
ernave dhe fjalëve,
atë e ka si llambadhe
që hieshon shëllqërorin,
po që jashta shpis' nuk ndrin.
Kur i ngrija fshehur grackat,
qullurë, ullishtave,
sa mezi që merrja frymë
po t'i tundte era vadhët;

lutja për hirin e mëmës
që t'i zija mbrëmanet
plot me zogj të gjallë.
Shkonte vasha mespurtekë,
shtija gur e më mallkonte.
Pra që u rrit, – si më rrëmbou!
Kur e shoh, më ikën mendja,
dridhein e nuk marr dot frymë.
Dita ka diellin që e zbardh
para syve tanë,
porse ç'yll e ruan vashën
edhe mua në këtë mall?
Kur un' dal te Shureza,
vucën merr e vjen te lumi,
porse mb'udhë e trembur
kthehet e vështron katundin.
Luleja e çelur
një të hëne plot hare,
t'enjten, duke u bërë e bardhë,
ku ta dish a e sheh të dielën.

KËNGA IX

Ç'ëndërr të keqe pa trimi!
Dhjetë dit vajza e bëshme,
ndo në arë e ndo në shpi,
rrinte vetëm me gjitonët.
Trimi i paske hipur atit,
të egrit, të tmerrshmit,
te Kroi i Ri t'i jip ujë,
porse ajo, si e kish zakon,
s'vinte më te Kroi i Ri,
po m'i vate në ëndërrët.
Mbrëmanet, një varg me vasha,
të ardhura prej arave,
ne tryeza e t'et të çunit
plot hare u hapën.
S'erdh me to, po tirr në shpi
vajza e mjerë, kaq e dashur, –
si bijtë e të varfërve,
të paveshur, të pangrënë,
thuaj ndarë nga të lumët,
nga zotynë s'shohin mirë,
besën e kanë mbi veten.
Trimi fjeti i helmuar,
në ëndërr pa derën e saj;
te një gur e në Shullë,

zgjidhte nga një tufë rëzë
e m'i vij në prehër.
Ajo ngriti sytë
e më pa të dashurin,
u pruar e uli kryet
e më shkundi rëzën,
thuajse pa një të huaj.

KËNGA X

*Valle e natës
së pashkës
Zgjohu, trim, gëzuarë!
Zotynë la varrinë,
perëndojnë yjezit,
shuheh zjarret, derdhet ujët,
bota vishet ndër të reja.
Po kështu, zemër e dhemshur,
priresh edhe ti e gëzuar.
Si një qni ngarkuar me trima,
që te mesi i detit shohin
fshanë e dëshiruar,
erdhe gjith^r hir e hare,
Po kush të mori më sysh?*

Një pjesë e valles

*Kush porsiti renë e malit
mon' me shi të na kujtonte?
Zonja e madhe u nxitua*

jashtë katundit të vejë,
në një dasmë tok me çupat.
Kishte detinë në sy,
hien e shpisë në zemër,
kur na pa djalin e saj
dor për dore me një çupë.
Vajza ndjeu nd'eshtërat
gazin t'i përshuhet;
si një mermer që mendon
shihte dhe përpara syve
dherat i venin e i vinin.
Djali iku e humbi brinjës:
të përlotur ktheu sytë
qiellit që rrethonte dheun
vetëm, se dielli kish rënë,
yjet edhe s'kishin dalë.
Ish si zemër që mërzitet
nga kjo botë e panjohur
e nuk sheh se ku të vejë.

Gjithë vallja

Ngrehu, levendi djalë!
Vajza që ti dashurove
është' me ne në valle.
E di mir' zonja jot ëmë,
ndonse nuk e thotë,
se ti dole në katund
porsi vera në tryezë
e mbi dhe njeriu me fjalë.

KËNGA XI

Duro, zemër, e duro
sa duroi mali me borë.
Shkrepetinë nëntë diej,
zbardhëlluan kumbullat:
trimi nga katundi i largët
doli e i pa menatë
dhe harroi shtëpinë.
– Lumi unë! – thoshte mali.
Si ai qelqi, që m'i fryn,
bjerr ndriçimin nga hukatja,
porse brenda gjithë ndrit,
ashtu është vajzë e mjerë.
Ka vetëm t'ëmën e t'anë.
Ata e duan. Kujt t'i thotë
«po», në mos u thëntë atyre?
Ajo lë fshatin e quhet
nuse e trimit huaj.
Po na vjen një ditë e kthjellët,
që t'ulet ashtu në derë,
të më qepë linjëzën,
Vështron detin:
fluturojnë dallëndyshet;
e vihet e më këndon

këngët që i thosha vetë
nd'atë mot që duheshim;
e harron zotin e saj,
më unj kryet e në mend
sjell fytyrën time.

Ja, si bregu i braktisur
gjembave e thellëzave,
ku vijnë e ndërtojnë njerëzit
një katund plot hieshi
te luginat gjelbërore,
është malli i trimave.

E stolisur, në mes grave,
vajza del për t'u martuar,
edhe lindin djem sydritë.

KËNGA XII

Si suvalat e detit
e turbullt' e si një mal,
nuk pyet më për anijen,
ashtu dhe gratë në krua,
o te lumi, o për shkarpa,
flasin për çupën e varfër,
që i biri i zonjës madhe
e don edhe dashurohet.
Vasha rrinte gjithë turp
vetëm me gjitonet;
ato ktheheshin nga puna
mbrëmanet e veç për linja
flisnin, për shami e fustane.
Një të diele menatë
e gjeta në Korqiollo:
– Trim, ti mua në më do fort,
udhëve të mos më pjekësh,
ndër shoqe mos më vështrosh.
– Vashë, malli im i parë,
unë i mjeri s'e pandeha
që kështu të bëja dhunë.
– Mos u qaj, o ti bir zoti,
mos bëj që të jem fajtores

për lotët që s'duhen derdhur:
s'dëmtove të varfërën,
as helmive çupat,
njeriu s'i bëre keq.

VJERSHË E BIJËS SË KOLLOGRESË

Në atë katund ku sonte do më arrish,
s'e ke të folët tonë, s'e ke shpinë;
atje s'ë kopshti yt, atje ske ndere;
o zemërgur, përse nuk rri me ne?

KËNGA XIII

Valle

Me që, zot, do të na lësh,
vafsh si një yll që dritën
nuk e bjerr udhës së tij.
Bir, me helm të ritë e tu
mos qoftë përzier.
Atë dit' që të na vish,
qoftë i butë dimëri,
me ullinj edhe me qumësht.
Dhe bija të bëshme
mëmat më martofshin shumë
me djema të zgjedhur.
Të na vish si nga larg vijñë
fjalët e të dashurve,
si mes për mes fletëve
të ides që kam te dera,
duket më të aguar Shenjëza
e më gëzon zemrën.
Era e lehtë që tund fletët,
gjumin njerëzve u letoftë
ndaj të gdhiri,
edhe unë i vihem punës,

që të rrit fëmijët.
Sjellsh ti një ushtëri fatmirë,
të na i hapë këto brigje
lirisë që borëm.
Në të veshura të zeza,
nuseja kurrë mos daltë;
te vallja që dridhet,
zonjat me djemthit në duar
buthtohen edhe vështrojnë;
tërë gjëria të mbledhur
njihen plot hare;
lule e ver' mësallave,
mall për të këcyer
me trimin që e ke.
Ti te hieja e shtëpis' sate,
nën të huajt' kur të rrish,
ç'jemi ne ndër njerëzit?
Por ai zot, që gjithë gaz
të zbukuroi djalërinë,
djepin ta veshi me ar,
aq sa një katund për ty
lutet, ai zot të do.

KËNGA XIV

Pasi dielli i ra te shtrati,
m'u pataks e mjera:
vuri shpejt të veshurat,
doli nga rrij i biri i zotit.
Era ngrinte pluhurin
e e shfrynte mureve;
asnjeri s'kalonte andej.
Por atje, te buzë e udhës,
Rina flit vetëm në vatër:
– Ku ta dish në do të shkojë
trimi i hieshëm më ksaj udhe!
Fatmiroshe ato n'Greqi
zërin që i dëgjojnë!
Vate! – tha me vetëhe,
u kthye në shpi,
mori tërkuzën e trastën
e më vajti nga ullinjtë:
mblidh ullinj e qante.
Pasi shkundi pesë ullinj,
tek i pesti, në shullë,
ndejt e e zuri gjumi.
Trimi në ëndërr m'iu duk,
që i doli udhës lumit.

Fushat ishin plot me borë,
rrobat mbi krah i pikonin.
– Me këtë mot ke bërë finjën?
– Si të janë skuqur duart!
Vasha vu buzën më gaz,
kur, – ia befti një erë e fortë,
shkundi born' e drurëve,
e përflaku porsi valë
e të kaltër si një det
poshtë kodrave e hapi.
Vate dhe trimi, i rrëmbyer!
Te një spart ajo u zu:
pas e ruajti e larg e pa
si një flutur përmbi ujët,
që tundet e, vende-vende,
zbardhon së këputuri...
Porse u ngrit veriu i ftohtë,
që m'i ngriu zverkëthin
edhe gjurin e zbuluar, –
m'i këputi gjumin.

KËNGA XV

Udhës sime lutesha:
– Shën Mëri e shpive tona,
këto udhë të m'i ruash!
Pasnesër gdihet e diel
e ti del nëpër katund.
Arat të mbijn' të shëndosha,
lopët të mos na pëlcastin,
shpitë mos vishen në zi,
gjith' të thonë: «Ruajna!»
Pse nuk prita, por u nisa?
Do më kishe dhënë uratën,
do të kishe ndier vashat,
që me bukë s'fryhen.
Daç të tjerrinë te dera,
daç t'u tringëllojë vegja,
asaj udhe më nuk shkoj.
S'është bisha për njerinë,
as shqipja e lisave,
as ngjala e ujrave;
vetëm burri është për gruan,
kurme që u kalben nën baltë,
ndërsa të mirë ata s'shohin,
se, kur duhen, bëjnë faj!

Udhës, ashtu lutesha.
Tek arrita e natën fjeta
im vëlla Koniati, djalë
si një lule, i vdekur,
më del veshur në të bardha.
Milosao – Si e thonë këtë fshat,
ku ti rrije, o im vlla?
Sa gëzim që të na shohin
zoti tatë e zonja mëmë!
Koniati – Dheut errët, ku ti fle
në mes dushqesh edhe detit,
ka mot, o vëlla, që dola.
Erdha të të ngushëlloj.
Njerëzit rrojnë në shtëpi
të përçarë e në zi,
po kur dielli del nga mali,
gjith, njësoj në shtrat i prën.
Dy të rinj që duhen,
gjendjen, botën s'e ndërrojnë.
Si të shpëtoi nga goja
që, kur vashën pa fuqi
përmbi dhe trimi e do,
merr mëri zoti që e bëri?
S'e largoi ai Kalabrie
hidriotenë, sydritë,
shtatmagjepsurën Luizë?
Shpuri mbrëmanet në anije
mbulesat që bëri gjyshja,
e te shpia e boshatisur
natën e fundit u mblodh.
Trimi e arriu e e puti.
Luiza – Në atë dhe, ku po shkoj vetë,

thuam në do gjë ti trim.
Trimi – Kur të vesh te bregu i huaj,
hidh në det mandilin,
lut të vijë përroit tonë,
që të di se nuk u mbyte.
Lut dhe zonjën shën Mëri,
kurrë zi mos të të sjellë.
Kur kaloi një javë e gjatë,
trimi gjet mbi zhur mandilen
edhe tha: – Si ajo që iku
edhe rron përtej,
kështu rrojmë ne pas vdekjes.

KËNGA XVI

Era që e ndreqi motin,
fry nga deti.
Te Kodr' e Llumbardhave,
lehtë se ç'ma hapi derën,
ëmbël më dheli fytyrën
e më reshti gjumin.
Milosao – Më rrofsh, i ftohti veri,
që më zgjon e më gëzon!
Sa i ka hie koçimares,
kur ia përkul degëzat!
Ti s'leve në dhe të huaj.
Veriu – Kur leva të parën herë,
dushku u tund te Pokfilli.
– Të bijën e Kollogresë
mos e pe nd'ata përrenj?
– Dita me diell gëzon
të shëndoshë e të sëmurë.
Me kitar', vasha krenare
luante me djaln' e bardhë
e i frushullon fustani,
gjiri i fryhej, rrotullohej
e m'i shprishej shtekthi
e m'i flisnin syzit.
– Mba tutje, bushtëra erë,
se më ngrive eshtërat!

KËNGA XVII

Shtëpi tona të shpërndara,
do t'ju shoh pasnesër.
Do shoh bregn' e Rakanielit
e vashat që lajnë.
Nesër ndaj të ngrysur
shkon vasha nga dera ime
edhe sheh shumë hare;
pyet: – Ç'është kjo hare?
– Ësht' hareja e t'bir të zotit,
që po na vjen nesër.
Zemra vashës i kërcen.
Mblidhet tek të motrat,
ulet, ngrihet, del te dera.
Nga çdo anë sheh plot zjarre:
çunat, me urë në dorë,
ndjekin udhëve lakuriqët.
Shpëndrit vasha prej hareje,
porsi djali një mëngjesi
që gdhihet me gaz.
Përmbi shtratin e mëndafshtë,
drita që m'i ndehet,
m'i këput atij gjumin.
Sheh të ëmën nëpër shpi
me gërshet të shpleksur

e me lidhëse në dorë;
mbi tryezë sheh pasqyrën;
brof në këmbë, se kujton
trimatë në Shurezët
e stolitë e vashave
përgjunjur në Shëndëlli
përpara Mesosporites.

VJERSHË E BIJËS SË KOLLOGRESË

Isha në vallet e i ndryshuar erdhe:
më shture sytë e m'u errësua jeta.
Mos e ki rëndë, o diell, kjo re e lënë
në të takoftë e ndrin dhe ajo një herë.

KËNGA XVIII

S'ishin grahma trimash
e grash të martuara,
as rënkime zemre
që lufton për vdekjen,
porse ishin frymë
prej djemthish që prëhen
djepeve me ninulla
më të rar' të diellit;
e si fërfëllimë gjethesh
të hardhis', si fryma e ditës
në ato zemëra të lehta,
kur lëshohetë thëllëza
nga lumi i Teodorit.
Ajo shkoi mbi qeramidhet
edhe ra te krei i djalit
të parganiot Milloshinit,
që ish te shtrati i vëlushtë
e m'u vu e ma ushqeu.
Si mbaroi së ushqyeri,
hapi krahët e m'u ul
përmbi tendën e mëndafshhtë
e ia lëshoi këngës.
Djalthin e zu gjumi.
Nd' e zu gjumi, le të flerë,

mos kujtoj' të bardhën mëmë,
që e zbathur e pa frymë
pyjevet po më rrëqiset
duke i thirrë zotit saj,
që doli e nuk u kthye.

KËNGA XIX

Më të rar' të dimërit,
vajta bashkë me tim vllëzër
te stani i Marlules,
i pritur ka mot. Bariu
ngrohu qumësht e i rrëmbyer,
syt' me lot: – Ha, trim i bardhë!
Yt gjysh, kur vinte, nuk donte
veç qumësht të ngrohtë;
pastaj, gjer të gdhihej,
ushtrinë e harronte.
Pa kreni dhe i trishtuar
rrija si në vend të huaj.
Fjetën tim vëllezër.
Delet që zhurmonin,
gjumin ma këputnin.
Kur u çova për së pari,
nga Mbuzati hënëza
sipër detit llamburinte.
Kur u çova për së dyti,
ylli s'ish duke vështruar
njerzit e bishat që flinin,
por u takste deleve
net me fate të mëdha.
Kur u çova për së treti,

hëna kishte perënduar;
 ndonjë ka, aty-këtu,
 po kulloste kodrave
 gjysmë të zbardhuara.
 Kur të katërtën u zgjova,
 delet tona ishin hapur
 lumenjve të kaltër.
 Mua më zu malli i katundit.
 Dola poshtë shesheve,
 që ishin lagur: kish dëborë
 të pashkrirë, të përhapur
 nën hien e shkurreve,
 e vashën kryegështenjë
 njoha te udhë e katundit,
 njoha shtatin plot hir,
 spikun e kaltër të fustës;
 e takova nëpër zhugat.
 Trimi – Se ti vije somenatë
 gjer këtu, nuk e pandeha.
 Vajza – Pse, s'kam ardhur tjera herë?
 S'patëm me kë t'u dërgojmë
 bukën vëllezërve. «Shko, mblidh
 dhe dy skorje», më tha mëma.
 Sonte mos fjete më truall?
 – Afër zjarrit i mbuluar.
 – Bobo! S'mund të vije mbrëmë
 në shtëpi? – Te shpia ime
 vajza kryegështenjë
 tani më s'po duket.
 – Sa ka dielli që rron,
 mos, kur ulet mbrëmanet,
 vetëm s'rri?

– Kur të kthej në dhe të huaj,
ngopmu ti, moj zemërgure,
si të huaj të më dish!

–E përse? Ne pran' e pranë
ecnim. Ajo u përmbajt
e pastaj sytë e përlotur
i ktheu nga plepat anësh.

KËNGA XX

Gjethet ishin si të mpira,
dielli i fshehur resh,
zembr' e grave pa dëshirë,
kur ia dha një shkundullim.
Ullinjtë e thyer,
shtëpitë e rrëzuara,
njerzit i braktisën
mërisë së dheut.
Ulërinin egërsirat.
Përmes gjëndjes së tmerruar,
që sillej, përpiqej udhës,
asaj nate të pabesë
kam diktuar vashëzën,
vashëzën meshollëzën,
atë kryegështenjëzën.
Si ai që një yll të qetë
sheh e zemërën ia ngroh,
yll që thot: «Vështromëni dritën,
bota nuk do të shkallmohet», –
bardhëllore unë e pashë.
Vajza – O i bardhë bir bujari,
në më merr, ku po më shpie?
Unë s'jam një zonjë e madhe
si mizorja jot kumatë.

Trimi – Shkodra më s'thuhet qytet;
përtej malit gjejmë priftër
që të na martojnë.
Un' me shigjetë e parmendë,
ti kasollen të më ruash
edhe rrobat të më lash,
vetëm për mua të vetmin.

KËNGA XXI

Nesër gdihet shën Mëria,
flakadani seç u ndez,
udhët janë plot me fjalë.
Mana, ullinj e vreshta tona,
verdhëlluar hënës,
kurrë të mos i gënjeni
vashat e këtij katundi.
O ti mbrëmje e bukur,
kush me ty po rri tani
që e zuri gjindjen gjumi?
Mua thëllëza te shtrati
më sheh kurm të heshtur,
sikur të shih një statujë;
si të pandehë se nesër
është dita ime e madhe?
Shkrehen pushkë e bje kambana
me hare më të aguar;
motëra ime nga deti
hap dritaren e sheh motin
e gjith' kurmi po m'i qesh.
Shtëpitë tona pastrohen.
Para shpive, – thirrma e valles.
Kunatat që, mbrëmanet,
bënë fjal' te vatra

edhe fjetën zemëruar,
rrinë afër në vallet,
të zëna për dore.
Vajza kryegështenjë,
liruar nga prindët,
vjen te unë e te zotynë,
që e bëri pa mëkate,
që ul sytë e sheh mbi dhe
gjithë njerzit si vëllezër.
Nesër ajo, në kët' orë,
uletë në shtratin tim,
më jep faqen për të puthur,
më le gërshetin nën llërë.
Djemt' që do m'i lejnë,
trojeve tona do dalin,
ndër ullinj e kopshtije,
ashtu si del hënëza
e njohur nga bota.
Shën Mëri, ti mos na le,
pasi të hyjë në shpi
e stolisurë me ar,
e pritur nga bujareshat,
e rrëmbyer nga gjitonet, –
si nga bari një vjollcë,
që tryezën kundërmon.
Si liri për gjithë vendin
qe shtëpia e tim gjyshi,
por tani është' nën të tjerë:
nusja nuk gjen në shtëpi
asgjë për t'u madhështuar.

KËNGA XXII

Bie, por s'dua të fle.
Mos e mbyll ti derën,
le të hyjë era e detit,
të më ftohë, si më ftoh
vashëzat më të prashitur;
le të hyjë dielli,
që te vatrat, i pafaj,
na u rri pranë mëmave,
u kujton kohën e shkuar.
Vajzën me shtatin e bukur
unë të dashur e pata
e m'i leu një djal' që i ngjet.
Me hare në këto shpi
ajo përkund djepthin
e mua brezin më qendis. –
Bie, por s'dua të fle.
Si drita në qiell e syu
në kurm të njeriut,
kur e sheh të pamenduar,
ajo shpisë i ka hie.
Ditët e mia fatmira,
do kujtoheni mbi dhe

si këta brigje e lumenj,
që të moçëm do t'u duken
atyre që do të lejnë. –
Bie, por s'dua të fle.

KËNGA XXIII

Milosao – Si një re me shi të fshehur,
mbi katund shumë e bardhë,
që nuk di ku të pushojë,
grua, ti rri kur jam në shpi.
Kur dola, të gjeç se qaje.

Nusja – Birit tim njeri s'ia mbrojti
foshnjërinë dhe askush
nuk i ndihu kur ma zuri
vdekja, që gjakun i piu.

– S'është zemërimi i zotit
djalin, grua, që të rrëmbeu:
dheu të gjithë na mbulon.

Si te djepi, natën,
te veshët i tingëllonte
kënga e djemve e ai s'e dinte
se lart yjt' lëviznin

e posht' fshati merrte frymë,
ashtu shihte edhe anije
detit, e lumit të madh
trima zallit, kuaj, –
e gjithashtu vdiste!

– Porse t'ëmën që ma mbante
atje lart im bir s'e sheh.
Ai mbeti me sy hapur

nga un', bërë si lëvere...
Në katund do vdes e para...
Po, ma tha... Të ritë tim
cili varr e ha te kisha?
– Ç'është' kjo fjalë? Ëngjëll vashë,
jam i yti! Kush të huaj
shtatin tënd mua ma bën?
Llërët edhe zverkun
i vështrova e m'ia putha.
Ajo fshiu lotët,
si pëllumb, shumë e menduar,
mbi mullinjtë shtiu sytë,
te ku shtrihej vreshta jonë.

KËNGA XXIV

Kush kujtoi se do më lije,
e pafat motëra ime?
Sa agonte përmbi det,
më liroje shtratin,
që të ushqeje sirkun.
Fustanes që skuqte,
shëndrisnin tavanet.
Bobo! flotë si një flutur
se ç'më vure e mëndafshin,
vash', do mos e shihje!
Të tjera mbi dhe i kryen
ç'pati zënë dora jote
e ti më je pluhurosur.
Fron i jetës, ata sy
janë tokë e myk u bë
ajo buzë, mollë e ëmbël,
në njëzet e pesë vjet.
Kuj më le në këtë dhe,
hir i madh i shtëpis' sime?
Kush më del në derë
të zilepsë vashat
e lumbardhat ta vështrojnë
që nga qeramidhet?
Shtrati mbeti i pashtruar,

njeri s'ecën nëpër shpi.
O! gjer t'ikin këto ditë
e të hyj ndër yje,
të të shquaj e përdorez,
larg prej shpitrave të tjerë.
më ne të mos ndahemi!

KËNGA XXV

Dy dit' mjegull edhe shi
verën donin të na reshtin;
tek e katra, ndër lëmenj,
shtruan duajtë në diell.
Unë, vetëm, i helmuar,
vajta gjer te Shureza,
ndenja te bythë e ullirit.
Një trumë stërçokash vinin
kashtronjës, duke u çirur
aqë sa brofa në këmbë.
Pyllit takënte
sëpata e grave;
këngë vinin vreshtave;
bota dukej të kish lerë
asaja menate. —
O e bukra motra ime,
mos ka rrush te varri yt?
Vend të bukur në të dhanë,
prapë s'shtrihesh dot e lumtur,
Pse s'rri përherë me mua?
Kurmi i saj i bërë pluhur
nëpër rroba i ka rënë
e këto fjalë s'i ndjen.
Zoti i dherave të shumta,

që dha ditën plot dëshirë,
më vështroftë dhembshurisht,
këtë jetë ma këputtë,
të më dalë dorës tij!

KËNGA XXVI

Era fryu prapa shpive.
Motra ime e vogëla
vishet edhe lahet,
merr gjilpër' e penë
e më ulet kundrejt detit.
Rri mbi uj' Ylli i Mëngjesit.
Afër, mbi fron i fanepset
zonja ime tek qëndis,
siç e kish zakon, një kezë.
Nusja – Ashtu, bij'; dielli që del
vajzës së larë i qesh
më shumë se dheut.
Ajo vashë aq e gjallë
rritet nën hien e s'ëmës
e qetë e e dhembshur,
shtatin plot me hire,
shpive ecën si një yll.
E bija e gjitones
ma kundron e dëshiron
ajo zonj' ta komandojë;
çupatë gjifryra
asaj dere e duan burrin,
ndo bari, ndo me parmendë.
Kur e la shtëpinë e t'et,

fajnjëria u errësua
edhe zilisnin fatmadhin
katundin e dhëndrit.
E në vdektë, i shkon mëma
nga derë e të shoqtë e qan.
Ajo flit – e unë u dhashë,
më pa dhe vështroi vashën
e bëri buzën më gaz,
një gaz prej së vdekure.
Motra ime e marmarosur
më shtiu sytë në fytyrë.
Froni ishte i liruar,
rrezet e diellit skuqnin
streht' e qeramidheve.
Posht' te lumi, shëlgjet,
të zbërdhulur e të ftohtë,
era i tundte gjithë hir.

KËNGA XXVII

Vasha e mjeruarëz
hyri tek e emta.
Vasha – Ulu e bëmë gërshetin.
Ndejti drejt shtëpis' së zotit.
Dielli binte që nga dera,
afër djepit pes' thëllëza
nën frone përpushnin.
Vashës i shpëtuan lotët
mbi dorën e s'emtës.
E emta – Ç'është helmi yt, moj bijë?
Vasha – Helmi im është i madh shumë.
Pa shih këta zogj që rrojnë
vetëm, po fatbardhë: s'kanë
njerjë egërsirë.
– Vajzë, bijë e sime motre,
ndo ti bën buzën në gaz,
ndo ti flet o shtie sytë,
s'gjendet zemër që s'të do.
– Porse mua nuk më vlen:
s'është mëma të më shohë.
Nat' e ditë më qërton
njerka mizore që kam.
– Mos më qaj ti, bija ime:
tani shpejt më vete nuse

e te zoti yt fatmirë
gjithë helmet i harron.
Vajza me një psherëtimë
tërhoq gërshetthin e artë,
bëri e fshiu lotëzit,
sytë i shndritën.
– E sa kam të rroj akoma?

KËNGA XXVIII

Ranë këmborë e tambure.
Me një vel të zi në krye,
ime motër maste
një trëmbë lesh e mëndafsh,
që e kish tisor vetë mëma.
Trimit që do i mirr të bijën,
ia kish tisor për shatore,
që ta hapte natën
ushtërisë kur t'i printe;
por s'e dinte motra ime
e prandaja, e harruar,
fill vetëm kujtoj mëmën,
kryepluhurosurën
e që s'njihej më te varri;
iu veshën sytë me lot.
Ish pa jetë si piktura,
që mbi shtratn' e nuses
në mesditë i qesh shtëpisë
e s'e ndien kurmin e saj
me atë flok të bukur.
Ulur pranë, unë e vështroja.
Madhështorja mëma ime
pat besuar që me ushtri
Arbërit unë t'i ndihja;

e la besa edhe vdiq.
E kujtova dhe, nga duket
kopshti, u ktheva e qava.
Arat e prashitura
shiu i butë i bunarte.
Kajsia me lule
frushullonte si një valle
që ulet e më pret nusen,
pret të dielat plot fruta.
Motra – Ja tryeza e shtruar,
froni pranë, o vëlla;
hajde, ngushëllohu,
kaq i ri dhe veç helmuar!
Milosao – Motra ime e vogëla,
pasi m'ujdise shtëpinë,
po të shoh të lodhur, vetëm,
e që s'të hedh syt' njeri...
– Lavdi pastë në qiell zoti,
që na mori zonjën mëmë!..
Kur të na kujtojë ajo
nga vend i paqes,
njësoj është... – Ti je e lumtur
se gjithnjë si desh e mjera
bëre: ditënë punove,
natën fjete, si një dritë
që ndizet edhe shkëlqen
gjersa shuhet, edhe botës
më s'i lypset. Mua mëmën
një e huaj ma largoi.
– Mëma pat shumë gëzime,
porse ajo motër e mjerë,
punëtore e varfër,

i la shtatin tim vëllai
si drita që rri tek ylli.
Ç'e mërzit të zezën?
Përse nuk e lë të qetë,
pasi të gjithë e harruan?
Sa e bukur kishte lerë!...
Sa hie në ato zakone!...

KËNGA XXIX

Ujërat menë, ra veriu,
male dhe sheshe u veshën.
Si udhën e ëngjellit, verë,
të shoh edhe trembem.
Djemt', që botën shtrigë
njohur nuk e kanë, qeshin
porsi shqerrat në livadhe.
Degt' e trëndafilave
shkundin vesën edhe vashës
mbi gërshetëthin i bie,
që pleksi me vjollca;
bie mbi foshnjën e fqinjës,
që i lot te prehëri.
Ajo e puth e më skuqet,
se mendon te djali i mallit,
që një ditë do t'i lejë.
Pelat zbuten për të hipur;
burri shkul pendët e zogjve
të stolisë kryet;
si veriu që përthan lulet,
ai prish një shesh me sirq,
që një rrobezë të bëjë; –
fatbardhë sikur të tiste
rrezet e diellit vetë!

Vera e magjeps më shumë:
lule të bardha, lule të verdha,
të përhapura, të vjerra,
duan veç gojë t'i flasin.

KËNGA E PARË

Mbi të Bardhët shkëmbinj Turi heshte.
Kodrave përreth, flokët gjëmborë,
t'ndezur nga dielli ua tundte flladi në perëndim.
Mërgimtari qielli lart
iu shpalos në dritën e zbehtë,
poshtë dhe Krati i kaltër mes fushave,
që për të janë brigje të vetmuara.
Lehtë ia puth dhimbjen e thellë
një gaz, si ai që shfaqet kur mendojnë
t'brengosurat zemra madhështinë e vet

Me të lartin mendim e me zemrën
që i hovte fluturonte drejt lindjes.
Në mes të kodrave ai pa
dallgët e Jonit, nga të cilat Veriu
mbarset me ngrica dhe puth kolonitë epirote
me flatrat e gjera.
«Andej është atdheu», tha, dhe sillte në mend
punët e njerëzve dhe zjarret e mbrëmjes,
shokët e dallgët e fatkeqësive që i ranë.
Andej kthjelltësia e qiellit asnjë zemre
s'i sjell gëzim. Ditën s'e rrok
as vështrimi i njeriut krenar.

Njerinë aq të bukur dhe me aq përgjërëm,
të nxjerrë në dritë nga gjysmëperëndi,
shigjeta e huaj e shtriu përdhe.
Zjarri i përuli pallatet e mëdha
dhe të bukurit tempuj, dyer të qiellit.
Veç ndoñjë grua ikën. Përrenjtë e atdheut
sjell ndër mend. Foshnja në dorë
ngjan si vjollcë në të fishkur.
Nën pranga ndien peshën e fyerjeve
dhe më kot mendja i fluturon tek i shoqi
që aq e druanin dikur. U lye me gjak
shtëpia nën të huaj. E pse nga qielli
mbiu i lirë shpirti? Për këtë fat? –

KËNGA E DYTË

Prijësin plak!) e tret
dashuria e Atdheut me brengë të fortë.
«Bijë, më jep lahutën! Zemra më çahet.
Medet! Do t'i ikin ditët prindit!
Si një ëngjëll i lartë
në sjellje ngjante, me ëmbëlsi të tillë
që mendjes njerëzore ia çelte qiellin.
T'shkathtët gjymtyrë lehtas i vesh
një fund i kuq. Në ije e shtrëngon
një rryp i kaltër. Gjiri i plotë i hijeshon.
Syrin bojë qielli ia ndrin një flakëritje
që shpirtin krejt ta thith e fytyra e saj
dhe trëndafila dhe zambakë shkryn.

1) Prijësin plak Perlat, mbrojtësin e Stefigradit, që kish ikur në Itali.

Floku i artë i zgjidhur shkëlqen
 mbi qafën borë dhe i shkujdesur varet
 në mes, gërshet me fill të mëndafshhtë i lidhur.
 Ashtu në Tmol një të tillë hijeshi
 bariut i shfaqin në enët e qumështit
 lulët e verdha t'fushës plot aromë.
 Me një harmoni notash që të këndell
 ajo po vinte, lahutën merrte
 nga muri e prindit ia jepte në dorë.
 Pranë prindit qëndronte në një shtrat
 dhe mbi bërrylin e butë e mbështetur
 pushonte faqja mbi dorën si borë.
 – Veç një, Skënderi i palodhur kurrë
 qe për Epirin gjatë,
 po e ndoqën vitet. Kështu bijtë e tu
 të njomë do ishin, ah, medet, Perlat*)
 Po u zhdukën, ah, u zhdukën
 Guma e Telemi, burbuqe në shpërthim.
 Fenisie e mirë, çfarë hijesh të shtrenjta
 t'u shfaqën që ti qan pa ngushëllim? –
 Qetësohu,
 zemrën ma shkrin, kë ke parë vallë?
 «O bij'! Le t'flenë! Pse veten e mundon?
 Ka shumë kohë që ata nuk janë gjallë!»
 U zhduk Fenisja! Bijë, ti e kalove
 detin me mua dhe mëma
 u zhduk si hije e lehtë.

*) Perlatit i ishin vrarë bijtë në luftë. Gruaja, Fenisia, i
 kishte vdekur

Ku shkon? Qëndro! Këtu ke shoqe hirplot
të thosha – e ati ka shumë miq e shokë,
Zemra ime, Elodë, këtu qëndro,
të thosha e të shtëngoja në krahë
dhe me dorë t'i fshijsa lotët.
«Nënë! S'më dëgjon? Te kodra ti mi,
babai ku është vallë? Jam vetëm,
do them atëherë e duke rrahur plisat
e kopshtit do t'kërkoj. Jam vetëm.
Më kanë lënë këtu
pa baba!» Ishte fjala jote e helmuar.
Bija ime, në moshë të njomë je
dhe të të le?

Jo, Elodë!

Ah, s'ka asgjë më njeriu që nuk ka atdhe!
Ku ka e brishta dikë që ta ndiejë?
Ja, të parët harron
e mjera gjindje aty ku mbërrin
në Italinë e gjerë, larg Shqipërisë.
Nën qiell të huaj vdekjen
do gjejë. Bijë e mjerë, kur muzgu zbret
do shkojë ta mbyllë derën e në çdo hije
do t'i ngjajë se shëh të prindit

faqen e zbehtë.

Mo të dy duart mbulonte fytyrën
dhe klithte dhe si erë e rrëmbyer
vendin e la dhe atit i qëndronte
përballë: «E ardhmja të shuhej për fare
në zemër të njeriut se të brengosur
or' e çast s'do të shihja atëherë ty.
Si mëma do të rroj dhe unë. Le t'prehet
mendimi yt. Mëshirë për bijën tënde

që volem ty në jetë të ka m'heshtetja.»
Dhe e pajturuar nga dora lahutën
ia merrte nga sytë në të. Është fytyrën
një rrëke lotësh rrjedh e kulluar.
Dhe ja tek ndiejnë që po hapet dera
dhe krejt i ngjashëm në shtat me një hyjni
befas u del në sy një luftëtar.

.....

...arriti

dhe derën ia çelën, të kthjelltit sy
nga lotët fshinte Elođā. Nga fytyra
e nga veshja Perlati e njohu
si bir të Epirit, të errtat mendime
iu zhdukën. U ngrit. «Pra, ra
gjindja jonë dhe ende jemi no?»
I përgjigjej i bukur e i zyrtë:
«Zot, prapa meje shtrihej Kruja e trimat.
Krahet e stuhishëm, medet, s'janë më!»
Përplasi shuplakat plaku e vasha
sytë plot lot ktheu nga muri e dhembshuria
e përfshiu si vashë që natën bredh
dhe sjell ndër mend diellin e saj të bukur
që para dasmës ia pat rrëmbyer vdekja,
hesën e fshehtë e t'ëmblat premtime
e nëpër fije i ndrit si perlë loti.
Po hapte buzët plaku: «S'është dhimbja
që u lan prapë jetë hijeve të shtrenjta.
Cdo gjë mbaroi për ne, veç virtyti
s'u zhduk, e kemi ngushëllim
gjersa të ikim dhe ne nga kjo jetë».

Foli e qetësia ia zuri vendin dhimbjes,
pastaj e uli pranë Odiseun e sofrën
menjëherë e mbushi Eloda plot.
Dhe si i hoqi përkrenaren
e ari i flokëve i ndriu, vështrimit krenar,
fytyrës prej ëngjëlli
dhe fjalës plaku i rreptë ia njohu
prejardhjen e lartë. Eloda, që ia priste
përkrenaren me dorë, u skuq nga drojtja.
Në vështrim iu end një ngazëllim
si e florinjta rreze retë i çan
e si me lule kindet ua stolis.
Perlati, duke parë atë fytyrë
me admirim mes një grumbull kujtimesh
të ëmbla, kujtoi vitet e largëta.
Ja, pyllit gjethet ashtu ia përtërin
armikja e dimrit dhe pas një shiu
çelet krejt ajri, në mes barit del
e thjeshta vjollcë dhe aromën shpërndan.
Kujtimin ma sjell të prillit të qartë
që dashuria ma bënte të artë.

KËNGA E TRETË

E shtroi në çast sofrën vasha e urtë
dhe ajri i errët mbuloi
kubenë. Ashtu mbi Kanosë rrezja e kaltër
e Arturit ndrit e përmbi brigje
të Ofantit. Shkëlqente qielli i qetë
dhe veriu në gji të njerëzve zgjonte
mendimin e jetës dhe xhindet qiellore
zgjuan një tronditje. Ja, sytë i hedh
vasha në fytyrë të djaloshit
që e vështron. Nëpër deje u shkon
një dridhmë e butë. Te Vendi i lindjes
zemra e Perlatit rri. Kreshnikëve
u kujton të bëmat dhe pyet për fatin e tyre.
Në gji mbyt një psherëtimë. «Ku më çon?»
flet djali i hijshëm — aty ku derdh dielli
të njëjtat rreze lart përmbi pallate
e në të zbraztit tempuj nga ikën besimi
dhe gjaku i trimave, medet, u derdh kot.
Vdiq Skënderbeu dhe me vërshim më t'egër
u derdh Mahmudi që sa herë pat rënë.
Devetë e mbytën fushën. Flamuj e çadra
u shpalosën mbi kodra; krejt të zbehtë
mendueshëm rrinin pleqtë e vaji i rrjedh
në heshtje gras që vështron kurorën

e nusërisë varur mbi krevat.
 Të të gjallëve të paktë trimëria
 vajtohet; ata s'e ndiejnë; në qoftë fat
 le të mos vdesim pa luftë gjer në fund.
 Prijës qe Golemi*). Ata luftuan në fushë
 dhe vdekjeprurës u qe krahu. Me të rinjtë,
 te bedenat qëndronin. Fitorja u kthye
 nga ne. Armë të tjera sollën. Më kot,
 se shpërndareshin përballë trimave t'shqar.
 Medet, ju ditë lavdie! Ç'pamje kobzezë
 që lindi! Ja ku bredh tani vdekja
 në udhë përmbi të gjallët e kapitur.
 Aty një shpatë me tringëllimë të mbytur
 mbi bedenat lëshohet e braktisur.
 Këtu vjen gruaja dhe bashkëshortit të ri
 ca ushqim i sjell. Foshnjen ka përbri
 që derdh lot dhe vështron. Sa e kanë dashur!
 I pa këto dhe ndjeu rrezikun
 Golemi. Nata erdhi dhe u mblodhën qytetarët
 në një këshill të përbashkët.
 U ulën kreshnikët. Në dritë të hënës
 u dukën fronat e zbrazët. Një dhimbje
 e zymtë pllakosi gjokset. Patën ndritur
 një mijë, tash janë treqind. Boria më kot
 thërret të zhdukurit dhe të heshturën dhimbje.
 Djali i lartë, që ia ruajti
 prindit të fuqishëm urtësinë mbretërore,
 njerëzve trishtueshëm u flet:
 Këtu gjindja jonë do të gjejë varrin?

*) Pal Golemi, trim legjendar i këngëve popullore arbëreshe:
 Këtu jepet si vëlla i Moisi Golemit dhe baba i Odiseut.

Po ç'lavdi ka vallë
rinia? U shpërtheu në mes të zemërimit
si rreze trimëria, po vendi e koha
fitoren ia mohuan atij guximi.
S'është vepër e pëlqyer prej qiellit
të vështrosh etërit e përgjakur dhe të ndiesh
klithmat e nënës së shtrenjtë n'agoni.
Ngjanin rënkime të miqve besnikë
q'i thonë të vdekurit të fundmen lamtumirë,
kur zbret në gropën plot kafka, në harrim.
S'do qe larguar populli prej andej,
po ata trima që heshtin pa lot në sy
u thanë: «Ç'bëni? Ku është forca juaj?
Ikni, fatzinj! Po qëndroni?»
Sheshet, kodrat e burimet e dashura
kurrë më nuk kini për t'i parë.
Po u rrënuar gjithçka, pse të qëndroni?
Ikni, fatzinj!» U shpërndanë. Një tmerr
i pakuptueshëm na pushtoi. Një erë
u ngrit, gjëmoi bubullima e të përflakura
u zbuluan luginat e kreshtat. Ngadalë
një kometë vërshëlleu. Poshtë lagjet
e Krujës digjen, digjen çatitë. U err
prapë ajri, mbi mal
kindet e verdha shtrin dita. Te muri
hordhitë i çon Mateti. E zyrtë mes tymit
po zbret dita e re e kulluar.
Ne luftuam me shpata, përtokë shtrirë
dergjat armiku. Mbi mure pak ushqim
popullit iu nda e jehoi një këngë gëzimi.
Me një shenjë të Golemit u derdh rinia.
Vendet i ruajtën gratë. Ecëm përpara

në heshtje. Na pushtoi një brengë,
kur pamë në rrugë orenditë e shpërndara
dhe bashkë me to ikonat luleveshur.
Përkulte mbrëmja përmbi tokë kryet
e stolisur me vjollca dhe errësonte
çdo gjë përreth me një zymtësi të hidhur.
Në qiellin e Krujës të ndritshmit yje
i vështruam për të fundit herë
dhe në heshtje gratë në vaj qenë shkrirë.
Tani lajmëtarët e gjumit të qetë,
lodhja dhe paqja, të egërsuarin vrull
e shuanin mes vegimesh të çuditshme.
Pranë armëve hovi rinor
pushton popullin e lodhur nga varganet,
mbeturinat e fundit të qytetit që vdes.
Veç me ta u nis mbreti i ri. Gratë
i shkulin flokët e plot dhembshuri
i kthenin sytë nga shkëmbinjtë e shtrenjtë,
që nesër do t'i shohin të braktisura,
shtëpitë e për to askush s'do kujdeset.
Shoqet do t'i thërrasin. Të brengosura
me bijtë pranë në vise t'huaja do shkojnë.
Dhe pranë gjirit i shtrëngonin foshnjat.
U nisëm e zemra nuk ma ndieu dot
të fundmin amanet t'Golemit q'e desha
aq shumë e pak ma njohu ndjenjën birnore.
Pa u vënë re kaluam të armikut radhë
dhe shumë ditë qenë që agimi
brigjet e Jonit na shndrronte n'ar.
Atje punuam si e donte çasti
dhe, ja, mbi breg, anijet e ndërtuara
më në fund nxinin ndër tmerret e natës.

Brigjet amtare mendime
 t'ëmbra e të egra më zgjuan në gji
 dhe Aleksit*) i thashë të rënda fjalë.
 (i lartë qe ai, i çiltër në veprimë.
 Ne patëm lindur të donim shoku-shokun
 dhe të krenohemi me atë dashuri).
 «Ku janë festat e atdheut? E frymën
 e lindjes sate të bukur kush na e çon?
 Ku është dielli i Krujës në fushat latine?
 Dhe s'do quhet kurrë më, kurrë më i gjallë
 atdheu ynë? E ne rrojmë e një dorë
 e pabesë mbretit hirin t'ia shpërndajë?
 O turp! Hijet e trimave ç'do thonë?
 Po t'atdheut mure? Ah! Mos rrofsha më
 në qenka e thënë nderi t'më errësohet.
 Pranë nderit eja, o zemër, me -mua rri.
 S'do e dijë bota? T'jemi të lartë vetë!
 Ç'duam më? Mendja e huaj s'të mbështet.
 – Ti kthehesh? Ati vallë ç'do të thotë,
 në iu shoftë fisi? E ti do ta vështros
 atë fatzi t'bregosur? Oh, kreshnikët!...
 – O bir i Aleksit, sytë e babait tënd
 në luftë qenë vetëtima dhe kur gjoksin
 Alketima ia lidhte nuk vajtonte.
 U skuq flakë në fytyrë dhe i zemëruar
 më pa djaloshi tek po largohej,
 duke më lënë me dhimbje e dashuri.
 «Zemrën e ka të madhe... Sa më donte!
 Mosmirënjohës! Po tash? Veç atë kisha,
 tani që e humbas do të jem i qetë».

*) Shoku i ngushtë i Odiseut

Dhe duke u zhytur në një mijë brenga
«Pse rroj më? – mendova. – Në atdhe
të rend, dhe mua le të më marrë vdekja.»

.....

U nisa me vetvete i zemëruar
dhe ikën shumë ditë gjersa në të ngrysur
njoha fushën që ngrihet valë-valë
dhe pushë bregun ku fle nëna ime.
Një re ngrihet, herë e kaltër, herë e zezë.
Dhe veli i natës i lagur me shi
po erret dhe ndër brinjët e shkëmbinjve
po fluturojnë thërmija cingërimë.
Dhe ja së largu ujat ulërijnë
me zë të mbytur e nën këmbë maja
u tund, u drodhën lisat e greminat
buçitën dhe roja edhe dyert
e Krujës, duke u përmbysur përdhe,
u shembën me gjëmë që hakmarrjen e fundit
do zgjojë mbi botë duke shkrepëtirë.
Me shkrepitimë pa fund, nga jashtë shpërthyen
topa t'përflakur që duke gjëmuar
në mes reve të ndezura buçitën.
Ashtu si zjarri dheut ia kafshon gjirin.
në udhë, që ndeshet me përrenjtë nëntokësorë,
ajri i rralluar dendësohet e del
me buçimë dhe shemb vendet më të largëta
duke fryrë gropën e zmadhuar.
Qe dita e atdheut. A humbëm të gjithë vallë?
Dhe rendja tatëpjetë malit të shembur
po, medet, o vise t'atdheut, medet!

Më rrallë ndiheshin drithmat. Me plot tmerr
 ngadalë një buçimë tundte herë pas here
 me fishkëllimë të gjatë ajrin e heshtur.
 N' at' kohë brenda çaja. U gris manteli
 i stuhisë dhe hëna e përzhitur
 e zbardhi tokën. Një rreze e thyer
 në fluturuesen re të errët
 nga floku i agimit dilte
 dhe me refleks të zyrtë në pellgun e gjakut
 dhe në fytyrat e vdekura zbehej
 para këmbëve të mia. U drodha i tëri
 se rendja nëpër shtigje me kufoma.
 U zbulua tempulli. Nga Akuila një zë
 shpirtin ma preku: O ti fatzezë
 gjini njerëzore, ndeshesh me vetveten
 e egër, pa qëllim gjersa gjen vdekjen. ,
 Mbase mallkon tani zemërimin tënd
 hije e egërsuar e Matetit. Ti fluturove
 në natën e shekujve dhe të vrau një qenie
 si ti. Ti s'ngushëllohesh e as unë s'qesh.
 «Jam njeriu i gjakut». Që nga zëri
 Golemin njoha, renda dhe më pa.
 (Qe i plagosur në grykë, të zbehta
 i kishte faqet, përkrenaren të thyer,
 gjoksin t'përgjakur kish e propë trimi
 rënkim nuk nxirrte). «Gjallë je ti, Aleks?*)
 Larg shko, armiku ra. Tanët arrij,
 Odiseun paç vëlla!». E ktheja fytyrën
 mënjanë dhe mbuloja sytë

*) Në fillim i ati i Odiseut e kujton djalin si shokun e tij, Aleksin,
 kur e njeh e porositi edhe një herë të largohet.

me klithmë të fuqishme. «O ti birl
Ç'të bëra unë? Pse bregun e huaj
do që të prek me brengë? I thatë qerpiku
i atit qe. E pra ty më kot
do të t'kërkoj në të largëtin mërgim.
Nisu. Djali i Skënderit larg
shkon dhe ai nga ky breg. Qielli
ndihmoftë atë dhe Shqipërinë!» Dorës
më shtrinte e binte. Kur të akulluar
e pashë pran' meje u shndërrova në mermer.
Mendimi i zgjidhur veten më nuk shihte,
si një tis ma vesh shpirtin; u ënda pa mënd
në vise të panjohura. I humbur udhët
përshkoja me qetësi-llahtarë në fytyrë.
Po papritur në këmbët më ra
një pendë e kaltër dhe erdha në vete.
Ku jam s'e di. Me shpata të copëtuara,
me përkrenare, mburoje dhe trupa
udha është plot dhe një luftëtar
mbi një kodër kufomash sikur fle.
O zemra ime e zbrazët tanimë!
Aleksi qe. Pse po ia ndjek gjurmët dhimbjes?
Me babanë tok varrosa shokun. Desha
të pres të vinte turmë e re të shembte
fushën e lashtë të vdekjes. Doja të vdisja,
Doja të merrja fund në luftë me armikun.
Tani mbi amtaren çati kishin zbritur
hijet e njohura dhe unë i kapitur
mbi pragun e shkretuar isha ulur.
Nga dielli ndezur brenda vareshin gjethet
e lulet që dikur e mbushnin ajrin
me aromë e shpirtit i zgjonin dëshirë

të shkrihej dhe ai me atë lumturi.
Dhe dhimbja seç më derdhej në psherëtimë:
«O babë! O shok! O vatra ime e shtrenjtë!
Për fare ju humba. Mos qe vallë një krim
q'ju desha juve? Ah! Pse vallë dritën
unë pashë të ditës? Në qetësinë pa fund
të hiçit flija edhe ti më zgjove,
o qënie e lartë, mes popullit tënd t'burgosur.
Të paktën shihmë nëse vallë më ke parë
se nuk të shoh tashmë ndër sende të tjera
që zgjojnë shpresë a frikë, s'po të gjej.»
Endesha në atë mendim dhe ja tiparet
e sendeve vagëlloheshin e një qetësi
më shuante ndjenjat e trazuara.
Dhe i lehtë tek unë mbi flladin e qetë
Aleksi*) vinte. Më shihte, të njomur
e kish qerpikun nga një lot i fshehtë.
«I mjeri ti! Po-fle? Mos e ke pranë
Aleksin? S'kthehet më ai e asnjeri
si ai s'të do; se ai të pat dashur
aq shumë! Shpëto veten! Pse e mundon
Golemin? Ai ty të përgjërohet
për dashurinë atërore, shqetësim
veç për ty ka nën tokë. Mosmirënjohës
mos ji ndaj tij. Ja e shoh tek po niset
nëna ime dhe zemrën ka te djali,
edhe lotët asaj kush ia ter vallë?»
Dhe qau e u zhduk. «O hije të të mive,
pse më lëndoni? Për një qëllim të lartë
po ju bindem». E u nisa. O perëndi!

*) Hija e shokut i thotë Odiseut të shpëtojë veten.

Dhe nënë e tij kish vdekur. Tani gjëmbat
çelin n'atdhenë e djegur dhe veç unë
në truall të huaj iki pa njeri.
Këtu heshti e, nga dhimbja e tij i prekur,
Perlati qau dhe me ligjërim të ëmbël
e qetësoi. «Jo gjatë do gëzojë
(thosh ai) gjindja e poshtër
dhe as zemërim i qiellit s'është ky,
nëse dhimbjes sonë me dritë aq të bukur
lavdia i qeshi dhe shkëlqeu i tërë
në ballë të bijve shpirti i të parëve.
Leri me ne brengat e qetësohu».
Kodrat i mbulon vesa. Barëra t'buta
shfletohen e qeshin; kallinjte e gjerë
sofatin e prarojnë dhe të rëndat vile.
me hijeshi Polinin seç e veshin
dhe kolonia e re fle dhe harron
lavdinë e vjetër. Lumenjtë amtarë
dhe gjindja përtërihet,
pa e ditur të shkuarën dhe e panjohur
e kalon jetën. O! Kur vallë do të tundë
një fllad nga Epiri ato kodra
e do të zgjojë bijtë e vërtetë?
Për krutanin luftëtar
e shtroi Eloda me t'linjta e me purpur
krevatin.
Gjatë ndenji zgjuar me një shqotë të ëmbël
në gji. Odiseu e mendonte namin e ndritur
të të zot të shtëpisë e hirin e vashës,
gjersa qetësia shtriu hijen që shuan
afshin e të mëdhenjve e shpresën e të mjerëve.

KËNGA E KATËRT

Në mes të llambave të shkëlqyeshme hëna
me vijë të artë ajrin çante e buzë përrenjve,
që ua zbulon Specani valën, kapte
ullinjtë nëpër degët e të cilëve
një zhuzhitje insektesh s'kish pushim.
Po gaz i errët i natës s'harmonishme
s'guxon t'ia marrë trimit t'Sfetigradit
të pushimit harrimin q'ia veshi shqisat,
po me limfën e gjallë fluturon
shpirti i qetësuar si një që dëgjon
vëmendshëm ca tregime dhe papritur
e zgjon nga qetësia një i hidhur mendim.
I ngjante se në ajër fluturonte
mbi të reja qytete ku një i ri qiell
shndriste nga lindja gjer në perëndim
dhe zakonet e shtëpitë e pa asnjë vel
madje mendimet shihte ai e kuptonte
si e bëjnë ata jetën të shumëllojshme.
Të qartë vështrimin ia bënte flladi
kështu që ai mund të shihte përreth
lumenj e fusha e shpate të thepisur.
Dhe atje ku është fryma e akullt e veriut,
që fushat zhvesh e njerëzit plogështon,
fantazma t'errta para syve iu shfaqën.

Qenë ato hije që e kanë të shuar
çdo frymë kombëtare në fytyrë
dhe kurrë s'kënaqen me gjënë e lakmuar.
Mjegulla e helmët shpirtrat i përplas
dhe midis tyre zemërimin nxit.
Ah, qielli atyre çdo mirësi u ka marrë.
Endet tradhtia dhe zemërimi djeg
ndër gjokse dhe një tym i zi ngrihet
herë pas here nga ato zjarre e nxin,

.....

Sytë Perlati te një kodër çoi
ku e rrethuar nga ullinj e nga burime
një shatore ngrihej plot hijeshi.

II

S'e njihte atë Perlati, Të përgjumura
trajtat e hijshme një zemër pa shpresë
mbyllin. O Astir! Për vëllezërit e tu të shuar
vashat turke nuk qajnë. Ora e fundit
trimërisë sate i erdh. Rënkim i luftës
s'po i shpërthen nga buza kundërshtarit
në betejë. Tani ty toka e huaj
në gji të mban e mbi ëndrrat e lavdisë
mendimi të endet i trishtueshëm.
O lum ai në prill të jetës! Krijues
i bëmave t'larta në gjoksin bujar
shpërthente i lashti zemërim përvëlues.
Prej Krujës zbriste i stuhishëm

mbi Kidn' e shtypur e s'linte pa marrë hak
për vuajtjet ndonëse fëmijë i njomë,
Si vdekja mbi armiqtë hidhej e mbi fyerjen
e atdheut vajtonte dhe tërë zjarr
tri herë lëshoi kushtrimin' e luftës.
As për çlodhje nuk zgjidhte përkrenaren,
po i egërsuar në mes të goditjeve
te muri mbështetej dhe në shtëpi
hynte përmes një udhe me kufoma.
Dhe ashtu si errësirën e shkriu dielli
para lavdisë së shtangur ai arriti,
mu aty ku ish Mbreti i dëshiruar.
I madhi u çudit, fytyrën zjarr
ia dhuroi dhe zemrën ia qetësonte
me gaz mendimi për një hero të ardhshëm.
Kush ia rrëmbeu atdheut atë guxim?
Cila i buzëqeshi kur gjithçka
digjej e sytë nënave i thërriste?
O Auletë! O Auletë! Mbreti vdiq! Mbajnë zi
në Kidnë hijet e prindi arratiset
e pranë ty të do. Kush e lë
të lutet prindin plak, pa u brengosur?
Ikje e mbaje mendimin
se edhe ajri i druhet Astirit tënd
dhe që, me veten i zemëruar, krenari
endet me dashurinë tënde e premtimet
që vajton kot, pse Jurica* s'deshi.
Në dimër iku ajo. Bletët shkundi
një fllad i lehtë mbi lulet dhe i çon
në ajër, tufa-tufa i mbledh

*) I ati i vajzës

dhe prapa saj prek rërën latine
Astiri e shkon aty ku është Jurica.
Mes qiellit dielli mbushte luginat.
O pinjoll i mbretit, – tha ai –
ja mburoja (e në këmbë ia hedh), Ajo ishte e kotë,
për pinjojtë e Kidnës të shpërndarë.
Ti e di që i takonte dora ime
motrës së zemrës sime. Vajzën tënde
kush do ma marrë?» E s'qau më kot.
E mori Auletën. Rrushi i përflakur,
i varur përmbi hirin e Juricës,
i ftonte për psherëtima.
Ai vinte me nusen e përlotur,
linte shokët e arratisë e shkonte
ku qenë pemët e vetmuara.
E shihte Perlati. Të errtat brigje
shtriheshin rreth. Mbi tokë
jeta pushonte e kodrat dremitinin.
Nën të mëndafshtën shatore ai fle
e një llambë me natën lufton.
Mbi fytyrën ku enden kujtimet
e hidhura, ëmbël Auleta vigjëlon.
Te përkrenarja sheh një foshnjë,
kapej atje, i dridhet një buzëqeshje.
E sheh, e puth dhe synë e ndezur
drejton te yjet e psherëtin e tërë lot
e shtrin trupin nga lodhja të sfilitur.
Plaku thotë në ekstazë: Ç'është lavdia
e vdekshme, nëse i forti gjen përkujdesje
te ti, o grua e hijshme!»

III

«Kush vjen në natën e errët? Të ëmbël
e ka qerpikun e fjalëzën e butë.
Me hijeshinë i rrëmbën të gjithë.
Kush vjen? S'është kodra e Krujës kjo.
Pse ul sytë, o Perlat, e të dhëmb zemra?
Më nuk jehon buçima e luftës,
Kaloi mjaft kohë që kur ia rrëmbeu Golemi
zembrën Daidës...

...Ty gjoksin ta zbuti
dashuria e Fenisies. Si hije
veç Daida të vjen? Ia ndien të lartën
hijeshi të buzëqeshjes? Dorën borë
drejt perëndimit shtriu e nisi
të flasë dhe e bëri të ndiej' gaz e nderim.
Ngriti sytë e pa një diell të ri,
të reja brigje dhe Elodën e shtrenjtë
më të ndritur në fytyrë se çdo grua.
Nga shkëmbi i lindjes pa e me sy ngulur
plaku gëzonte. E menduar
pranë një varri

Astronomija*) qëndroi. «Nënë e nderuar»,
ku janë ditët e dashurisë?
Fëmijët ti s'i sheh mes trëndafilave
të kopshtit, as gëzon një shok të hirshëm
si perëndi». E zambakët e flokëve shkundte
edhe thërriste: «Lamtumirë!»
Papritur, flladi i freskët
tundi pyllin dhe gruaja tha:

*) Llagap tjetër i Daidës, nënës së Odiseut


«Nga vjen tingulli latin i gëzueshëm?
 Ju falem, miq! Ju që ju ndriti fati
 dhe hapët mikpritës kopshtin që e lëmon
 flladi pjellor dhe ju që fatn' e hidhur
 qetësuat në hijen ku pushoi vaji.
 E do të vijë një ditë që nga ajo kodër
 dikush mendimit do t'ia hapë fletët
 dhe nga atdheu i lashtë ta drejtojë.»
 Heshti e po mendonte për ligjin
 që të mëdhenjve u shkakton brengë të madhe.
 Dhe u zhduk në mjegullën e kaltër.
 U zgjua trimi e kujtonte natën e errët
 dhe i butë një zë n'ajër i jehoi.
 Kështu një ëngjëll foshnjes i kthen gjumin
 që bufi ia prishi. Eloda po këndonte,
 në gji i luante flladi, i ndriste agimi.
 «A ka fund dashuria jote, zot? Lum ai
 q'e ke në kujdes...
 Ti zemrat ndez e u fal mirësinë tënde,
 largësitë zhduk e njeriun që të lutet
 me një dritë të pashpresuar rrezaton».

Me fytyrën që i ndriste rendi jashtë
 mes bimësh të livadhit që nën fllad
 përthyejnë diellin që në to prarohet.
 Në brigje të gjelbra mes gurësh t'lëmuar
 vrapojnë ujërat. Perlati,
 që natës italiane për herë të parë
 ia thithi frymën këndejej,.....
 Për vëllezërit
 dhe për betejat e moshën e njomë
 i fliste e për dashurinë e nënës.
 Asaj i endej një nënqeshje në buzë

«A do shkojmë ne vallë (thoshte)
aty ku është nëna?» Me një puthje
ai e qetësonte e faqen një lot
ia njomte. Qielli lart gëzonte
me fllade më të ëmbla se këtë çast.

IV

Me njëqind lule bënte një vel
me ngjyra t'bukura e freskia e jetës
rridhte aty e ngricën e shkrinte.
Trimi i këputi e thuri një kurorë
hijeshiplotë, vesënjomur e t'dlirë,
ku derdhte aromë zambaku e trëndafili.
Hijet e zymta të natës mendonte
dhe Auletën e bukur plot me dashuri.
Që në agim
Odiseu zgjuar ndiente në shpirt luftë:
«Pa dashuri a ka jetë?» E te zemra e vvarë
një shpresë i ndizej për një t'ardhme t're
me bijën e Perlatit, po menjëherë
qortonte për guximin shpirtin e vet.
Ki më tepër besim, o trim, se fati
s'e vë shpërblimin më lart se virtyti.
Në dorë të vet mban dorën e Elodës.
Në mërgim
i kanë ata zemrat dhe një mendim
rron në dy gjokset. «O ti që brengën
qetëson, — këndoi Perlati, — veç për ty,
mbi vogëlsinë tonë, vitet shndrisin.
Dridhen botët, sa hedh ti një vështrim!»





«Krutan i mërguar»

P O E M Ë

Shqipëruar nga

ANDREA VARFI



THE UNIVERSITY OF CHICAGO

PHYSICS DEPARTMENT

CHICAGO, ILL.

NJË SHPËRBLIM

Edhe fjala nuk i shkoi,
e përbuzur, as u shua,
se Zeusit i pëlqeu,
si na thotë gojëdhëna,
të kujdesej dhe për dasmën
e hyjneshës s'ujrave,
S'heshti as buza e shpirtmëdhenjve
për vlerën e trimërive
të djaloshit Aqileht,
që i mban mend dhe i nderon
edhe sot gjithë një botë!

PINDARI – ODET ISTMIKE – VIII, str. 9

PROLOG

ODE ARBËRORE

Brigjet joniane të Kalabrisë, verë 1481

Kur mërgoi te lëtinjtë
trim Rrembhelmi i Udhiseut¹⁾
dhe i Praklenës, shtëpia
n'Arbër bëhej shkrumb nga zjarri;
tata, Atdheu i kishin rënë.
Zemra e tij ishte zymtuar,
ashtu siç është dhe nata,
por zemra nis t'i kthjellohet
nga dy sytë e Gjuhëmirës.
Dhe një zog i bardhë, i bardhë,
posi bora e malit Pindit,²⁾
më iu sul mbi kokë trimit;
e këtij nga përkrenarja
m'i rrëmben pendën e kaltër
dhe rrëmbimthi fluturon
drejt e te shtëpia e vashës,
bijës së Perlat kreshnikut
dhe të Mallmarës së mirë,
e në prehër m'ia lëshon,
teksa ajo, ulur te pragu
shihte detin arbëresh.

Gjuhëmira – Përse vallë, o zog i bardhë,
po më sjell sot këtë pendë
që prej Arbrit
nga ai Vend ku kam lindur,
ku kam dhe të mi vëllezër,
pendën që mbanin mbi kryet
në Sfetigradin plot zulmë,
ku dhe turka e mahnitur
dilte të vështronte trimat?
Zog i bardhë, ç'më hap plagë
dhe tani që e shkretë mbeta
edhe larg Atdheut tim? –
Zogu – Vashë e mirë, Gjuhëmirë,
vish cilonën ngjyrëgjelbër,
çohu shpejt e pastro odat
se po të vjen trimi i zemrës,
ai që aq fort të do,
sa të donte edhe jot ëmë;
që aq fort do të të mbrojë,
sa të mbronin të tu vëllezër! –
Gjuhëmira ashtu siç ishte,
dhe pa skemandil mbi flokët,
shpejt më çohet, shpejt më rend;
por aq papritur has trimin,
saqë papritur ma puthi,
duke qarë nga gëzimi.
Dhe përdoret ajo ma mori
dhe të dy më hyjnë brenda
në shtëpinë me tri qoshe,
që i kish ngritur Tatëloshi.

KËNGA E PARË

Era brigjesh shkundte shkurret,
më të kuq ngjyer nga dielli
që nga mali i borëm zbriste¹⁾
dhe m'i përcëllonte rrugës
shqepzin borë përmbi zverk
vashës, q'ecte e menduar.
Andaj mbi brigje t'Agosë²⁾
ky Rrembhelmi i Udhiseut
i ndal hapat e mori frymë.
Ky sheh qiellin e huaj,
që pa re pjerrej karpatesh
të përhirta, e rrëzë tyre
ky sheh fshatra pamjevrazhdë;
dhe mbi shkëmb Furinë e re³⁾
e vren t'heshtur; e poshtë fushës
ky sheh tufa që etjen çetnin
buzë Krathit kaltërosh,⁴⁾
që blerimit qetë shtrihet,
Por kjo s'ish veç pamje çasti
tek ky trim zemërfuri,
që nis flet me vetvete:
Rrembhelmi – Kjo pamje më të kuq ngjyer
një çast zgjati, si të kuqtë
tek fytyra e kësaj vashë,
Gjuhëmirës zemërvrarë,
që mahnitja ma pushton⁵⁾
sa sheh bimë proaska e brigje,
sipër qiellin e tej detin
me ujdhezat e Hjeagut:
por, sa nis lehtë një këngë,

sjell ndër mend mëmën Mallmarë
edhe vasha ngushëllohet
me shpresën se s'do të shohë
zbehtësi n'odat e mia! -⁶⁾
Kështu flet bujar shtegtari
dhe ma kaplon hidhërimi.
Pa na zbret për nga lind dielli,
e ndaj Jonit të veriut,
tej rrëpirës i ngul sytë.
Dhe nga dielli që po zbriste
sheh si ndriste ujët detit,
sikur yjet me zhyt zbrisnin:
Një pikzore kaq të bukur,
sa ta shihte dhe malsori
do gëzohej, por jo trimi,
se m'i kujtohet Atdheu,
dhe prap' ma pushton mëria:
«Nxjerr tym Kruja përtej detit!»⁷⁾
thotë. Edhe ndër mend i vijnë
të bëmet, njerëzit e njohur,
zjarret, zemrat e dragojve,
ankthe lufte e të këqija:
«Memec është atje dhe qielli,
lëngon dhe bari luginash,
në varr gjë nuk ndjen as tata!»
Kujton trimi edhe vetveten,
përlotet dhe fshan «O tatë!»
N'atë det brengash dot s'gjen
as për vashën fjalë t'ëmbël;
fundi i mynxyrë i Atdheut,
trumba njerëzish përshkënditur,
napë vdekjeje m'i hedhin!

Ai na zbret, por, eh, nuk sheh
shpirtmëdhenj, mburrje për t'ardhmen!
Zemra i qan për ato kohë:
pa m'i ther se as krojesh arbe
dot s'i shkon as vasha-nuse!
E te vendi i huaj trimit,
tek kujton tatën e shkretë,
mendtë i merren, befas meket,
dhe kërkon «një pikë ujë!»
Vasha-nuse e mban dhe shfryn
ndaj vetë zotit shpirtkazmë:
Gjuhëmira – Zot, kot quhe «i plotfuqishëm»,⁸⁾
kur rri sheh shtrojepërgjakur
praqet tanë nën osmanët!
Vallë pse shkrepë prej qielli
agu i lirë, kur në tokë
do përplasej kjo mynxyrë? –
E dëgjon trimi dhe vrehet:
pa nga zemra i shfryn mëria
si një rreze zjarr e diellit
që zhurit e gris dhe qiellin.
Atje lart i ngjan se sheh⁹⁾
përmbi fron fillimnë e jetës,
hije njerzish vetëngjizur,
ngjitur nga botë të ndryshme;
shpirtmëdhenj, që radhas ndrisin
përballë planetit tyre
dhe të gjithë të bashkuar
nga një mall për gjithësinë,
brenjë tokësore s'kanë.
Ndër ta, si shkëlqim hënor,
dhembje trimi vren Rrembelmi

vetëm tek shpirtmadh Mirbani,
korrur në luftrat për Krujën!
Dhe nga ky vegim fantazëm,
para syve i mbeti trimit
shtati hie i Mirbanit.
E me brengë po mendon:
Rrembelmi – Kush më sjell prapë ato ditë
kur i gjallë ishte Mirbani,
fryma zjarr e gjithë Krujës?
Ai m'ishte mburrje mëmash,
kur rrebesh mbi muret shfrynin
gjithë hordhitë e Ali khanit.
Sikur gjithë ajo lavdi,
aq fort mos kish ndezur flakën
e zilinë në gjoks tim,
që edhe sytë m'i errësoi,
mbase edhe sot do të shndrisnin
vatrat, nami arbëresh! –
Pa këtu kujton *Rrembelmi*
ato ditë edhe një herë,
kur la sallat mbretërore
edhe u derdh në sheshe luftrash,
ku na u duk se po përtërinte
lavditë e Gjyshit të madh,¹⁰⁾
që pa ndihmë e mposhti Azinë
edhe Evropën barklubi:
aq lavdi pat korrë trimi!
Por si korre kaq lavdi,
ky djalosh shpejt na kërkonte
të drejtonte edhe një sulm
nga fortesa mbi osmanët.
Po atë sulm n'ato ditë

dhe Mirbani e kish kërkuar,
e drejtimi i atij sulmi
domosdo iu dha Mirbanit,
pa Rrembhelmi u fye rëndë.
Por kur zbriti e teta mbrëmje
përmbi Krujën e rrethuar,
djaloshi Rrembhelm shikoi
brenda sallash mbretërore,
me habi Mirbanin shtrirë,
tek s'levizte as qepallë,
dhe në gojë asgjë nuk qaste,
por rënkonte e gulçonte.
Atij s'mund t'ia zbuste brengët
dhe as mund ta ngushëllonte
as hojmjalta fjalë e Marës,
as kujdesjet, dashuria,
as dhe sytë aq vështrimkthjellët,
buzëqeshja e përmbajtur:
Të gjitha në zemrën plagë,
(nga tallazet e atdheut),
Mirbanit s'i linin tragë,
siç s'i lenë as retë hënës,
kur e vakët çan mes yjesh.
Por e keqja ndjell të keqen:
uri shtriga pas tri ditësh,
si prej zotit t'ishte yshtur,
nxin qytetin e rrethuar
e mjaft trima ia heq luftës.
Prej të ngrysurit pallat,
uri shtriga na sodiste
se qysh prita osmane grinte,¹¹⁾
gjithë ata trima suli

që në ndihmë i vinin Krujës.
Dhe të nëntët që shpëtuan
të plagosur, Ali khani¹²⁾
rob ia nisi zot sulltanit,
që sërish ai t'i dërgonte
Ali khanit dallgë-dallgë
hordhi të tjera për sulmin
kundër gjokseve të Krujës!
Olimpi gjëmoi, dhe gjëma¹³⁾
shkund me gurët dhe Mirbanin...
U qet nata, e kur nga lindja
ndriste qiellit Parmenda¹⁴⁾
dhe pendari dilte praktik
që pas vendit të Parmendës
të maste sa natë kishte,
Rembhelmin, zemërpushtuar
nga beteja kryetrimash,
tek sapo ma mposhte gjumi,
trimit krahun pa kuptuar
ia përkund një dorë aq lehtë,
sa iu duk si fryma e mëmës.
që po i thoshte: «Atdheu digjet!»
Në ças zgjohet e pranë tij
nuk ka mëmën, por ka Marën,
nusen-vashëz të Mirbanit:
faqeskuqur, të përmbajtur,
që mezi frethonte vajin.
Qerpikët me lot përmbytur,
shqepzeflakur prapa krahësh,
n'atë natë ngjyrë argjendi,
ku përçark gjë s'pipëtinte,
si pa mend e lenë trimin...¹⁵⁾

Tek po zbret për nga lind dielli,
 e ndaj Jonit të veriut¹⁶⁾
 tej rrepirës, i ka sytë,
 i kujtohet tok me Krujën,
 dhe kjo ngjarje, e mendon
Rrembhelmi – Sa zë t'ëmbël kishe, o Marë!
 Dhe ti, zot i qiellit, dije¹⁶⁾
 se nuk ka asgjë n'Atdhe,
 që nuk është edhe ndër trimat!
 për kaq armiq që sot kemi
 dhe për gjakun që s'po derdhet
 për Atdhe siç duhej derdhur,
 dhe ti, zot, na je përgjegjës!
 Të flas zhveshur: nuk jam vashë,
 që kur nata i sterrosset
 lutje e lavdie s't'i kursen.
 Mirban, eh, zjarr i pushtetshëm
 të rëmbeu larg qytetit:
 gjak të merrje për suljotët,
 por, shpirtmadh, t'ish kurmi i shkoqur;
 edhe tek unë zilia... –
 Këtu heshti, kryet uli
 dhe në vaj na mbytet trimi.
 E kujton i përmallur
 atë kuvendim me Marën:
Rrembhelmi – O ndër gratë e para e Krujës,
 të këqijat për Atdheun
 dhe për ne s'kanë të sosur! –
 Mara – O ti i biri i Prablënës,
 zemra e Mirbanit nuk mposhtet,

por një parandjenjë e mjegullt
brenda zemrës po më thotë
se Mirbani s'do më kthehet! –
Sytë trimit iu përlotën.
Rrembhelmi – Po bie Atdheu ynë!
Ne dhe zotin kundër e kemi
dhe ndaj tij, as lutjet s'vlejnë.
Por ti drojtje të mos kesh,
se Mirban fatosi s'është
një prijës në mes prijësish!
Në gjurmët e tij po nisem! –
Si t'ish yll m'i tretet Mara
por gjithmonë i qëndron pranë.

KËNGA E DYTË

Sa mbaroi në shesh të luftës,
dhe si hije në mes lulësh
dritë yjesh, iu ngjiti qiellit,
kujtimet-ankthe t'Adheut,
që edhe i mposhtur nuk po jepet,
zjarr Mirbanin prapë e ndezin
dhe vëshrimin hedh mbi tokë.
Ai sheh arat dhe sheh ujrat,
kallzit, pemët-shujtë njerzish.
Brigjesh detesh sheh brezare
të punuara dhe mbi detet
një qilim qiku të kaltër,
pa më thotë me vetvete:

Mirbani – Dhe në klithma e në rrebeshe
s'm'i vret sytë aspak kjo pamje.

Toka e qeshur, tej ju njerëzit
ushqen ndjenjat për gëzime:
mbi ç'është e mirë ndër brezat,¹⁾
ndër gjithë njerëzit pasardhës
kthisin jetën; e kjo lidhje
dhe të vdekurit mban gjallë,
ndot e tekje i varros!

Andaj dhuna e një njeriu
përmbi njerëzit në botë,

kurdoherë kundërshtohet,
Dhe kush vdes për këtë udhë,
nga çdo brez ai përligjet.
Për këtë udhë, edhe unë,
o moj Mara ime e shtrenjtë,
ty të humba përgjithmonë.
Ti do ngresh sytë e do qash.
Do mejtosh n'aq fort të desha
gjersa prej teje u ndava!
Por të pakën, mos m'harro,
që ta ndiej grushtin armik
më të lehtë! Ah, kur dhe zoti
më me shpirt ndaj nesh do shfaqet?
Eh, po shkrihet brezi ynë!... –
Ai fliste e andej nga lindja
po na i ndriste muzgu yjet
tek e tuk kupës qiellore;
lehtë plisave të blerët
shkonte lepuri kullotash;
e nga tymi mezi shquhej
edhe ajo shtëpi e shkretë
me tri qoshe, ku me punë
plak Perlati ngryste orët,
që kërkonte t'i mbaronin.
Dhe Furia e papërmbajtur²⁾
i pushton gjoksin Mirbanit,
sepse e sheh si një grusht njerzish
kurdoherë i zhytin turmat
thellë e më thellë n'humnerë
zgjedhe e prangash te kjo botë,
ku mundohen natë e ditë
vetëm trimat që nuk shtrohen;

sepse sheh se si po struket
në një qoshe mirësia
qiellore, dhe për njerëzit
(kinse në emrin e paqes!),
zi më zi po i shton mjerimet;
sepse sheh nëpër pallate
një kandil të zyrtë varur,
që po ndrit si kandil varri
atë natë aq të rëndë,
q'ë gëzojnë disa krimba
kot në salla katragjyshësh!
Dhe mëshirëploti zot
u qëndron atyre pranë,
dhe si dielli dëshmon,
kështu pranë u ka qëndruar!
E për ju, kroje, karpate,
gjuhë ati, Epëri,
gjëmoi qielli e gjetkë u kthye!
Tani jemi ndër të huaj,
të shpërndarë po na treten
gjuha dhe cilësitë tona!
Mjerë ne! Të paatdhe,
rrojmë pa qëllim mbi tokë!
E pra, në një kohë i patëm:
Atdhe, gjuhë edhe cilësi!
Jeta vetë ishte për popull,
që, mejtimgrysur rënkon,
se s'kujton lavdinë e parë,
gjaknë e zemrës arbëreshe.
Vallë ç'zjarr e çon ndër male
shpirtin zjarr të Perlat trimit?³⁾
Atij gjë s'i mbet mbi tokë

veç shtëpisë shkrumb në flakë.
Atje foshnjërinë e shkoi,
shijoi gazet, hidhërimet;
atje priti ai rreziqet,
ngadhënjeu, u rrit si prijës.
Në një breg lumi rreshtoi
burrat trima, e ndrit betejash
përmbi vdekjen e zhduk frikën,
dhe nga gratë veshjekuqe.
Shkrepte agimi e fushës luftës,
mbi kalorësit kufoma,
hingëllinin tek-tuk kuaj
thundërkuq, ndën krifet brushë
syperflaktë, e mbi breg tymi
flet për ndeshjen. e mbi kodrat
lufta ziente përçark ajri
të mirr frymën e timba nxihej
prej një mjegulle beteje:
dhe Perlatin e pushtonte
gaz i fitores-habi.
Dibër, moj, pse turbullohe?
Nëntë ndeshje atij s'ia prekën
krenarinë e ngadhnjimitarit
dhe nuk është punë trimash
se kujt qielli ia hedh rrezet!
Por, eh, ra dhe Sfetigradi!
Edhe pse vendlindje humbur
nusja e re, me burrin mundur,
as në vajet, zemërvrara
mallkim kurrë ajo s'lëshoi
ndaj Perlatit. Dhe në ditën
q'u mbajt zi për Sfetigradin,

te ballkoni ajo 'mu shfaq
si të tjerat, e tronditur
nga kambanat tinguj-zie.
Sytë e saj ishin siç është
dhembja në një zi të madhe.
Pranë trimit s'pa Rrembhelmin
që përpara si zorkadhi,
që ma zë dita në Fjerzë,')
nuk i ndahej Gjuhëmirës,
vajzës «mirë» të Perlatit,
dritë jetë e fatosit,
me ata sy aq vështrimëmbël,
rritur me djalin jetim,
te kodra, tash mbetur shkretë,
vatrë e njëjtë e dy fëmijëve,
mall i njëjtë për Perlatin,
që nga gazi fluturonte
kur i shihte kacavjerrur
në një trishkull të dy bashkë.
Sa kujton të dy fëmijët
nis Perlati e qetësohet,
dhe fatos sërish po kthehej.
Por papritur i kumtonin
se fajtor na paskej qenë
që kish rënë Sfetigradi,
se «për mllef, thoshin, Perlati
s'paskej luftuar si duhej»!
Edhe pse pa vend dënohet,
për Atdheun i rreh zemra:
në një vit ndërron tre vende,
me gjak lan sheshe betejash
që në veshë i ndien përherë.

Por të ndyrët dhe trutharët
në shënjestrë e kanë vënë
për një faj që s'kishte bërë!
Zemërplazur, shtrëngon dhëmbët:
prapë ndeshet dhe fiton,
për vete s'mban lavdi.
Pa Mallmara, e shoqja e shtrenjtë,
e dërrmuar nga kjo gjendje,
sytë i mbyll dhe e lë vetëm
me të voglën Gjuhëmirë.
Qetësi më s'ka Perlati
edhe hidhet n'Hesperi.
Këtu i vjen edhe mandata
se «mbret Gjergji na la shkretë».
Pikëllimi e pushtoi,
se pa fundin e atdheut
e me t'arbëreshë flet.
T'Arbëreshët – Ti lot derdhe, o Perlat burri,
me ne brengat tona i qave;
ikja prej Atdheut tënd,
për ty qe pelin, o trim!
Po ç'të bëjmë? Këtë fat
na paska cak'tuar qielli.
Ç'të bëjë i ziu njeri? –
Dhe tani pa asnjë shpresë
dhe pa ditur ç'mund të bëjë,
shtrëgatën krenare e shkrin
në një shkretëtirë t'huaj.

KËNGA E TRETË

Dimri shkundi nëntë herë!'
krahët borë t'Apeninit
përmbi degët gjetherëna
dhe me diellin e vakët
shkoi mëllënja ndër ullishtet;
kurse bregut të një lumit,
një shtegtar që i prin një turme,
sa sheh re pluhur së largut
turmës shpejt i ndërron udhën.
Rrembhelmi – Kreshniku tartar ua mbathi²⁾
me vrap këmbëve ndaj detit
duke lënë prapa frikën!
Andaj sonte dhe ti, erë,
që prej Arbrit më fryn qetë,
sikur përkujton lavditë,
më mburo dhe vatrë e Krujë!³⁾
Eh, ç'më djeg malli i Atdheut!
Po dot s'kthehem, sepse gjetkë
po më pret detyrë e lartë! –
Tha dhe zemërhelm u nis,
e kaloi zallin e rrugës.
N'armë i ndriste syri i hënës.
Ravgoi natën, gjithë ditën.
Kur ra muzgu më veriun,

që zhvishte drurët e zverdhur,
trimi larg vëren një shpellë
me një zjarr të madh përpara
e rreth shumë t'armatosur.
Me ngurim e plot dyshime
për tek shpella ai na niset.
Po kur zjarrit pranë i qaset
i ndal hapat se për tokë
mb'anë rrugës, pranë shokësh,
sheh ushtarë që lëngojnë
gjithë gjakra e duke u dredhur.
Atë mbrëmje fare pranë
mbi një timbë trimi ndalet:´)
Atje na qenkej një krua
ku na rritej një ulli:
(si atje dhe vasha i ndalej
n'Arbër kur shkonte për ujë.)
Dhe në Krujë i shkon mendja
e te lili i bardhë i nuses...
Por tani dhe bisku i lilit
i ngjan ngjyer me gjak t'arbër!
Pranë e ndarë në dy pjesë,
i del parzmore e Mirbanit:
dhe pendët e përkrenares
ia thyen, ia drithton era
rrafsh me biskun, e mbi buzën
e përgjakur të parztores...
Po më psherëtin e thotë:
Rrembhelmi – Eh, fatosi ynë i mjerë!
Vetëm një zot shpirtskëtërrë
ty të mposhti e ç'mund të bëje
kur u derdhe për gjakmarrjen

e azganëve suljotë;
që të ligjtë i bënë copë?
Edhe jetën tënde e humbe! —
E qepallën e përlotur,
mezi Rrembelmi e mund:
se kujton sa t'arbër shuhen
dhe të zbrazët ndien zemrën,
edhe pse në fusha lufte
dilte mundës e i çante krahun
turk Ali khanit fodull.
E mbi timbë ku qe ulur,
atë mbrëmje edhe muzgu,
që nga kodrat me kaçuba,
tinguj të përzishëm fyejsh
i përcillte e iu kujtuan
me gërmadhat dhe heronjtë.
Por ato kohë më s'kthehen,
sepse edhe në tingujt ndien
stepje gishtash, tringe t'huaj,³⁾
që po prishin jonësinë.
Ndaj nga timba ku ish çohet
që të shkøjë e ta pështyjë
atë mistrec që prish tingujt,
por ia mpin befas mërinë
një si akull: kujton vlerat
dhe të bëmet, por çap s'bën,
atë çast zemra s'përgjigjet:
zverdhet, mpaket dhe gulçon.
Dhe mbi gjymtyrët si akull
bryma ulet posi borë.
Pranë i shfaqet nj'udhëtar
dhe pyet për Ali khanin

dhe për llahtarin e grave.
Trimi hesht dhe ai thotë:
Udhëtari! – Vallë a mos shpirti për luftë
ty t'u mpi, sepse atdheut
një fatos po i mungon?
Dhe ai, ndofta, për faj tënd!
Ai bëri, siç do bënte
Gjyshi i madh, edhe pse fati⁶⁾
u tregua njerë me të! –
Por sheh brengët e Rrembelmit
hije e Mirban udhëtarit,
dhe përmallet e shigjetat,
(shpërthim shqotash njerëzore).
i frethoi shpejt shpirtmadhi,⁷⁾
dhe ma ndien si një vëlla,
sepse (n'udhëtimin hije),
sapo që kthyer nga Kruja
ku kish parë odat e tij:
mbi shtrat; rrjeta merimangash,
vazot tharë e gjithë pluhur,
pranë vatrës, krejt të shuar,
shtrirë e shoqja, Mara e shtrenjtë;
prej pullazit ai me sy
kodra, miq kishte qafuar
dhe përmallshëm kishte thënë
«Unë s'jamë më në mes tuaj!»
E tani te dheu i huaj
sheh Rrembelmin krejt të shkretë,
pa ma shtyn zjarr i Atdheut
t'i drejtohet edhe zotit:
Mirbani – Me ngulm, zot, të drejtohem:
dikur thonë, merrje pjesë

dhe ti në punët e tokës,
merrje pjesë edhe ndër ankthet,
doje edhe vatrën tona.
Dielli n'Arbër s'pa të lindin,
as të vdesin mendjekotë,
që t'u shkojë e zbrazët jeta;
por atje dielli pa
vetëm vrulle të stuhishme
në krahere të bashkuar.
Në një shekull atje ndritën
vepra që ndritin me shekuj!
Zot, mos vallë është e vërtetë
që tani je kundër nesh?
Dheut t'huaj, i panjohur,
trim Rrembelmi i Udhiseut,
plot virtyte, nuk ka t'ardhme,
këtu s'ndien as dritën tënde...⁸⁾
Dhe fjalën e ndërpreu
se një valë drite llapsi
(nga një kometë në qiell),
që na iu duk aq e ngrohët
sa dhe drita e diellit marsit,
që shkrin akujt e mbart lulet,
edhe nata puhivakët
më të ndritshëm i bën yjet.
Përmbi detet kreshpëruar
hije shpirtmëdhënish vallzojnë,
dhe nga pirgu mëmë-zonja
shikon manat dhe gëzoftet.
Dhe hije e Mirbanit ngjitet
lart më lart kupës së qiellit.

KËNGA E KATËRT

Kundrejt Jonit n'Hesperi,
në një kodër Perlat plaku,
larg lumenjve stërgjyshore,
të veçuar ka shtëpinë,
por jo zemrën, që edhe ëndrrat
m'i sheh n'Arbër si gjithmonë.
Edhe e bija e Tatëloshit,
Gjuhëmira, po në Arbër
si fëmijë lot në ëndrrat
ato lodra aq të hijshme,
ndaj sa zgjuhej, gazi i trej
Fat i madh për ato kodra
që për të ardhja e Rrembhelmit,
bir miroshtit t'Udhiseut,
aq të shumëdëshiruar
nga plot vasha për kurorë.
Ç'ndiente vasha në gjoks, djali
si t'ish orë, ia kuptonte,
edhe vasha i ulte sytë
zemërgaze e zemërdhembshur.
Hija e Mirbanit në qiell,¹⁾
edhe ngjyrën q'u jep dielli
cirkave kur bora shkrin
nga pullazet, e vë re,

andaj hap krahët vigane
e me gaz niset drejt tokës.
Edhe si ujanë drite
përshkëndit hijet këllirë
të të gjithë të këqijve,
(që sa janë përmbi tokë
në pelin na nxijnë jetën:
kryeperlën e natyrës),
se këllirat dhe ndër qiej,
të ndërkyera, pa shpresë,
enden duke nxjerrë klithma,
si mbi tokë nxjerrin bishët
ulërima e mjaullima
ndër net bore e thëllimi,
që kur nuset i dëgjojnë,
në shtrat ndiejnë rrëqethje,
Hije e shpirtmadhit Mirban
çan mbi male, fusha, dete,
mbi katunde jetënxira,
dhe si ai që n'Atdhe kthehet
pas një rruge fort të gjatë,
zbret ngadalë përmbi tokë.
Ë mbi kreshtën më të lartë
ulet ndënë qiell' e kaltër
q'ishte si një fushë lirë
e përkundur nga fllad deti
kur përziën lehtë lulet.
Dhe te flladi e pëkrundte,
në fytyrë, si të gjallë
e ndien veten, edhe zemra
nis t'i rrahë si mbi tokë:
Në mes qiellit shikon trimi

një si dritë që ngjall gurët
dhe blerimin jep ndër pyjet:
zjarrin e natyrës, diellin,
që me dashurinë e flaktë
vijon punën e lavdishme
me qëllim: Ditën e madhe²⁾
ai zjarr, mes tingujsh gazi
nis t'i endë vashës pajën.
m'ia stolis me yje mbrëmjes
dhe për ditë hiret e saj
po m'i rriten, siç m'i rritet
edhe i pastri zjarr i zembrës
kur përkdhel lulen e parë,
edhe sytë e flaktë u hedh
pemëve dhe prozhmeve,
që të pastrit fllad i qeshin.
Dhe tek trimi m'i shkon mendja,
pa më skuqet, m'i rreh zemra.
Ai zjarr aq ëndjemjaltë
ngjiz të bëmet edhe prehjet,
e me t'ëmbëlën dhe të thartën,
ankthin-pendë e puthjen-flakë,
q'edhe kur s'e nxjerr dot fjalën
sytë e sjellja vetë flasin.
Kështu fshehtazi na zbret
në mes njerëzish dashuria.
Pas një drithërimi t'ëmbël
depërton kjo jetën tonë,
përtërin, krijon familje
pa pushim edhe përjetë.
Dashurinë e pa Mirbani
dhe shkëlqeu nga gazmendi,

e si shigjeta na çan
drejt nga Çiamisi, e qëndron³⁾
te një tempull i rrëzuar,
që mbi barin prej së lashtit
jeton rreth parzenave,
gërmadha të shekujve.
Atje gjet një qetësi,
si atë të netëve
kur s'fryn erë qiejve:
pa iu ngjall një mall i turbullt.
Ajo pamje pa lëvizje
l kujtoi në parzëm vdekjen,
e më ndien tinguj varri,
që mejtimi i lartë i fshin:
thahet lulja, buçet bisku:
kështu vjen vdekja pas jetës,
dhe pas vdekjes na vjen jeta:
dashuria për të tjerët
dhe për ne lind dashurinë...
Trimin nga këto mejtime
e largon një llamburitje
që çan erën, si veriu
i çan retë majë kreshtash
dhe nis vallen fushash drita.
Po Mirbani zemërdjegur
gjithë zjarr i thotë diellit:⁴⁾
Mirbani – Ti që botës i sjell gaz
dhe shëndet e bukuri,
m'i dëgjo dhe këto fjalë:
Përmbi tokë i mbylli sytë
një shpirtlartë, Udhëiseu;
që sa rrojti paqe s'pati.

Ne pandehëm se ai paqen
do ta gjente tek i biri,
(sot i shkretë në mërgim.)
që me duaj si dy sytë.
Dhe si nuse për të birin
dëshironte të kish bijën
e një prijësi të atdheut,
edhe ky burrë i panjollë.
Të dy njëri-tjetrin duan.
Diell, m'i mburo, m'i ngroh
ato dy zemra të reja! —
Këto tha dhe rrezet dielli
i drejtoi nga brigjet harca,
ku të rrallë lisa rriten,
dhe ku mbjell më pak zi fati.
E plot gaz Mirbani çan³)
gjithë mall vërtik drejt Krujës.
Dielli ndaj perëndimit
ia praron veshjen, e pamja,
me atë pah përmallimi,
si prej ajri hir i jep,
nëpër retë kaltëroshe,
të përndara poshtë rrëzash,
që vijon t'i çajë, e pret
brenda zemrës të dëgjojë
më të madhen drithmë jete!
E shpejt thjeshtësia e çiltër
posi vetë dashuria
me shkëlqimnë e saj e vesh.
Dhe Mirbani, i mahnitur,
s'ia ndan sytë Krujës tij,
që me Arbrin tok i duket

në përtritje, ashtu si donte.
Pa i afrohet e shpërthen:
Mirbani – Përshëndetje, o Kruja ime,
dëshmi drite përmbi tokë,
vepër e njerëzve të thjeshtë,
q'u takon nderi, lavdia! –
Shpirtmëdhenjtë që lart shihnin
gjithë shend. Edhe *Mirbani*
pas i ndjek qiellit të pastër.

SHPJEGIME

Kjo poemë e rinisë së hershme të poetit e pabotuar gjer në vitin 1977, kur e botuam ne për herë të parë, u gjet në shtatorin e vitit 1975 në fondin «De Rada» të Bibliotekës qytetare» të Kozencës (Kalabri), vetëm në gjuhën italishte. Në dorëshkrim është pa titull, pasi mungon mbulesa.

Ne, duke u mbështetur në përmbajtjen dhe në një shënjëzim në parathënien e botimit të parë (1836) të poemës «Këngë të Milosaut», ku poeti shprehimisht flet për një poemë të rinisë së tij me titullin «Esule di Croja», i vumë po të njëjtin titull «Krutan i mërguar».

Dorëshkrimi i poemës në italisht, nga i cili u shqipërua kjo poemë, është i vitit 1841. Pasi fragmenti që riprodhon poeti në parathënien e poemës «Këngë të Milosaut», nuk haset në dorëshkrimin e 1841-së, ne mendojmë se, gjatë periudhës 1837-1841, kjo poemë duhet të jetë ripunuar prej poetit gjersa ka arritur në derdhjen (versionin) e 1841-së.

Në origjinalin italisht poema ndahet në dy këngë, por këngën e dytë, e cila zë tri të katërtat e krejt poemës, ne e ndamë në tri këngë, pasi vetë arkitektura dhe ndërtimi sa më i qartë i saj, e kërkonte një ndarje të tillë. Prologu në dorëshkrim është në prozë poetike dhe e gjithë poema në Il-rrokëshin e bardhë. Pasi bëmë disa prova dhe pamë se në 8-rrokëshin karakteristik të De Radës jepej shumë më mirë ngjyrësia shqiptare dhe dilte më në pah stili poetik i autorit, ne i dhamë, si prologun dhe krejt poemën, në këtë metër. Po kështu, për të dalë më në pah ngjyrësia shqiptare, disa prej emrave të personazheve të poemës (të ngjizur prej De Radës së ri me anë kompozitash në greqisht) ne i shqipëruam në përshtatje me natyrën e gjuhës sonë dhe duke ruajtur kuptimin e përafërt të çdo emri kompozitë. Kështu emrin

«Nevralge» e dhamë me emrin kompozitë «Rrembhelm», «Astonemo» me «Praklënë», «Eugloe» me «Gjuhëmirë», «Erolave» me «Mallmarë», Emrin «Odise» e dhamë në trajtën që do ta jepte në shqip vetë De Rada «Udhise», Emrit «Morvan» (për të mos i kujtuar lexuesit tonë emrin apo epitelin e përcjmuar «mervan» «i ndyrë», «i ulët», «mizor», «i poshtër»), i bëjnë një ndryshim fare të lehtë, duke i dhënë një emër shqip, që pasqyron edhe vetë tiparet e këtij fatosi shpirtmadh, emrin «Mirban» (që *ban* (bën) *mirë*).

Si në gjithë punën tonë, edhe këtu, për ta dhënë sa më qartë, pa iu larguar ideve dhe përfytyrimit (figuracionit) poetik të De Radës, nuk i kemi mbetur skllav ndërtimit shprehës eliptik të tij dhe vende-vende, ku e kemi parë të nevojshme, kemi bërë edhe ndonjë shkurtim fare të vogël për hir të qartësisë poetike.

Në të njëjtën kohë, duke ndjekur vetë praktikën e zakonshme të poetit, anash vargjeve kemi vënë emrin e personazhit që flet me të tjerët apo me vetveten dhe në krye datën kur zhvillohen ngjarjet, ashtu siç e yston (sugjeron) vetë poema.

NJË SHPËRBLIM

Ashtu si në krye të poemës «Këngë të Milosaut» edhe në krye të kësaj poeme De Rada vendos një citat po nga Pindari (Ode Istmike, str) 9). Po këtë herë nuk e jep nga origjinali, po nga përkthimi në italisht i Borghit. Dy vargjet e para De Rada i zëvendëson me pika. Ne, për të dalë ideja më e qartë, i cituam edhe këto dy vargje, duke u mbështetur në të njëjtin përkthim. Kjo odë, kushtuar nga Pindari, Kleandrit të Egjinës, pas betejës së famshme të Salaminës, jemi të mendjes se u zgjodh nga De Rada si dëshmi e bindjeve të tij se edhe qëndrimi heroik i krutanëve në mbrojtje të Krujës, do të ketë «shpërblimin» e tij të madh historik: do të shënojë preludin e shpëtimit të afërt të kroit Shqipërisë. Po ky citat, ku përmenden Zeasi (Zeusi), hyjnesha e ujrave, (Teti, Dcti), Aqilehti, (Akili), jemi gjithashtu të mendjes se u zgjodh nga De Rada edhe si dëshmi e bindjeve të tij se arbëreshët (shqiptarët) janë pasardhës të drejtpërdrejtë të atij rodi pellazg e vigan, që i dha lashtësisë, jo vetëm kryefatosat më të lavdishëm, si Aqilehtin me shokë, po edhe vetë perënditë e Olimpët,

si Zeasin me shokë. Dhe pasardhës të këtij kalibri, që gjatë gjithë shekujve shkëlqyon me Burrin (Pirron), Lekën (Aleksandrin), Skënderbeun me shokë, pa tjetër do të dalim fitimtarë, sepse në ndihmë të tyre kanë një vazhdë të pasosur heroizmesh, pra, në ndihmë të tyre kanë edhe gjithë «të mirët», shpirtmëdhenjtë e pavdekshëm, që si hije përjetë sogjetojnë (vigjëlojnë) mbi qiellin shqiptar, të gatshëm kurdoherë për t'iu gjetur krahë mëmës Shqipëri. Për poctin kjo besëlidhje e përjetshme në mes të fatosave të gjallë dhe fatosave të së kaluarës nuk është një vizion artific, i rëndomtë romantik por pasqyrë e një të vërtete stërshekullore shqiptare, që mbështetet në besën e dhënë, të cilën për ne kurrë nuk e tret as dheu, besë e pavdekësuar në baladën «tonë të lashtë» «Kostundini dhe Garentina».

PROLOG: ODE ARBERORE:

1) Trim Rrëmbhelmi i Udhiseut ky fatos, i mbetur që fëmijë jetim, i rritur në shtëpi të kryefatosit Perlat bashkë me të bijën e këtij, Gjuhëmirën, pasi ka luftuar gjer në fund për mbrojtjen e Atdheut dhe të Krujës, detyrohet të marrë rugën e mërgimit në Itali, ku ndodhej edhe plaku Perlat me të bijën.

2) *posi bora e malit Pindit* – Për De Radën, Pindi, Dodona, Malësia (Molosia), Pelasgjia (Thesalia, Olimpi), si vatra të lashta pellazgësh, janë edhe vatra shqiptarësh.

3) *në shtëpinë me tri qoshe* Tiparin triqoshësh kësaj shtëpie De Rada nëse nuk ia jep si simbol të një vatre konspiratorësh, («trishja» ishte simbol i shoqërive të fshehta revolucionare), këtë tipar mendojmë se ia jep kësaj shtëpie si shenjë dallimi, si pikë drejtimi e grumbullimi për arbëreshët e tjerë të sapovajtur nga Arbr i pushtuar prej otomanëve.

KËNGA E PARË

Rrëmbhelmi tok me vashën Gjuhëmirë, që herët në mëngjes po rend drejt bregut jonian të Kalabrisë. Nga zhvillimi i ngjarjeve të poemës, ky fillim të lë të kuptosh se Rrëmbhelmi është në udhën

përgatitore të zbarkimit në Shqipëri tok me forca të tjera arbëreshe nën udhëheqjen e të birit të Skënderbeut, Gjin Kastriotin.

1) *që nga mali i borëm zbriste* – Në tekst është «që nga Apenini i borëm zbriste». Për shkak ritmi dhe njëkohësisht për shkak se nga shënimi i vendit dhe i datës që kemi vënë në krye të prologut del qartë ku zhvillohet ngjarja, ne zëvendësuam emrin *Apenin* me emrin e përgjithshëm *mal*.

2) *Përmbi brigjet e Agosë* – Në tekst emri *Agosë* është *Agoa*. Për t'i dhënë një ngjyrësi arbërore, ne i bëmë këtë ndryshim të vogël, pasi në arbërisht *agoja* do të thotë *agu*, agimi. «Kur agoja është e vjen prej detit Jon», thotë Serembja në një varg të tij. Si toponim nuk jemi të sigurt në është i vërtetë apo i krijuar prej poetit.

3) *dhe mbi shkëmb Furinë e re*. – Në tekst emri «Furia» jepet me *F* të madhe, pra si emër i përveçëm, ndoshta sepse ka dashur t'i japë kuptimin e «tërbimit hakmarrës» të «Furieve» (Erineve) të mitologjisë antike greko-romake, shpirti i të cilave tërhiqej dhe vërsulej për hakmarrje vetëm për çështje të drejta. «Omnis furiis surrexit Etruria justis» (Gjithë Etruria u ngrit (me këmbë) e shtyrë nga furia (tërbimi i drejtë) thoshte Virgjili.) Nga një furi kësajsoj, nga një shpirt hakmarrës i drejtë janë të ndezur, bashkë me vashën, edhe fshatrat arbëreshe, pra gati të shpërthejnë kundër çdo zgjedhe.

4) *buzë Kratthit kaltërosh* – Lumi Krat (Krathe i lashtësisë), përgjershinë e luginës së tij, është më i madhi në Kalabri.

5) *sheh ujdhezat e Hjeagut* Në tekst emri *Hjeagu* është *Eagji*. Edhe emrit të kësaj ujdheze të detit Jon (që De Rada e nxjerr nga shqipja «i jonë»), për t'i dhënë një ngjyrësi arbërore, i bëmë këtë ndryshim të vogël. Edhe për këtë toponim nuk jemi të sigurt në është i vërtetë apo i krijuar prej poetit.

6) «*zbehtësi n'odat e mia* – Gjithë kjo tablo jep tërthorazi gjen-djen psikike të Gjuhëmirës e cila, edhe pse arriti dëshirën e saj të madhe, (bashkimin me trimin e zemrës së saj), prapë e ndien se jeta e ngushtë, lumturia brenda mureve të shtëpisë së të shoqit, i duket e pakuptim, nëse nuk vihet edhe në shërbim të idealeve të mëdha patriotike, shoqërore, njerëzore..

7) *nxjerr tym Kruja përtej detit*. Emri *Kruja* në tekst është *Kroja*.

De Rada edhe këtë toponim e nxjerr nga «krua». Po në këtë rrugë ecin edhe arbëreshë të tjerë.

8) *Zot, kot quhe «i plotfuqishëm.* – Në poemë ndërhyrjet e vashës Gjuhëmirë janë fare të pakta, por edhe këto mjaftojnë për karakterizimin e saj si një shoqe të denjë për Rrembhelmin; kjo nuk është e pajisur vetëm me bukurinë, fisnikërinë shpirtërore, po edhe me një dashuri aq të zjarrtë për atdheun dhe lirinë, sa që rebelohet edhe kundrejt vetë zotit.

9) *Atje lart i ngjan se sheh* – Këtu kemi çastin-çelës (momentin kyç) të krejt poemës: kundër «besëlidhjes» së armiqve të Shqipërisë e të popullit shqiptar të bekuar prej vetë zotit të qiellit poeti kundërvë si bashkëluftëtarë të pë jetshëm të Shqipërisë e të popullit shqiptar armatën e pasosur të heronjve të rënë në betejat shekullore për mbrojtjen e lirisë. Këta «shpirtmëdhenj», paraardhës të popullit tonë, janë rreshtuar me gjithë shpirtmëdhenjtë e gjithë popujve të tjerë, nga dëshira e zjarrtë për të triumfuar e d.ejta dhe liria. Në mes të këtyre «shpirtmëdhenjve» të vdekur, De Radës, në vegimin e tij fantazmë, lart në qiell i ngjan se sheh (dhembje trimi prej të gjalli) «vetëm tek shpirtmadh Mirbani, korrur në luftrat për Krujën». Dhe këtu i përtërihet si krejt e gjallë e kaluara: lavditë e Mirbanit, bregat e vetë Rrembhelmit.

10) *lavditë e Gjyshit të madh* – lavditë e Skënderbeut.

11) se gjithë ata trima Suli – De Rada, duke përmendur ndihmën e shqiptarëve suljotë Krujës së shekullit 15-të, tërthorazi thekson edhe ndihmën që këta trima i dhanë, bashkë me arbëreshët e Greqisë, kryengritjes greke e gatishmërinë e tyre e të gjithë arbëreshëve për ti ardhur në ndihmë atdheut e popullit shqiptar në betejat e afërme për çlirimin nga zgjedha otomane. Nga grafia e emrit *Suli*, të cilën De Rada e shkruan *Souli*, kuptohet se në atë kohë poeti ynë duhet të jetë vënë në dijeni mbi bëmat e Sulit përmjet burimesh frëngo, kryesisht përmjet botimeve të Pukëvililit të periudhës 1805-1820.

12) *Ali khani Kruja* – bie në duar të hordhive të Ahmet bej Evrenozit dhe të sulltan Mehmetit më 16 qershor 1476, pra emrin Ali khan, që do të thotë «komandant Ali», De Rada këtu e përdor në kuptimin e përgjithshëm të komandantit armik.

13) *Olimpi gjëmoi, e gjëma* – De Rada përmend Olimpin: a) si

malin ku kishin selinë perënditë e lashtësisë pelazgjike, pra edhe shqiptare), b) gjeografikisht fusha poshtë Olimp të quhej Pellazgji; po edhe emri i saj i mëvonshëm «Thesali», sipas De Radës, shpjegohet me shqipen «te zalli»; c) për De Radën tregohet që për analogji një skenë – ëndërr personale, të paraqitur me shumicën e tyre prej popullsisë shqiptare.

14) *ndriste qiellit Parmenda* – Hyllësi (konstelacion yjesh, mbase hyllësia «Qerrja», që bujqve, pendarëve, barinjve u hyn në punë edhe për të kuptuar se sa orë natë ka akoma.

15) *si pa mend e lenë trimin...* Pas këtij vargu De Rada jep për analogji një skenë – ëndërr personale, të paraqitur me vargje.

16) *Dhe ti zot i qiellit, dije* – Rrembhelmi, siç do ta thotë më poshtë poeti, përpara mynxyrave që ishin përplasur dhe përplaseshin me Arbërin dhe Krujën e tij, me zemrën plot helm e vrer, urren jo vetëm miqtë e rremë evropianë e papën me beqimet hipokrite apostolike po edhe vetë zotin.

KËNGA E DYTË

1) *mbi ç'është e mirë njerëzore...* Mirbani, e tok me të De Rada, këtu dhe në vargjet e para e pas, na jep kuintesencën e koncepteve filozofiko-shoqërore për vetë jetën njerëzore, koncepte shumë përparimtare për kohën.

2) *Një furi e papërmbajtur...* Ana shoqërore e koncepteve të Mirbanit. e pra edhe të të riut De Radë, këtu e më poshtë shkon ake u theksuar; urrejta për padrejtësitë konkretizohet me urrej-tjen për vetë zotin e pallatet e sundimtarëve etë shtypësve, në dashu i për Arbërin e tij, për arbëreshët, të «shpërndarë ndër të huaj», ku edhe vetë gjuha e cilësitë kombëtare më të mira janë në rrezik «të treten».

3) *shpirtin zjarr të Perlat trimitit* – Mirbani (hije) që lart nga qielli, duke pasë si në pëllëmbë të dorës tokën e Arbërit dhe vendbanimet e arbëreshëve të shpërndarë brigjeve të Hesperisë (Italisë)

jugore, dallon shtëpinë me tri qoshe të fatosit Perlat. Dhe këtu e në vargjet që pasojnë, ne njihemi së afërmi me jetën dhe bëmat e këtij kyetrimi, me të shoqen besnike, Mallmarën, me vajzën-mirë (zanë), me jetimin e vogël, Rrembhelmin, birin e Udhiseut e të Praklenës, që po rritej në shtëpi të Perlatit tok me Gjuhë-mirën e vogël.

4) që *ma zë dita në Fjerzë*. Në tekstin italisht fjala Fjerzë është «*Felci*» si emër i përveçëm, që do të thotë *lier*, Pasi ngjarja zhvillohet në rrethet e Shqipërisë verilindore, (Dibër, etj.) në vend të një emri të përveçëm, (toponimi) dibran të panjohur «*Fier*» e pamë të udhës të përdornim një toponim, tani shumë të njohur po të atyre anëve, toponimi «*Fjerzë*». Krahasimi me sorkadhin këtu është për Rrembhelmin, i cili, siç e thekson në pak vargje-shtojcë poeti, që ne i kemi hedhur këtu, duke u besuar shpifjeve e intrigave të kurdisura kundër Perlatit, largohet prej shtëpisë së tij, duke ua bërë edhe më të rëndë dëshpërimin Perlatit dhe Mallmarës, që «e dërmuar nga kjo gjendje, / sytë i mbyll dhe e lë vetëm / (Perlatin), / me të voglën Gjuhëmirë». Dhe Perlati, pasi sheh se «për të s'ka më qetësi, detyrohet të «hidhet n'Hesperi» (Itali). «Këtu i vjen edhe mandata / se mbret Gjergji paska vdekur».

KËNGA E TRETË

1) *Dimi shkund nëntë herë* – Fjalët «nëntë herë» nuk duhet të merren në kuptimin «nëntë vjet» me radhë, po në kuptimin që edhe elementët e natyrës nuk mund ta duronin që otomanët të arrinin të shtyheshin gjer në Otranto, andaj brenda dim:it 1480, pasi ra Otrantoja në duart e otomanëve, nëntë herë bora i mbuloi Apeninet. Themi kështu sepse fjalët «nëntë herë», në kuptimin nëntë vjet», nuk i përgjigjen as mërgimit të Perlatit, që bëhet përpara vdekjes së Skënderbeut (1468), as mërgimit të Rrembhelmit, që bëhet pas rënies së Krujës (1478); as rënies së Otrantos, që është e gushtit të 1480-ës.

2) *Kreshniku tartar ua mbathi* Këto fjalë në gojë të Rrembhelmit dhe skena e shpellës me luftëtarë të plagosur, që vjen më pas, na tregojnë tërthorazi se jemi pas betejës për çlirimin e Otran-

tos dhe dëbimin e otomanëve nga brigjet italiane, që ndodhi në vitin 1481 dhe ku, si mund të merrt me mend, duhet të ketë marrë pjesë edhe Rrembhelmi e arbërshtë të tjerë.

3) *më mburo ti vatrë e Krujë* – Rrembhelmi dëbimin e «kreshnikut, khanit, komandantit tartar dhe hordhive të tij nga Otrantoja e vlerëson si preludin e dëbimit të barbarëve otomanë edhe nga Shqipëria e Ballkani, që është i mendjes se do të bëhet me anë të kryengritjeve zinxhir të popujve të shtypur, të ndihmuar edhe nga popujt e tjerë të Evropës. Rrembhelmi, «i djegur nga malli për Atdhe» do të dëshironte të kthehej menjëherë në Shqipëri, mirëpo hëpërhë nuk mundet, se e «pret detyra e lartë»: (përgatitjet për zbarkim nën udhëheqje të Gjon Kastriotit), andaj, i përmaulluar, i drejtohet erës duke i thënë: «më mburo ti vatrë e Krujë!».

4) *mbi një timbë trimi ndalet* – Rrembhelmi, i lodhur nga udha, ndalet të pushojë mbi një timbë (shkëmb) pranë një kroci, atje ku ndalet dhe vasha ditën kur vinte për të marrë ujë. Mendja i shkon te martesat dhe, ndërsa lodhja e gjumi e marrakotit, përpara i del «lili i bardhë i nuses» me biskun të ngjyer «me gjak t'arbër», pranë «e ndarë në dy pjesë / i del parzmorja e Mirbanit» pastaj i del një udhëtar, që është vetë hieja e Mirbanit në gjithë skenat gjer në fund të kësaj kënge.

5) *stepje gishtash, tringe t'huaj* Për De Radën, kusht themelohet për mbajtjen gjallë të «shqiptarizmit» në gjithë shqiptarët e mërgimit, tok me mjeshtërinë e përsosur në ekzekutim, është edhe ruajtja e zhvillimi i mëtejshëm i karakterit kombëtar të çdo manifestimi kulturor-artistik të trashëgimisë (traditave), pra edhe të këngëve, të muzikës, andaj asnjë tringë (tingull) e huaj nuk duhet qasur në këngët dhe muzikën tonë, sepse prishin jonësinë (melodinë) kombëtare.

6) *Gjyshi i madh...* – Ai, fatos (Mirbani), që «ndofta për fajin tënd»; o Rrembhelm, i mungoi Atdheut, bëri, ashtu siç do të bënte Skënderbeu. Këto fjalë të udhëtarit (që është vetë Mirbani) janë thika më e rëndë për ndërjegjen e djaloshit, i cili vazhdon ta ndiejë thellë brengën që dikur, në të ritë e tij, nga zilia, nuk i shkoi në ndihmë Mirbanit (kujtoni këngën e parë).

7) *dhe shigjetat...* – i frethoi Mirbani pedohet në çast për godijen që i bën djaloshit dhe menjëherë ndien një dashuri të

fortë prej vëllai për Rrembhelmin, sepse edhe tek ai • sheh të zjarrtë dashurinë për Atdheun, pra sheh vazhdimësinë e luftës për çlirim.

8) këtu – s'ndien as dritën tënde – Mirbani, pasi përballon (sfidon) zotin duke iu kundërvënë me simbolin e dritës së përjetshme, Diellin, si dëshmitar të lavdive arbëreshe, edhe një herë e lut, po edhe e kanos, që të tregohet mirëdashës të paktën ndaj brezive të reja shqiptare, të përfaqësuara nga Rrembhelmi, se po të mos tregohet i tillë do të ketë si përgjigje të merituar përbuzjen dhe urrejtjen e tyre.

KËNGA E KATËRT

1. *Hije e Mirbanit në qiell* – Për De Radën lufta për çlirim e popullit shqiptar dhe të popujve të tokës nuk është një luftë e kufizuar, po një luftë revolucionare me përpjesëtime vigane, që zhvillohet anembanë gjithësisë, në qiell e në tokë, sepse është luftë në mes dritës dhe errësirës, në mes drejtësisë dhe tiranisë. Dhe në një luftë të tillë askush nuk mund të qëndrojë soditës i thjeshtë. Tok me masat e shtypura nga tirania e shtypësve dhe të mbajtura në errësirë, rreshtohen në ballë të tyre si flamuj kushtrimi gjithë hijet e të rënëve për idealet më të larta të njerëzimit.

2) *me qëllim*: Ditën e madhe. Për Mirbanin dhe gjithë «shpirt-mëdhenjtë», «hijet këllirë» duhen shfarosur edhe në qiell, që mbi tokë e kudo të ndihet dhe të ndritë sa më e fortë drita, e trupëzuar (personifikuar) nga «zjarri i natyrës, Dielli», i cili «vijon punën e lavdishme me qëllim: Ditën e madhe:» lumturinë e jetës njerëzore, lumturinë e njerëzve.

3) *drejt nga Çiamisi, e qëndron* – Çiamisi (lumi i Çamërisë «Thyamisi»), që De Rada i ri e italizon në «Tamigi»

4) *gjithë zjarr i thotë diellit* – Mirbani, edhe pasi nga dashuria e zjarrtë për Rrembhelmin e Gjuhëmirën, që dëshironte t'i shikonte të bashkuar, e kishte detyruar veten t'i lutej edhe vetë zotit, të qiellit që t'u bëhej krahë këtyre dy të rinjve, prapë nuk është i sigurt plotësisht se zoti, që mbron të këqijtë e shpirtkëllirët, ka për t'i ndihmuar andaj ky i drejtohet Diellit, trupëzmit (personifikimit) të

dritës, atij që «botës i sjell gaz / dhe shëndet e bukuri». Dhe Dielli përnjëherësh rrezet e tij «i drejtoi nga brigjet harca, / ku të rrallë lisa rriten, / dhe ku mbjell me pak zi fati», nga viset malore si qendra të arbëreshëve dhe të patriotizmit shqiptar.

5) *E plot gaz Mirbani çan* – Mirbani i kënaqur çan dëcjt Krujës së tij e dielli ndaj perëndimit «ia praron veshjen» e ai pret të dëgjojë «më të madhe drithmë jete»; shpërthimin e kryengritjes në kryeqytet dhe në krejt Arbërin; çlirimin e sheh të sigurt, sepse shikon të ngritur në luftë gjithë «njerëzit e thjeshtë», q'u takon nderi, lavdia», vepër e të cilëve është edhe vetë Kruja e tij, kjo «dëshmi drite përmbi tokë».

A. Varfi.



LIRIKA



I përktheu
nga italishtja

KLARA KODRA



1911

1911

1911

E VERBRA

Prijës i shkëlqyer i ditës,
larg nga ne po ikën ti.
Sytë e mi që s'shohin dritë
s'po të gjejnë kurrsesi.
Unë e zeza! Kthimi yt
sytë s'do m'i hapi dot.

Ish një kohë që të shikoja
dhe mbaj mend ende tani
rrezet e tua që flakëronin,
muzg e agim me bukuri,
kur te ti unë mishëroja
emrin tënd, o shkëlqimplot'.

Lamtumirë, s'të shoh kurrë më
po atë flakë qiellore
ende e ndiej se si më nxeh,
si më djeg në krahëror.
Zot, ti një të mirë më more
po me shpirt ende shikoj.

SONET

Unë s'e shoqëroj këngën me lirë
që të mund me t'ëmbël melodi
t'i jap shpirtit tim pakëz qetësi
andaj e zyrtë është kënga ime e dliirë.

Dhe Eutirpja ime vetëm për këtë i lutet
Apollonit leshverdhë që gjithnjë
m'i përgjërohet mendja për çdo gjë
po kur arrin te ai nga turpi struket.

Nëse do t'pyesë: Kush për udhë të nisi?
Mërkuri, thuaji, që i vodh...

.....

Për sa kohë që frymëzimi gjallë të jetë
do t'këndoj vargje t'dhimbshme e mundimet
me t'cilat Fati se lë njerinë të qetë.

*) Gjysmat e vargut të parafundit dhe vargu që pason nuk
deshifrohen.

KËNGË PËR VDEKJEN E SKËNDERBEUT

Cila erë do ta rrëmbejë vallë këtë trup? O, sa orë hareje shpresoi ai dhe s'pati kurrë! Të rrethuar nga rrufe e dallgë ne s'dimë ku iku toka: vetëm ne në këto vise. Pse, moj re, ti thyhesh dhe hap një qiell të bardhë mbi viset • Shqipërisë?

Edhe veriu fryn më fort dhe duke na harruar shkon mbi det. Ndofta nuk e di se për fatin tonë të zi ne jemi të shkretuar. Ja, lindi agimi i vendit tim. Po shoh prapë fushat e zbehta dhe kodrat gjethezeza: ja shtëpitë e nënës sime, ja gratë e rritura me mua që të ngritura pa gdhirë dalin në dritaret e pallateve të vesh-trojnë ditën. Ato janë të brengosura se Skënderbeu u bë dhe. Kur u nisa unë më pyesnin: O Serafinë, a ke vallë një nënë që të të presë në breg dhe të shtërngojë me duar të dridhshme gjymtyrët e tu të freskëta? Apo do të jesh atje si toka që njerëzit e shkelin me këmbë dhe s'e vënë re?

Unë duhet t'u përgjigjesha atyre: Unë do të vajtoj si ora e zezë që kalon nëpër dyert e mbyllura dhe ua vret fëmijët në shtrat nënave të ngrira nga tmërri.

Këmbanat mbrëmë kumbonin në zi në të gjitha brigjet se heroi vdiq: dhe ja, nëpër altare u shuan qirinjtë, veç drita e vatrës i ndriçoi shtëpitë; në ëndërr e panë atë trimi dhe vasha dhe pleqtë dhe të gjithë luftëtarët, të gjithë ishin bërë mospërfillës ndaj tokës së mbjellë

me pemë dhe hënës. Medet! Nga dheu nuk ngrihet më ai, në fushim vetëm çadra e tij mungon...

Po pse vallë, kur dielli u shua në mal, vajtuan se kishin humbur rrugën dhe vetë dielli mbeti pa vajtim?...

PËRSIATJE

* * *

Nëse s'do të më përmbante frika se mos të të lëndoja, o perëndeshë, i gjunjzuar te këmbët e tua do të lutesha, jo që të të lyp ndonjë gjë, po që të njohësh në tërësinë e vet se ç'dashuri të thellë e të dhembshur më zgjove në gji dhe po të lejoje t'i jepja një të puthur asaj dorës sate, duke u bërë kalorësi yt besnik dhe i qëndrueshëm, besa jote dhe ajo e zotit që mora në pagëzim do ishin gjithkund dy shkencat mbretërore të shpirtit tim krenar.

*
* * *

Kur ajo qesh dhe të ngul sytë që shkëlqejnë nga gëzimi, të ngjan se je në qiell të hapur dhe shpirti yt mbetet i mahnitur, çdo theks i zërit të saj është një rrufe që të plagos pa shërim dhe këmba e saj është aq e lehtë, sa ke dëshirë ti shtrohesh si qilim.

*
* * *

Mundohem të kujtoj e s'më vjen ndër mend cilq

magji më shëroi vallë aq plagë. Po goja jote ka veç
ajo magjinë që duke folur qetëson e zhdruk çdo dhimbje.



Jam i lumtur se kam lindur në këtë kohë, se vetëm
në këtë kohë mund të shihja shembullin e bukurive hyj-
nore.



O gjeni, dhunti e parë e zotit, ndihmomë në këtë
stinë që balli im të rrethohet nga kurora e bukur e
kësaj kohe. Pastaj do ta vë këtë në këmbët e tua dhe
do të lus vdekjen.



Ti, buzëmbël, që jep shëndet me puthjet e tua, ti
me gjirin e bardhë që do të ushqente denjësisht një
Kupid tjetër... O! Ti dhe unë do të ndjekim një fat të
ndryshëm sepse njerëzit të cilët na luftojnë do na ndajnë.



Kur flet ajo më zbret ndër rremba një freski si ajo
që i jep uji malor të sëmurit të etur; në qoftë se e

bardhë në fytyrë dhe e trishtuar ajo hesht më rrëmben me mëshirën e saj të ëmbël dhe kur shfaqet midis vajzave të tjera ashtu si hëna e plotë ndër yje, më mbush me gëzim dhe kur më hedh sytë e saj hyjnisht tërheqës më zhduk nga shpirti të gjitha mendimet e trishtuara dhe çfarë lutje tjetër të bëj për atë veçse që t'i bie një herë në gjunjë dhe ajo të më presë si ëngjëll shpëtimtar. Në shkretëtirë del një shtresë me rërë dhe pastaj era i hedh përsipër të tjera e të tjera dhe s'del më në dritë, ashtu është xhelozia në zemrat që nuk i shëron asnjë fjalë.

Cili fat më solli në këtë zell e më bëri skllavin tënd? Tani më s'e mendoj të zgjidh këtë zinxhir, mendoj edhe se s'kam ç'ta bëj më jetën. Sepse përveç teje, Gavrilë, asgjë s'më duket e denjë për të cilën jetoj.



Natën që shkoi duke fjetur m'u duk se u ktheva në atdhe dhe se bëhej aty festë e madhe. Këngët e mëparshme, që aq shumë më dëfrenin, jehonin që të më kënaqnin; vajzat, që dikur më ngjanin më të bukura, hynin në valle që të më gëzonin, shokët më flisnin për lavdi e punë fisnike dhe unë me mendjen gjetkë u ngrita pas pak kohe dhe, i rrëmbyer nga zjarri i dashurisë, arrita ku ishe ti, e bardhë dhe e pikëlluar. Dhe ti i ngrite e qetë sytë që plagosin dhe unë u largova duke vajtuar; që kur të pashë nuk të tradhtova as për një çast. Dhe në mes të vajit u zgjova.

●

SERAFINA TOPIA
(NJË PASQYRË JETE NJERËZORE)

poemë

●

Përshtatur
në gjuhën e sotme nga

ANDREA VARFI

●

1900

1900

KËNGA E SERAFINËS

Artë, verë 1442

Vashë, rritesha plot hire
tek vatra e prindërve:
si filizka e sapoardhur²⁾
që hijekëndshme rritet
në kopshtin e perandorit.
Vashë, u rrita e zilisur
nga gjitone e nga të huaja.
Si të ndieja shi e breshër,
që mbi tjegulla kërcitnin
a të prehesha e dirsitur
përkundrejt të korrave,
mua më gëzohej zemra;
si djalthit q'e zgjojnë natën
ta çojnë në banja deti,
dhe që sheh nga qerrja e s'ëmës
yjet: një mori kandilesh
përmbi maja lisash lart;
pa më duket sikur ndodhet
në një botë aq të largët
nga shkolla që sa mbaroi
e pyet: Ç'është ai shesh
që si fushë e verdhë tundet?»

Dhe e ëma atij i gjegjet:
«Deti, ndriçuar prej hënës!»
Hej ç'e lumtur mosha e djalthit!
Kur të shtatëmbëdhjetat mbusha
vajta ku më lanin shqindet»))
katër shërbestare t'urta.
Ndënja lart, e vetëme,
hijeve ku buron Luri,
krua përkundruall detit:
shihja e s'ngopesha së pari.
Më këmbë isha ndaj mersines,
majë së cilës po terej
një skemandil ngjyrë deti,
ku qëndisej shqipja e bardhë,
q'udhës gjetën dhe e lanë.
Dielli digjte, e shërbestarët
ndenin shqindet përmbi shtogje
lulezbehtë e erëmirë.
Por ja, mbi kalin e bardhë,
si petrit i veshur n'ar,
m'erdh Bozdari i Shtresajve,
fis armik me zotin tatë,
(atë trim ma lavdëronin
gjithënjë shërbestarët),
dhe më gjeti vetëmë.
Bozdari — Zonjës vashë, skemandilin,
që më ra, kush vallë e ndejti
mbi mersinë?
Serafina
Ish me pluhur nga të rrugës
ku e gjetën ndaj e lanë.
Edhe u ndejta që ta hiqja
nga mersinia, por më shkau

prej gërshetit prapa shqepza,
që vetë e kisha qëndisur.

Guxoi trimi e ma rrëmbeu,
edhe shpejt e ktheu kalin.

Serafina – Na, merr tëndin! Jepëm
shqepzën!

Bozdari – Mos m'u bëj koprace, o vashë,
është thesar i jetës sime! –

Serafina – Unë gracka s'di të ngre.

Bozdari – Unë e di që më largohet
dhe më thanë që si vlla,
apo njeri të shtëpisë,

kurrë, o vashë, s'do më quash.

Unë s'kam as prindë, as shokë.

Si stoli, shoqe të vetme,

prej bukurisë që ke,

lërma këtë puhi vere.

Po s'më hape ti parajsën

e zemrës sate, do shkrihem

pranë teje, o mburrja e kohës! –

Unë e skuqur, e vërejta

buzëqeshur, dhe i thashë:

Serafina – Në janë të tillë armiqtë

dhe s'duan t'u mburren shokve,

i them shqepzës: «Shko me të!» –

I ra kalit, edhe fryu;

edhe sytë unë s'ia shqita,

veçse kur m'u zhduk zabelit.

Pastaj me të dy pëllëmbët

mora ujë edhe u hodha

ku kish lënë gjurmë kali,

moq t'i shihnin shërbëtarët.

Sa e lumtur ajo ditë:
kudo pa hije osmani!)
Arat kishin sjellë bukën,
lumenjt, rridhnin, murmuritnin,
këndonin zogjtë edhe cinxujt,
që me verën vijnë e ikin,
sapo m'u shfaqnin në jetë,
aq të hapët e të lirë!

KËNGA E PARË

Zadrimë, verë 1442

Kur drerin që gjojtën malit
në pallat shqytarë e sillnin,
te një lis ulen të prehen
Nikë Dukagjini e djali,
Komini i Topiajve,
ardhur për të njohur vendin
ku do vinte nuse e zonjë
motra e tij. Dhe atje flasin
për dëshira e për ç'do bënin
kohën kur t'u vinte radha,
si të gjithve, edhe atyre.
Edhe plaku Dukagjin,
në shtëpi ndenjor në dhomë
fliste me të birë e vogël:
Dukagjini — Zahari, askush nga ti
të mos marrë vojshtinë e Fjegut,¹⁾
që të ka lënë jot ëmë.
Si të thyhen a të zbrazin
vendet tona armiq' osman'
prapë ai Fjeg zot ty do ketë.
Sot fshatrat që pat shtëpia
duhet që të jenë shteti

q'yt vëlla do të rreshtojë
krah gjithë Arbrit, ku aq pjesë
rreshton krushku zoti Ndre;
edhe e bija, që na vjen
nuse e t'yt vllau, mos ndjejë
zotërimnë e t'et zvogluar. —
Zaharia — Pajën që të solli im ëmë,
ajo don që të ma japë
tata i të dype mua,
se nga shtëpia gjë s'pata;
kurse ti merr dhe ia jep
një të huaje, që shpirtbardha
as e njeh, edhe ajo të shquhet
me gjë tonë edhe më tepër! —
Dukagjini — Për të mbrojtur gjë e prona
dhe më tepër, unë e desha,
more bir, këtë martesë
me shtëpi aqë të madhe.
Po më shumë se martesë,
gjithë e thonë, na vlen vasha!
Gjithashtu, dihet se kejzen,
para dorës së t'yt vllau,
po ia vënë asaj qytetet,
që në porta e brenda kanë
armiq t'egër: e ajo pranon
ballë zjarrit të blatohet!
Bir, kushqia që ne bëjmë
kërkon të lidhë krejt vllazrit
që mbi dhe i ndau fati,
se arbreshi shpirt e di
që bashkimi ynë i dëbon
shpellanikët e uritur²)

Zaharia – Dëm s'na bëjnë ne osmanët
Në qytet q'hapën dyert,
shtëpi ,temupj ata s'ngasin
Por një sundimtar na duhet
që t'i mbajë në fre turmat
dhe qetësinë të na mbrojë.
Frerët nga duar elenësh³⁾
osmanët mbi tokë i morën,
si të drejtë mbi të rremët. –

Dukagjini – Këtu trokë osmanët erdhën
dhe tashti kanë shtëpitë
e gjithë atyre që vranë!
Pranë tyre priset besa
dhe me të jeta e ndershme,
zakonet tona të hijshme...
Ata shpejt nga duart tona
do na zhvatin zotërimin,
që kemi nga prindët tanë.
Ne do bëjmë ç'thonë ata:
unë, jot ëmë, yt vëlla,
do t'u jemi shërbestarë!
Ata mbase atëherë
matarimnë e pajës mëmës⁴⁾
mundet ty të ta dhurojnë...
Po përpara se në baltë
emrin tim ata ta flakin,
të flak ty: shpejt, shporrmu sysh! –

II

N'ato çaste poshtë n'Artë
flet Shtatyra me të bijën.

Shtatyra – Erdhi letër nga yt atë
q'atje shpejt thonë të vemi,
se, o Finë, ai vesh mori
që përditë t'ik shëndeti
dhe asnjë b̄ar këtu s'të vlen.
Dhe mjekët e këshilluan
që ti ajrin ta ndërrosh.
Andaj gjer të hënë bashkë
me Tanushin, ne do marrim
Udhën e Gjatë. E q'andej?)
ditët si era na çojnë
te zoti yt atë në hijet
e Himarës aq të freskët. –
Serafina – Asnjë ende nuk e di
si shërohen këto ethe... –
Kështu tha vasha e lindur
të mos jetë zonjë e vetes.

KËNGË E BOZDARIT ME SHOKË SERAFINËS

Artë, një mbrëmje të po asaj jave

I

Ditët po ikin, e ti m'u mbylle, o zonjëz,
e zbehtë si asnjëherë e mendjelodhët.
Jam i shtëpis' së huaj e s'di çfarë dëshire
për faj të kujt s'plotësove, e re n'atë mërzi,
që të ka kthyer n'hije, ndjekur prej parajse.

II

Dhe pse s'më foli kurrë prej syve unë ia vodha
zemrën, e s'di në i lumë u bëra apo i mjerë.

III

Sa herë e luta, q'ajo, mermer i bardhë,
të vinte e duart të m'i hidh në qafë.
Përlotshëm të më thosh: «Kët' orë pata;
s'kam kujt t'i jap për qafje, veçse ty!»

IV

A është' ajo? Apo si n'ëndërr ma sjell zemra?
Po, po! Ajo m'u shfaq menduar për gjith'
kohën;
ngado të mblidhen retë, ajo m'i tret!

V

Gërshetat korb, mollzat hir nga ata dy sy.
Me to ti linde, të mundje zemrat edhe t'i
shëroje.

VI

O gjë me ëndje të paprekura, o duar,
edhe ti shtat, që kur më shfaqe, ngazllon dheu!
Por unë, i ndershëm, pa lakmi të çastit,
ty, vashë, të drejtohem, besnik dhe i pastër!

KËNGA E DYTË

Himarë, shtator 1442

Që së jashtmi, ku në hije
gështenjash na qe freskuar,
vasha ngjitej dëshëruar,
mollzaskuqur te pallati,
se erdh lajmësi me lajme:
Serafina – Ç'lajme të mira na solli
për shëndetin e Kominit?
Ndreu – Zogu larg folesë, n'erë
nga koha pa fund merr jetë
e s'kujtohet më. Dhe ti,
që më je kaq e shkujdesur,
sërish s'do më burbuqosesh?
Ulmu pak pranë, moj bijë,
se me gaz zemrën ma mbush! –
Serafina – Ta mbush, se më don, o tatë;
mbase zoti s'do na ndajë!
Ndreu – Ç'faj ke që si zog nden krahët?
Apo mbase nuk ma thua
brengën që të trazon zemrën?
N'është' kështu, aher ke faj. –
Serafina – Pse më mësove të lexoj?
Të shoh te pasqyra e kohës

shesh andrallash njerëzore,
 që me helm po më mbulojnë
 dhe popuj që ç'deshën bënë
 krenarisht, edhe pastaj
 te gufrë e kohës ku lindën
 ranë e sërish u harruan,
 edhe lart të tjerë u ngritën,
 krejt filiza e gjak i huaj:
 kthisën, prishën frute bote,
 edhe pasi i ngrysen vitet,
 balta e dheut i mbutoi
 ndënë luleza të reja.
 Ashtu ne, me këmbë brenda
 në të njëjtën llucë, shkasim! –
Ndreu – Bijë, i flak përtej leximet! –
Serafina – Tashti s'mund të lë pa parë
 Ç'm'është hapur para syve. –
Ndreu – Edhe në t'helmoftë jetën
 aq të shtrenjtë që t'u dha? –
Serafina – Kjo është jeta e të gjithve. –
 Dhe me buzëqeshje helmi
 vasha dorën ia puth prindit
 e shpejt del, sa hyri e ëma.

II

Ndreu – Ç'brendë kishte në gjì vasha,
 o Shtatyrë? Ë si këtu
 sërish shpejt na u burbuqos? –
Shtatyrë – Kur erdh n'Artë ish shumë keq. –
Ndreu – Dhe ti mua s'ma tregoje,

veç saj, kemi tjetër dritë? –
Shtatyra – Shkoi ajo. Tash ta martojmë:
 shpejt martesë e shëron.
 Po Komini ç'të ka shkruar?
 Do të vijë tok me dhëndrin? –
Ndreu – Do të vonojë edhe pak,
 se kanë ca ngatërresa
 brenda, e sa t'i rregullojnë...
 Shkruan: «Jashtë vrehet qielli.
 Në shtrat në Krujë ka rënë
 Gjon Kastrioti nga helmi
 për të bijtë e sëmurë
 n'Adrianopojë. E osmani
 po kërkon prej Aranitit
 fortesën n'Ulqin, të çojë
 ushtëri, që me anijet
 lirisht të shesin, të blejnë
 nëpër det të Atërisë!»
Shtatyra – Osmani shpejt do kërkojë
 edhe fëmijët kërthinjtë,
 po s'ia ndali dorën kush!
Ndreu – Grua, ne dorë nuk heqim
 nga besa e të parëve tanë:
 ç'është kundër saj, s'pranohet! –

KËNGA E TRETË

Himarë, 23 qershor 1443

Me mend ndiqte zonjza Finë
një ngjarje që pa në ëndërr,
tek ishte e shtrirë në fron.
Zgjuar pas mesit të ditës,
s'dij ku ish, e s'dij seç ishte,
vetë ajo, aq e shastisur
sytë i kish hapur e rrinte.
Po më pas dhe dalngadalë,
e rrëmbyer nga kujtimet,
me të cilat fjeti, e mblodhi
dhe në vete vasha erdhi
e për ç'pa në ëndërr ajo tha:
«Vallë atëherë kur të vdes,
a do të zgjohem përsëri
Kështu zhytur në mejtime,
përpijet' hidhet se dëgjoji
«kuajtë që hingëllinin,
potkonjtë që trokëllinin.»
Atë çast hyri Ndriana.
Ndriana – Bija ime, yt vëlla
erdh me dhëndrin, po ngrehu:
e ke të bukur, vllastar,

ashtu si je dhe ti vetë,
që ta pish në kupëzë! –
Dhe tek fliste hap dritaren,
e në mes shtëpisë ra
një tufëz e lehtë dielli.

Ndriana – Dëgjo, zonjza *Serafina*:

eja të pyesim qyqen,
q'ende rri në fresk të malit,
dhe si ushtimë e vetmuar
zotëron arat e qeta:

ta pyesim sa vjet ende
në *Zadrimë* do ta ndjesh?

Serafina – E ç'më duhen mua vjetët
e një jete kaq të shkretë? –

Tha kështu dhe shpleks gërshetin
më këmbë para pasqyrës.

Vala e zemrës në buçimë
vashës faqeve i sillte

një nur, si as tjetër vashe.

Gazmendej e s'dij nga çfarë.

Plaka mbanë, si shënjtores,
i sodiste krye e shtat.

Dhe mbi to, në qiell lart
tinguj kambanash valzonin
në hare.

Serafina – E kremte nesër?

Ndriana – Ësht' Shëngjini. E qyqja duket
se pyet «ku, ku më vajtët?»

gjithë ato shoqe të mia,

q'agjëruan dhe Shëngjini

kë deshën u dha për burrë.

Por erdh koha shtëpit' lanë
dhe të shkretat tashti flenë,

gojëmbyllura përjetë!..
Ti, para se kalit t'huaj
t'i hipsh nuse e të ndrrosh mall,²⁾
shqepzën e varrit qëndismë,
ku të kem fronin tim zbrazët,
rrethuar nga djepe bebesh
të mbuluar me të linjta,
q'i ngre, i ul frymëmarrja.

Të kem fshikzat e mëndafshit,
hënën lart, tjerrset përgjumur
afër shportave me fshikza;
sipër kruan e pashtershëm. –
Vasha as dha fjalë, as tha «jo»,
po me dhembje buzëqeshi.

Serafina – A po më shkon në një vend?–

Ndriana – Ku të duash. –

Serafina – A më gjen

vetëm dy lule grivori,³⁾

si ato atje në brinjë? –

Ndriana – Pse u skuqe? Kjo është shenja
e dashurisë ndër vasha,

siç është fjala «po» për trimin...

Gjithnjë lexon, bija ime

mbyllur si një murgë andaj... –

Tha dhe doli.

E vasha, vetëm,

ra përmbys shpejt përmbi shtrat

se iu shkreh një vaj me dënesë,

pasi ajo, bijë bujarësh,

po besonte profka plakash

dhe kështu përulte veten

para kujt s'do donte kurrë.⁴⁾

Plaka, e djersitur, u kthye
me diellin ndër faqe; e vasha
ia bëri me shenjë t'ikte.
U ngrit, u la, dy grivorve
halat ndër lule u preu;
përcëlloi njërin për vete
edhe tjetrin për Bozdarin,
pa m'i ve kundrejt veriut.
Atë mbrëmje u mbyll n'odë
dhe hijeshia vashore
iu bë napëz zemrës saj,
e nga salla plot bujarë
mezi i vinte ushëtima:
E vetmuar, e brengosur
diçka shqep gjer natën vonë.
Por tek duart s'ishte mendja,
tek binin sytë s'ish zemra,
shoqja e tyre e përgjithmontë.
Jashtë hëna zbardhte botën:
yjtë e ndritur që kish zgjedhur,
të rrallë qiellit mbi male,
hyjneshën hënë e përcillnin
mbi shtëpitë në mejtime.
Vonë vasha fjeti e çkrehur;
n'ëndërr pa veten n'humnerë
të përzier me të vdekur
që pat njohur, dhe i dukej
si t'i kish pranë të gjallë.
Lulet jashtë i thaheshin.

KËNGË E NIK DUKAGJINIT VASHËS SË TOPIAJVE

Himarë, qershor 1443

Ky Arbri ynë, si pallat fatmirë,
te dera me të zotrit kryeprerë:
posi në burg, eh, një të hirshme zanë
e mban këtu një forcë fshehtësi,
dhe ta çlirojë pret ndonjë kushri:
e burrë u bëra e dua t'ia dal mbanë!

Sapo arrita, ja, në vend t'asaj,
te kurmi ndjeva dhe unë ato magji;
se hije e saj mbi gjithë zotëron
edhe të tret mejtime e mburrësi!

Me të shtëpisë e prisja, hëna ndrinte;
ajo nga dal-ngadal përmbi koçi
hënën vështronte, edhe tek ne s'po vinte!

Ku isha unë qe, por nga të tjerët
s'u nda aspak, e s'di në m'hodhi sytë:
po veç të zbehtat faqe i kam soditë!

KËNGA E KATËRT

Himarë, gusht 1443

Shkrepi dielli mbi Himarë;
hapnin dyert njerëzit
që flasin e dinë ç'bëjnë.
Sapo dita u gdhi, Tanushi
na u zgjua e kërkoi t'ëmën,
q'adhuronte edhe m'i lutet:
Tanushi – M'u mërzit përditë shpati,
dhe pa shokë, zonja mëmë!
Tashti sosën manaferrat,
as qerre thuprash s'më bënë! –
Shtatyrë – Pse, bir, në banjat e ngrohta
rri larg bijve të bujarve? –
Tanushi – Sepse shok me shokun janë
gjithë ata në mes të tyre,
dhe ndonjërin do ta shty
ndonjë ditë në bujanë.!)
Buzët mjaltë e përmalluar,
ia puth mëma edhe i thotë:
Shtatyrë – Për një javë vemi n'Artë. –
Dhe përdore djaln jashtë.
Pastaj mëma thrret të bijën.
Ecin pak e n'hije ulen.

Bijës saj shqepzën e bardhë
ia ndreq ballit, dhe gërshetin
ia lëmon, i përkëdhel faqet,
aq të kthjellta sa edhe dita
që agon për ngazëllim.
Sipër nj'ilqeje i këndonte
një zog erës me harenë
që ndien biri i njeriut,
kur mbi pemë kokrrat mbledh,
teksa lart e përkund flladi
e poshtë arat valëzojnë.
Dhe pastaj të birt i tha:
Shtatyra – Për pak kohë edhe jot motër,
o Tanush, do të martohet;
dhe ti do njohësh qytete
e gjiri shumë të largët.
Kushdi Fina a do të vijë
prapë ta shohë shtëpinë
e prindërve në Himarë!
Dhe unë e yt atë, o bir,
do t'i mbyllim sytë shpejt.
Ju, kur dielli do të bjerë
përmbi gjithë ç'do t'ju lëmë,
na kujtoni, paçi uratën! –
Ngashërима e mbyti djalin:
balli i bje te prehri i s'ëmës,
lotët dot nuk i pushojnë,
gjersa e motra ndrydh mejtimet
që m'i turbullonin zemrën,
dhe m'u ngrit, si ngrihet zogu,
me vështrimin poshtë zallit
ku diç shihte e i tha Tanushit:

Serafina – Ama, ç'trim! Dhe kur të
rritesh

do të qash kështu? Dhe unë,
sa e marrë, ty të solla
pelzën, si t'ishe kalorës!
Ngrehu shpejt! Eja të zbresim
që të dy te zalli i detit,
ku hardhia vilebardhë
përmbi valë varet. Eja,
do të ngjit atje mbi të! –
Djali i skuqur, fshiu lotët
dhe së motrës i dha dorën.
Tatëpjetë, herë ferra
vashës i kapte cilonën,
herë era i zgjidhte shiqepzën,
gërshetën ia shpupurishte.
Kur arritën tek hardhia,
që prej hijes saj një trim
iu shfaq vashës me poni.
Vasha e njohu, edhe u çel,
sytë e kthjellët iu qetuan,
buzëgaz i tha Bozdarit:

Serafina – Teksa vren, o trim gjahtar,
detin që s'ku farëgjëje,
e ke zogun mbi hardhi! –
Sa tha fjalët, fluturoi
një pulëbardhë mbi det;
por, të shkretën, një shigjetë
n'erë e mban, e bie mbi valë
për t'u mbytur.

Në çast vllathi
vrap të veshurat i hoqi

edhe nd'ujë u lëshua.
 Me turp, vasha nga hardhia
 u mat t'arrinte një degë
 me dy vile rrush, por trimi,
 q'ish m'i lartë, e arriti degën
 dhe ia theu; teksa vasha
 përmbi shapkë llërët ndejti
 për t'ia shpleksur atij pendën,
 nëpër gjethe e fletë pleksur.
 Dhe një afsh i drithëtuar
 të dy bashkë fort i lidhi.
 Serafina – Kur nga Rahëmiri zbritja
 pashë anijen e panjohur;
 parandieva se do vije
 megjithëse nuk e besoja. –
 Bozdari – Unë thoshja mos m'harrove,
 pasi shkoi kaq shumë kohë. –
 Vasha iu gjegj e kënaqur:
 Serafina – Tashti çdo gjë e harrova,
 edhe pse shumë u vonove. –
 Bozdari – Por s'do të vijë ajo ditë
 kur në hije të ksaj peme,
 do të më jepet e gjithë
 vasha që desha e s'iu ndashë
 që mëngjesin kur e pashë? –
 Serafina – S'lindëm ne me fat të bardhë
 E pse? Brenda në qytet,
 ku të dy kemi shtëpitë,
 dora e huaj në mes futet,
 dhe ne njëri-tjetrin s'mundëm
 për kaq muaj ta shikonim!
 Dhe tashti mezi u pamë

tek ky breg: kënd lumturie. —
 Tha dhe sytë lot iu mbushën.
 Bozdari — Edhe ty të kanë thënë
 se anije turqërie
 e rrethuan detin tonë?²⁾
 Apo ndofta e more vesh
 tash nga unë, andaj m'u zbehe?
 Në to hasa e u dredhova
 e tashti ja sapo zbrita
 te ky zall, ku ti m'u shfaqe,
 o moj zemër, zëra jonë.
 Edhe në më druhe, o vashë,
 për betejat që i presin
 djemtë, vërsnikët me ty,
 mos harro sot: ti m'e para,
 ndër sa janë mburrje mëmash,
 që ke lindur arbëreshe,
 edhe ata, po prej një gjaku
 me ty janë, prandaj s'ka pse
 ti të druhesh dhe në derdhen
 mizëri armiq mbi ne!
 Zemra jonë nuk tronditet
 mjaft që të na japsh flamurin
 me brezin tënd t'artë lidhur! —
 Serafina — Hajd, Bozdar, le të gëzojmë
 këtë çast që po na ikën,
 prej të njëjtit fat të ndjekur! —
 Jashtë valësh del i qullur
 dhe në dorë mban Tanushi
 pulbardhën krahëpërgjakur.
 Serafina — Na merr rizën, fshiu e
 vishul —

Dhe Tanushi u largua.

Serafina – Ti, Bozdar, ku shkon tashti?

Bozdari – Shkoj në Krujë, tatëmadhi

më ka thirrur, se po vdes

ai prijs i kombit t'Arbrit,

q'u sfilit në luftë e gjak.

Por lundrojnë anije osmane

Venedikut për t'ia mbyllur

detin, dhe unë u shtrëngova

të zbres në tokë t'armikut. –

Serafina – Pse ma thua këtë fjalë?

Tha dhe ngriti syt' nga deti.

Serafina – Edhe që na zunë osmanët

detin, tash sa e mësova.

Hej, më parë m'u sos gazi

që pandeha se më priste!

Shih, tashti për asgjë fare

dhe ky çast i lumur prishet:

t'arbëreshë po na qasen! –

Dhe nga vinin ata, kthehet:

Shqytarët – Vashë zonjëz përshëndetje! –

Serafina – Mirë se vini, bashkëvendës!

Jeni lodhur këtij shuri:

hani nga ky rrush dhe ftohi! –

Shqytarët – Të na rrosh, o vashë

zonjëz,

ylli ynë i pashojtur

në shtrëngatat që pllakosin! –

Zot Bozdar, era pushoi;

nisemi?

Bozdari – Me leje, o vashë?

Tanushi – Dhe ne shkojmë shpejt, o
motër,

zonja mëmë po na pret.
Për mua ky trim e vrau
pulëbardhën, o shqytarë! –
Trimi i zbehtë u afua
te shqytarët pranë kalit,
dhe m'ia hipi, pa ia shuar
zjarrë e gjoksit deti i afërt,
që me zhurmë të pasosje
dukej se përpinte brigjet.
Vasha e ngrysur ndenj te zalli
plot pendim që s'ia tha brengën
trimit dhe me vllan përdore
niset, me vështrim nga deti,
gjersa ai iu zhduk nga sytë.
Dukej si mermer i sjellur
në prag jete, por pa shpirt.

II

Dhe më drekë në tryezë
gati s'futi gjë në gojë,
po qëndroi si t'ish e huaj,
gjersa shkoi u mbyll fare
n'odë gjumi edhe vajtoi
vashërinë e saj të pastër,
por aq shumë orëzezë.
Pa shqetsimet tokësore
rrethi i qiellit rrotullohej,
por të gjallve u mernte kohën.

Fushash bulkthet tërtëritnin
edhe prehje s'mund të gjenin
as dhe natën, se na qenë
brenda thesarit të botës.
N'erë zogjtë, e barit ftohtë,
sikur të ndienin ç'andralla
kishte jeta, sa cicrinin;
dhe veriu që po frynte
anembanë sikur fliste
për diçka n'at' hapësirë
si të fjetur, të pasosje.

KËNGË E SERAFINËS

(fragment)

Ishim vasha bujaresha
dhe tek zalli bredhërinim.
Unë, nga Himara e ardhur
me lëmsh në gji atë javë,
gëzim s'kisha, ndonse pranë
shkumëbardhës valë, e buzët
nga puhiza plasaritur.
Vela ndritur një anije
nga larg me Bozdarin vinte.
Gjer në çast kur bëri kthesën,
gjithë dëgjuan një këngë,¹⁾
që humbiste e ngrihej prapë
përmbi djep të valëve.
«Për një javë patëm mjegull,
dhe nga shkuam, ne na fshehu,
si ta kishnë armiqtë botën.
Por pastaj, të dielën mbrëma
shkrepi hëna dhe u mbushën
udhët, tempujt edhe deti.
Nga pallati tash më sheh
vasha që mua më do!
Kështu mua më tha zemra.»
Dhe vërtet, në dritë hëne,
ndonse larg, ne qemë afër.

KËNGA E PESTË

Artë, shtator 1443

Te pallati në Topiaj
dje mbrëma ca zonja vasha
na mësoheshin në valle.
Ca kur lodheshin e linin
edhe tok na preheshin,
me fytyrat ëmbël ndritur
prej dritës së aq qirinjve.
Zëra e hireve të dheut
me këmbë mbi gjarpërin,
nga qiellzëna u jip uratën!)
Tingujt e dy harpave,
pa u ndier jashtë, u ndiznin
n'atë çast dëfrimi gjiret.
Kur u hap dera, se erdhën
të merrnin Olimpinë,
bijë mëme e vetëme
hyri era e na solli
ushtimë të largme këngësh.
Serafina, prijse e mbrëmjes,
u ngrit dhe të kushërirën
e merr për dore e i thotë:
Serafina – Rimë edhe pak, Olimpi.
Jashtë ende ushtojnë këngë
nga djelmoshat qytetarë.

Shkojmë pak e t'i dëgjojmë
prapa qelqeve t'ballkonit. –
Shpejt shërbenjset ndritën dhomat
dhe vashat gërshetahijshme
shkuan edhe ballin ndejtën
pranë qelqesh të ballkonit,
trimat poshtë nisën këngën:

KËNGË E TRIMAVE

Më shumë nga ç'pandehja qeshë i lumtur,
se Hëna e dashur e qiellit m'u buthtua²⁾
e botë e re për sonte u hap...

VALLE E GRAVE

Përmbi zemrat na kaloj
nj'erë që lulet i muar,
fatnë e jetës na e buar³⁾
Tautitat fërshëllejnë:⁴⁾
djemtë u bien, ç'dëfrejnë,
se trimat humbën lavdinë
dhe na mbushën me lot gjinë.
Princët tanë enden pas rroljesh,⁵⁾
e na rendin pas kaprollesh;
pra t'huajt hedhin vështrimin
nga pallatet mbi vegjinë
t'huajt duan t'errësohen
tempujt ku të parët flenë,
ndaj pa qirinj e pa meshë
princët tanë po i lenë!

KENGË E TRIMAVE

Ky zë atdheu, që diell s'e mund, as shi,
o vashë, ty, moj, ta ka rritur, helmin...

Serafina – Kush të jetë dhe kë përshëndet?

Olimpia – Në dritë të hënës duket
si t'ish biri i Shtresajvet,

që është kthyer parëdje

Serafina – Mbase përshëndet si fqinjë,
zotrin tënde! –

Olimpia – Atë unë

mund të thuash q'as e njoh,

se «një dit' s'e mban shtëpia!» –

Po në ças n'odën ku rrinin

hyn shërbenjsja e i thërret

dhe dritaret vashat lenë.

e pas saj kthehen në sallë.

II

Shtatyra – Tashti, vasha bukuroshe,

u argtuat, pra, ërdh koha

të gatiteni t'i shtrihi

në krah gjumit kohëvjedhës... –

Kështu tha, e dyert hapen

e njëra pas tjetrës vashat
zonjën Finë përshëndetin
dhe dalin.

E Olimpia
mbrojtur nga shqytarë, rrugës,
ballë për ballë na haset
me të birë e Veli beut,
ndjekur prapa nga sejmenët.
Ai i qaset dhe me hije
ecjen vashës ia pengonte.
Shqytarëve u thotë vasha:
Olimpia – Ndalni pak, të shkojnë ata! –
otomani: – Jo, bre! Ne me ty do shkojmë!
Si ti, bij fisnikësh jemi.
Edhe larg syve të prindve,
bashkë të kënaqemi! –
Edhe i zu dorën që digjte.
Shërbestarët – Bubu, zot, sa u gënjeve,
mbase edhe pa të keq –
Shqytarët: – Heshtni! Kjo është ora e zezë.
Më s'durohet të pëgëhet
nga ca t'ardhur hiri i zonjzës
që në pallate e kudo
gjith' qyteti e nderon! –
Dhe nga milli nxorën kordhët.
Sa thirrën, në çast u gjend
atje Bozdari me shokët
dhe me gjoks u del përpara.
Zhurma ngjitet në pallat,
ku po shtroheshin për darkë:
Serafina shpejt shërbenjës
dërgon poshtë, vesh të marrin

çfarë ngjiste. Otomani
mes pështjellimit thërret:
Otomani – Pa zurna ju qysh guxoni
të më mblidheni në shesh? –
Pa iu gjegj, ia vesh Shtresi
me pëllërnjë, edhe nga duart
ia shqit vashën, që na e shtyn
brenda në oborrin pranë,
dhe ia zbraz osmanlliut
duke ndjellurë mynxyrë
lart në shtëpitë e qytetit.
Sheshi në mes thirrmas zbrazet.
Lart shërbenjësit u ngjitën...
Dhe pse s'dinte si qe puna,
zonjza Finë hante veten.
N'atë ças gjëmoi nga kulla
topi që lajmëroi vdekjen,
edhe tronditi qytefën.
E me vete vasha thoshte:
Serafina – Ai të fshihet, dhe të ungjitet⁽⁴⁾
t'i lajmohet e vërteta
sa më shpejt n'Adrianopojë. –

KËNGË LAMTUMIRE

Artë, shtator 1443

BOZDARI

I lum ky zall ku munda të të shoh
teksa ik e s'di në prapë a do të shoh.
E vërtetë është që një orë e zezë
më ndolli e pa kohë jetën ma errsoi;
po ti sytë e ëmbël botës mos ia ndaj;
e zemra ma don mos t'hasin në faj.

SERAFINA

Dola rrahës, ti të më ngopsh sytë
dhe një herë, sa jam zonjë e fatit unë,
se zemra ime tretet, vjen me ty
të të gjejë zgjuar dhe në gjumë.

BOZDARI

Nga të huajt i përzënë, shkuar java,
çanga e njohur që kur leva s' do më kthejë
në qytet, ku eh, njëj ëndrret unë i ngjava.
Gjithë mburrje se të doja, ndokujt mirë
nuk i bëra, por për ty nuk pata vlerë.
Po sot dole, e rreth t' u bë një parëverë:
moj e lume, moj e bukur, lamtumirë!

SERAFINA

Më shko me shëndet! E në vend të huaj,
ku do jesh m'i hijshmi ti në mes bujarësh,
mos më rri helmuar, bindjen ti e ruaj
se sërish do kthehesh, një orë të bardhë,
t'i ngushllohet zemra dhe murgës së shkretë!

BOZDARI

Me shëndet më mbeç! Në hasç në të keqe,
jetllën e gërshetit m'ia lidh një lumbardhe,
ma nis që nga dera, e si të më zej' hera,
te këmbët e tua, vashë, kam për t'ardhë.

SERAFINA DHE SHOQET

Kallëzohet lashtit, na u nda një herë
prej vashëzës trimi dhe shkoi detit gjerë.
Vasha na e priti sa vashë më s'dukej,
por nuk shih anije e shpresa m'i këputej.

Një mëngjes te zalli me shpirt helmrrëmbyer,
në mingëll të hollë, vasha na qe kthyer!')

As plakej, as rritej. Edhe një të hënë
trimi shqotash rrahur pranë i qe gjendë.

Aq të bukur vasha kurrë s'e kish parë:
Me lule të bardha, pranë tij mbulohet
për t'i thënë trimit «zemra më gëzohet!»

KËNGA E GJASHTË

Artë, shtator 1443

Që menatë shumë herët
era frynte e nëpër vathra
nga çdo zhurmë e saj te shtegu
dhëntë zinin blegërimat,
si dikush andej të shkonte.
Nëpër natë u ngrit Bozdari
që të nis udhën e largët,
por u qell që të shikonte,
si zakon e kish, qytetin,
ku të bukurën po linte,
ndofta në gjumë n'at' orë,
mbuluar vetëm me linjën
tek mirr' frymë edhe odën
në një vend të shenjtë e kthente.
E kush t'i thoshte që vasha
ishte ngritur përkundruall
si e shkretë? E kush t'i thoshte
se gjer kur deti do ndante
të dy zemrat e të rinjve?
Kur hap derën, n'ag të zbardhur
kudo na qe hedhur hi,¹⁾
që nga fletët era e fshinte,
si qilim trollin kish shtruar.

Në shtëpin' kundrejt, në vatër
fqinja Ashtjamirë djalin
e sëmurë po përkundte,
dhe që mos ta gdhinte i zgjuar
ajo ninullën e zgjaste
jonelehtë e trishtimplotë.
Ashtjamira: «Zëri i bukur, siç e pata
vashërisë, më arriftë
atje ku na fshihet gjumi,
edhe djalit më ia sjellte.
Ma nistë pajtor, të kthjellët
posi zemra, e aq të thellë,
sa gjithë andrallat m'ia dlirtë,
e m'ia heqtë këtij mitaku,
përpara se të rëndohen
sytë e mi të lodhurit.»
Me vrundullimën e erës
ai zë u mbyt dhe hyri
motra e tij, Apollonia
krenarisht. Një palë rroba,
n'ar vllaut ia kish qëndisur
për mërgim. E t'ia shikonte
në trup, dhe prej tij të mernte
ndonjë fjalë a porosi,
nga të gjithë erdhi e para.
Por s'pat fjalë ai për kënd,
ndofta sepse ardhja e motrës
ia këputi atij mejtimet.
Vllaut t'heshtur iu soll prapa
dh'i hap mbulesat e shtratit:
po një breng e një mundim
ia zbehu faqet e njoma.

«Vllaun ia mori shtëpisë
e bijë e Topiajve,
gjithmonë armiq të tyre!
Për të parë atë, një shtrigë,
vonoj natën, e e gjet e keqja!»
Ai me sy shponte dhe detin
gjer në fund e atë e gjente,
(dhe kur s'ish e zonjë e vetes).
Dita vinte më t'aguar;
kur shtëpia iu hap dritës,
shqepzat vjerrur mbi pikzoret²⁾
valavitnin nga puhija.
Portash nallat trokëllitnin
se shërbenjse shkonin-vinin
– O im vëlla, – tha vasha,
vafsh shëndoshë! Dhe mbaj mend
historin' që po të them,
tash që i ri ende i mitur,
po më nise dheut hapet.
Na qe një rrethujzë-kopshtë
në gjin' e Detit të madh.
Mburra e saj ishin tri motra,
që të gjithë i nderonin.
N'oda në valle këndonin:
«Kur vjen vera për t'u ndukur?»
E në mes kësaj: «Po kur
bora e bardhë do na mbyllë
brenda, me quaret plot?»
Se çdo gjë mbaron, harronin,
dhe me vete gjë s'do merrnin
nga të mirat ku notonin.
Po kush vdes, e kush largohet,

edhe koha e tyre ngriset.
Duke i lënë mes ujanës,³⁾
udhëbyllur anembanë.
Ulur ndën drurin e bukës⁴⁾
thanë: «Pra, kjo jeta jonë
paskej qenë ha-e-pi!⁵⁾
Ato janë, im vëlla, pllazma
të ca bija magjistarësh,
që kudo lindin, të thithin
jetën e të miturve. –
Tha dhe iku, e e la vetëm
në dyshim që s'kish të sosur.

II

Kur më të shkrepur të diellit
ia hip kalit, i shkoi pranë
pallatit të zërës tij.
Dritësoret ishin mbyllur;
vasha, atje ish si e huaj.
Më t'aguar gjumi i dheut
e kish marrë kryet rënë
përmbi zemrën e zhuritur.
Pa e shqetësuar nata
thellë e më thellë ajo zhytej
si në pus hieja zhytet
sa më larg grykës ne ikim.
Ish mesditë kur e trembur
hapi sytë e shpejt nga shtrati
ngrihet dhe llërëpërveshur
hap dritaren. Njerëzia

nëpër udhët e nga dyert
 shihnin dheun e përhitur.⁴⁾
 Kishte kohë që Bozdari
 qe larguar pa u vrejtur;
 edhe vasha i thotë s'ëmës:
Serafina – Zonja mëmë, do të doja
 të shkonim gjer Sillahorë
 mos hiri ra dhe mbi det.
 Zonja qeshi e urdhëroi shqytarët,
 e shpejt hipën në koçi,
 me shqep të linjtë mbuluar,
 dhe për udhë u nisnë e shkuan.
Shtatyra – Resht nga dielli gërshetin
 se të dogji që menatë.
 Më mbaj vesh, o bija ime.
 Gjithnjë ti je buzëzbehtë,
 andaj duam që ta dimë
 çfarë ke? E pra, yt atë,
 si askush, për ty kujdeset.
 N'Arbëri nuk ka askënd
 të begatë e me gjiri
 si shtëpia ku shkon nuse:
 mos helmo andaj më tatën. –
Serafina – Për mua, o zonja mëmë,
 mbi të gjitha vlen urata. –
 Dhe dy lot iu rrokullisën
 për nga zemra e shqetësuar.
Shtatyra – Ne shpejt, tha yt atë, kthejmë
 në Himarë, ku u përtrive.
 Këtu mundet Veli beu
 të ngatërrojë edhe neve
 n'atë vrasjen e të birit,

që të na marrë edhe shtetin.
Ca gra mendjetrasha thanë:
«Te e kremtja e Topiajve
i prapi që u do bijën,
i vret djaln osmanlliut
Flakë zjarri ia rrëmbeu
krejt fytyrën Serafinës.
Po shpejtonin kuajt hapin;
kur binte dy ora e kishës
ato dolën kundrejt detit,
ku voziste një anije
që të shkuarën e vashës
në gji brenda po ia merrte.
Nga deti i mbetën sytë,
e u zhurit kujtimi i trimit,
edhe ndenë faqet jeta
nisi t'i tretet si dylli
kur rreze dielli i shkrijnë.
Si shënjtore, pas pendesës,
plot hir, nga gjithë e nderuar,
hyn në kishë e n'altar prindësh
tok me mëmën u përgjunj,
ndaj ikonës... por me mendje
endej jashtë»)



KËNGA E PARË

Himarë, tetor 1443

Patriarku i Venedikut¹⁾
për martesë po rrëfente
dy filizat, që asgjëkundi
si këta nuk pati toka,
filiza t'Arbrit krenar.
E para erdhi e u përgjunj
vasha plot lavd nga Topiajt,
që tha, gjer në veshë e skuqur:
Serafina – N'është faj, unë jam dashur
me një trim që më nderonte:
tashti, që prej tij të zgjidhem,
duan me tjetër të lidhem:
t'i shkel besën kujt më deshi.
njëj që lindi prej të mirësh.²⁾
Patriarku – Kush të desh, zonjës e mirë,
tashti ty a t'është afër? –
Serafina – Valët e detit ma çuan
larg, atje ku deshi osmani. –
Patriarku – Pra, për qetësinë tënde
paska pasë kujdes vetë
ati që kemi në qiell,
dhe pse nuk të kishte hije

që t'i jepeshe një burri
 fshehtaz t'yt et e sat ëme. –
Serafina – Për besë, askurrë s'iu dhashë! –
Patriarku – Je vërtet bijë arbëreshi.
 Kombi i Arbrit i përçarë,
 i pabashkuar, ndër shokët,
 pa flamur është e pa libra
 në një gjuhë kaq krenare:
 është i vetmi komb fathumbur.
 Porse pastërtia e nderi
 bijash bujare në vatër,
 janë dhuratë prej qiellit. –
Serafina – Vetë do' t'isha e nderuar
 në shtëpi t'atij bujari;
 dhe tash që ma kthejnë zemrën
 nga vashria e bardhë gjetkë,
 jetë më nuk shoh përpara. –
Patriarku – Çdo gjë na venitet vashë,
 tok me ditët që kalojmë:
 koha zgjidh bijtë nga prindët,
 gratë nga burrat që patën.
 Bien poshtë gaze e malle
 që ta dashurojmë jetën,
 por jo që t'ia marrim vendin
 arësyes në shpirt tonë...
 Tash më thuaj, e di njeri
 nga qyteti ku nderohe,
 që ti, moj e bijë e dukës,
 ngarë je nga krimb në gji?–
Serafina – Gjer tashti s'kam mëkatuar;
 vetëm se ia thashë vetes
 dhe tashti që po rrëfhem. –

Patriarku – Ndaj qetohu në fat tënd
e bekuar dhe e dëlirë.

Arbrin e sundon osmani

Ai, siç e pe, edhe ty
të shtëmëngu e të shkëputi
nga visari i moshës re:

Ai, po deshi, të lë
dhe të shkretë, pa vëllezër,
dhe pa prind, pa pasuri. –
Serafina – Ashtu është.

Patriarku – Andaj ti bindu
prindërve zemërsëruar,
si vepron një bijë e urtë
dhe si ëngjëll në fron ulu
e nderuar nga të gjithë. –

Serafina – E kush di çfarë na pret
dhe çdo ngjasë në të ardhmen –

Patriarku – ... Kjo martesë do të jetë
për të mirë t'arbëreshve... –

Vasha rëndë e plagosur
na u ngrit me tru të zbrazur
dhe me zemrën pa një shpresë.

II

Jashtë kishës po na binin
kambanat, dhëndri rrëfehej,

Patriarku – Ti përmbi gjithë vërsnikët
moshatarë në vend tënd,
dëshiron që të jesh prijës.

Tashti po të ve përpara

një vërsnike, që s'ka shoqe
në krejt botën evropiane.
Kjo vashë që t'epet lindi
ku ti s'mund të shihje as diellin.
Është fat i madh që lidhim
me krushqi sot t'arbëreshët
e përçarë, q'e shikonin
njëri-tjetrin si të huaj,
prapë i bëjmë motra e vllazër.
Kjo martesë do të jetë
portë e lumtur bujarie
ndër gjiri që do përtrijë.
Kush me shokë na boshkohet
ai fiton mbi të përçarët!
Por çdo arbëresh krenar
i vetmuar pret armiqtë.
Këta së bashku e rrethojnë,
e goditin nga çdo anë,
dhe e mundin; pra, përçarja
për ju është e keqja e madhe.
Niku – Ne nuk duam gjënë e tjetrit;
jemi pak dhe pa një ndihmë.
Ndër ne janë e na përçajnë
pyka t'huajsh, gjakshpirtdhelpra,
që kudo na nxjerrin krye. –
Patriarku – Andaj, bir, ju, vlla me vlla
vesh u merrni për të mirën
e vetvetes. Ish një kohë³⁾
kur një grusht t'arbër bashkuar,
ndënë flamurin e tyre,
shtrinë krekosjen aziate,
që krruste t'afërt, të largët,

Katër herë edhe më trima
mund t'iu japë sot bashkimi,
ku çdo krekosje e huaj
do dërrmohej. Sot, siç jeni
bishte-bishte, dhe të huaj⁴)
pa të drejtë, duknë e jetës
jua marrin; erdhën kohët
kur atyre shumë u duhet
krahu i tjetrit: bijtë tuaj
plogështinë t'ua zhdukin.
Ata, mbetur pa zotrimet,
edhe në shtëpi pa nder,
s'kanë tjetër veç të bëhen
shërbenjës të osmanllinjve.
Fat si ai kurrë mos paçin
bijtë e bijat që do lindë
me ty vasha zonjë, o bir!
Siç ishte përgjunjur, hidhet
shpejt më këmbë trimi Nik.
Niku – Jo, askurrë! Vetëm jepëm
uratën t'ulem në dasmë
me gjirinë arbëreshe pranë.
Edhe toka kurrë mua
ndënë këmbë s'do më dridhet!

KËNGA E DYTË

Himarë, tetor 1443

Në pallatin te Topiajt
qytetarë e vartës mbushën
kurnjet gjer poshtë në shkallët,¹⁾
pasi lanë ata përjashta
shiun, breshrin, shkrepëtimat.
Ngado ish dritarehapët
Himara, sikur po priste
t'u ternin rrugësh rrëketë
dhe mëndafshveshur të shkonte
n'ato salla ngazllimplota.
Por atje çdo bujar ishte
ballëngrysur, sikur sillte
ndër mend diçka që kish humbur
apo fishkej, si t'u qasej
fati i ri ditve që vinin.
Edhe shqota anembanë
kish shojtur zjarret në fusha.
Dhe ndën shi që herë-herë
nga gjethe lisash të lartë
era ia reshte përsipër,
një kalorës ngiste kalin,
q'aty këtu thundërlodhët

qellej llucash, sikur trembej,
 dhe kalorsin lart mbështjellë,
 e lëkundte të mërzitur,
 se me kohë s'do t'arrinte
 te martesë e zonjzës Finë.
 Kur më t'errur mbrin pallatin
 dhe hyn në sallën plot drita,
 (si tereqen qull ia marrin,²⁾
 shërbestarët që prej krahësh):
 befas del Muzak Golemi!
 Shpejt ndër dhoma hapet fjala
 dhe rreth iu derdhën bujarët.
 Me ta përfalet e thotë:
Muzaku – Afshi i ksaj dere të madhe,
 me djem trima e këngë vashash
 arbëreshe e fatbardha,
 zoti im ungj, nuk di se si
 kurm e zemër po ma deh.
 Unë vij prej vendi armik,³⁾
 thua sikur dal prej burgut. –
 Zoti Ndre e merr përdore,
 më tej hynë, e pranë e uli.
Ndreu – E kam mirë prijsin Gjergj?
 Tjetër zot nga Kastriotët
 s'do të vijë në gaz tonë?
Muzaku – Ai më dërgoi mua
 me bashkim, dashuri, besë
 kudo që jemi t'arbëreshë
 dhe me dhuratat q'i bën
 për martesë kushërirës. –
Ndreu – Të më rrosh, o bir, se mua
 me trimrin tënde më ngjalle

ëndjen, që, si mike e rreme,
 mun te pragu i pleqërisë
 ditëshkurtër, më pat lënë.
 Ty ende s'të kish jotëmë;
 këtu priste ajo martesën;
 vallet shpirtrat na i rritnin...
 Plot me njerëz ish qyteti:
 drizave që zverdhin brinjat,
 zogjtë kurkullosheshin
 mbrëmjeve nëpër foletë;
 dhe ne shpirtqetë shtëpive,
 pronash tona tok u mblidhnim
 sikur krejt t'ishim të lirë...
 Por, eh, ajo kohë iku! –
 Në ças dera u hap e dhëndri
 hyri tok me Patriarkun.
 Shok, i njohur i Muzakut.
 Niku e përqaq mes fronesh
 kadifeje të mbuluar,
 nga njëqind më të dy anët:
 veç për gra e veç për burra.
 Salla me t'ajrarmet drita')
 ● të pashojtura, qetet.
 Dhe shqytarve duka u thotë:
 Ndreu – Të sjellë vajzën Shtatyra
 sepse erdhi i kushëriri. –
 Pasi pritën mjaft, na shfaqet,
 e rrethuarë prej zonjash,
 me cohën e parë veshur,
 vasha, mburrja e të gjithë Arbrit:
 gjithë u ngritën me nderim.
 Iu përfal Muzak Golemi –

edhe vashës na i thotë:
 Muzaku – Kushërirë Serafinë,
 të kam sjellë nj'anak perlash
 të tejdetit, që ta çon
 ty jetimi i mbretit t'Krujës.
 Me to bashkë çon urimet
 për mëkëmbjen e atdheut
 që pret nga martesë jote.
 Dhe ty, vlla, bashkshort i saj,
 të çon kordhën e Stanishit,
 plot me fat, se është e atij
 që na u shojt pa kurrnjë faj. –
 Qetësia kudo ra.
 Nëpër gishtërinjtë e mpirë
 mezi vasha e mbajti anakun,
 sepse e mori vesh q'i vinte
 prej të ungjtit të Bozdarit,
 por s'desh fati t'i ishte mbesë!
 Pa m'i rrokullisen lotët
 «sumbilla-sumbilla faqes kuqe,
 pikë-pikë gjirt bardhë».
 Bujareshat ta qetonin,
 (si për të keqe mbëledhur,
 kur thonë se «do të shkojë»),
 përreth saj kuvendonin:
 «Oh, sa shumë e goditi,
 atje ku më s'ka si kthehet!»
 Aher u ngrit Kont Urani
 që nga froni e i tha vashës:
 Urani – Mos u helmo ashtu, zonjë,
 sepse sonte i dhuron kejzen
 Lidhjes së luftës funderrët...

Dallga që mund të përplaset
kundër nesh është larg akoma,
erërat q'e nxitin s'duken.
N'u errtë ora, fisit tënd
përreth gjithë do t'i jemi.
Nga një det, po gjah i lehtë,
si ne, është dhe Venediku.
Me ne humb veten dhe papa.
Pra, te Lidhja jonë kanë
dhe ata shpëtimnë e tyre. –
Patriarku – Unë lajm gazmor ju sjell:
prapa jush bota evropiane
u radhit dhe në veri
ushtëtarët gati janë
për t'i rënë qen osmanit.
Urani – Pra, o zonjë, fatit tonë
iu jep vetë, e shpejt do ndiesh
afshnë e Verës së re tonë:
si ndaj qyteteve t'Arbrit
të kalosh, e gjersa malet
dukagjinase të njohësh,
që nga dyer e dritare
lule e rruajza do t'hedhin;*)
në shpirt t'Arbrit do t'ushtojë
krisma e topave ndër re,
plot urime për ty, o e mirë,
që në gjirin tënd na ruan
fatnë e mirë për të gjithë. –
Teksa flitej plot lëvdata,
i vëllau i nusos hyri,
ndjekur nga djema të bëshëm
detëtarësh a të ardhur

nga parmenda për të dielën;
me ta tok dhe djem barinj.
Bariu – Do na ndieni, zotrinj, ardhjen
se bashkatdhetarë jemi
dhe puntorë nëpër pronat,
nga ushqehemi të gjithë.
Ne erdhëm se morën vesh
që këtu një shok na ndodhet
i trim-birit mbretit tonë.⁶⁾ –
Muzaku – Po, o lalë, Ai qëndron:
majë e hijshme e lisit tonë,
ajrin tonë thith gjithmonë! –
Bariu – Është ende i arbëresh?
Mbase e mbushin helm të huajt'
rreth të ziut fat t'arbreshve! –
Muzaku – Me t'huaj, atje ku jemi
matemi përditë, o lalë,
dhe s'ka bir nëne të huaj
që ndën këmbë Ai s'e shtrin! –
Bariu – Të na rrojë, o bir! Se osmanët
në krye të radhve tona
po të gjenin ungjin tënd,
që zoti shpejt na rrëmbeu,
siç na mban larg dhe fuqinë
e trim-birit mbretit tonë,
ne sot pa atdhe s'do t'ishim,
as të vetëm në mes popujsh,
të largët në gjak e gjuhë...
Dhe faltoret po na bien.
Kodra e fusha që kalove,
dhe i pe shkretë e shpendrambytur,
më përpara lulëzonin.

Muzaku – Bëj durim, o tatëloshi,
ende ne po marrim frymë!
Dihet, kalojmë një kohë
më të rëndë nga të gjithë.
Kur po ngisja zallit tonë,
zbehur ndënë muzg të mbrëmjes
edhe anësh detin sterrë,
mua më dukej se era
po e shtrinte e bënte pluhur,
si të qe ai zall i vetmi
arbëresh që m'ish përpara.
Por si u ngjita lart ndër pyjet,
ku kish zjarre e dema e dhi,
u kujtova q'Aqilehti⁷⁾
bash këtu në këtë erë
është rritur e kalitur,
po ashtu si ne të gjithë;
bash këtu edhe Likëndrri,⁸⁾
dy prijs ndër burrat e dheut. –
Kështu tha e gjithë arbreshët
me një «ah» zemre iu gjegjnë
dashurisë aqë të madhe
për rod tonë aq keq përndjekur!...
Por nga podi i hapur djemtë
shkrepën armët anëmbanë:
retë e vrenjtura në qiell
çahen pa shkrepitima e shi
Dhe në tokë lisat era
i përkulte tok me drizat
që u bënë rrafsh me brinjën;
dhe lart qiellit retë i ndiqte.
Dhe poshtë dy djem të rinj,

të mbledhur pranë vatrës
 pasi kafshët i strehuan,
 pa pyetë aspak për erën
 që po shfrynte, ata plot jetë
 këngë të moçme këndonin:
 «Ç'do na thuash, zot, me erën
 që po ndiejmë qiellit kthjellët,
 për të ardhmen që na pret?
 Vallë a do ta marrim vesh?»
 Dhe kjo këngë, ushëtimë
 e atyre që më s'janë,
 lënë bijve për të mbajtur
 gjallë mallin për vendlindje,
 shqetësoi zotërinjt' në sallë:
 lart ra heshtja mejtimngrysur.
Bariu – Na lejoni që tash dorën,
 zonjës nuse ne t'ia puthim,
 dhe më tej mos ju mbodhisim...
 Bijë, mos më rri në helm
 dhe si bora që do tretet,
 por si zonjë mendjehollë
 dhe krenare për trim tënd,
 prite ti verën e jetës! –
 Tha më plaku, e ata dolën.
 Zotërinjt' shkuan me nusen
 ku tryezat ishin shtruar,
 ca që t'uleshin në fronet,
 ca me frone për t'u ulur.
 Sa u shfaq nusja, dritaret
 ca nga fletët, ca nga xhamet
 hodhën një dritë të blerët
 që kandilet mbyti, e sytë

jashtë u kthyen edhe diellin,
nëpër retë e çjerra e panë;
e poshtë, u dukej
si të preknin Apulinë
përtej detit. Dhe një gojet
nëpër odat nisën lutjet,
gjersa në shtëpitë e qiellit
dielli u zhduk dhe muzgu ra.
Dhe me fjalë e ngushëllime
cilido thujse largoi
shqetësime e brengë, e ulet
në tryezë i lehtësuar.

BOZDARI DHE DETARI

Deti Jon, tetor 1443

Detari – Vetë e sheh, shqota na shtyn
thellë, nga më s'duket toka;
errësira fsheh çdo gjë
dhe çdo fjalë e rrëmben era;
vetëm çan sa gjerë e gjatë
djepe shkrepëtima detit,
honit ku ne brenda ramë. –
Bozdari – Mbaju, burrë shpejt t'arrijmë
edhe shqota ndihmon detin;
gjuhët zjarr nxjerr gjiri i natës
të ndiejë Arta: sheshi i luftës
që sonte po pastron era.
Atje, vlla, unë kam shenjzën,
që sa t'erret nesër dita
përsëri do ta shikoj:
sa m'u rrit, ç'hije ka marrë
dhe mendjen ç'ia turbullon.
M'u fanit në gjumë e gjallë,
dot se preka, e zjarr më ndezi.
Andaj deti na shtyn llëngthi,
që mëngjesi të na zerë
atje ku më ndodhet shenjza
dhe ku ftohet sheh të huajt. –

KËNGA E TRETË

Artë, tetor 1443

S'di me ç'ëndje n'atë mbrëmje
sapo ngryset Serafina
s'ngopej duke parë jashtë
gjersa bëhej natë, edhe
në masur mëndafsh pështillte,
n'heshtje, e vetme. E kundrejt hëna
zverdhte mbi një vetull reje
dhe ndën re ndizej një yll.
Kur ish zhytur në mejtime,
hapet salla prapa saj
edhe mbushet me bujarë,
q'i përçonte zoti tatë.
U ngrit vasha e sa hodh sytë,
fill e te një trim i vanë:
ish minxuari djalosh,
në shtëpi jo i zakonë.
Bora i zbardhi faqet aqë
sa që i tha Marku prej Matjes:
Marku – Mos u zbeh, drita ndër vashat,
se kush hyni n'altar i len –
gjithë armiqësit te pragu. –
Qeshi duka, i ati, e tha:
Ndreu – Vajzën, mjaltët e shtëpisë,

ju të parët ma takuat:
përshëndeteni pa drojtje
si një yll të mirëdashjes.
Pinë, folu që të sjellin
buzësumbullat këndej.
Bashkë verën le ta pimë
si në kupën e kungatës,
ta shijojmë si vëllezër. –
Dhe bujarët na qenë ulur
rreth tryezës në këshillë.
Dukë Ndreu hoq mënjanë
Ndinin, bir' e tij të mesëm,
djalë pesmbëdhjetë vjeç,
edhe e nis te fjegju i jashtëm
me një letër për Shëndetjen.
Djalin tok me trima e ndoqi
me sy prindi sa u mbyll nata,
dhe në gjoks iu tretën brengët.
Udhëve qytetit ngitnin
hije ndënë dritë hëne;
lart e poshtë lihnin qentë,
të vetmit që mbase kanë
një farë kujdes për fatin
e njeriut q'u jep bukën,
po nuk dihej çfarë u thoshnin.

II

Zemra e Algazilit errej
tek po zbriste nga kështjella
pasi kish vrarë peshkopin.
Strukej në konakët, mbase,

që t'i gjente ballsam krimin.
Mun te zjarrmi i madh në vatër,
sapo çliruar fërgesash,
zonja Violë mbi fron prehej,
edhe buzëqeshur ndehej,
mëndeshës djalin ia merrte
dhe në prehër po ma zgjidhte.

Viola – Shpejt do flasë. Po ti ç'ke
që nuk ule, o Algazil? –

Por ai gjetkë e kish mendjen:
gjithë n'akth priste ç'do ngjiste
pas mynxyrës q'ai kreu,
edhe andaj na kishte zbritur
që ta ndiente më nga afër
ç'erë po frynte qytetit:

vij vesh ç'thoshnin shërbestarët,
do të thoshja, edhe hijet
që lart e poshtë shkaktonin
lehje qensh...

Viola – Folë! Ti ç'ke?

Algazili – Këtu sonte s'mund të rri!
S'di ç'më shtyn që të dal jashtë!

Viola – Dil; për mbarë të të dalë! –
Tha dhe e zbehtë në fytyrë
vogëlushin ngre në krahë.

– Nesër do ta çoj në kishë:
keq po më rëndon mbi gjunjë... –
Desh dhe më të thosh, por fjalën
ia pret një flakë që del
nga tymtorja përkundrejt
dhe q'e ndriti gjithë lagjen.

Algazili – Hesht! –

Dhe një çast të dy s'folën.
Por ajo ashtu si e nisi,
i vazhdoi përsëri fjalët:
Viola – Keq po më rëndon mbi gjunjë
ky fëmijë; edhe të rëndët
vjen që s'është i pagëzuar.
Dua të vete në kishë... –
Një gjëmim nga buza e detit
u shurdhoi veshët.
Algazili – Hajd, shporru
me kë të duash, moj bushtër! –
shfryn, hap derën edhe zhduket.
Nga bregdeti topat krisnin,
predhat binin mbi kështjellën,
q'u vesh flakë e tym, dhe zhurma
gjer në malet lart dëgjohej.
Krrut ndër treme *Algazili*
mjaft na ndenji i terratisur.
Nd'udhë plumbat fishkëllonin
dhe shigjetat, që mos dilte
nga konakët ku edhe kishte
djalin, bisknë e tij të shpirtit.
Edhe hëna nëpër re
ishte krrusë, e binte shi,
kur ai arrin të gjejë
mbrojtje pas vidhit të kishës.

III

Kandilerë mbushën odat
në pallat të Shtresajvet,
sikur ndonjë burrë a grua

ishe duke dhënë frymën.

Gjela – Ah, Bozdar, o bir, shtëpia

nuk të mbajti as sa të gdhihej

dhe të thosha: «Erdh im bir!» –

Shpejt e shpejt gjitonet derdhen:

Gjitonet – Paska lerë orëzë

kush ka djem! Përjashta i kemi

gjithë kraharorzbular

ndaj shigjetash shkrehur natën!

Gjela – Më thoni: vajtën ta gjenin?

A ma panë?

Shërbestorja – Ende s'u kthyen.

E pa, s'di kush, ndër Topiaj.

Apollonia – Atje është gjarpërushja

q'i hodh syrin... –

Po ndërhyri

shpejt e ëmta, Kallogreja:

Kallogreja – Pusho, Ljonë! S'është kohë

thashethemesh. Ajo vajzë

është e zgjedhur për shtëpinë

e sat ëme nga yt ungj, Gjergji.

Bujarinë e besës saj

i ka hije që t'i hyjë

në gji kjo shtëpia jonë.

Bota nuk është një flluskë

që prej ujit e çon pipza

e fëmijve duke lojtur...

Burrat zbresin në shesh lufte

t'i ndihmojnë drejtësisë

që njeriu e ka detyrë.

Andaj, gra, dhe ne në kishë

shkojmë e lutemi që shpejt

të na zbardhë dita e kthjellët...
 Tha dhe u bindën. E shtëpitë
 zbrazën. Zonjat zemranxira
 shqepzat e terjortur ndreqën
 dhe me nxit zbritën rrethuar
 nga një lehë prej gjitonesh,
 Curle, lodërti e ngrinin
 në kushtrim lufte qytetin.
 Gratë kishën e Shënmbisë
 gjetnë e iu larguan zhurmës.
 Dhe në fjeg jashtë qytetit
 Ndini, djali i dukë Ndreut,
 me Shëndetjen gjet barinjte
 ulur rreth një zjarrmi t'madh,
 që shpejt ngrihen për nderim.
Shëndetja – Çonī shpejt e zgjoni shokët;
 le t'i lenë grigjë e pendë! –
 Tha dhe priti. Atje u mblodhën
 ndo njëqind djelmosha e trima;
 bimcat e pallatit t'errët
 i hapën dhe armë zgjodhën
 dhe në dritë pishe i ngjeshën.
Shëndetja – Letra që na solli djali
 thotë: «Shokë, zini kullën
 dhe ta mbron. Unë sonte
 me ushtarët do mbroj udhët
 e qytetit, që i gjallë
 këmbë armiku të mos dalë!»
 Me ju duka la të birin;
 e dëgjoni, shokë e vllëzër! –
Ndini – Vashë s'jam të rri i fshehur!
Shëndetja – Kështu thotë yt atë, duka.

Ndini – Po s'them unë. E kur s'i bindem
as tim ati, askush s'më ndal. –
Dhe hip kalit e kthen udhën
ndjekur nga të dy shqytarët.
U beson barinjve kullën
dhe shpejt ia arrin Shëndetja
me ushtarë, e ndënë shi,
kundrejt qytetit p'ot thirrma.

IV

Në një çast zbarkuan zallit
vargaritë e Radavanit,
radhë-radhë lart u ngjitnin,
forca osmane nga fortesa
zbritnin dhe u ndanin udhve.
Sa erdhnë afër, *Algazili*
disa i njohu edhe la vidhin.
Algazili – Ç'strehë kini veç këtyre,
nga shigjeta e shi t'ju mbrojnë? –
Osmanët – Gjysma jonë e ordhia jote
jashtë horës presin ditën;
ne do zemë gjithë portat. –
Algazili – Dalim shpejt te udha e
madhe! –
Atje ndeshën t'arbëreshët,
prej anijeve të zbritur.
Dhe përleshje e rreptë nisi;
Nga gjëmim e krizma pushkësh
u duk qielli se po çahej
edhe topi prej kështjellës

bënte shëmbje në ndërtesa,
përmbi thirrma e të qara.
Atje ku ish, ndaj shtëpive,
me Shëndetjen, zotin Ndin
vendi më s'e mbante dot.
Ndini – Po shkoj, ja, atje ku vriten
dhe më pak janë t'arbëreshët.
Dhe im atë atje më do!
Gjashtëdhjetë djem e ndoqën,
po m'u futën në një udhë
plot të vrarë e trarëngritur
dhe pandehën q'aaq e patën...
Krismat larg sa ndiheshin;
pastaj një breshër bombardash
në një mjegull zhavrre shëmbi
njërën anë të kështjellës.
Osmanllia e tronditur
prapa bëri nga rrugicat.
Por një tog pas Algazilit
u vërvit në rresht në rrugë,
që e përmytur rrëkesh shiu,
ndriste nga dritat prej bimcash.
Që nga dyert e shtëpive
edhe nga t'errtat dritare,
kthyer prita, shtinin trima.
Me vrap armiqte u përpushën,
duke u shtyrë e çajnë rrugën,
se luhaste shqota dritat
dh'u prish shënjat shigjetarve.
Kur ja, tek zbriste me shokët
me ta ndeshet bujar Ndini.
N'atë ças prej rrugës anash

ndieu thirrma t'arbëreshe
që me zhurmë u afëronin.
Mori zemër edhe shtyu:
një osman prej togut ra
me klithmë pranë Algazilit.
Ky me ushtë iu mat Ndinit
që me shpatë e priti, e maja
s'iu ngul barkut, po në kofshë.
Por nga t'arbreshët q'u derdhën
pas krahve Ndinit, Bozdari
ia pat turkut dhe ia dendi:
prej gurmazi i ndan kurmin
dhe e rrëzon kaçup për tokë
Algazilin. Një plak osman
thret: «Në besë, o arbëreshë!
Ne shtëpit' tuaj nderojmë.
Gjer këtu sulltan fodulli
na degdisi e na solli
s'di nga ç'vendlindje e shkretë.»
Trim Bozdari i dha besën
dhe la të mblidh armët Damsin,
prijs të krahut tij e shiu
dukej se derdhej prej qiellit;
pastaj trima i dha Ndinit
gjer në shtëpi ta përcillnin.

KËNGA E KATËRT

Artë, tetor 1443

Përse po bie këtë natë
shiu si mëri e qiellit?
Bie që të lajë udhët
prej gjakut të sapovrarve,
gjak q'ende ka hije jete.
Bie që të fshijë kodrash
krenarinë otomane
të strehuar pa një çadër.
Bie q'agim i parë i ditës
të ndriçojë pyjet, detin
dhe në hapësinë e botës,
të gdihet pa drojë, Arta.
O gazmend që gjithë helmet
i mbyt dhe në mes shtërgatës,
se rrjedh nga çështja e lirisë,
që dy-tri herë ndër re
ndriti jo me krahë qifti,
por me dy fletë sa detil...
Llamburitin cirka lugjesh
mbi dritaret fletëmbyllur...
Pastaj gaz e fjalë e fyej
me kitara ziejnë vatrash:
dhe lart shi, zhumhur i gjerë...

Veç vetvetes, as kënd s'kishim!')
për mbështetje, e s'di kë kishim
jashtë nesh; edhe si mjegull
që dëborën mban mbuluar
po na mbronte nga zuzarët,
zjarri i zemrës për liri.

II

Para Agimit, në fortesë
Milosau, - Vanieri, Urani,
Radavani dhe Topia
brenda sallës po pushonin,
po pushonin, kuvendonin;
u mungonte trimi i Shtresaj.
Ata morën një vendim:
«Trimat gjithë të pushonin;
gratë ushqimet të gatitnin,
shpatat, kamat të lanitnin:
pas të gdhirit prapë sulm
mbi armiqtë dhe jashtë Artës.»
Si u dha verë Bozdari
luftëtarve t'asaj nate,
i tërhequr prej erëndjes
s'asaj lulje q'erdh ta haste,
shkoi në kishë e i puthi dorën
mëmës tij edhe emtës tij,
e me to tok bisedoi
gjer te porta e pallatit ,
ku u tha se do vonohej
gjersa ato të shtronin darkën.
Shkoi e s'pa çastin të hynte

te Topiajt, ku nga salla
që të gjithë ishin turrur
pas trim Ndinit të plagosur.
Që nga dera mbanë, e motra,
(që të zhveshurit e djalit
as përmbajtjen vashërore
nuk ia stepi), u duk e zbehtë
edhe me duar në flokë.

Bozdari – Zonjë, gjakun s'ia ndaluan? –

Serafina – Nuk iu derdh dhe aqë
shumë. –

Bozdari – Mos u tremb, do bëhet mirë. –

Serafina – Zoti neve na ndihmoftë.

Nga ju ne na erdh shpëtimi

Po ai turk, verën që shkoi,

vrau një dhenarin tonë,

çunin që më sillte qumshtin

gjatë smundjes; tashti i ra

dhe tim vllau e s'di qysh ty

mirënjohjen të ta shfaq. –

Pa iu shfaq vashës në faqe

një si trëndafil, por shpejt

iu zbeh si t'ish cipëz qepe

që ndrit pas flakës së ndezur.

Vasha ndehet i hap derën

e një dhome qirinjndezur;

ishte dhoma ku flij Ndini.

Zonja mëmë vështrimterur,

dyllë e verdhë, e mbante djalin

vënë krahnë e saj te zverku,

te Tamburi e Hankali sytë,

që me gjilpërë t'argjendte

maste varrën.
Tamburi – Shkoni flini
tashti murga, sepse djalit
delli i zemrës s'i është prekur:
Ndini ynë do të ngryisë
edhe njëqind vjet të bardhë:
pra, tash me gjumë t'i nisë! –
Një flakë djalit dhe mëmës
u rrëmbëu shpejt fytyrën,
po gëzimin s'ua zbuloi.
E graria duke folur
në vargan po dilnin jashtë.
Dhe Hankali po ia lidhte
me ndriza të linjta kofshën.
Pastaj shtratin ia erruan
më shpërvjerrse. E shqota shfrynte.

KËNGA E PESTË

Arbri i jugës, dhjetor 1443

Pas një jave djemtë e Artës
armiqtë arrakatë i kapin
në një llakë plot ullinj.
Poshtë llakës rridh një lumë.
Një kaljanë osmanësh, t'ardhur
për t'u ndihur të përzënve
që prej Arte, shtruar prehej
së përpjetës, përtej lumit.
Mbi kaljanë, çukës malit
ndritnin shatore të pakta
dhe gati kundruall syve
të bujarëve të Artës,
që, pa ditur, ndezën zjarre
llakës për të ngrysur natën.
Para filladeve t'agimit,
shpejt nga shatoret te çuka
përkundrejt, dy vetë zbritën,
si turq veshur, turqisht flitnin.
Kishin letër prej sulltanit
për pashanë, një ish-grek,
shkakëtar q'u mbyt Frosina.
Ky tashti, jetëkënaqur,
si qen ndaj birit sulltanit,

baltës e këmbve të tij, flinte.
 Me djalin foshnjë në krahë,
 del te dera e i pret e shoqja,
 nj'arbëreshe, edhe bijë
 e peshkopit të Toptanvet,
 që me të shoqin, pa brengë,
 sikur t'ishte qielli i zbrazët,
 na thëthinte erën ndotje,
 n'atë vend ku jashtë kishës
 ati i saj u vu kurorë.
 Letrën mori, e hyri brenda:
 Evoda — Kalislip, t'erdhi një letër
 nga i madhi padishah! —
 Ai duarsh ia rrëmbeu
 dhe me sytë e përpiu:
 Kalislipi — Paska ardhë ungji i
 sulltanit
 me një ushtëri kiamet,
 për ta zhdukur faret Arbrin!
 Këshillim kërkon me mua.
 Ja, Evodë, unaza e fronit! —
 U vesh, hipën edhe shkuan
 e më nuk u kthyen prapa!
 Sipër çukës, anës qiellit
 që zhuritej, ndrit një flakë.
 Asaj drite, që sill ditën
 e Arbrit të tij i falej
 Skënderbeu, q'ishte kthyer
 gjallë nga Turqia e largme,
 teksa lajm me gaz u çonte
 gjithë bujarëve t'Artës
 dhe këta në luftë u ngritën!

Të pabesë armiq radhitur
pas ullinjve, duarfshehtë
shtinin, trimat t'i vononin.
Atje pranë ishin shkarpa,
prerë lumit për guroret.
Bozdari dërgoi i mori.
Dhe mbi ullinj q'i rrih era
me tërbim, ato i hodhën.
Dhe ullishtes flakë i vuri
prej njëj ane. Pa shpërtheu
flakë tmerr që mbyti qiellin.
Kot kërkon frota e verbuar
ndonjë shteg që të shpëtojë,
kot kërkon armëpushim.
Bozdari – Urdhëroj: vritni osmanët
q'ende s'i ka djegur zjarri!
Si gjanprinj ne do t'i kishim
në vend tonë! Hi të bëhen,
që pa droje t'hedhim hapat! –
Tha dhe si shkëmbi qëndroi
para vdekjes së të shkretvet,
gjersa flakë e klithma shuhen...
Kaloj lumin edhe hidhet
kundër ushtërisë s'ardhur
nga Moreja, mbi të cilën
që prej malesh po mësynin
ushtarët e Skënderbeut,
dhe ajo, si nuk gjet as pashën
në shatore, nis të thyhet.
Sa hap shatoren e Pashës,
Bozdari sheh t'i përgjunjet
me djalin në krahë, Evoda.

Evoda – Hyni, zotrinj edhe vllëzër,
 këtu gjithë ç'ka t'armiqve,
 është tashti në dorë tuaj.
 Po më plaçkën mos përzieni
 dhe një grua, motrën tuaj! –
 Bozdari – Grekët erdhën të na vrasin,
 apo skllëv turqsh të na bëjnë!
 Të gënjeu, o zonjë, fati
 që ca çaste të shkëlqeu.
 Mos u druaj, sepse ndodhe
 në gji të gjirisë sate! –
 Tha dhe e ngriti, e rreth shatores
 i la shokë që ta mbronin.
 Vetë u ngjit ku ishte i ungji
 t'ia puth ballin për fitoren.
 Por e gjet t'ungjin të vrenjtur:
 Skënderbeu – Bozdar, dije, se edhe
 turqit
 sado të gënjyer qofshin
 për sa shihet dhe nuk shihet,
 edhe ata, si ne u ngjizën.
 Edhe ata bij zoti janë.
 Edhe ai t'urrejnë u thotë
 si gënjeshtërën edhe kobin!
 Të drejtë e të mirë i njoha,
 si vëllezër unë i pata.
 Andaj besuan ta gjenin
 mëshirën që na kërkuan.
 Por në gjirin tonë s'gjetën
 asnjë shenjë të tynzoti.
 Dhe për ne mbaroi dita! –

Këto fjalë ndër bujarë
si kambana zije ranë.
Më të ngrysur n'Artë u kthyen:
e mbi brengët e Bozdarit
dhe mbi vashën që do gjente,
iu ngrit mburrja për fitoren,
edhe për shtëpinë e së ëmës,
që sërish me Skënderbenë,
dil e para ndër të parat.

KËNGA E GJASHTË

Artë, mars 1444

Dashuria lind te zemra
e njeriut, si edhe lulja
lind te balta, por që s'merr
(se kjo s'ka) as erë, as ngjyrë.

Dhe ajo si lulja fishket.
Ashtu edhe lumturia
që na jep stolia e vashës,
hiri i saj dhe hijeshia:
pa e ditur as burimin
pse na dukej aq hyjore.

Në qytet hidhen dy valle
njëra me flamur të kuq
dhe shqiponjën krahëzezë;
tjetra me flamur të bardhë
dhe me diell e me hënë.

Bozdari – Përse ata dy flamurë? –

Komini – Njëri është flamur i Arbrit,
sërish zot i vetvetes!

Tjetri yni, q'është ngritur
time motër të nderojë
që të dielë po martohet.

Bozdari – Ku martohet.

Komini – Në Zadrinë.

Bozdari – Cila motër?

Komini – Serafina.

Ne një kemi.

Bozdari – Po ajo vetë

a e dinte? –

pyeti i prerë e iu qep goja;
dhe pas krahësh, në skëterrë
jeta e shkuar iu ronit.

Shkoi përpara e ushta-urë
brenda i ndizej dhe ia grinte
zemrën tym-e-zjarrzhuritës.

Ja, shtëpive u afrohet.

Vallet si tërkuzë u dridhnin
pranë tij, e ai si hije
e pajetë e si i huaj
vallet çau e i la prapa.

Dhe atje iu duk se jetën,
si t'ish mur kristali, e çau,
nën thundr e shkeli, e shkoi.

Në shtëpitë zhurmëtare
gjë për të trimi nuk gjeti;
gjë për të tash që të mbetej
nuk paskej kthisur ndër motet!

Edhe ajo që i mori zemrën
sykëqija magjistare,
zonjë e festës qytetare,
nderesh, begatish e nginjur,
duke pritur dhëndrin rrinte,
pa kujdesje për lavdizën,
që na ishte mburrja e trimit.
Hynë shpejt e ëma e motrat
tek ish djali. E ëma i thotë:

Gjela – Si më rri kaq i vetmuar
këtë orë lumturie?
Ndrrohu, para se të vijnë
qytetarët të t'urojnë
për këtë ditë, që vetëm
ti ua bëre të shëndetshme! –
I ndezën kandilë, e kupën
ia mbushën verë të zgjedhur;
pa zë ndenjën; edhe e lanë
në mejtimet e tij mjegull...
Prindtë e tij për qytet qenë
më të mirë se t'asaj!
Ajo vetë: lule balte
q'e shtyp këmba e një burri!
Sa, si ajo pispillosur
tok me vogëlsitë e mjera,
shuhen ndënë dhe! E jeta
u kthen krahët, pa përfillje
për llanjuzërinë e tyre!...!')
N'atë ças vallja e qytetit
ndën dritare t'hapta i erdhi:
Vallja – Na thur fatin gjithë
dhe në kopshtë të parajsës.
E sëmura te shtëpia
nga veriu e ndrron shtratin,
pastaj nga jugu na e kthen,
por nuk i përtrihet jeta,
se një herë ajo na vjen! –

II

Heshtnin këngët me qytetin
sa më shumë qasej mbrëmja:

kur përhapet lajmi i keq
 dhe kambana e kishës madhe
 e vazhdonte e e zgjaste zinë
 mbi ushtarë e rrëmet jashtë.
 Në pallatnë e Shtrese u ngjitrë
 Dodë Gjeka edhe Prenk Gjoka
 dhe qëndrojnë ballë trimit:
 Doda – Të marrë jemi që i lëmë
 të shkelin të drejtën tonë
 turq e të krishterë bashkë?
 Një shigjetë greke sonte
 shpoi në shpatull Radavanë,
 edhe ra i madhi i Arbrit!
 Dje na pru turqit mbi shpinë
 Kalislipi, e mjaft shtëpi
 qajnë bijt' q'ua korri vdekja!
 Sonte duam gjak të pimë
 tek i biri e e shoqja bushtër! –
 Bozdari – Tash ushtrin' s'e drejtoj unë:
 e drejton vetë qyteti:
 e tij është' dhe plaçka e luftës:
 le të bëjë si të dojë! –
 Tha, i përshëndeti, e shkuan...
 Ra kambana e falëbrëmjes,³⁾
 që me shfaqje t'yjve qjellit
 zbut kujdesjet e shtëpive
 dhe pastaj na i tret gjumi.
 U endnin lakuriqtë, e helm
 s'm'i çonin prej mbrëmjes s'errët
 qiellit, që pak m'ia ka ënda.
 Aher duka Ndre përdore
 merrte Ndinin e plagosur

dhe si e ulte na i thotë:
Ndreu – Dashtë fati yt i mirë
që kjo plagë që ne bëmë,
siç na erdh me faj liria,
të të mbajë larg, mos lash
ti të ligat që ne bëmë. –
Hyn me t'ëmën, motrën nuse,
vlla Komini e krejt shtëpia.
Ndreu – Thoni të shpërndahet vallja!
Ndani kulaç pas zakonit:
gazin tonë e errësoi
fluturimi i Radavanit,
drita e Arbrit! E ndofta nëmë
më të keqe do na lërë
ajo mëmë që, siç e ndiej,
tok me birë e saj të shkretë,
sonte duan që ta vrasin,
pasi e ftuan të rikthehej
në besën e prindve saj.
Shko, Komin, te i biri Shtreset,
dhe nga unë plaku i thuaj... –
Komini – Unë atje veçse me shpatë
të lanisur, ndryshë s'hyj! –
Edhe u ngrit e i vërviti
sytë flakërim së motrës,
q'i ndrruan asaj fytyrën.
Ndreu – Ora që na u shfaq e bardhë
këto javë, pa faj tuaj,
po për faj t'atij djaloshi,
q'i rrëmbyer shkon e s'vren
se pa dashur po lë udhës
pjesë nga të vetëvetes,

ndiej, për besë, se kjo orë,
me ato hije e fat që dukej,
vjen tok me asgjënë e saj...³ -

III

Atëherë sheshit kishës
turmë grash me shqepzet borë,
q'era prorë u dallgëzonte,
prisnin zemërvrara. E drita
e një varg flakashkash binte')
mbi një stivë dru, që majën
lart në t'errët t'erës fshihte.
Qielli plot me yje, territ
sa merr zjarr stiva na zhduket
dhe mes flakëve të blerta
del një e re tok me një foshnjë!
Që nga dhoma e vetëmuar
përkundrejt, e pa Bozdari
atë që desh: flakadanin
bash në pragun e martesës!
atë që i pati dhënë
besën e vet të rreme
n'atë gojë zjarri e pa.
Dhe tek digjej, me të bashkë
digjej edhe bujaria
dhe e drejta e tij të priste
ndonjë gjë prej qiellit dliret!
Pa iu duk si t'ishte shuar
brenda varrit të çnderimit!
Po dhe xhindet iu larguan

që një hije i nxirrnin para
në vend të vashës së dashur,
sapo shfaqur reve mendjes:
e pafajme dhe plot hire,
si në fjalë e mall të saj,
tek u bindet prindvet saj,
si bijë e dukës që lindi...
Andaj dhe të keqe s'bëri!
Në këto mejtime plaset
përmbi shtrat, edhe burithi⁷⁾
si një dem në tru plagosur.
Por Evoda që pat marrë
gjumsin prej doret të dhembshur
dhe tok me të birë e piu,
u bë fletë karte e bardhë,
dhe si dikush ti hiq napën,
pa fatin q'e priste turmën
për mynxyrën që po kryhej;
e pa nëmën që pa ndalje
derdhej si vërshimë ujrash
përmbi Arbër. E pa vendin
ku pat lindur plot me burra
të drobitur dhe gra skllave
në shtëpitë, pre t'armikut;
dhe ngado, rreth tyre, gjithë
ngrinin duart kundër tyre.
Dhe t'arbreshve, q'ende mbanin
në Greqi prona dhe kopshtira,⁶⁾
si rreth armiqtë u vërtiten
që t'u zhvatin tokë e gjuhë
edhe shpejt krejt t'i përpijnë.
Pa bujarët q'u mërguan⁷⁾

n'ltali: ca nëpër ckërka
me pak dele mbajnë shpirtin;
dhe të tjerët, strehëshkretë,
ndënë hije ullinjsh, lisash,
ku të rralla gra, plot brengë,
mbledhin ferrash kokrra e lënde;
dhe gomarë brinjëdalë
shtigjesh dhish mezi po ecin,
cohë dhe kusi ngarkuar:
për haraç i zhvat Despoti,⁸⁾
i huaj me gjak e gjuhë,
se arbreshët krejt të vetëm,
mbetën t'huaj ndër të huaj
dhe pa prijs nga kombi i tyre!⁹⁾
Në kaq tmerr i pa Evoda,
sa, e prekur, harron vdekjen
edhe thotë: «T'arbëreshë
i kam zotin tatë e mëmën!»
Dhe si t'i largohej shqota
e të hapej një rryp qiellit
koha e ardhme iu zbulua:
Dhe pa kundrejt saj një mëmë,
veshur me cohën e zisë
tek po nxirr nga gufra e zezë
e detit t'errët të birin.
Nd'erë mëma foshnjën ngriti
dhe e çoi përmbi një kodër
që rrih dielli gjithë ditën.
Shpatit dy rrëke e ftohnin.
Atje vashëzat, pas punës,
këngës ia thonë si zogjtë
përmbi begatitë e botës,

q'askush s'mundet t'i grabitë!...
 Ajo pranë i vinte shqytën
 e shtëpisë, ku dy yje
 në një fushëzë t'argjendtë,
 mbi gjimush purpri, e lirin¹⁰⁾
 e Dodonës sipër saj.
 Dhe në duar i besonte
 mëma flamurin e Arbrit,
 që rrih shqota ta rrëzonte.
 Pastaj mëma e përgjunjur,
 sytë e kaltër të përlotur,
 nis të falet. Dhe kundruall
 u përgjunj me të Evoda...
 N'atë çast flaka kërcëllimë
 e pështolli, i mori frymën,
 dhe mes gjuhësh zjarri e tymi
 vasha mori për nga hëna,
 kënd i bukur i pasosjes.

kapnoj me vrap, dhe pyje.
 gjelbërisin mëndiell dhe hije.
 një i kulluar sipër mëndit të
 kaset për fundituar bakile në drejtë

c/ Deiratli. sh

KËNGA E SHTATË

Artë, mars 1444

Ëndrrin të shtunën Bozdari
sikur mbi kalë po bridhte
fushës gjerë aq sa djersinte
kali e i zbardheshin këpucët:
Bozdari – Kali im i zi, u lodhe? –
Kali – Fryn kjo duhmë, e ndër kallame
pluhuros grigjët që rendin
për bar të njomë, që fushat
asgjëkundi nuk e kanë.
E zbardh vdekja e dheut shkretë!... –
Në çast jashtë gjëmim armësh
dhe në gjumë gjithë u trembnin.
Pastaj rrezesh diellit zgjuar,
dil qyteti udhës madhe
të shikonte Dukagjinin,
që Bozdarit vin t'i merrte
vashën. Harqe me tri ngjyra,
si ata që lëshon poshtë
dielli e shqotat mbyll e tret,
ishin ngritur përmbi udhën.
Ndënë harqe shkonte dhëndri,
ar, argjend nga qeskat zbrazte.
Sot do jepte gjithë botën,
se të tijnë e ka për jetë

Niku thesarin e Arbrit.
Mbi kal hipur, Shtresi zbriti
vetëm te vetmia e zallit,
që deti e fshikullonte
valëkaltër e u jip hije
si Këtitj dhe tjetrit zall.
Bregut kali linte rërës
radhë gjurmësh trajtë sysh,
pasqyruar n'ujët anash;
e kundrejt mbi ujët zbardhnin
velahapta vetmitare
anije, prej botet ndarë.
Eh, sa anije plot njerëz
andej shkuan e soditën
dhe sot balta i varros n'heshtje,
pranë zhurmëris' së kohës,
n'heshtjen: detë gjëmëgjërë!
Po më poshtë trimi hyri
në një rrugë nëpër plepa,
ku i del një hije mëme
me një foshnjëzë në duar,
e përplasur, s'dij se nga.
Kjo përkëmbësh iu vesh kalit,
që kërcen qirith nga frika¹⁾
dhe pranë saj e flak trimin,
ku mjaft kohë ndenj pa ndjenja.
Kur erdh në vete, qe errur.
Mbi luhatje hijesh dushqesh
u ngre; frethin kalit drojtur
ia kap, hip e zemërbrazët,
si t'ish prej botet shkëputur,
shkonte drejt ndaj një gremine.

Përfund saj iu shfaq një plak
 i shtrirë e me një dhi pranë.
 Plaku e njohu e i tha Bozdarit:
Gura – Mirë q'erdhe, mos m'hanë ujqit.
 Zoti, o bir, të mira u dhashtë
 zonjës sat ëme edhe ty! –
Bozdari – Gurë murg, këtu..ç'ke rënë? –
Gura – Mbi greminë atje sipër
 isha dhe kullotja dhitë.
 Kjo murgë pas kecit saj
 që i kish hipur mbi një shkëmb,
 vërriste e të çante zemrën.
 Desha t'ia zbritja e shkava,
 dot s'u mbajta e këtu rashë.
 Dhe kur pashë ditën prapë,
 këtu tok me dhinë u gjeta.
 Kjo kullot rrëzat dhe etjen
 mua me qumësht ma shuan...
 Sot martohej zonjza vashë
 e pallatit, e gjith m'harruan:
 edhe e vetmja bijë imja
 për t'i bërë nder asaj...
 që me helm e lë qytetin;
 ndër ju pritnim t'hynte nuse
 për të mirën e të gjithve;
 edhe vetë ndër ju donte.
 Po si nga shtëpi e mirë,
 prindve saj ajo u bind.
 Ndër ta punova q'i vogël;
 ndër ta hëngra bukë e idhëz.–²)
 lu pre fjala e ra përdhe...
 Prej tij djali u nda, e shkoi.

II

Vasha që dukej m'e ngurtë
 nga ç'i kish hije një nusje,
 me kurorënë në krye
 atëherë dil prej kishës,
 e bardhë e fytyrëprerë.
 Si dolën dhe panë diellin
 gratë u mblodhë n'anë e zunë
 prap' këngët q'u preu mesha:
Kori i parë «Pat një mëmë që e bëri
 bukëdhënëse e t'urtë,
 dritë të pallateve!
 Pat një zot tatë q'i zgjodhi
 më kohë një teh të mprehtë
 ndër bijt' e zotërve tanë.»
Kori i dytë: «Pat përpara vetëveten,
 që çdo mburrje e errëson...»
 Me t'arritur te oborri
 në një re ari e argjendi,
 që nga dielli llamburiste
 hedhur që lart prej dritaresh,
 ajo ngjitej; e mes zhurmës
 së polemës, që sa i njihte,
 e mirr dhurëtitë e saj,
 në kurm akull dhe në shpirt,
 ajo dukej ëngjëll qiejsh
 që n'harenë e njërvet,
 nga ç'kish lënë ende nuk ndahej,
 Doli e ëma e m'u lidh brezin:
Shtatyrë – Bijt' e mi, paçi uratën! –
 Edhe brenda ulen afër.

Mëma u ndesh para më këmbë
dhe i vërejti e nuk të ngopej.
Shtatyrë – Trim, o shtylla e shtëpisë
së Dukagjinit të lirë,
ma duaj, se mbi ty mbahet
kjo hardhi e re, e drojtur,
fytyrëbardhë si hëna.
Dhe ti hieja ime, o bijë,
ku korr drapri ndër beteja
vazhdat trimat, ndero burrin!
Short si ky nuk të sjell koha.
Dashuria e vashës është
lulja e zemrës e kalorsit! –
Pastaj arkat me sheqerka
nusërie sollën. Nusja
mernte e u jepte varfanjakve,
varfanjakve e fëmijve.
Ajo sot nd'arbreshtë e saj
është hiri i qiejve.
Dhe çdo njëra shërbestare,
q'ë kish harruar vetveten
për harenë e dosmës, shkante
andej-këtej nëpër odat
velushkuqta e mëndafshbardhta
përmbi mure e qiellzana
që shkëlqenin kundrejt ditës,
nga drithronte një puhizë
plot aromë pemësh, lulësh,
si e ardhur që larg dheut,
po e butë si një motrëz.
Kur na ulen më tryeza,
gazin q'ishin tok me bijtë

dhe me burrat, bujareshat
plot ëndje dlorët e shfaqnin.
Ulej si tërshërë e thekur
nusja ndaj të zott, e sytë
vetëtimthi i tërhoqi
prej një froni, mbetur zbrazët.³)

Po gëzimi e argëtimet
zgjatin gjersa nis e zbret dielli,
edhe vonë rrushtë sjellin
ndër fajanca, e e shoqja e Buzës⁴)
ia nis tok me Shtratigonë:
«E kush na bëri tryezën?
Na e bëri buka e vera...»
Atëherë zonja e Veshit
u ngre dhe vate te nusja:
«Eja, zonjë, ta dëgjojmë
këtë këngë atje larg,
dhe kundrejt botës ku linde!»
U ngrit dhe për dore shkojnë,
dhe dritarësh zbrazen armë
nga çdo anë e retë ushtonin
këto kërisma lumturie...
Te portë e tretë më këmbë
Ndoni i verbër sikur dritën
e largonte, lot qerpikët
dhe në veshët mblidh gëzimin,
kur atij nusja i foli:
Serafina – Ndon, ti mbete pa sheqerka.
Andaj merr këtë aspër ari.
Dhe të lutem më kujto
kur këtu do të harrohem
nga kush më fat do të ketë.

Dhe kur të zhvishet pambuku
shtëpive ti më kujto! –
Ndoni – Prijseshë, yll i parë i Arbrit,
përse tek i kthjellti zë
po të vlon ty pikëllimi?
S'kish pallat qyteti ynë
ku të shkoje zonjë nuse;
pranë njerëzve të tu t'ishe?
Për ne ish mjerim nga zoti,
si mjerimi im, që s'm'epet
drita e diellit, të të shoh! –
Zemërpastra mallëngjehet,
sytë ia hodhi një dritarje
dhe me duar gishtrinjnigjitur,
larg nga zhurma, ajo lutet:
Serafina – Zot e at... ardh të ora kur
vetëm ti të mbretërosh
në shtëpinë e gjithë njerzve,
U bëftë dëshira jote
si në qiell edhe ndaj meje,
se kjo dit' më nxu jetën! –
E më s'tha, se e mundi dnesa,
vaji ia errësoi botën.



KËNGË E ZADRIMOREVE SERAFINËS

Zadrimë, mars 1444

Mir' se na vjen, nuse, se gjithë të mirat
sivjet na sjell vera, e të na rrish gëzuar!

Sa fatlume mëma, që puth nuse mollën
e që me pajë, i fali gjithë mirësitë!

Helmet do t'i reshten e zonjë e tokës saja,
do të dijë vetëm ç'hir i fali qielli.

Si pulbardhë ujane, mbi të gjitha e bardhë,
krahët na i hapi e erdh në malet tanë.

Dimrit këtu bora ndehet posi det,
edhe jetës zajet syri nuk ia sheh.

Këtu ngrihen retë plot shkëlqim në verë,
posi prej kallinjve ngrihet kokra e grrurit.

KËNGA E PARË

Arbër i veriut, dhjetor 1446

Tek ato male lumi i Madhit')
çeton pela; edhe dielli
nëpër pyje e mbi shtëpitë
shkëlqen sipër avëlmendesh
dhe sheh vasha që s'sheh dheu.
Po fërtyma e petritve
që nga qielli stërpik trollin
pika gjaku e pendë vidash.
Atje, brenda dhomës, n'hije,
pas dasmet, me faqe t'hajthme.
zbehur nuk e di nga ç'brenjë,?)
me t'ëmën, zonjza Gavrilë
rrinte ditë e dit' të gjata.
Jashtë çuna plot gëzim
zhurmëtarë, sipër qerresh,
zbritnin poshtë në lëmenj,
kur i erdh vllau i larguar
që prej kohësh, shumë i bardhë,
shumë i bardhë e i dobësuar
ujit ngjelm, që Venedikun
po e fryn, duke e hajthur.?)
E puth vasha, e «Këndeje Todër,
(i tha e ëma), bir, moq ikë,

Ajri i huaj nuk të shkon;
në shtëpi ke gjith' të mirat;»
Trimi qeshi e e ndoq ndër dhomat.
Bota që çdo mbrëmje i vidhte
nga një ditë, s'mund t'ia veniste
një fytyrë të një vashe
n'atë det të Venedikut
ku pallati i pasqyrohej;
edhe mbushej me trishtim,
ndonëse atëherë vera,
që ndan lule e s'vren ku bien,
kishte gdhirë me lirinë,
që ngjau sikur i heq napën
gjithë botës dhe njeriut
t'ardhmen plot gaz ia tregon.
Por sa u tha që bëhej ndeshje
në qytetin Lis, ky shpejt
lyp uratën që të shkonte,
se latinë do të gjente,
të paktën do ndiente gjuhën
që flit vasha e Venedikut.
Mëmë nëmura nuk donte
as e varfra motër, por
ai s'tundej dhe i zgjodhën
shqytarë, i zgjodhën shërbenjës;
ia zgjodhën, ia porositën.
Me të shkuar në Zadrinë
zbritën nga kujt e shtruan
mësallën mbi bar të njomë.
Sa merr vesh, atje i arriti
me të bijt' zoti i qytetit.
Dukagjini – More! Pse jep shkak të thonë

«djali i dukë Zaharisë.
(që në varr zemrën ma mori),
në vend tim, shtëpinë time
ma paska gjetur të mbyllur»? —
I puth ballin edhe shkuan
në pallat, ku zonja e thinjur
na i priti e nder u bëri.
Mbanë i rrinte bija e vetme,
vashë shtatëmbëdhjetë vjeçe.
Si n'ag gushti yjet zhduken
se del dielli, mbreti i vapës,
ashtu vasha trimit zemrën
aq të djegur, ia ndez flakë.
Si në frone u ul familja,
vasha shkoi, por gazi s'fiket.
Nga të gjitha shtëpitë erdhën
që t'i bënin nder bujtarit;
(thoshje, erdh' gjith' qyteti),
gjersa dielli hyri dhe
në pallat shtrohen druezat.
Zgjaten gjer vonë bisedat,
tok me verë e me të ngrëna,
shkonin orë, e napa e gjumit
shtrihej mbi banesa njerzish.
Por si ka hije për vasha
t'arbëreshe, e bija e shpisë
me bujtarët s'mundi t'ulej.
Pastaj malli për sho-shoqin
keq afron të dy filizat,
apo dielli lart e deshi
që t'u delte një çast fati:
natën panë të dy n'ëndërr:

«sikur qenë të dy bashkë:
qielli dritëbardhë u hapej
e drejt tij dolën te pragu;
e pas tyre burra e gra,
posi ata, në dyshze afër;
pamje shortesh tejtoksore.
Shihnin anës perëndimit
qiejt, si qelqe në dritare,
ndarë llastrash plasa-plasa.
Por ja se n'ato të ndara
ca po zgjateshin e zbardhnin
sa më tepër zbardhej koha;
ca zgjeroheshin si trungje
drurësh degë e fletëbore,
mollë si qendra t'argjendtë,
në fund lule gjith' të zbehta;
herë humbisnin fletë e lule,
gati si t'i tërhiq era;
u mbyll qielli e në tru retë
si u mblodhnë, ashtu po treten.
Kur na erdh mëngjesi e çasti
që të dy shtat afër shtatit
dhe frymë ndaj fryme rrinin,
shokë ishin në madhështinë
e teatrit botës, ndonse
njëri-tjetrit nuk ia thanë:
andaj unë s'di n'i gjeti
dita e re si dy të vluar.
Todri shkoi në Lis, krenar
për të dashur aq fisnike;
dhe në të përdorur shpatë
ndër të gjithë e nderoi dora;

edhe zonjzën çdo fitore
 që dëgjonte, edhe më t'hijshme
 po e bënte e po e treste.
 Thoshje «rron vetëm me ajër
 deti e toka ku është trimi
 dhe nga sa heshtja i fsheh.»
 Pastaj shirat erdhnë e s'reshtën,
 aq sa mbet palestra shkretë.
 Andej, rrahur diellit, erës,
 erdh fytyrëbronzët trimi
 te kështjella e saj një mbrëmje.
 Sa ndien troknë e kalit vasha
 shikon tok me Serafinën,
 të kumatën napëzartë,
 që gjer te kindi m'i ndriste
 krahvet hjetufl⁴ e argjendtë.⁴)
 Vasha kish përmbi stolitë
 lavdinë q'asaj ia solli
 ky trimosh, e ndihej orë.
 Serafinën trimi e kishte
 fis dhe të njohur që n'Artë,
 andaj s'ëmës ia kthen trimat
 edhe vetë ndenj si mik.
 Ndenjia e tij ish gaz i gjatë
 për shtëpinë derëhapët.
 Qytetarët gjithë binden
 se për grua do të merrte
 konti i Danjës pa dyshim
 shtatlangorenë Margjelë.
 Në të kremte kërshëndellesh
 djalit mëma i dërgon letër:
 «Helmi për një bir që rrita

e që i rritur më dha krahë
 dhe si vdekja i mori t'atin,
 nis mjerimnë e mua plakës.
 Kot që jam zonjë bashtinash
 dhe në tokë e nderuar,
 kot bëra meshë e u luta,
 po qe se ti nuk më kthehe.»
 Mb'udhë të lodrës së diskut
 letrën djali e merr, dhe e ruan
 e lart ngjitet gjithë helm.
 Një veri me borë e ndoqi
 gjer në shtëpinë mikpritse.
 Atje lyp leje për Danjë.
 Serafina – Rri dhe nesër, zoti Todër,
 pastaj kthehesh tek të tutë.
 Tok me Margjelën qëndisëm
 n'ar një vel për motrën tënde.
 zonjën Gavrilë e na duhet
 dhe një ditë që ta sosim. –
 U mund djali edhe vonoi.
 Por si u ngrys, një borë e hollë
 nis të bjerë, e gjithë natën
 gjer te zalli i detit vuri
 shtrat të bardhë. Ë një gjëzim
 bumbullonte qiellit vrerët
 përdridh borën, lidhte trimin
 ndënë tjegullat, që sipër
 mblihdnin flokë, e andej bunarnin⁵)
 nëpërmjet strehësh gjithë udhët.
 Në prag kërshëndellash vetëm
 mjegulla u davarit
 papo era maleve

e pështillte, e ndante, e zhdukte;
qielli ndriste e e zbardhte ditën.
Dritësoret njerzit hapin
dhe tagji zogjve u fëdhin.
Trimat vendosin të dalin
nesret për gjah derrash t'egër.
Për t'i bërë gati armët
zoti Todër buzë muzgu
del nga dhoma; e atë ças,
si prej erës e rrëmbyer,
andej del të shohë Drinin,
si i turbullt shkrinte borën,
edhe gazmorja Margjelë:
Por te dera sa e hasi
u hoq mbanë, faqeskuqur.
Todri – Vashë zonjëz,
po shkoj ku kam fusha, male
dhe shtëpi, ku ti do t'hyje
gjithë gaz. Por zemra jote,
që gjithnjë po më largon,
më dëshmon se kam të meta;
ndaj s'do të jem kurrë i lumtur. –
Margjela – Dashtë zoti tatë e mëmë!
Fati im – e mira ime! –
Tërhoq vasha, e turbullt, dorën
dhe hyn brenda. Por i panë
dhe në shtëpi vanë e thanë.
Mendja e saj iu bë martesë;
edhe ethet që e digjnin
i duroi më këmbë n'heshtje.
Krejt shtëpinë njerë e ngrirë
e përshkoi, dhe e qetë dukej

vetëm mbrëmjes, e së jashtmi
nga dritsoret sërë dritash
ngjante si burim ndriçimi,
kurse brenda ish kishë varresh.⁶⁾
Pal Dukagjini kripbardhë,
që s'dij gjë, te vatra shkoi,
ku rreth zjarrit do ta gdhinte.
Edhe gratë pas zakonit
rreth tij vihen. Me to bashkë
dhe gjitonë, bujq, barinj.
Pali – Po Margjela shkoi të flerë?
Gjith na lanë!... Ti, të paktën.
ime re, këndona sonte
ndonjë përrallë a të ngjarë
t'arbëreshe, që mban shkruar
n'arkën tënde. Se, si vashë,
ndë shtëpi, ti, e vetmuar.
gjithnjë shkruaje e këndoje. –
Shkoi e reja e mori kartra,
lidhur me gjalma mëndafshi,
dhe nis lëçit poemën
«Parayllja e Radavani».

KËNGA E DYTË

Ish një prift, bir prej të mirësh,
në Janinë, q'humbet gruan
aq të shtrenjtë, krejt të re.
I vetëm, pa farë e fis,
bijës së vetme shtatvjeçe.
si më drekë dhe më darkë,
ai vetë ia priste bukën...
Atnë e saj ajo e priste,
si t'ish vetë ylli i mbrëmjes,
që nuk lodhet duke pritur
mbase fatin dhe s'ngatrron
udhësh jete që nuk njih.
Edhe dallga e botës gjerë,
q'atë mot jetën e zhveshi
nga blerimi edhe vajzën
e shqetësonte dhe e rriste.
Kur u rrit, agimit parë
ngrihej dhe tagjiste sirkun,¹⁾
zbrit në kopsht, që e rrethonte
me gjire e sope shtëpinë.
Mbi një sukë vajza vinte
një flanikth me zogën qorre
ndënë një dushk degëvishkull.²⁾
Zoga si ndiente puhinë

që ia kreshtëronte pendët,
njihte ditën, niste këngën
sikur thrrit në pyll të bijtë.
Dhe nga qielli i lirë shoqet,
prej këngës së saj tërhequr,
zbritnin re e re te dushku.
Atje ngjiteshin dhe vajza
shkonte i shqiste dhe i merрте,
e me radhë n'odë i vinte.
Një bir bujari shtëpinë
kish kundrejt dhe hera-herës
dilte dhe andej shikonte;
dhe ajo priste ta shihte.
Por nuk flisnin. E një ditë
djali vajzën e pyeti:
Radavani – Vajzë, bijë prej të mirësh,
gjithë këta zogj ç'i do?
Që t'i hash a që t'i shesësh? –
Parayllja – Ç'më thua kështu, o trim?
As t'i ha dhe as t'i shes.
Unë i dua kaqë shumë,
sa kur s'kam u blej tagji. –
Po me kaq ata u ndanë
sepse gratë që kalonin
me nderim i ngjatjetuan.

II

Të dielën e Dafinës
e çoi i ati te kopshti
ku kish mbjellur portokalle,

se nuk dij si ta kënaqte.
Por shpejt vasha atje mërzitet
edhe kthehet. Mb'udhë loznin
djem me disk, e ai kaloi
pranë këmbëve të kalit,
që për pak e rrëzoi vashën;
por djañi bujar q'ë njohu,
i kap frenë e në mes shokësh,
të radhitur anës udhës,
e kaloi. E me përulje
duke i dhënë frenë i thotë:
Radavani – Pa ty s'mund që të rroj
më! –

Vasha u skuq e nuk tha fjalë.
Kur me t'atin hyn në dhomë
vasha i f'hotë këto fjalë:
Parayllja – Zoti tatë, më të dielën
nuk do dalim. Sot u skuqa
si fajtoje e si e nxjerrur
në teatër para gjithve... –
Tata – Por i thjeshtë edhe i sjellshëm
siç i ka hije shtëpisë
së madhe të Flakërinjve,
ish djali që t'erdh në ndihmë! –
Parayllja një të hëne
të paspashkës, shqepzëlidhur
të mpron prej erës gërshetat,
ndënë një ulli përpinte
me sy qiellin, ku u endnin
zogjtë. Edhe kur dushku mbushet
plot me zogj, e qetë ngrihen.
Por sakaq pas i gjëveshi?)

gjëmë e shpejtë. E sheh të varen
nëpër degë zogj të vvarë
dhe një trim te kopshti hidhet,
Parayllja – Bubu, ç'bëre! Tash, shko
merri

ti q'i vrave! Mua duart
mos më prekshin në mëkatë! –
Dhe shkoi. Në shtëpi u ngjit:
si ogur i zi iu duk
që vrau zogjtë Radavani.
Dhe në fron ndaj shtratit vasha
me mend zogjtë i shihte varur
si ninza të fatit saj!
Gjithë javën as u duk
ku shikonte Radavanin.
Me kalim të kohës mbyllet
në shtëpi e nis të duket
sikush t'ish ikonë dhromi⁴)
që s'ia di për shi e breshër,
e pandjeshme, s'desh të shihte
asnjë nga udhët e ndryshme,
që i sjellin dobi njeriut.
Por më vonë, (se askush s'mundet
të qëndrojë i vetëmuar),
posi hëna e re që ndrit
në mes reve, atij i duket,
apo edhe vetë i shfaqet.
N'ato ditë nëpër rrugë
buçet thirrja: «Shkelën turqit
në vreshta, në kopshte tona!»
Shpejt del mbroja venedike
tok me trimat e Janinës,

nën flamur të Flakërinjve.
 Dhe ndaj muzgut bëhet lufta;
 por, eh, nis drejtohet keq,
 keq mbaron dhe pse plagoset
 shpejt komandari latin.
 Dhe sa trimi i Flakërinjve
 arrin të strehojë ushtarët
 në shtëpi brenda një fshati,
 turqit çark me zjarr ia bëjnë.
 Si u çlodhnë e hëngrën darkën
 në mes vllëzish, ndaj mesnate
 Radavani i zgjoi e u thotë:
Radavani – Shokë, ne nuk kemi ç'presim!
 Djemtë tanë këtu janë
 kurse latinët tej detit
 dhe mbreti grek i Bizantit
 as e çan kokën për ne!
 Ndihma kemi vetëveten!
 Ne në botë u krijuam
 që të keqen ta luftojmë! –
 Hëna – gjysmë u ndriti rrugën
 djemve qytetit në sulm
 mbi armiqtë kredhur gjumit,
 që t'habitur, çarravitur,
 hijesh trupash së lart-poshti
 i goditnin dhe i vritnin.
 Pak shpëtoi dhe terri i natës!
 Kur u gdhi tanët të lumtur
 fshatrave-vëllezër hynë
 E kur kthyen në Janinë
 grat gërsheta hijerënda,
 t'urta (se gjë tjetër s'kanë

veç të bukurit, që sytë,
 si ua japin, ua marrin!),
 në shesh dolën me kurorë.
 Dhe çdo vësh të vëllaut,
 edhe çdo mëmë të birit
 kurorën në ballë i vinte.
 Por, fatosit, që kaluar
 printe pāra, asnjë zonje
 s'i tha zemra që t'i ndente
 edhe atij një kurorë!
 U fol se lart, të veçuar,
 ndaj shtëpis' së Paraylljes,
 djali vashën has tek dilte
 prej rrugicës për ta parë.
Radavani – Gjithë shokët u nderuan!
 Prisja dhe unë, po s'pata! –
 Vasha skuqet dhe e pyeti:
Parayllja – Radavan, ç'kërkon prej
 meje? –
Radavani – Kërkoj besën që të jesh
 zonjë në shtëpinë time!...
Parayllja – Kush të sotmen s'ka në dorë
 nuk jep besën për të ardhmen! –
Radavani – Ne te besa njëri-tjetrit
 jetën tonë e pështetim
 dhe paprerë shtëpi hapim. –
 Dorëdridhur zgjidhi brezin
Parayllja e ia ndehu trimit:
Parayllja – Të jap brezin, shokun tim;
 lidhja kordhës që mbron jetën!
 Dhe mbi sup ia ndejti, e trimi,
 aq i lumë, i dorës së kordhës

ia lidh nyje e i bje kalit
që nget potkonjtrokëllimë.
Nga e patën parë, s'di:
pa kudo dhe me zili,
e krenare bujareshat
veç për ta e hapnin gojën;
aq sa për ta njohur vashën
na u ndezën dhe bandillët
e ushtrisë venedike.

KËNGA E TRETË

Dita e Ujit të bekuar
erdh e kthjellët, në mes vashash
përpara ujit të shumtë
një kumandari latin
i treguan Paraylljen.
Kjo nga kryqi i zhytur nd'ujë
sa ngre kryet, ndezur flakë,
vetëtimthi ndër bujarë
trimin pa dhe uli sytë.¹⁾
Një veri i thatë mbrëmjes
fryu e bora zbardhi fushat.
I huaji t'i afrohej
dhe me të të kuvendonte,
një ganece m'i dërgoi.
Vasha bëhet pikë e vrer,
dh'e dëshpruar brenda dhomës,
shurdhon kryet gjithë ditën
përmbi qerthull dhe anëm;²⁾
vetëm ndonjë lot zhuritës.
i rrëshqiste atje ku rrinte.
T'et gjë nuk i tha në mbrëmje.
N'heshtje mbeti gjithë javën,
gjersa një muzg dite i ati,
si na u ngre nga gjumi, i lypi

ujë të lahej, dhe e vrejti
 krejt të zbehtë zemërvrarë.
 Tata – E moj bijë na gënjyen
 sivjet ullinjtë, edhe shqerrat
 po na ngordhin nga brazima.
 S'kemi ç'bëjmë. Fryma e keqe
 shoi dritën e parajsës
 në shtëpi, ku ëngjëll m'ishe.
 Ç'kryeartëza e borinas¹⁾
 patëm ne në vjeshtë, o bijë!
 Herët në mëngjes më zgjonin
 me mejtim se ti e hipur
 përmbi fron, po i tagjisje.
 Tash si varr po hesht shtëpia,
 as me vepra të përshpirtshme
 dritës më s'ia afron tët ëmë.
 Dhe të mërkurë mullenjën,
 që tok me yllin e dritës
 të gëzonte, e gjeta vjerrë
 dhe symbyllët, e s'më the ç'pati. –
 Vasha s'foli; por ç'tha prindi
 i hap një synor, ku kishte²⁾
 gjëra që s'dinte, e iu tretën.
 Vasha natën pa në gjumë
 sikur po nxirrte thimjan
 nga thëngjij që qenë shuar
 dhe ia jip një spektrit zi...
 Sa u zgjua nisi punën.
 Shërbestarja shkoi në krua.
 Prifti me ofiq në dorë³⁾
 zbreti kopshtit. Kur ja, hyri
 i pakripi prijs i huaj,

sa mbet vetëm Parayllja.
Brofi, e froni handakoset
edhe ndaj dritares thirri:
Parayllja – Këtu s'janë të tu motra;
të pacipta edhe përpara
prindve dhe vëllezërve tyre! –
Në çast hyri e zhveshi shpatën
Radavani, duke thirrur:
Radavani – Zonjzë, mbyll derën e
jashtme! –

E trullosur, shkon ta mbyllë
por nga vringëllima shpatash
e mbledh veten dhe vëren
qen latinin orëprerë!
Pranë atij sheh *Radavanin*
me shpatën majëpërgjakur,
edhe nga përkrahja e fronit⁽⁶⁾
ku pështetej, i pabesi
para këmbvet tij rrëzohet!
Parayllja – Korba unë! Ç'më gjet sot:
u mbyta në turp e faj! –
Radavani – Motër, kjo qe e papritur!
Gjyshët më lanë pas tyre,
të bindur q'asnjë i huaj
s'do t'i thoshte nusje a vashe
fjalë që t'ua skuqë faqen! –
Parayllja – Pra, me mua s'të ka hije! –
Trimi, trupnë ende pa vdekur
e kap, e flak nga dritarja.
Radavani – Po shkoj! Këtu më s'ka gjë
të të trembë. Gjakun fshije! –
Parayllja – Që sot unë s'kam më nder

në mes të gjirisë sate!
Këtë unë e parandjeja..
Andaj faj bëra që dhashë
besën edhe për të ardhmen.
Tashti shko! –
Radavani – Ti mos më nëm,
se veç teje njeri s'kam.
Merrëm dorën edhe besën
e martesës së gjithmonët.
Tashti ika e dhomën mbylle! –
Duke ndier zhurmë fjalësh,
që te kopshti poshtë ushtonin,
dhe si pa edhe dëgjoi
ndaj shtëpisë njerëz, erdhi
i ati lart e shpejt u ngjit,
kaptoi n'odën e përgjakur
dhe gjet mbanë shtratit vashën
në vaj mbytur:
Tata – Kanë skuthe,?)
ti, moj bijë, paske qenë,
sa si bushtër ndillje qentë? –

III

Bujareshat nga zilia
stërkrekosur, për inat
të të dyve, na i shkojnë
si një vllaut qen llatinit,
kur shokët e tij e ngritën
me daulle e titarata

që prapa shtëpisë së priftit.
 Sapo merr vesh Venediku
 dërgoi lajm e jepte urdhër
 që ushtëria të qëndronte
 ndihmëtare e Janinës,
 gjersa Kshilli i Parësisë
 të mësonte të vërtetën.
 Aher vashës prej të shoq
 i erdh urdhër dhe e bindur
 prindit shkretë i del përpara:
Parayllja – Zoti tatë, nga qyteti,
 ku as duan të më shohin,
 le të shkojmë në konakun
 që ne kemi në bashtinë.
 Gjëma q'u bë, si desh zoti,
 dhe në dhomat më pret ecjen,
 pa le që të dukem jashtë... –
 Dhe kështu lanë shtëpitë
 edhe shkurtin e kaluan
 krejt në paqë e të harruar,
 Sikur mos t'ishin të gjallë.
 Por kur pushkët na afruan
 u fol se «kuaj osmanësh
 sërish shkelën tokat tona!»
 Dhe nga fshatrat më të largta
 më këmbë erdhën e kaluar
 trimat dhe prijës kërkuan
 Radavanë e Flakërinjve:
 shqytë e nderit t'Arbërisë!
 Por bujarët na e shtynë
 për të nesërmen kuvendin...
 Trimi, nd'udhë mbetur shkretë,
 priti vashën Parayllje,

se i pat dërguar fjalë.
Edhe ajo e bindur vinte
mes për mes dhenve e qeve,
që po rridhnin ngatërrimthi:
Radavani – Hej! Po ikni, o
t'arbëreshë? –

Me kësulatë në dorë,
Katundarët iu përgjegjën:
Katundarët – Jo, zot! Sapo të strehojmë
grigjët dhe të ngjeshim armët,
dhe na ke pas, ku të duash! –
Kështu folën me një gojë;
edhe trimat armëngjeshur
dolën përjashta qytetit
dhe u mblodhën ku ish prijsi,
që shkëlqente prej çelikut.
Ky hip kalit dhe u nisën
tok me qerret prapa tyre.
Me nxit, si mundën, u nisën.
Dhe një t'enjte keq përleshen
në një prrua me osmanët.
Kur ra mbrëmja, gjithë fshatrat,
me kambanat bubullimë
me hare i presin trimat,
tok me prenë e fushës luftës.
Breg më breg gjer në Janinë
ndizen zjarret lajmëtare
të fitores; edhe natën
me valle dhe këngë e gdhinë.
Zonja Thanë që mëngjes
thirri t'urtin kushëri:
Thana – Shko m'i thuaj *Radavanit*

se e ëma i çon të fala,
 dhe se kshilli i Venedikut
 na kish thënë «iu bë mirë
 atij që desh të bën dhunë
 në shtëpi t'Arbrit mikpritës».
 Gjer të martën presim krushkun
 Arianit, që të shikojë
 ku e bija e madhe e tij
 ka për të kaluar jetën
 posi nuse e tim birit.
 Pra, e pres të vijë, i thuaj. –
 Erdh të hënën Arianiti –
 nga Kotorri. Dhe Janinës
 u përhap lajmi i martesës,
 gjer në shtëpinë e priftit.
 Të mërkurë mbrëma erdhi
 ushtëria e me dauille
 mbuloi udhët. Edhe vallja
 në pallat dritarehapët
 të Flakërinjve uroi
 si qytetin edhe mëmën
 që të ketë fat martesë.
 Që nga dhoma e saj kundruall
 vasha ndez qirinë e pret
 lajmëtaren Sinforozë,
 së cilës i tha sa erdhi:
Parayllja – A e pe gjëkundi trimin –
Sinforoza – Unë atë fare s'e pashë
 Mbase ishte me të vjehrrin,
 me gjirinjtë e krushqit brenda. –
 Vonë heshti zhurmërima.
 Edhe vasha përkundruall
 shoi qirinë e ra për gjumë.

Kur u zgjua, fjala e saj
 ish e lehtë e shumë e rënë .
 Duhej t'ishin aq të lehta
 gjithnjë dhe në çdo vend fjalët
 e gjith' njerëzve, që përjetshëm
 nuk ushtojnë e as u gjegjen
 veçse fjalve të përvdekshme,
 që së bashku koha i shuan... „
 Si tha meshën i ati mblidhet
 plot me helm e turbullim,
 Pranë pragut gjet të bijën,
 edhe brenda na e thirri:
 Tata: Parayllje, më shkatrrove
 një shtëpi të mirësh shumë.
 Ligjëtari burgjehapët⁸⁾
 të kënaqë Venedikun,
 që një vrasës shfajësoj,
 ty t'hedh fajin, se «tërhoqe
 një të huaj në kurth » thonë. –
 Tha e shkoi në dnesë i mbytur.
 Ajo me një dorë e tjetrën
 me ç'fuqi pat godit kryet.
 Parayllja – Faji i shpirtit të sat bije
 është që t'huaj ia ndotën
 hirin q'i pat falur zoti!
 Dhe tashti, e zeza unë,
 dhe ty shpirt, shoku im i mirë,
 po të lë përgjithmonë! –
 Pranë e deshi shërbestaren,
 që s'di ku ia çoi i ati. ,

Dhe për drekë në tryezë
sa u ul, se gjë nuk hëngri.
Kur i ati shkoi në shtrat
dhe u shtri, vasha lotçurgë
n'heshtje, nasqiris, andron
t'et këmishë, raso e tirq.
Shikon grurët, vajtë e pulat,
që i mblodhi në furrik.
Del sërishmi në dritare:
askush s'e pa nga pallati,
q'edhe n'ëndërr tash i mbyllej.
Askush s'i tha që s'qe kthyer
me ushtrinë trimi i besës!
(Edhe fajet ndër ne bëhen,
më të shumët, nga mosditja).
Vajza e lojtur mendsh, në mbrëmje
merr një gjishtëz helm e zbret
n'atë kopsht sikur të zbriste
prehrit të rinis' së saj.
Ndenji pak ku aq mëngjese
ajo ndillte zogjtë e qiellit,
edhe sytë iu gozhduan
qiellit qartë e të përjetshëm,
që për të (si asgjë) do shuhej.
Era shtynte për nga lindja
re të bardha. E ato hasnin
yjet brazdës perëndimit,
skenë shfaqje, që s'kuptonte
se po mirr fund jeta e saj;
dh' ajo ngrihet edhe thotë:
Parayllja – Jemi t'hua, yj të largëm.
Atje ku isha përpara

se të njihesha me ju,
sërish kthehem që të prehem! –
Edhe helmënë e shkretë e piu!
Andej, si e ndarë botet,
të gjen t'atin ajo shkoi,
t'i kërkonte atij uratën.
Por nga dritaret e hapta
hynte nata e lagështitur
dhe pendimi e pushtoi,
se s'do kishte më kush plakut
t'ia mbyll derën zjarr t'i ndizte,
darkë e drekë ti gatiste!...
Parayllja – Bubu! Ende e përgjithmonë
bota me gjithë sa lindin
është e mirë, e veten nëma
sapo zonjë, po desha e bëra! –
Helmi zorrësh e trondit,
dh' u rrëqeth, edhe shpejtoi
të gjen t'atin tek po hante
bukën me diçka të mjerë
në tryezë ndaj qiririt.
Parayllja – Ler tryezën dhe sat bije
i dëgjo sonte rrëfimin:
më shkoi keq, e unë vetveten
e helmova, vetë e vrava! –
Tata – Ah Skëtterra na pret poshtë!
Parayllja – Mos më tremb, o zoti tatë,
por më mbaj në gjirin tënd,
se ende besën s'e humba.
Me njeri nuk të fëjeva,
as me nderin tim, po e nëma
gjithësinë, sepse dielli

s'ish i atij që besova!
Tashti sa jam gjallë, i truhem! –
Nga pikllimi i plasi zemra.
U ul i ati dhe ndër duar
i ngre kryet bërë dyllë:
Tata – Bijë! Bijë! Folmë prapë!
Parayllje! M'u ngjall prapë,
Zoti Krisht! Bubu! Më shkoi
si një ëndërr! S'është më
bija ime!... Po të ngrohta
faqe e duar ende i kal
Për varr jo, mos ma gatitni,
ta kem pranë edhe nesër!
Se një ëngjëll më pat lindur
grua zeza aqë e ëmbël.
Njeri s'na deshi gjersa
dhe shtëpinë ma shkretuan.
Ja në truall, e pagojë,
ia shoi sytë vetëvetes.
Tashti që s'kam time bijë
s'ka pse të më gdihet dita,
se njeri mua s'më zgjohet.
Tashti që s'më je, ta lë
dhe shtëpinë e zotit tatë
dhe të lyp derë më derë,
nëpër erë e nëpër shi! –
Nga këto thirrje edhe kujet
e shërbestares, na turren
gra gjitone dhe prej trollit
e ngrenë e në shtrat e shtrijnë...

KËNGA E KATËRT

Dhënarë tek milnin ndien
nga një djalë i tufës fqinjë,
q'erdh të merr një kushtinj gjize:¹⁾
Djali – Me dhën ishim te liqeni
rrëzë sopit; dhëntë tremben
dhe nga drizat me vrap varen;
ne të gjithë shpejt u ngritëm
dhe te shkëmbi pam' një hije. –
Dhënarët – A e njohët e kujt ishte? –
Djali – Dyllë e verdhë me sy t'errët
kundrejt t'errëtit qëndronte:
era, që flakte nga çerdhet
zogjtë, i rrëmbente fustanin.
Në liqen poshtë ndën hënë
valët rendnin si të marra.
Me një dorë t'hajthme mbante
shqepzën, me tjetrën tregonte
vendin ku një yll po digjej;
ne na u suall dheu rrotull.
Lalë Ndreu tha «patjetër,
në vend ku është ajo s'ka
asgjë të mirë ta mbajë!» –

Vonoj trimi gjersa shiti
 prenë e luftës q'i takoi
 dhe së mjerës nuse i bleu
 gjithë stolitë e martesës
 për dukatë nëntë mijë.
 Udhës, tek kthehej, pushoi²⁾
 në konope. Dhe fatlindur
 që t'i shfaqej natën n'ëndërr
 ç'do të kishte në gji dita,
 na shikon nj'ëndërr të keqe:
 nga një shpat i tyre i duket
 sikur ndien thirrmen e vashës:
 «Radavan!» e përtej lumit
 ndën ullinj një ujk i madh
 asaj tek kërkonte ndihmë,
 ia vërvit kthetrat në krye.
 Pa dyfek dhe pa hark trimi
 një klithmë tmerrri lëshoi:
 ujku i frikur rresht përroit,
 dh'ajo e qetur ndenji ulur.»
 I tronditur, brof me klithmën,
 që do ta ndiente gjithmonë,³⁾
 ia hipi kalit e fryu.
 Dhe mëngjesin e një dite
 përkundrejt iu shfaq Janina.
 Mb'udhë i dolën dy gomarë
 të dy ngarkuar me thasë,
 q'i ndiq me thupër në dorë
 një nga gratë e vendit lindjes:
 Gruaja – Mirë se vjen, trim bujar!

Por vonë erdhe për të mjerën.
Parayllja helmoi veten.
Edhe kisha atje lart
e pranoi se u rrëfye! –
Kali u hodh mend shtypi gruan:
trimi çau për nga kisha
e shën Përpetës, sot mbyllur.
Në mes shqoi varrë e saj,
sapo lyer me gëlqere,
prej Bathës fletëskalitur¹)
përmbi gurin e mbulesës.
Ngriti gurin e mbulesës.
dhe në mes eshtrash në tretje²)
nëpër lotët e syve tij
shqoi edhe e gjeti vashën...
Radavani: O, moj motër, edhe ti je!
Andej vetëmë kambanat
e meshëve e përmendën;
doli dhe varrin e mbylli.
Q'andej shkoi në beteja
lart në Shkodër. E atje mbeti
ditë e muaj, pa iu ndarë
brenda shpirtit tij të heshtur
një zë, si ta ftonte vdekja.
Pas ca vjetsh qyteti ynë
na kërkoi nga Shkodra ndihëm.
Si të gjithë që vozitin
përmbi det, dhe Radavani
në altar kishe kungohet.
Pasdreke, si mik në Fugajt
e pret Rina e Milosaut,
t'i lij në kujdes të shoqin.

Por s'guxoi t'ia thosh, e n'odë
 e vetmuar, ajo mbyllet,
 dhe me duar të saj s'preku
 ajo as verën, as petkat
 që dërgoi vetë në anije.
 Shkumbë ish deti e atë mbrëmje
 dukej sikur një fuqi
 e lëkundte edhe e përziente,
 kur anijet arbëreshe
 dhe latine na u nisën
 plot me trima q'i prit vdekja.
 Si u nisën, u ndeh nata
 shumë e thellë edhe me gjumë;
 edhe Shkodra ia la rrugët
 si shesh erës, edhe veten
 e harroi dyermyllur.
 Vetëm, ndezur n'odë gjumi
 të së bijës Kallogresë
 ndriste një qiri si fjalë.
 Mbi dallgët plot peshq, anijet
 shkitnin se u shtynte velat
 erë qytetesh të bregut.
 Trimi fjet pak atë natë;
 pastaj dielli ra nd'anije
 dhe ia ngrohu e i rëndoi kryet,
 në një kënd e zuri gjumi.
 Veriu i egër frynte
 përmbi një kotruve uji,
 (q'ishte lënë për t'u bujtur⁶)
 pranë vendit ku ai prehej),
 dhe i përkëdhelte veshët
 si gjësim i largët malesh,

dh'i ngjante se jetë e qetë
ditësh fatlume e priste,
ku veriu i egër shkonte,
posi psherëtimë e dheut
përmbi arat që u korrnin.
Dhe i dukej se po zgjohej
n'hije dafina të detit
ku pështeste kurmnë e lodhur:
por e sheh veten ndën velat
e anijes dhe rreth detin,
që larg bëhej njësh me retë;
e kish pranë Paraylljen
që një shportë rrush të bardhë
i kish sjellë e bashkë e hanin.
Na u zgjua kur sytë i shquan
zallin nga ish varri i saj...?)

III

Anijet që larg i shquam:
nga shtëpitë lutnim valët
që si male fryheshin
dhe anijet shtynin mbrapa,
që të lagnin qiejtë e largët.
Po vetëm kur u mbush java
retë u hapnë e era ra
edhe kreshpëroret fusha
të detit u kaltëruan,
dhe n'anijet velat ndritën,
duke rrjedhur pika uji
përmbi ninull të suvalës.

Aher nga fortesa e zalli
shkrep e gjëmon osmanllia.
dhe pastaj në përleshje
gjithë natën. Dhe u gdhimë
zotër të shtëpive tona...
Këtu për të tretën herë
ra kambana e mesit natës.
Mesha niste e Serafina
pështjell letrat ku kish shkruar
poemën që u lëçiti
të vjehrrit e njerzve tjerë
atë natë pranë zjarrit
dhe shkoi brenda të stolisej;
gjithë u ngritnë e vatrën lanë.

KËNGA E PESTË

Zadrimë, dhjetor 1446

Si sos mesha e mesnatës,
u hap dera e në mes tingujsh
surlësh, fyejsh njerzit dalin
sipas qejfit jashtë kishet.
Çdo burrë me gruan shihej
me pishtar ndezur në dorë,
duke shkuar në shtëpi
për t'i shtuar gazin ditës,
që me ëndje e pret çdo vatër.
Dhe bijë e Gurës e shkreta,
me një vel zije mbi krye,
me foshnjën në krahë doli
mëndjeturbull si e mpirë
dhe trokiti në pallat ,
të së resë së Dukagjinit.
lu hap porta e e mjera hyri
edhe m'i afrohet zjarrit
pranë shërbestareve.
Vetë vashëza Margjelë
dha çelsat t'i ndreqin shtratin
edhe t'i jepnin mbulesat,
sepse e ndiente q'edhe ndihma

zbut mjerimnë; e e bija e Gurës,
pa një fjalë, shkoi të prehej.
Pas pak mblidhen të shtëpisë
rreth e rreth buzmit të vatrës
që të ngrohen dhe një herë
përpara gjumit të dytë.
Niku pyeti Serafinën:
Niku – Ty të njihte vasha e mjerë
që kish foshnjën? E kujt është?
Serafina – E kryebariut tonë.
Ishte shumë e hijshme, e urtë;
e të gjithë e donin shumë.
Po shejtani ia nxiu faqen
sapo mbush të tetëmbëdhjetat.
Lojtur mendsh pas modës huaj,
që pat sjellë zoti Todër,
kur erdh nga qyteti i huaj
e tek ne mik qe kondisur,
u kandis e atij iu dha.
Ditën e martesës sonë
asaj që nga maja e shkëmbit
ati i shkretë iu gremis,
dhe pa ndihmë ai dha shpirt
dhe njeri s'e mori vesh.
E, si duket, q'atëherë
për fatzezën nuk mbet tjetër
veçse ai bir bujari.
Niku – Që na fle i qetë sonte
pa përfillur zot e botë!
Leka, vllau i vogël, shtoi:
Leka, – Ndaj, për nder të zotris' sate
dhe Margjela e mëshiroi... –

Plaku i ndershëm, Pali, vrehet:
Pali – Me të tillë bishtra prapa,
si guxoi e erdh ndër ne? –
Serafina – Zoti tatë, atij ende
vajza nuk i është shfaqur.
Sa të gdhihet unë vajzën
e gatit edhe e nis.

II

Kur u gdhi e ra mëngjesi,
vasha Margjelë tek flinte,
nga të lehurat e qenve
u trondit, e kryerëndë
e la shtratin. Dhe nga dhoma
sheh kundrejt se po largohej
zoti Todër pa një shok.
Veç e veç shkonin dhe vllëzrit,
nusja, e shoqja e më të madhit,
etur që të shihte gjahun
lart në malin e përborëm.
Si arritën në mesditë
një pallat q'ish në mes bredhash,
ndezën zjarr me ashëra.
Dhe me të ngrëna e të pira
shkoi e kremtja tok me joshjet
që kurdo njerzve u bën.
Në Danjë e ëma kur pa
që zot Todri nuk u kthye
tok me lajmësin në kohë,

ajo krushqve të së bijës
më s'ua zgjati edhe të kremten
bën martesën e thrret gjithë
ç'kishte vartës ta nderojnë.

E që nesrej në koçi
lotët ter Gavriila e niset
pa gjëri' (se as kish mbi dhe).

Në Prevezë, tok me trimin
që i ati, kur ish gjallë,

e fejoi, ajo shkonte
çerezbehtë, sepse brengat

i vallzonin para syve,

teksa qyteti rreth saj

e pranë krushqve kalorës

valle hidhte dhe e uronte.

Vallja – Mos na rri, zonjë mejtuar,

sikur fluturon kët' orë,

se krejt qyteti t'urojnë!

Po ato këngë, q'u bie

në qembal, o moj gjishtbardhë.

aq trishtuar, sa na duken

si nj'ushtimë helmi zemret,

brengëplasur dhe në mes

të një jete të begatë,

ato këngë leri prapa,

që shtëpitë ku ti shkon

të mos mbushen me trishtim. –

Vallja poshtë e larg qytetit

u ndal dhe gjithë më këmbë

e përsëndetin gjersa zhduket.


Por ushtima edhe më tutje

e përcolli mal më mal

vashën mejtimepërlotme.
Po atë mëngjes plot akull,
Todri, i vllau, pranë Drinit
ku kish pritën zemërdridhur
ndien në ças zhurmë nga dushqet
dhe ndaj tij po m'i vërvitet
derri i egër gojëjargë,
nga langonjtë i përndjekur.
Djali del nga prita e shtigje,
shokët pa i vënë re:
ia këput boshtnë e kurrizit
edhe bisha u përplas
me feçkën thellë në borë.
Por që larg një klithmë ndjeu:
Leka – As bir arbëreshi s'linte,
dhe as bir i një bujari,
ti, që kujt të ndeji dorën
i merr krahun dhe pëgën
shtëpin mike! –

E një shigjetë
iu ngul barkut. Todri e shkuli
porse mendtë na i merren,
dhe përgjunjet përmbi borë
duke thirrë:
Todri – Kjo nuk është
trimëri! Edhe të mbarë
as shtëpisë sate, as simes,
s'do t'i sjellë. Por paske fat
sepse larg tashti më ndodhe.
Edhe vlla e bir nuk kam
që një fytyrë si imja
të ta zbehë jetën ty!... –

Ikën vrasësit. Dhe bora,¹⁾
tok me diellin q'heshte qiellit,
si dy shokë vetmitarë,
n'ato çaste të llahtarshme,
pranë trimit i qëndruan.



KËNGA E SERAFINËS LEHONË

A·bri i veriut, shkurt 1450

«Qelqe të përflakur diellit
mbyllnin gjithë dritësoret,
ku na rri pas lehonisë,
nusja, zonjë e Dukagjinit.
E kënaqur vëren delet
si po kthehen për te qëngjat,
q'u ndrit malli si yll drite,
ndonëse në mjegull veshur.
Mëmat dele sot s'kullojnë
në mes lulesh ngjyrëshumta,
ku në verë na lëshohen
edhe zogj që të mahnitin,
por të thatat fletë shkulën,
lagështitur ndën borë.
Hoqën, ç'hoqën, tash me gaz
po na kthehen plot me qumësht
që u ndjell gjumin fëmijve.
Po ngroh dielli dimëror,
dhe asaj zonje përmbi gjunjë
djalthi i thith të puthurat,
që asaj aq ia ka ënda,
ënda e gjinjve qumështkrua,
që krejt kurmin ia këndell

dhe që m'ia rrit djalëthin
për t'i folë asaj më shpejt.
E ëma e këtij djalthi
e ka shtëpinë ku lindi
shumë larg, (si t'ish e vdekur!);
«ka të zotin larg në Napol
me syzeza rreth druezash.
Edhe propë e ëma e djalit,
mendjen t'errët si dhe muzgu,
që çdo gjë e vesh në t'errët,
po mban djalëthin dhe e do.
Ajo mes këtyre malesh,
ku s'erdh për të ndezur vallet
por të ndiejë laureshën,
me shqep gërshetat mbuluar,
sheh, e ulur prapa qelqesh,
si agimet e pruar,
lart përmbi andrallat tona,
djalthit saj shtroje t'ia bëjë!
Dhe kur na lindi ky djalthë,
në të gjerin rreth të bardhë,
hëna nëpër qiell të mjegullt
ngadal ecte, si e ftuar.
Djalthi i saj, i athët lindi:
idhull për vasha bujarësh
edhe për armiqtë tmerr!
(Ksaj s'ë reje ndjenjëmadhe
kurmi i tretej para agimit.
Nga ëmzonjat që i mbanin
rreth hyllnarët, dhe dritsoren
njera e hapi e shikoi jashtë:!)
Serafina - Ç'kohë është? -

Ëmzonja – U tret hënal
 Serafina – Mua fryma do më tretet
 kur për ju do gdhiet dita. –
 Ëmzonjat gjithë u përloitën.
 Jashtë qentë lehjegjëmë,
 sulur ndaj përroit thellë,
 pas bishës që frynte yshkash,²⁾
 tek gështenjat ndalnin lehjet
 edhe thirrma e njeriut
 përndante datën në t'errët.
 Butë-butë binte shiu,
 dhe një dele e shkretë e lagur
 blegërinte e ngiste vq̄hit,
 mbante vesh, prap' blegërinte.
 Vajmedet! Në gojë t'ujkut
 gjendej biri i saj pa ndihmë!
 Kaq e deshë mëma djalthin,
 sa u mbyll në fat të saj,
 jashtë s'doli e prehje gjeti
 për vetvete n'atë d̄jep.
 E ëma e këtij djalthi;
 e shëruar, e përvashur,³⁾
 me Tëmijën, që krejt njerzit
 tok me dhomat e pallatit,
 i habit; e mezi pret
 që nga Napoli të atin
 dhe këto fjalë t'i thotë:
 «Merre, o at' i tij, dhe puthma.
 se qëndroi net pa puthje
 dhe ia zuri gjumi s'ëmës.»

KËNGA E PARË

Krujë, 26 prill 1451

Ish mesditë edhe vallja
të hareshme e pa kujdesje,
si t'ish gjallë koha e pleqve,
e gjet shtëpinë krenare
të Gjonit të Kastriotve.
Mbi fron të pruar rrinte
nusja, e bija e Arianitit,
shqepzëngritur përmbi ballë
nga shkrepnin kejza e gërshetat.
Zonja e bujarisë s'Arbrit
kryelartë e ndiente veten
tek kujtonte se kish burrë
prijsin e kalorësve.
Pastaj tok, zotrinj e zonja,
kushdi me ç'ide të larta,
shkojnë në të ndritshmen sallë
në tri anët veshur n'ar.
Si prej pllakash të kristalta
stisur ishte ana e jugut
dhe përpara se të gdhihej
si në pasqyrë jip hënën
dhe ndonj' yll në qiell kundruall.
Edhe nëpërmes hardhive,

e nëpërmes kallmeve,
që përjashta ushqen toka
dh'u përkundte xhufkat era
e që përkëdhelnin qelqet,
ngjante sikur vetë qielli
që nga ana e kthjellët, shihte
brenda muresh sesi njerzit
mbronin jetën mos u shkrihej
edhe përmjet qelqesh t'hajthëm.
Pasi për nder gjithë i sillen
rreth lartarit të martesës,
q'andej shkuan rreth druezash.
Cilado nga bujareshat,
sipas qytetit nga vinte
dhe besimit saj në shpirt,
dritë të ndryshme lëshonte.
Ato bashkë kuvendonin:
çdo e thënë e tyre ishte
ushëtimë e mprehtë e ditës...
Pasi mbaroi dreka, heshtën
dhe me fëmijë në gjunjë
ato katër djem dëgjonin,
që ia merrnin dhe ia pritnin
një këngë, në ças të ngritur
nga fjalëflakti Shan̄tor.
Q'andej shkonin ku buçitnin
anëmbanë tinguj joshës
për në vallzimet plot ëndje
Në rreth trimat na u ngritën
edhe vashat gjithë turp,
që muzika ushëtimë
harmonie të përjetshme,

i pat zgjuar, iu përgjegjë,
si një ritmi të pasosje,
po me hapat e valltarve,
që si zotërit e dheut,
gjithë shtrollin e mbulonin.¹⁾
Zonja Serafinë e zbardhur
prej borës së Dukagjinit,
në mes shoqesh, me të motrën
e Radavanit po fliste.

Kur, si për diçka t'harruar,
sytë kthen e sheh se rrugë
një zotit t'Artës i bënin:
«Kush ka më hije nga ti,
që të fshihesh?» ai i tha
e i jep dorën, dhe në mesin
q'ishte i zbrazët, e tërhoqi
për vallzim, e atje Bozdarin
ia njeñ. Edhe trimi zbehet
i kënaqur e ajo shkitaz
e shikoi e dalngadalë,
si e mpirë, u tund, e trimi
u gëzua se shorti e solli
që ta kish në krah një herë.
Tinguj nxjerr njësoj kitara
dhe si era e detit pishat
në rresht zallit i përkund,
dhe si murmurimë e valës
gjirash peshqit nanurit,
ashtu rreth e rreth ushtonte
shtroll' i zemrave të tyre,
(pa mos zgjuar ata tinguj
ndënë dhe trimat dhe vashat

që dikur për valle i nxitnin!),
Kur lart shumë iu ngjit dallga,
u tërhoq te zalli vasha
dhe me syt mbi cohën-valë
ia qetonte rrahjet zemrës,
edhe prehej. E pastaj
një tok trimash na përfshinë
nuse e vashëza të tjera
n'atë dallgë vallëzimi,
që, eh, jetën na rrëmben
dhe na heq nga çdo andrallë.
Në kësish mejtime zhytur,
gra fytyrëprera hyjnë
që nga dera e thrasin: «Zonjë,
ngrehu, në e do tët shoq,
se po vriten!» Zonja Finë
brof më këmbë edhe ndjek gratë
gjer në dhomën e lartarit
të martesës, ku dy trima,
Nik edhe Bozdar përballen,
kordhët tehmprehta ndër duar...
Por në çast e ëma e prijsit,
vetë zonja Voisavë,
me duar të saj dy tehat
e kordhëve t'tyre mbajti;
dhëndri, i biri, Skënderbeu,
në mes heshtjes plot nderim,
bën përpara edhe f'hotë:
Skënderbeu – Në mes begatis' së huaj
isha. Dhe fatin e mirë,
e shkelmova, që atdheut

të pafat, t'i jap një shtet,
si të gjithë e kanë. Shoqe,
si prej qiellit e dërguar,
m'u duk ora që më solli
në shtëpi. Por më gënjeu!
Zotër të shtëpive tyre,
bijt' e kombit tonë sot
njeri-tjetrin po hanë.
Si simbol për fatin tonë
le të jenë këto fjalë,
q'i pat thënë një martir:
«T'huajt' na shqyejnë, e zorrët
qentë e vendit na i hanë!»...
Serafina shpejt të shoqin
e rrëmben përkrahu e i thotë:
Serafina – Mbi ne fajin do ta hedhin!
Ne në jugë na përçmojnë
posi malësorë t'egër.
Edhe neve ata na duken
si gjarprinj e jo si vllazër
të një gjaku e të një gjuhe,
që kur ritin e tynzoti
e përfaqësojnë priftër
të Stambollit e të Romës,

armiq t'egër në mes tyre,
q'edhe neve na përçajnë:
këndeje gegë e andej toskë...
Shkojmë, Nik, në shtëpi tonë.
që mos të helmojmë më
prijsin e kalorësve
në pallat ku i jemi miq! –

Lanë dasmën. Dhe me ta
n'heshtje nisen dhe shqytarët
përmbi kuaj. E asnjë s'thoshte
çfarë bluante në tru.

KËNGA E DYTË

Arbri i veriut, 1451

Kur mbi male, asaj jave
ndrit yllsia e Parëmendës,
Niku, zonja dhe shqytarët
në një shesh me lisa dolën;
por ca hije përreth presin
dhe sllavisht njëri urdhron:
«E shtëmëngni anash zonjën!»
Edhe një me një u sulën.
Si shkretimë Dukagjini
iu përgjegj me pallë urdhrit
të atij prijësi të huaj.
Si ia çau më dysh kafkën,
krahatorë e bark e eshtra,
njëra pjesë e kurm-kufomës
te një shok, me dorë, u kap,
kurse tjetra ra prej kalit.
Shoku, i kapur prej kufomës.
klithmërendë atë e ndoqi
dhe me të ndënë patkonj,
u përmbys, e atje pa ndihmë
mbet, se shokët krisnë e ikën.
Andej Niku, si i dehur,
tru e trup në valë e dallgë,

tok me zonzjën e shastisur
dhe shqytarët vazhdoi t'ecë,
gjersa ndriti dhe gjet rrugën.
Kur te lumi i Madhit dolën,
në një kodër me gështenja,
shërbestarë atyre u hapin
me nderim një pallat t'errët,
(dikur pronë e zotit Danjës).
Disa na shtruan druezën,
disa lajm çuan Zadrinë.
Pastaj në nj'odë ndaj diellit
zonjës Finë aq të lodhur
shtratin seç ia shkrifëtuan,
ku ra butë e e zuri gjumi.
Por i shoqi, i shtrirë veçmas
n'ish-pallatnë e zotit Todër,
(shok e fis, që vetë e vranë
edhe bashtinat ia morën),
hapte sytë odave t'shkreta
dhe shih jashtë, sikur t'ishin
gjithë dritësoret hapur
e të shkretë e shih dhe Arbërin.
Atë mbrëmje zoti Nik,
ashtu si herën e parë,
tok me gjithë të shtëpisë,
ndjeu shumë thellë brengën
për krimin që kreu Leka,
i vëllau, dhe sy nuk mbylli.
Pasi u gdhi, ai vuri re,
zbuluar nga rreze dielli,
një pikzore lart mbi shtrat
q'e pat lënë Gjakoviti.

«Te një fushë e pakufishme,
sipër një liqeni t'pastër
fluturonin zogj; mbi bar
në koçi të madhërishe
dhe me kuaj qimebardhë,
ish zonjza Gavrillë e Todri.
Dhe Gjakoviti më këmbë,
vashës, si t'ish bijë qielli,
tufë lulësh i dhuronte:
vasha, fletë n'erë jete,
e vërente me ca sy
ku dalloje një mejtim
krejt të vagulltë e pasosje».
Dukagjini brengërendë
i vërejti e para i dotën
gjallë, të rinj e të bukur,
aq të dliirë e pa djallzi
te kjo botë, ku edhe Niku
kishte bij, e kish mëkate.
Edhe me një lëmsh në gji
urdhër dha e shpejtoi nisjen.

KËNGA E TRETË

Artë, dimër 1468

Me dy qen korbecë stani
mbanë, lart te maja e malit,
mbi një shkëmb Bozdari i Shtresit
u ndal që hapësirës qiellit
mendtë e tij t'i davariste.
Po edhe ajo s'e lehtësoi,
dhe sërishmi ai përmblihet
në vetvete dallgë e brengë:
Gjatë natës që kish shkuar
Olimpia e Topiajve,
që në zemër t'atij trimi
vendin e së kushërirës
kishte zënë, paskej pranuar,
(si nuk ka hije për zonja),
që t'i hapte atij shtëpinë,
ku s'qe i ati e fshehtas mëmës,
pa kurorë na e kish pritur
shtratit shkrifët n'errësirë.
E kish, ku ta di sa javë
që të vllzërit e vegjël,
tepër të butë, të motrën
e shikonin në tryezë,
me gërshetë t'artë mpleksur
në një jetullzë të bardhë
përmbi zverk të bardhë borë.

Vllezërit nuk ia dinin plagën
 fshehur n'atë gji të njomë,
 plagën që ndoq nga shtëpia
 hijet plot nder të të parëve!
 Trimin nga mali dhe shiu
 na e ndoqi për qytet:
 shpejt shkrepëtiten, bubullitën
 mali e deti dhe nuk dukej
 n'ishin fjetur apo zgjuar
 njerzit brenda në shtëpitë.
 Në pallat të Shtresajve,
 me një vel flakrimë arit
 përmbi shkrepëtim të syve,
 motra, zonjë Artemisia,
 nga qytet i të shoq' ardhur
 s'kish tri ditë e n'odë vllaut
 me foshnjën e saj në krahë
 na i çoi kandilerin.
 Arta — Ma mbaj pak; shih sa i bukur!
 Puthëm, bir, o mjalti i mëmës!
 Zemra ime! O im vlla,
 ma shiko dhe m'u gëzo!...
 Të gjithë në qytet thonë:
 «Leu si rrezja që s'sheh veten,
 por të gjithë i hijeshon». —
 Dhe buzëqeshur në duar
 ia ve djalthin dhe pështeti
 mbi druezë kandilerin;
 e në dhoma shkoi të mbyllte
 dritësoret, që mos hynte
 brenda lagështira e natës.

Jashtë përmatanë rrugës
dritësoret ende hapët
kish pallati i zot Mënikut.
Që nga brenda nëpër qelqe
shquhej shqota vrundullimë.
Në parmak ndaj kandilerit,
nga jashtë Olimpia dukej
tek qëndiste edhe këndonte
lehtë një këngë trishtimi.
Sapo e pa motra e Bozdarit
me vetvete thotë e turbull:
«Ajo farë mbase është
që po na merr ne më qafë!»
Dhe kanatat plas me zhurmë.
Dhe ajo q'erdhi gjithë gaz
n'ato dhoma, ik plot helm
dhe te vllau harroi djalthin
që këndellej për gji mëme
aqë sa po e mbyste dnesa
Bozdari mbanë shpërvjerrses
vren një pikzore dhe preket
edhe thotë: «Ah, zonja mëmë!»
Psherëtin thellë e përlotet
Ashtu e gjen shërbestarja
kur erdh edhe i mori djalthin.
Dhe drueza shtrohet vonë;
dhe vetë ora e zezë qellej.
Edhe vetë shiu dukej,
me gjithë atë zhurmërimë,
si të donte të fshih gjëmën.
Në duezë ndenj Bozdari
sikur t'ish në rreth të huaj,

dh'u mblodh shpejt në shtrat e priti
në pallat heshtja të binte:
edhe aherë ia la dhomën
vetëm dritës kandilerit
Hapi portën e oborrit:
prapa e shtynte era e jashtme,
edhe mishrat ia përgjethte.
Shkrepëtinte, e shiu det
që me bubullimë derdhej
pellgje-pellgje e kthente tokën,
Era e errët e oborrit
sillej rrotull e ogurzezë
i pëshpëriste: «Trim, mos shko!»
Po zemra fodulle i thotë:
«Të rri unë pa gëzuar
parajsën që po më hap
pallati i saj, se me shtëmba
po na rënka sonte shiu?»
Dhe në pellgun ku vallzonin
retë flakë, u fut. Nga kisha
ndjeu tingujt e kabanës,
si zë njerëzish që kërkonin
të reshtej shiu, se shkrinin
qeramidhet jetëmbrojtse.
Shiu që binte me shtëmba
shpejt dha gjegjien n'errësirë
kur me bubullimë krisi
dhe me krahë i shqeu retë
shkatrrimtarja vetëtimë,
aq sa shtreteve tronditen
në shtëpi të gjithë njerzit.
Olimpisë nga gishtrinjte.

mbi qëndismë i shket gjilpëra.
Vasha e trembur pushton vekun
e te xhami i shkon gërsheta:
errësirë ngado shihte!
Pastaj shkoi te pasqyra,
dyllë e zbehtë e vështrimegër:
vërejt veten dhe s'e njohu!
Dy lot iu derdhën vetiut,
s'di nga çfarë i ziente brenda;
i fshiu, po sërish i rridhnin.
Por ja, si nga dorë e jashtme,
hapen xhamet, edhe me erën
ndihen ulërime grash
dhe të përpjekme kanatash
nga pailati i Shtresajve
Nga zhumhuri i turmës n'ankth,
që zu poshtë gjithë rrugën
me të qara e pikëllima,
mori vesh që kishte vdekur
trimi, dielli i zemrës saj,
Një demon i ngul në tru
aty për aty mejtimin
se ajo vetëm ia trashëgonte
farën e trimit sapovdekur,¹⁾
që në bark mund t'ia kish lënë,
dhe e çmendur nis të zbresë,
po Bozdari iu shfaq si hije.
Bozdari — Olimpi, shpejt më jep dorën
dhe t'ikim se na fsheh shqota.
Ndieja se ti ndote vatrën,
unë besën, (andaj fajin
natës sontme shtrenjt' ia lava).

Kjo neve s'do na ndahet
asnjëherë dhe në strehën
aq të largët, që nuk njohim! –
Ajo ndaj trimit u ndeh,
po nuk kap as dorë, as krahë,
ku mundohej të pështetej,
dhe në trup i mpikset gjaku,
e përplaset brenda dhomës
q'asaj iu err e iu shua...

KËNGA E KATËRT

Artë, 1468

Na kish dalë zonja Emirë
te dera t'ia bën syth krahësh
shqepzën nuses së sëmurë,
që me borë e shqotë nisej,
se, si thoshin, do shërohej
n'erën ku ajo kish lindur.

Emira – Më helmolve, o bijë, zemrën,
që me kaq ngut po merr udhë
me një mot të vrerët pus. –

Serafina – Mos u druaj mëmë, zonja,
se sërish do të shërohem
n'erë e diell; edhe shpejt
do të kthehem me Hektorin,
të kënaqesh kur ta shohësh
duke u endur nëpër dhoma;
mbase dhe im zot do kthehet
gjer aherë e të gëzojmë. –

Emira – Vafsh shëndoshë! Po zemra o bijë,
ja m'u fishk, e s'di ç'po them,
ja se qielli po na nxihet,
që çdo gjë mua më ngjan
se nuk ndjell orë të bardhë.
Ka një vit që shkoi e ndjera

*
 mëmë zonja e joteja
 dhe sot nusen pa të fala
 në shtëpi të saj e çoj! –
 Serafina – Për ne gjithë, o mëmë zonjë,
 nga çdo anë që ta marrim,
 bota e parë shkoi e vate! –
 Kështu tha, por sa përmendi
 atë botë i rrodhën lotët,
 sa ia lagën krifën kalit
 me t'i hipur. Edhe u ndanë...
 Kur qe pranë Artës, një natë
 n'ëndërr pa, sikur tek ngjitej
 në shtëpi, nuk shih pullazin;
 dielli rrihte nga lart shtrollet
 e mbi muret mjeshtra e gra;
 dhe e ndjera mëmë e saj
 tek u thoshte atyre grave;
 «Ju, kur punoni me gurët,
 vasha të hijshme, këndonin,
 sepse kënga largon brengët
 që nga shpirti, i rriten krahët
 djalëthit të sime bije.»
 Serafina u zgjua me drithmë
 e desh të pushton të birthin,
 Serafina – Hektor, birth, m'i hap ti sythit! –
 Dhe e vëren e e puth me lot,
 Në mesditë arritën n'Artë.
 Duarngrohët, krahorlodhët,
 shkallëve shtëpis' së saj,
 Serafina na pushtoi
 vashën, bijën e Spanoit,
 mollë të freskët të vjeshtës.

Kontyllja – Oh, sesa luta Tanushin
 të më njih me ty, moj motër! –
Serafina – Që jam bijë e po i lë jetës
 lamtumirën, moj Kontyllje! –
Kontyllja – Lohja e shqota të ligshuan;
 po këtu do të përtrihesh! –
Serafina – Hektor, ç'ke? O moj Mili,
 qasja gjirit, mos zë sisën! –
Milia – E ka ngarë rrugës ethja.
Serafina – Ka mjaft kohë q'e nget ethja,
 E kisha ndër duar kur
 nga beteja patën sjellë
 flamur' e t'et dhe nga krahët
 më rrëshqiti. Dhe në çaste
 pavetdije, si nga fundi
 i vetvetes, nj'hije nate
 mbi fytyrë i zbret, e err...
Hektor, birth! –
Milia – Sikur po dridhet,
 zonjë, veç nëj gllënjë thithi. –
Serafina – Ah, u ktheva të më shuhet
 drita këtu ku m'u çel:
 ndaj m'u shfaq në ëndërr te pragu
 hieja e zonjës mëmë. –
Kontyllja – Ti pas ëndrrash po vret veten,
 motra ime. Në djep vinie
 dhe pamundjen që ndien sot,
 me të ligat ia merr gjumi. –
Serafina – Hektor! –
Milia – Ja, i mbylli sythit;
 po e zë vetë gjumi i lehtë.
 Mos mbyt veten, zonja ime! –

Dhe të bukurthin, të bardhin
djalthë në djep e mbuluan.
Pastaj radhë qytetarësh
erdhën ta përshëndetnin zonjën,
gjersa dielli perëndoi,
edhe dritat gjithë u ndezën.
Nga gjitonet e rrethuar,
ajo priti ballëdhëmbur
natën, që të mbetej vetëm.
Por gjitonet nuk lëviznin:
se njëra duaj të dinte
qysh i rrokullisej jeta;
tjetra t'i ndiente të folët,
aq lavduar në shtëpitë;
e ato s'kujtonin lodhjen
e sëmundjen që e grinte,
andaj hynë e dolën radhë.
Vonë heshtja ra dhe nata
gjurmët brengëve ua fshehu,
por për t'ikur, ato s'ikën.
Ditën tjetër Serafinës
me të birin e paethe,
në shtëpinë e prindërve,
strehë e shenjtë, prapë i shkrep
kthjelltësia e përparme,
faqet iu trandafiluan.

II

U gdhi dita e Shëndëkryqes,
dhe mejtimi që në gji

ajo ruante, na e nxiti
edhe drejt në kishë shkoi.
Sa hyri, gjithë e vërenin
e sytë i vajtën te vendi
ku dikur shihte Bozdarin;
por s'e pa. Trimi kish vdekur,
dhe ndën hije osmanësh, kurmi
s'ndihej poshtë rrasës varrit,
nga, si pjesëz e pasosjes,
sytë më ai s'mund t'i hidhte...
Fina si e ngushëlluar,
në pallat e qetë kthehet.
Edhe niset që ti shohë
përsëri shtëpitë.

Serafina – Ndihem

sikur jam përsëri vashë
në këto shtëpi ndaj detit,
por që i lashë, moj Kontyllje. –

Kontyllja – Koha e turbull s'i la nj'orë
tët vëllau t'u lej në fron
le pastaj të kishte nge
që t'i lyente shtëpitë. –

Serafina – Edhe prap' gazmore janë. –
Në tryezë pastaj të ulet
fytyrëqelqtë e me shpresë.

Tanushi – Ajri jashtë të bën mirë. –

Serafina – Mbase, po mos ngrihet erë.
Edhe pak e pastaj dalim
gjer te Shega, o Tanush. –
Dhe më vonë të dy dolën,
se edhe dielli ngrohte akoma.
Por sa mbërritën te shtëpia

e Olimbisë së shkretë
 na i arriti tek vidhi
 një kalorës që me nxit
 i jep Tanushit një letër.
 Trimi e hap e flet me vete.
 Fina shkon ndaj kryqit mbudhë
 dhe sheh Ndonin qorr me diell
 çerevdekur, zorrëthatë,
 q'ishte pështetur për kryqi.
 Serafina – Ndon qyqar, mos je sëmurë? –
 Ndoni – Po dëgjoj zërin gazmor
 të Finës, zonjës së Drinit!
 Tashti ty po të kujtoja,
 se më thanë q'ishe kthyer. –
 Shapkën nxjerr prej ballit dyllë
 ta nderojë. E ajo i qaset
 edhe i hedh ca aspra brenda.
 Ndoni – Zonjë, mos dil kësaj ane
 se mos hije e trimit mjerë,
 n'atë dashuri shtërngatë
 t'i rrëmben të gjitha hiret! –
 I k shpejt Fina, se e ndien gjallë
 plagën e fshehtë në zemër,
 dhe s'mund truri t'ia përlijë
 atë faj dhe pas martesës.
 Serafina – Villa Tanush, ç'mynxyrë e madhe
 ballë e zemër ty t'i ngrysi? –
 Tanushi – Mbase që sonte do nisem.
 Thonë se n'Himarë duan
 armëpushimin me turqit.
 Arbri tjetër, në mes ndarë,¹⁾
 mbetet vetëm në betejë! –

Serafina – Në shtëpi shpejt le të kthejmë! –
Dhe sikush me zemrën gjetkë,
veç e veç të dy u kthyen.

III

Buzëprerë, zemërbrejtur,
sapo hyri ajo pyeti:
Serafina – Si m'është' djali, o Mili?
Milia – Ethet prapë na e zunë;
po dhe drithërima e nganë:
andaj dërguam për mjekun. –
Serafina shkul gërshetat
duke qarë për vetveten:
«Dhe ndaj barit q'është bar
e që shpejt në kashtë kthehet,
gjithëmonë e thotë fjalën
me të drejtë kush e bëri.»
«Edhe kundër diellit vetë
q'e ka bërë, duhet ngritur!»
(*Serafinës* na i thotë
që brenda zemrës një zë).
Dhe si e marrë ajo na sulet
për te djepi i djalthit saj:
Serafina – Hektor, korba! Syri akull!
Hektor, birth, më shih, jam mëma!
Hektor, birth, mos më rënko,
se më bën të vdes rënkimi
që të del nga zemërza! –
Kontyllija – Gjersa nga vreshta të vijë
mjeku, shko në Lopsaj, thuaj
që të vijë zot Trifoni

t'i këndojë ungjillin djalthit,
 se si thonë, ka shëruar³)
 ai mjaft njerëz këtu. —
 Shërbestarja me ngut niset.
 Pastaj u ndezën hyllnerët
 dhe hyn prifti me ungjill;
 e zbuloi djalthin në djep
 dhe gjithë ranë më gjunjë.
 Prapa shtratit e gërmuqur
 qante e ëma, edhe dukej
 si një Magdalenë e re
 gjunjëzuar para Krishtit.
 Lutjet ia terën dhe lotët.
Milila — Duke heshtur lehtësohet
 djalthi, zonjë Serafinë. —
 Dhe kur drita zbardhte jashtë
 gjoni qetohet në kopësht
 dhe me të qetohet djepi.
Serafina — Birth, o birth, e zeza unë!
 Më Hektor unë s'do kem!
 Dhe më gjyshes së tij nipthin
 unë e shkreta s'do t'ia kthej! —
 Si tha mjeku, sapo gdihet
 vakën një kazan me ujë
 edhe djalthin ëmtë e mëmë
 brenda në kazan e futën.
 Pas çdo zhytje, si të dilte
 që prej ujit, djalthi ngrihej,
 shtynte duart që e mbanin,
 çonte krahët edhe barkun,
 edhe dukej se shpëtoi.
 Si një e marrë na e puth e ëma.

Shpejt e fshinë, e pështollën.
Por sërish faqet iu zbehnë.
Gratë fqinje sa vesh morën
prap' e mbulojnë shtëpinë
tok me llafe mejtimzbrazta.
Mëmëshkreta i mkon me lugë
lëng bajamesh me sheqer:
djalthi sa e shihte lugën
gojzën e zbehtë e hapte:
prapë dukej se shpëtoi.
Por në mbrëmje atë gojzë
përgjithnjë ia mbylli jetës.
Përsëri e futën n'ujë,
por q'andej doli si leckë.
Serafina – Ju lutem, na lini vetëm:
kaqë njerëz ma friksojnë
edhe po ma kapin drithmat.
Hektor, birth, qiriri yt
të më shuhet në gji mua!
I rri, Mili, afër sonte:
unë e veshur po pështetem:
sonte djalthi po na ikën!
Djalthi në djep po dihaste,
duke u shkrirë gjithë natën.
Më të nesërmen kabanët
e përcillnin si një flutur.
Edhe e emta e qaj me ligje:
Kontyllja – Bir gjigandësh, o Hektor.)
atje ku tashti më je,
Arbrin tënë fatmizor
kujto që pate atdhe
dhe gjithmonë atë ti ke!»

KËNGA E PESTË

Artë, 1468

U zhduk dh'ajo q'atë ditë¹⁾
e tash hije grash të rralla
shiheshin n'udhët me diell.
Një rrahallë tok me djersë²⁾
u lidh brenda dhe për fronit,
edhe pse desh të kthehej malesh,
në shtëpinë ku do gjente
të dy bijtë më të rritur,
thirrur dhe kthyer prej shkollët.
Por ethja shumë i rëndohej
e gjithnjë e dobësonte
aq sa gjumë s'gjente natën.
Nganjëherë na takonte
që e lodhur nga lëngimi,
shpresëdrojtur afërohej
në pasqyrë; e shih të tretur
zverkun edhe kriznë e hundës,
ballin-çerdhe sqojtësie.
Po na e mbyste kolla e i zbehej
dhe fytyra në pasqyrë.
E kryet aq të rënduar
në të shkretin shtrat i binte.
Ish fund maji e ajo harronte

të shih jashtë lulëzimin.
 Mjekët shpresë asaj i jepnin
 po të bënte banja verës.
 Andaj shpesh asaj tek ndiente
 ushëtimë fjalësh jashtë,
 i përfytyrohej deti
 valëqetë e shihte vashat
 tek dorë për dorë u zhytnin
 e puhija ua përkëdhelte
 gjiret n'ujrat kaltëroshe,
 e nga goja ua merrte këngën;
 «O ti det i mirë i jonë!»
 Por, eh, djersët i rridhnin krahësh
 dhe, drithmuar drithërimash,
 thëngjilleri kurdo i ndezur,³⁾
 në një kënd na e tërhiqte.
 Por, sërish, prej afshit nxehtë
 të verës shëronjëse t'afërt
 shpresë kishte. Kur erdh vapa
 e kunata dil veriut
 me qëndismën mëngjes herët
 sepse e donte ajo puhizën,
 edhe ndër mend kurdoherë
 kishte sirkun q'e këndellte
 gruan lakmonjëse e krenare,
 ose shtrushnë e avëlmendit...⁴⁾
 Në qershor na i erdhi lajmi
 q'atë mbrëmje a të nesërmen
 vinte i shoqi. Ditën tjetër
 Arbri gjithë kish të kremten
 për kujtim të Skënderbeut.
 Nj'erë perëndimi veshët


ia shurdhonte dhe shtëpitë
shungullonin. Tej, rreth vatrës
ku na u piquin zogj më hell
flit Kontyllja me kallzoret:
Kontyllja: – Pritni, motra! Shpejt, moj
Betë,

se tashti kazani u ftoh,
m'ia u hidh në pjata grurët,
merr u jep ti edhe mblatë
për përsheptjen e tim ungji,
mbretit Gjergj të Kastriotve! –
Dhe nga vendi anembanë
nisenë kambanat përzishëm:
dhe fshatrat, fumbur në natë,
zisë i bënin ushëtimë.
Kur, papritur, hapet dera
dhe me vrundullimë t'ërës,
që na i muarr zjarrit flakën
edhe hyllnerëve dritën,
u hodh princesha e Drinit,
në mes tyre:

Serafina: – Deh, më flitni,
që të paktën sot kambanat
mos t'i dëgjoj se më shuan! –
Dhe më t'afërmes që s'kishte
mëmë, as motër, i kap dorën,
ballë dyllë e plot llahtarë.
Dhe të gjitha gratë u ngritën
dhe shikojnë. E njëra i thotë:
«Ylli ynë, bija jonë,
bëj ti zemër!»
Serafina – Zemrën ne

PERMBAJTJA

| | |
|--|-----|
| KRIJIMTARIA E JERONIM DE RADËS..... | 3 |
| KËNGËT E MILOSAOS | 63 |
| ODISEU (fragmente nga poema) | 151 |
| «KRUTANI I MËRGUAR.» POEMË | 177 |
| LIRIKA | 217 |
| PËRSIATJE | 222 |
| SERAFIN TOPIA (Një pasqyrë jete njerëzore) | 225 |



Devetë e neve rrëthimisim shprehjetinës qiellore.
rrëthimisim dubë shprehjetinës kokërrizate yjeve.
hëna përhapte shprehjetinës qumështore
e ulet derdallëj lehtësisht pyjeve. MHS